




PROFILI KOMBËTAR I MENAXHIMIT TË KIMIKATEVE NË SHQIPËRI

Përditësim,
i vitit
2012



DEDIKIM I VEÇANTË:

Ky publikim u përgatit në vigjilje të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë

FALENDERIM:

Ky rishikim i Profilit Kombëtar të Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri u përgatit në kuadër të projektit “Forcimi i Kapaciteteve për Zbatimin e Qasjes Ndërkombëtare Strategjike (SAICM) për Menaxhimin e Kimikateve në Shqipëri”, i cili u zbatua nga Instituti i Shëndetit Publik, me asistencën teknike të UNITAR, Gjenevë, dhe mbështetjen financiare të Fondit të Nisjes së Shpejtë të SAICM.

Ky botim i Profilit Kombëtar të Menaxhimit të Kimikateve u realizua me pjesëmarrjen dhe kontributin aktiv të përfaqësuesve nga ministritë, institucionet dhe organizatat, universitetet, shoqatat jo-fitimprurëse dhe industria, me ndihmesën e Prof. Dr. Herman de Kruijf dhe të Zj. Yuri Saito, nga UNITAR

KOORDINATORE E PROJEKTIT:

Dr. Lindita Tafaj (Hajri)

ltafaj@chemicals.al, linda_tafaj@yahoo.com

Tel. +35542363066

Adresa: Instituti i Shëndetit Publik, Rr.Aleksandër Moisiu, Nr. 80, Tiranë

www.chemicals.al



unitar

United Nations Institute for Training and Research

PROFILI KOMBËTAR I MENAXHIMIT TË KIMIKATEVE Në SHQIPËRI

Përditësim i vitit

2012

TIRANË
Nëntor 2012

Përmbajtja e lëndës:

HYRJE	9
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	11
KAPITULLI 1: INFORMACION KOMBËTAR I PËRGJITHSHËM	28
1.1 Karakteristikat gjeografike dhe natyrale	28
1.2 Demografia.....	31
1.3 Struktura politike.....	33
1.4 Sektorët e zhvillimit	35
1.5 Shkarkimet e sektorëve kryesorë të ekonomisë	43
1.6 Vlerësimi	46
KAPITULLI 2: PRODHIMI, IMPORTI, EKSPORTI, RUAJTJA, TRANSPORTI, PËRDORIMI DHE ASGJËSIMI I KIMIKATEVE	47
2.1 Informacion i përgjithshëm	47
2.2 Prodhimi, importi dhe eksporti i kimikateve	48
2.2.1 Kimikatet industriale.....	48
2.1.2. Kimikatet për bujqësi.....	50
2.1.3 Biocidet për përdorim në shëndet publik	51
2.2 Përdorimi i kimikateve sipas kategorive	51
2.2.1 Kimikatet industriale.....	51
2.2.2 Kimikatet për bujqësi.....	53
2.2.3 Biocidet për përdorim në shëndetin publik.....	54
2.3 Ruajtja e kimikateve	55
2.3.1 Kimikatet industriale.....	55
2.3.2 Kimikatet për bujqësi.....	55
2.3.3 Biocidet për përdorim në shëndetin publik.....	56
2.4 Transporti i Kimikateve	56
2.5. Menaxhimi i mbetjeve kimike	57
2.6 Kimikatet e prodhuara në mënyrë të paqëllimshme.....	63
2.7 Vlerësimi	63
KAPITULLI 3: INSTRUMENTAT LIGJORE DHE MEKANIZMAT JO-RREGULLATORE PËR MENAXHIMIN E CIKLIT TË JETËS SË KIMIKATEVE	67
3.1 Përmbledhje e instrumentave ligjore që adresojnë menaxhimin e kimikateve	67
3.2 Detaje shtesë mbi instrumentat ligjore kryesorë që lidhen me kimikatet	85

3.3	Kuadri ligjor ekzistues sipas kategorisë së përdorimit, që i adresohet llojeve të kimikateve nga prodhimi/ importi deri tek asgjësimi	91
3.4	Përmbledhje e procedurave kryesore administrative për kontrollin e kimikateve	92
3.4.1	Pesticidet	92
3.4.2	Plehrat kimike	93
3.4.3	Substancat kimike & përzierjet të rregulluara nga REACH dhe CLP	94
3.4.4	Produktet Kozmetike	96
3.4.5	Detergjentët.....	96
3.4.6	Farmaceutikët.....	97
3.4.7	Produkte të Naftës.....	97
3.5	Mekanizmat jo-rregullatore për menaxhimin e kimikateve	98
3.6	Instrumentat ligjore lidhur me aktivitetet që kanë ndikim në menaxhimin e kimikateve.....	99
3.7	Komente/ analiza.....	103
KAPITULLI 4: MINISTRITË, AGJENCITË DHE INSTITUCIONET E TJERA QË MENAXHOJNË KIMIKATET		105
4.1	Përgjegjësitë e ministrive të ndryshme shtetërore, agjencive dhe institucioneve të tjera	105
4.2	Përshkrim i autoriteteve ministrore dhe mandateve	105
4.3	Komente / rekomandime	112
KAPITULLI 5: AKTIVITETET PÛRKATËSE TË INDUSTRI SË, GRUPET E INTERESIT PUBLIK, ORGANIZATAT PROFESIONALE DHE SEKTORI I KËRKIMIT		115
5.1	Përshkrim i organizatave dhe programeve jo-qeveritare.....	115
5.1.1	Përshkrim i organizatave dhe aktiviteteve të industrisë.....	115
5.1.2	Organizatat jofitimprurese (OJF) në Shqipëri.....	116
5.1.3	Sektori i kërkimit shkencor	119
5.2	Përmbledhje e ekspertizës jashtë sistemit qeveritar	123
5.3	Vlerësimi	131
KAPITULLI 6: KOMISIONET NDËRMINISTRORE DHE MEKANIZMAT KOORDINUES		133
6.1	Komisionet ndër-ministrore dhe koordinimi.....	133
6.2	Përshkrime të Komisioneve Ndër-Ministrore dhe i Mekanizmave Koordinuese	133
6.2.1	Komisioni shtetëror i regjistrimit të PMB-ve (KShRPMB)	133
6.2.2	Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile	137
6.2.3	Komisioni Teknik Këshillimor për Emergjencat Civile	137
6.2.4	Komiteti Ndërministror i Menaxhimit të Mbetjeve	138
6.2.5	Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.....	138
6.2.6	Autoriteti kompetent i COMAH (Kontrolli i Rreziqeve nga Aksidentet Madhore)	139
6.2.7	Komisioni Qeveritar për problemet ujore me vendet fqinje	139

6.2.8	Komiteti për implementimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (2005)	140
6.3	Përshkrim i mekanizmave për marrjen e të dhënave nga OJQ-të	140
6.4.	Vlerësimi	140
KAPITULLI 7: MENAXHIMI, AKSESI DHE PËRDORIMI INFORMACIONIT		142
7.1	Disponueshmëria e përgjithshme e të dhënave për menaxhimin e kimikateve....	142
7.2	Burimi i të dhënave kombëtare, aksesit dhe formati i tyre.....	143
7.3	Procedurat për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave kombëtare/ lokale	145
7.4	Disponueshmëria e të dhënave dhe literaturës ndërkombëtare	147
7.5	Sistemet kombëtare të shkëmbimit të të dhënave dhe kapacitetet e teknologjisë së informacionit (IT)	149
7.6	Vlerësimi	151
KAPITULLI 8: INFRASTRUKTURA TEKNIKE		154
8.1	Përmbledhje e infrastrukturës laboratorike	154
8.2	Fusha të tjera të infrastrukturës teknike	154
8.2.1	Laboratorët në varësi të ministrive	161
8.2.2	Laboratorët kërkimorë-shkencorë të universiteteve (publike dhe jopublike)	163
8.3	Vlerësimi i menaxhimit të infrastrukturës.....	165
8.3.1.	Menaxhimi i cilësisë	165
8.3.2	Menaxhimi teknik	166
KAPITULLI 9: PARANDALIMI, GATISHMËRIA DHE PËRGJIGJA NDAJ EMERGJENCAVE KIMIKE.		168
9.1.	Planifikimi i emergjencave kimike.....	168
9.2	Përgjigja ndaj incidenteve kimike	178
9.3	Vlerësimi dhe ndjekja e një incidenti kimik.....	180
9.4	Komente/Analiza.....	181
KAPITULLI 10: NDËRGJEGJËSIMI/ TË KUPTUARIT E PUNONJËSVE DHE PUBLIKUT; TRAJNIMI DHE EDUKIMI I GRUPEVE TË SYNUARA DHE SPECIALISTËVE		184
10.1	Ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit e çështjeve për sigurinë ndaj kimikateve, institucionet e përfshira.....	185
10.2	Edukimi dhe trajnimi për menaxhimin e shëndetshëm të kimikateve dhe mbetjeve	189
10.3	Vlerësimi	190
KAPITULLI 11: BASHKËPUNIMI DHE PËRFSHIRJA NË ORGANIZATAT, ORGANIZMAT DHE MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE.....		193
11.1	Bashkëpunimi dhe përfshirja me organizatat ndërkombëtare, organet e ndryshme dhe marrëveshjet.	193

11.2	Pjesëmarrje në projekte të caktuara të Asistencës Teknike dhe të Zhvillimit ..	198
11.3	Vlerësimi	203
KAPITULLI 12: BURIMET EKZISTUESE DHE NEVOJAT PËR MENAXHIMIN E KIMIKATEVE 205		
12.1	Burimet ekzistuese në ministritë/ institucionet për menaxhimin e kimikateve	205
12.2	Burimet e nevojshëm nga institucionet qeveritare për të plotësuar përgjegjësitë lidhur me menaxhimin e kimikateve.....	211
12.3	Burimet ekzistuese për menaxhimin e kimikateve në organizatat jo-qeveritare	215
12.4	Burimet nga aktivitetet e asistencës për zhvillim	216
12.5	Vlerësimi	220
KAPITULLI 13: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME224		
Shtojca 1:	Raportet dhe dokumentat kombëtare për aspekte të ndryshme të menaxhimit të kimikateve	229
Shtojca 2:	Grupi i punës ndërsektorial i SAICM	230
Shtojca 3:	Aktorët kombëtarë për fushat e punës të listuara në tabelën A në Planin Global të Veprimit të SAICM.....	233
Shtojca 4:	Shpjegues i shkurtimeve.....	236

HYRJE

Kuadri ndërkombëtar i politikave të mirë-menaxhimit të kimikateve

Kimikatet kanë sjellë një ndryshim të madh të cilësisë së jetës me përdorimin e tyre në industri, bujqësi, komunikim etj. Ndërkohë, është gjithashtu i njohur fakti se çdo kimikat mund të ketë efekte të dëmshme në varësi të vetive që ka dhe ekspozimit ndaj tij. Kjo është arsyeja që përpjekjet ndërkombëtare dhe kombëtare janë orientuar drejt kontrollit nëpërmjet mirë-menaxhimit të kimikateve gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor; duke gjetur alternativa të tjera më pak të rrezikshme për t'u përdorur, duke ulur ekspozimin ndaj tyre, duke përmirësuar komunikimin e rrezikut, etj.

Qasja Strategjike Ndërkombëtare ndaj Menaxhimit të Kimikateve (SAICM) u mandatua nga UNEP-i dhe u nxit nga Samiti Botëror për Zhvillimin e Qëndrueshëm i mbajtur në Johannesburg në 2002 si dhe Samiti Botëror në New York në Shtator të 2005. Ajo filloi si një iniciativë e komitetit shumëpalësh të rigrupuar nga UNEP-i, IFC-ja dhe IOMC-ja. Termi 'Qasje Strategjike ndaj Menaxhimit të Kimikateve' (SAICM) u shfaq dhe u përdor në Konferencën Ndërkombëtare të Menaxhimit të Kimikateve në Dubai në 2006. SAICM është një strategji gjithëpërfshirëse e menaxhimit të kimikateve në nivel global.

Qëllimi kryesor i mirë-menaxhimit të kimikateve është ulja e efekteve negative të kimikateve në shëndetin e njeriut dhe në mjedis. Arritja e pikësnyimit të Samitit të Johannesburgut që deri në vitin 2020 kimikatet të përdoren në mënyra të tilla që të çojnë drejt minimizimit të efekteve të dëmshme të tyre në shëndetin njerëzor dhe në mjedis ka nevojë për një përfshirje të gjerë të të gjithë aktorëve, që në një mënyrë apo një tjetër luajnë rol në hallka të ndryshme të menaxhimit të kimikateve.

Ky botim është rishikimi dhe përditësimi i parë i Profilit Kombëtar të Menaxhimit të Kimikateve (botuar në 2006 nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave). Ai është përgatitur në kuadrin e projektit "Forcimi i kapaciteteve për implementimin e Qasjes Strategjike Ndërkombëtare të Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri", 2011-2013, mbështetur nga Programi i Startimit të Shpejtë i SAICM, me Agjenci Ekzekutive Institutin e Kombeve të Bashkuara për Trajnim dhe Kërkim (UNITAR) dhe i zbatuar nga Instituti i Shëndetit Publik (IShP), Tiranë.

Objektivat Kombëtarë dhe rezultatet e pritshëm nga përgatitja e profilit kombëtar

Si një dokument "i gjallë", Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve pritet të prezantojë situatën konkrete të menaxhimit të kimikateve në vend. Nga viti 1996, kur u përgatit profili i parë, kanë ndryshuar disa aspekte të menaxhimit të kimikateve: është përgatitur dhe miratuar legjislacion i ri, disa institucione kanë ndryshuar varësitë e tyre, institucione të tjera janë krijuar; ndryshime këto të cilat duheshin reflektuar në tërësi. Objektivat dhe rezultatet e pritshme para se të fillohej puna për rishikimin e profilit ishin:

- Të sigurohej informacion për të gjitha aspektet e menaxhimit të kimikateve në vend; t'u jepej ndihmesë profesionistëve dhe palëve të tjera të interesuara me një informacion gjithëpërfshirës për menaxhimin kombëtar të kimikateve;
- Të krijoheshin lehtësira për shkëmbimin e informacionit midis palëve të ndryshme të interesuara;
- Të kuptoheshin dhe identifikoheshin nevojat prioritare për implementimin e SAICM;

- Të nxitej dhe të shtohet bashkëpunimi midis palëve të interesuara;
- Të sigurohet një bazë për mbrojtjen e përmirësuar të punonjësve, të publikut dhe të mjedisit;
- Të sigurohet një bazë për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rrezikun e kimikateve ndaj punëtorëve, grupeve të rrezikuara të popullsisë si dhe ndaj publikut të gjerë;
- Të sigurohet një bazë për identifikimin e nevojave dhe prioriteteve për asistencë teknike dhe financiare;
- Të përgatitet një bazë për një Plan për Zbatimin e SAICM;
- Të lehtësohet komunikimi ndërmjet vendeve për çështje relevante.

Proçesi i rishikimit të Profilit Kombëtar të Menaxhimit të Kimikateve në Shqipëri

Parimet që kanë udhëhequr proçesin e rishikimit të Profilit Kombëtar kanë qenë qasja e kujdesshme dhe përqasja përfshirëse, sipas së cilës të gjitha palët e përfshira në menaxhimin e kimikateve në vend kishin mundësinë të kontribuonin në proçesin e rishikimit të profilit.

Proçesi i përgatitjes për rishikimin e Profili Kombëtar u koordinua nga ekipi i zbatimit të projektit SAICM në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët vendas dhe UNITAR. Me fillimin e projektit në 15 Mars 2012, të gjitha institucionet e njohura dhe aktorët e interesuar në menaxhimin e kimikateve u kërkuar zyrtarisht të emëronin përfaqësuesit e tyre për zbatimin e projektit.

Struktura, metodologjia, proçesi dhe pjesëmarrja për përgatitjen e Profilit u diskutuan në Takimin e Nisjes së Projektit, i cili u mbajt në 24-25 Mars 2011 në Tiranë me pjesëmarrjen e UNITAR dhe në një mbledhje *ad internim* mbajtur në 28 Prill 2011. Sipas diskutimeve në lidhje me metodologjinë e përdorur, burimet e informacionit si dhe mënyrat e mbledhjes së të dhënave, u vendos që rishikimi i Profilit do të bazohet në Dokumentin Udhëzues- Për Përgatitjen e Profilit Kombëtar për Vlerësimin e Nevojave të Infrastrukturës dhe Kapaciteteve, botimi i dytë, draft 31.3.2011, i UNITAR dhe IOMC (Programi Ndër-Organizativ për Mirëmenaxhimin e Kimikateve).

Bazuar në strukturën e profilit të sugjeruar në metodologjinë e UNITAR/ IOMC, u ngritën grupe pune ku u përfshinë ekspertë dhe pjesëmarrës të tjerë në varësi të fushës së ekspertizës dhe të dijeve. Me qëllim nxitjen dhe vlerësimin e arritjeve të bëra gjatë përgatitjes së draftit të parë të Profilit, u zhvillua një mbledhje tjetër e ndërmjetme më 9 Qershor 2011. Drafti i parë i Profilit u diskutua në takimin e organizuar në 23 Shtator 2011. Gjatë këtij takimi madje edhe para tij çdo pjesëmarrës pati akses në draftin e profilit si dhe në shumë kontribute për profilin të mbledhura deri në këtë mbledhje. Rishikimi formal përfundimtar i Profilit Kombëtar u krye gjatë Takimit për Rishikimin e Progresit të Projektit, zhvilluar në datat 9-10 Shkurt 2012. Në këtë mbledhje u mbledhën informacione të mëtejshme dhe opinione nga pjesëmarrësit si dhe u caktua një afat tjetër për komente apo inpute të tjera, pas së cilit Profili do konsiderohej i miratuar nga institucionet e përfaqësuara në takim dhe institucionet e njoftuar. Proçesi i Rishikimit të Profilit kombëtar ishte në vetvete një eksperiencë e shkëlqyer për këmbimin e informacionit si dhe për rritjen e bashkëpunimit midis palëve të interesuara.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Profili i përditësuar Kombëtar i menaxhimit të kimikateve përbën një dokument të rëndësishëm për Qeverinë Shqiptare, pasi jep një vlerësim të aspekteve ligjore, institucionale, infrastrukturore, teknike të menaxhimit të kimikateve në Shqipëri. Ai u përgatit përmes qasjes përfshirëse, sipas së cilës të gjitha palët e përfshira në menaxhimin e kimikateve në vend patën mundësinë të kontribuonin dhe të parashtronin mendimet e tyre, duke marrë pjesë në procesin e përditësimit të profilit.

INFORMACION KOMBËTAR I PËRGJITHSHËM

Republika e Shqipërisë shtrihet në Europën Juglindore, në perëndim të Gadishullit Ballkanik, dhe laget nga detet Adriatik (bregdet ranor) dhe Jon. Sipërfaqja e Shqipërisë është 28'748 km² nga të cilat 27'398 km² janë tokë dhe 1'350 km² janë sipërfaqe ujore. Në veriperëndim Shqipëria kufizohet me Malin e Zi, në verilindje me Kosovën, në lindje me Maqedoninë, në jug dhe juglindje me Greqinë. Në përgjithësi, elementët klimatikë kanë ndryshime të konsiderueshme në krahina të ndryshme të vendit, veçanërisht temperaturat dhe reshjet. Shqipëria dallohet për sasinë e madhe të reshjeve, të cilat përqëndrohen kryesisht në veri, perëndim dhe jugperëndim, me një vlerë mesatare vjetore 1'430 mm.

Sipas Censurit të zhvilluar në vitin 2011, numri i banorëve ishte rreth 2.8 milion banorë. Pas vitit 1990 popullsia njohu dukuri të reja siç ishte migracioni, që ndikoi mjaft si në strukturën ashtu edhe në ritmet e rritjes së saj. Lëvizja e lirë dhe e pakontrolluar e popullsisë brenda vendit ka ndikuar në ndryshimin e raportit të popullsisë qytetare me atë fshatare.

Sipas të dhënave të INSTAT-it për periudhën 2006-2009 “Tumoret” dhe Dëmtimet e jashtme dhe helmimet” ishin arsyet e dyta dhe të treta të vdekjeve në Shqipëri mbas sëmundjeve të sistemit të qarkullimit të gjakut me rreth 85 dhe 30 vdekje / 100'000 banorë/vit.

Shqipëria ndahet administrativisht në 12 qarqe, 36 rrethe, 374 komuna/bashki.

Sipas të dhënave të INSTAT-it për 2008, industria ka kontribuar me 9.8 % në Prodhimin e Brendshëm Bruto, bujqësia dhe sektori i peshkimit me 18.5% dhe sektori i shërbimeve duke përfshirë tregtinë, hotelet, transportin dhe komunikimin dhe shërbimet e tjera me 50.7%.

Ekonomia Shqiptare bazohet në iniciativën e lirë, ku 80% e produkteve të brendshme vijnë nga sektori privat. Sektori i industrisë ka kontribuar në mënyrë të qëndrueshme me 11% të PBB. Varësia e përhershme e Shqipërisë ndaj nxjerrjes së mineraleve vjen si pasojë e ekzistencës së shumë rezervave që mund të shfrytëzohen për qëllime tregtare. Depozitat e kromit, bakrit dhe nikelit janë hapur prej kohësh, por pajisjet dhe metodat e industrisë së minierave janë tashmë të vjetëruara dhe shumë punime janë braktisur; megjithatë, Shqipëria zë një vend të rëndësishëm në Europë për prodhimin e kromit.

Gjithashtu aktivitete të tjera industriale që operojnë në vendin tonë janë ato të industrisë nxjerrëse të naftës dhe gazit natyror, industria përpunuese, industria e lehtë, industria ushqimore dhe pijeve, prodhimi i çimentos, si dhe metalurgjia.

Bujqësia mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm për ekonominë e vendit. Kontributi i saj është ulur me kalimin e viteve. Familjet që jetojnë në zonat rurale vazhdojnë të kenë peshën më

të madhe në ekonominë e vendit; 46.5% e popullsisë banon në zona rurale, ku bujqësia është aktiviteti kryesor për nxjerrjen e të ardhurave për jetesë.

Shqipëria është e pasur me burime të ndryshme *energjie*, që nga nafta dhe gazi, qymyri dhe karburante fosile të tjera, deri te fuqia hidrike, biomasa natyrore e pyjeve dhe të tjera burime energjie të rinovueshme. Hidro-energja përbën mbi 97% të energjisë elektrike të prodhuar. Aktualisht shfrytëzohen vetëm 30% e burimeve hidrike. Sektori i energjisë kontribuon me afërsisht 10% të PBB.

Periudha tranzitore në Shqipëri gjatë viteve '90 solli mbylljen e shumë ndërmarrjeve industriale dhe minerare. Mbetjet dhe kimikatet e prodhuara gjatë periudhave aktive janë depozituar në kënetë apo magazine, duke krijuar në këto vende zona të ndotura me pasoja negative për mjedisin dhe shëndetin. Shumë familje që kanë lëvizur nga njëri vend në tjetrin janë strehuar në ndërtesat afër apo brenda këtyre zonave të ndotura, duke shkaktuar probleme shëndetësore për shëndetin e njerzve dhe për aktivitetet e menaxhimit të kimikateve në këto zona.

Zhvillimi në sektorin industrial dhe minerar në disa rajone të vendit tonë ka ndikuar në gjenerimin e mbetjeve, sterileve dhe kimikateve të cilat hidhen në vend-depozitime të cilat nuk plotësojnë kushtet mjedisore.

PRODHIMI, IMPORTI, EKSPORTI, RUAJTJA, TRANSPORTI, PËRDORIMI DHE ASGJËSIMI I KIMIKATEVE

Para viteve '90, si rezultat i politikës së prodhimit të çdo gjëje në vend, prodhimi i pesticideve, i plehrave kimike, i sodës, i acidit sulfurik, i glicerinës, etj., kishte një përparësi të veçantë. Periudha pas viteve '90, përveç uljes së prodhimit të industrisë kimike, u shoqërua me shkatërrimin e disa ndërmarrjeve kimike, të cilat u shndërruan në zona të ndotura shumë shqetësuese dhe me risk të lartë për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin rrethues. Në sajë të përpjekjeve të shumta ndërkombëtare dhe kombëtare, një pjesë e mirë e këtyre pikave të nxehta mjedisore tashmë janë rehabilituar, por vazhdon identifikimi dhe veprimi në zona të tjera më pak kritike. Megjithatë, gjatë këtyre viteve një pjesë e industrisë filloi të riaktivizohet, si nëpërmjet privatizimit të objekteve të industrisë së lehtë, asaj të drurit, kimike, mekanike, të disa sektorëve minerare në kariera (gurore), ashtu dhe nëpërmjet dhënies në konçesion të disa minierave të kromit, të bakrit dhe të qymyrit, të disa uzinave të prodhimit të çelikut, ferro-kromit, etj. Sot vendi ynë ka të zhvilluar industrinë e çimentos, pjesërisht atë metalurgjike, industrinë e prodhimit të mallrave të konsumit të gjerë, të cilat kanë nevojë për lëndë të parë e ndihmëse kimike, që kryesisht importohen dhe në pak raste prodhohen, por që kërkojnë treg për eksport, si të O₂, N₂, etj.

Pas viteve '90 nuk ka prodhim të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) në Shqipëri. Importi i PMB është shtuar rëndësishëm sidomos gjatë viteve të fundit. Vetëm PMB të regjistruara mund të importohen dhe të tregtohen. Legjislacioni përkatës është mbështetur në atë Europian.

Përdorimi i PMB është i moderuar; mbas një rënie të përdorimit të PMB në periudhën 2005-2009 me një përdorim mesatar prej rreth 250 ton/vit, tendenca duket të jetë një ngritje në përdorimin e PMB gjatë viteve të fundit. Përdorimi i plehrave ka qëndruar pothuajse në të njëjtat nivele për periudhën 1998-2009, me ndryshime të vogla në strukturën e tyre.

Buxheti për përdorimin e biocideve për kontrollin e dëmtuesve në shëndetin publik është krejtësisht i pamjaftueshëm. Nevojiten gjithashtu materiale manipuluese, veshje dhe pajisje mbrojtëse të punonjësve, etj. Nevojitet një projekt i përbashkët midis MSh, ISHP dhe Bashkive, në kuadër të të cilit të hartohet një program i për **kontrollin e integruar të dëmtuesve** të të gjithë ambienteve publike të qyteteve.

Në vend ka rreth 12'000 gjeneratorë të të gjitha kapaciteteve; vaji i tyre përgjithësisht nuk kontrollohet për përmbajtje PCB për të parandaluar ndotjen.

Nuk ka një sistem të sigurt në vend për administrimin e **mbetjeve të rrezikshme** të prodhuara nga industritë dhe ato shtëpiake. Mbetjet e rrezikshme që gjenerohen nga sektori industrial si dhe nga mbetjet bashkiake depozitohen në vend-depozitime së bashku me mbetjet urbane, duke paraqitur kështu një rrezik të madh për mjedisin dhe shëndetin njerëzor. Në kuadër të përmbushjes së objektivave për një administrim më të mirë të mbetjeve, MMPAU ka hartuar Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010 – 2025, në bashkëpunim me projektin “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor”. Gjeneruesit kryesorë të mbetjeve industriale kanë qenë industria kimike, metalurgjike, minerare, e naftës, industria e lehtë, ushqimore, kimikateve e përdorura për pleherime etj. Gjatë viteve 2008-2009 rreth 27'780 ton mbetje të rrezikshme u eksportuan në Suedi për asgjësim. Ky projekt u realizua sipas marrëveshjes teknike ndërmjet Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Europian (OSBE) në Shqipëri, Ministrisë së Mbrojtjes dhe një kompanie suedeze. Është planifikuar që 83 ton të tjera kimikatesh të rrezikshme të Forcave të Armatosura të shkatërrohen nga një kompani e kontraktuar nga OSBE në Prill 2012.

Instrumentet ekonomikë për administrimin e mbetjeve janë të pakta dhe me vlerë të pakonsiderueshme. Nuk ka në vend ndonjë impiant industrial apo landfill për trajtimin e mbetjeve të tjera të përcaktuara dhe klasifikuara sipas udhëzimeve të Konventës së Bazelit. Mbetet ende problem mbledhja dhe shpërndarja e informacionit për sasi të dhe llojet e mbetjeve industriale të reja që gjenerohen nga aktiviteti i subjekteve industriale të licensuara pas vitit 1992.

Një nga objektivat e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010 – 2025 dhe projektit “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor” është edhe menaxhimi i mirë i mbetjeve nëpërmjet ndërtimit të disa vend-depozitimeve të reja të mbetjeve në përputhje me standardet mjedisore në disa rajone.

Aktivitetet e riciklimit janë ende në fillimet e tyre dhe varen nga disponueshmëria e materialeve të riciklueshme me një cilësi të mirë. Në shumicën e rasteve industria e riciklimit varet nga lëndët e para të riciklueshme që importohen në Shqipëri. Mbetet problem mungesa e ndarjes së mbetjeve që në burim. Grumbulluesit individualë dhe kompanitë hasin vështirësi në gjetjen e mbetjeve të pastra dhe të ndara. Pjesa më e madhe e mbetjeve të riciklueshme vjen nga mbetjet urbane, dhe pjesërisht nga sektori industrial. Për momentin, sektori i riciklimit të metalit është më i zhvilluari. Për të mbajtur nën kontroll mbetjet që importohen për qëllim riciklimi është miratuar “Lista e Gjelbër”.

Ekziston një politikë dominuese dhe e përhapur e hapjes së gropave dhe e grumbullimit të mbetjeve në to. Instrumentet ekonomike për administrimin e mbetjeve janë të pakta dhe me vlerë të pakonsiderueshme.

Në magazinat e sistemit ekonomikë ndodhen rreth 130 ton kimikatesh industriale dhe laboratorike të përdorura. Në 2010 rreth 90 ton kimikatesh u ripaketuan dhe u hoqën nga kjo magazinë dhe u dërguan në Gjermani, Greqi, dhe Belgjikë. Kostot e pastrimit ishin rreth

476'000 USD dhe kjo u financua nga Qeveria e Hollandës, e Shqipërisë dhe nga OSBE. Është e nevojshme një zgjidhje e qëndrueshme për problematikën e kimikateve të vjetër.

Gjatë 10 viteve të fundit është bërë një punë shumë e madhe nga MMPAU për identifikimin e donatorëve dhe mobilizimin e fondeve për identifikimin, prioritizimin, kryerjen e studimeve të realizueshmërisë për pastrimin e vatrave të ndotura problematike në vend. Zbatimi i projektit “Rehabilitimi i zonës së nxehtë të Porto Romanos” ka qenë përgjegjësi direkte e MMPAU, e cila me mbështetjen e Bankës Botërore realizoi pastrimin dhe kthimin e 78'000m² sipërfaqe të ndotur në tërësisht të pastra. Zbatimi i këtij projekti me vlerë 5 milion USD, të dhuruara nga një grant i Qeverisë Hollandeze, bëri të mundur rehabilitimin e 3 pikave të nxehta të kësaj zone, punimet e te cilës nisën në pranverë të vitit 2010 dhe përfunduan në qershor 2011. Një nga pikat e nxehta mjedisore të identifikuar në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve në vendet e Ballkanit Perëndimor për t’iu adresuar problemeve mjedisore përmes rehabilitimit të pikave të nxehta mjedisore me prioritet të lartë” në vendin tonë ishte stacioni trenit i Bajzës në Shkodër. Në vazhde të përpjekjeve të MMPAU për adresimin e problematikës së vatrave të ndotura mjedisore, ka përfunduar në vitin 2011 zbatimi i projektit të MMPAU dhe PNUD “Identifikimi dhe prioritizimi i pikave të nxehta mjedisore në Shqipëri” me vlerë rreth 1.3 milion USD, financuar nga Qeveria e Hollandës. Ky projekt asistoi Qeverinë Shqiptare për të arritur objektivat e saj afat-mesme lidhur me rehabilitimin e zonave të ndotura për eliminimin e materialeve toksike brenda standardeve bazë të sigurisë. Në kuadër të këtij projekti, përfundoi në vitin 2011 «Studimi paraprak mjedisor i 35 pikave të nxehta mjedisore në Shqipëri». Ky studim ka përcaktuar një listë të shkurtër të 14 hot spoteve prioritare të cilat kanë nevoja emergjente për ndërhyrje rehabilituese.

Përgjegjësia për ndotjen është një çështje shumë e rëndësishme lidhur me pastrimin e zonave të ndotura dhe privatizimin e tyre. Nuk ka një legjislacion specifik për përgjegjësinë për ndotjen industriale të mëparshme dhe nuk është e qartë se kush duhet të paguajë për pastrimin.

Në të gjithë vendin, me përjashtim të ndonjë rasti sporadik, janë të pranishëm hot-spote të rinj në formën e shesh-depozitimeve të cilat janë jashtë kushteve higjieno-sanitare e mjedisore e për fat të keq pranë lumenjve e përrenjeve. Gjithashtu problem përbëjnë edhe shkarkimet e industrive aktuale. Mungesa e monitorimit periodik nga kompanitë private apo nga institucionet shtetërore dhe e kontrollit të mjaftueshëm përbëjnë premise për krijimin e hot-spoteve të reja. Në këto kushte duhet të rritet përgjegjësia e strukturave shtetërore jo vetëm në evidentimin, monitorimin si fazë parandaluese, por edhe në nxitjen e politikave miqësore me mjedisin, si “Zhvillimi i qëndrueshëm”, deri tek zbatimi i parimit “*Ndotësi pagan*”.

Strukturat vendore duhet të ndërhyjnë nëpërmjet planeve e programeve vendore të administrimit të mjedisit urban, për të mos lejuar urbanizimin e zonave të tilla, që mund të jenë përcaktuar si hot-spote apo që mund të kenë tendencën për të qenë të tilla.

Inventari i parë i **NOQ** të prodhuar në mënyrë të paqëllimshme në Shqipëri është bërë në kuadër të punës së kryer për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimt për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e NOQ, financuar nga GEF me UNDP si agjenci zbatuese dhe bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare, gjatë periudhës 2004-2006. Ky inventar u përgatit në përputhje me Manualin e UNEP për Identifikimin dhe Vlerësimin Sasior të Shkarkimeve të Dioksinave dhe Furaneve. Djegia e pakontrolluar rezultoi burimi kryesor i shkarkimeve në ajër të PCDD/F të çliruara në Shqipëri për vitin 2004, duke zënë 73.5% të totalit të shkarkimeve. Në kategorinë e proceseve të djegieve të pakontrolluara ishin marrë në shqyrtim vetëm djegia e mbetjeve urbane dhe zjarret aksidentale. Djegia e mbeturinave spitalore ishte burimi i dytë më i madh i shkarkimeve, duke zënë 23.8% të totalit të shkarkimeve të PCDD/F. Shkarkimet e

sektorit të transportit duket se kontribuonin me 5.6% në shkarkimet totale të PCDD/F në ajër. Shkarkimet nga kategoritë e tjera rezultuan të parëndësishme. Si përgjigje e rezultateve alarmante të inventarizimit të kryer, ku u vu re një kontribut i rëndësishëm i djegies së mbeturinave spitalore në emisionin e përgjithshëm të dioksinave e furaneve, u miratua nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Shëndetësisë rregullorja Nr. 6, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.

INSTRUMENTAT LIGJORE DHE MEKANIZMAT JO-REGULLATORE PËR MENAXHIMIN E CIKLIT TË JETËS SË KIMIKATEVE

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar me ligj Konventën e Roterdamit, Konventën e Bazelit dhe të Stokholmit. Ligjet përkatës përforcojnë nevojën e krijimit të Zyrës së Kimikateve, e cila do të realizonte përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto konventa, në të cilat vendi është palë.

Kuadri ligjor për kimikatet dhe substancat e rrezikshme egziston, megjithëse është pjesërisht në linjë me legjislacionin Europian, REACH dhe CLP.

Përsa i përket përafrimit të legjislacionit kombëtar me të drejtën mjedisore europiane, sipas iniciativave ligjore të parashikuara në PKVMSA 2012-2015 dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 9108, dt.17.7.2003 “ Për substancat dhe preparatet kimike”, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ka lëshuar disa akte ligjore të cilët do të transpozojnë disa prej direktivave të BE-së për kimikatet; 10 prej tyre janë aprovuar së afërmi ndërsa të tjerët janë në fazën përfundimtare dhe parashikohet të aprovohen brenda 2013.

Në vazhden e përgatitjes së legjislacionit për kimikatet, MMPAU është mbështetur nga projekti i BE “ Forcimi i Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri, SELEA” IPA 2010.

Kontrolli i lëndëve të rrezikshme mbulohet kryesisht nëpërmjet konventave përkatëse ndërkombëtare, por transpozimi i mëtejshëm i legjislacionit europian është i nevojshëm. Së bashku me këto, mungon dhe informacioni i nevojshëm për masat e sigurisë dhe mbrojtjes nga këto lloj kimikatesh.

Detyrimi i zbatimit të legjislacionit në lidhje me identifikimin e operatorëve industrialë që prodhojnë, ruajnë, importojnë dhe tregtojnë kimikate është relativisht i ulët. Forcimi i kapaciteteve për inspektorët sanitarë, mjedisorë, të sigurisë në punë dhe punonjësit e doganave mbete një prioritet. *Zhvillimi dhe zbatimi i procedurave në lidhje me importin dhe eksportin e kimikateve dhe shkatërrimin e mbetjeve të tyre sipas kërkesave të Konventave të Roterdamit, Stokholmit dhe Bazelit duhet të konsiderohen një prioritet.*

Aktivitetet përkatëse të industrisë, grupet e interesit publik, organet profesionale dhe sektori i kërkimit

Bashkëpunimi mes organeve qeveritare dhe sektorëve jo-qeveritare për probleme mjedisore në përgjithësi ka konsistuar në konsultime me aktorët e interesuar gjatë procesit të rishikimit të legjislacionit, strategjive dhe planeve kombëtare si dhe raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Deri më tani politikat qeveritare kanë qenë relativisht favorizuese për të marrë informacion nga OJF kombëtare; ato janë më favorizuese për të përdorur ekspertizat dhe përvojat e OJF ndërkombëtare.

Janë shpesh OJF që kanë bërë lobime pranë organizmave të ndryshëm vendim marrës në vendin tonë sidomos në lidhje me legjislacionin mjedisor dhe kohët e fundit edhe për kimikatet, sidomos ata të rrezikshëm. Roli i OJF në informimin e publikut rreth rrezikut të kimikateve është i dukshëm. Nëpërmjet publikimeve të gazetave, posterave, fushatave ndërgjegjësuere, emisioneve televizive ato jo vetëm informojnë publikun për rreziqet e mundshme por mbajnë qëndrime aktive në debate televizive, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe pranë universiteteve. Përfshirja aktive e OJF në debatet publike të organizuara për prezantimin e projekteve të ndryshëm dhe ndikimin e tyre në mjedis ka ndikuar mjaft pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së realizimit të këtyre projekteve nëpërmjet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të ngritura nga OJF, duke ndikuar njëkohësisht edhe në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të autoriteteve drejtuese për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe vlerësimin me seriozitet të aktiviteve me ndikim në mjedis.

Iniciativat vullnetare të industrisë nuk duket të kenë ndonjë rol të dukshëm në aktivitetet e menaxhimit të kimikateve në Shqipëri. Vetë-monitorimi i shkarkimeve të ndotësve është aktivitet i detyruar me ligj dhe kohët e fundit është vënë në efikasitet, sidomos në rastet e industrive që çlirojnë ndotje. Megjithatë, mund të përmenden iniciativa të bashkëpunimit të sektorit publik me atë privat në fushën e trajnimit të strukturave publike dhe atyre private, p.sh. në lidhje me përdorimin e biocidëve për kontrollin e vektorëve transmetues të sëmundjeve dhe të parazitëve në shëndetin publik. Si shembuj të këtyre iniciativave mund të përmendim trajnime të zhvilluara dy vitet e fundit nga ISHP dhe MSh, në bashkëpunim me kompani që prodhojnë dhe/apo tregtojnë produkte biocide.

Është e rëndësishme të përmendet edhe mbështetja rajonale e dhënë nga organizmat ndërkombëtare për institucionet kërkimore-shkencore, si projekti “Mbështetje për forcimin dhe fuqizimin e Institutit të Trajnimit dhe Kurikulës (Ministria e Arsimit dhe Shkencës) për futjen e lëndës ekstra kurikulare të Edukimit Mjedisor “Paketa e Gjelbër” për klasat 5-9 të arsimit bazë (REC me financim të Qeverisë së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta).

Forcimi i rolit të OJF sidomos në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit duhet të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit edhe me organizmat qeveritare në nivel qendror dhe lokal. Forcimi i kapaciteteve të tyre, menaxhimi finaciari, zhvillimi institucional, partneriteti në projekte të ndryshme me qeverisjen lokale dhe sektorin privat, komunikimi me publikun, mbeten ende problematika që kërkojnë vlerësim e zhvillim.

Projekti “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e Qasjes Strategjike në Menaxhimin e Kimikateve në Shqipëri” ka sjellë një rritje të përfshirjes së aktorëve jo-qeveritarë, si OJF dhe industrisë, në menaxhimin e kimikateve në nivel kombëtar.

KOMISIONET NDËRMINISTRORE DHE MEKANIZMAT KOORDINUES

Aktualisht në Shqipëri funksionojnë këto mekanizma koordinues të lidhur drejtpërsëdrejti apo indirekt me menaxhimin e kimikateve.

- Komisioni Shtetëror i Regjistrimit të PMB-ve,
- Komiteti Ndër-ministrior për Emergjencat Civile,
- Komisioni Teknik Këshillimor për Emergjencat Civile,
- Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet,
- Komisioni Qeveritar për Problemet Ujore me Vendet Fqinje,
- Komisioni i Autorizimeve për lëndët DDD.

Është ngritur një task forcë për implementimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit-RNSh (2005), me përfaqësues nga të gjitha ministritë e linjës dhe sektorët e ndryshëm në vend, e cila është e lidhur edhe me Pikën Fokale Kombëtare në ISHP. Ky komitet do të planifikojë, mbikqyrë dhe monitorojë implementimin e RNSh (2005). Përmbushja e kërkesave bazë për kapacitete të RNSh (2005) do të kontribuojë gjithashtu në plotësimin e disa prej kërkesave për futjen në BE.

Në legjislacionin përkatës është parashikuar ngritja e komisioneve të tjera si: Komiteti Ndërmintor i Menaxhimit të Mbetjeve, Autoriteti Kompetent për Kontrollin e Aksidenteve Madhore (baza ligjore për të dytin nuk është miratuar akoma).

Menaxhimi i suksesshëm i kimikateve në nivel kombëtar komplikohet nga fakti që zakonisht ministritë e ndryshme marrin pjesë në kontrollin e kimikateve në faza të ndryshme të ciklit të jetës së tyre, krahas faktit që ka ndërthurje në një farë shkalle të përgjegjësi për një problem të caktuar. Për këto arsye, është nevojë e domosdoshme ngritja e një institucioni koordinimi për menaxhimin e kimikateve ndërmjet të gjitha ministrive relevante, si p.sh. Komiteti Ndërsektorial për Menaxhimin e Kimikateve.

Zyra e menaxhimit dhe regjistrimit të kimikateve, ngritja e së cilës kërkohet në zbatim të detyrave që ka vënë ligji Nr. 9108 dt. 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, është gjithashtu shumë e nevojshme. Në Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA është parashikuar krijimi i kësaj zyre brenda vitit 2015. Kjo zyrë mundet të shërbejë edhe si sekretariat i Komitetit Ndër-sektorial për Menaxhimin e Kimikateve.

Në të shumtën e rasteve organizmat dhe agjencitë qeveritare marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve me mundësitë reale, pa mundur të operojnë në thellësi të problemit, për mungesë të personelit, të akteve nënligjore dhe, në shumë raste, të mungesës së përfshirjes në takime të rëndësishme për të kontribuar në prezantimin e përfaqësimit të mekanizmit që ato mbulojnë.

Menaxhimi, Aksesimi dhe Përdorimi i Informacionit

Instrumentat ligjorë kërkojnë që siguri dhe shkëmbimi i informacionit të bëhet në kontekste të ndryshëm. Baza e plotë ligjore, aktet ligjore në proces diskutimi publik, dokumentat strategjike, projektet, raportet si dhe informacioni i ofruar nga ministritë, si licencat apo certifikatat janë, në parim, të disponueshme on-line në faqet e internetit të ministrive përkatëse.

Disa të dhëna, sidomos ato të import-eksportit, bëhen publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të dhënat e gjëndjes shëndetësore publikohen nga INSTAT. Disa të dhëna si p.sh. të dhëna për përdorimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve, përbërësit aktivë të regjistruar për mbrojtjen e bimëve dhe produktet e tyre publikohen në mënyrë periodike; sasitë e kimikateve në ruajtje mund të merren me anë të kërkesës drejtuar ministrive përkatëse. Ministria e Shëndetësisë publikon në faqen e saj të internetit listën e përditësuar të përbërësve aktivë të lejuar për produktet biocide dhe dokumentat e duhuara për procedurat e autorizimit.

Dekada e fundit ka shënuar një revolucion për sa i përket lidhjes në rrjet të institucioneve publike; institutet kërkimore dhe, praktikisht, çdo zyrë në Tiranë ka ditët e sotme akses në informacionin e disponueshëm në internet. Situata është më problematike në rrethe, kur jo çdo zyrë ka akses në internet.

Informimi i publikut për çështje mjedisore në Shqipëri bazohet mbi Ligjin Nr. 8672, datë 26.10.2000, “Për Aderimin e Shqipërisë në Konventën e Aarhusit”, sipas të cilit Konventa e Aarhusit kthehet në një akt normativ, të detyrueshëm për t’u zbatuar në Republikën e Shqipërisë.

Rrjeti Institucional Mjedisor dhe Sektori i Informacionit të Publikut dhe Teknologjisë së Informacionit (SIPTI) në MMPAU janë institucione dhe rrjete publike të cilat mbledhin informacion dhe informojnë publikun për mjedisin. Shpërndarja e informacionit bëhet në rrugë pasive me anë të kërkesave me shkrim drejtuar SIPTI-t ose në mënyra aktive, me anë të publikimeve mujore të Buletinit Elektronik Mjedisor, publikimit vjetor të Raportit mbi Gjendjen e Mjedisit, përgatitja dhe dorëzimi i raportit dyvjeçar mbi gjendjen e mjedisit nga Agjencitë Mjedisore Rajonale të rretheve, faqet e internetit të komunave, etj. Strukturat për informacion publik për çështje mjedisore mbështeten nga tre Qendra Informacioni të Aahrusit (QIA) në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër.

Megjithatë, në disa raste informacioni është i varfër dhe me mungesa për shkak të mungesave në personel, kapacitete dhe infrastrukturë, siç është mungesa e një baze të dhënash dhe një qendër shkëmbimi informacioni, etj. Mungesa e një Zyre Kimikatesh, e cila sipas Ligjit 9108/2003 do të ketë detyrimin për mbledhjen e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit, është një mangësi e madhe.

Shqipëria nuk ka akoma një **qendër informacioni për helmimet (Qendër Helmimesh)**.

Ka një mungesë të literatureës, informacionit bazë dhe shpërndarjes së informacionit që lidhet me një sistem të dobët informacioni në vend. Kjo situatë është pasojë e buxhetit të kufizuar për literaturën përkatëse si dhe përfaqësimi i kufizuar i vendit në institucionet e jashtme të lidhura me kimikatet.

Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri” është krijuar faqja e internetit www.chemicals.al si një mjet për shkëmbimin e informacionit për menaxhimin e kimikateve. Në këtë faqe mund të gjendet lehtësisht i gjithë legjislacioni mbi kimikatet dhe informacione të tjera të lidhura me to. Një bazë të dhënash për biocidet do të shtohet në këtë faqe brenda janarit 2013; kjo bazë të dhënash do të ketë kapacitetet për t’u pasuruar me klasa të tjera kimikatesh apo rubrika të tjera.

INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Në Republikën e Shqipërisë operojnë shumë laboratorë kimikë e fiziko-kimike. Ata kryejnë analiza të cilësisë së kimikateve, identifikimin e substancave të panjohura, analiza të mbetjeve të rrezikshme dhe të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin, si dhe bëjnë monitorime të ndryshme të kimikateve në mjedis (në ujëra, tokë, sedimente, ajër), në ushqime, etj.

Laboratorët kimikë publikë që operojnë në fusha të ndryshme, në përgjithësi kanë një sistem menaxhimi të cilësisë akoma larg kërkesave bashkëkohore dhe që ka nevojë për përmirësim të vazhdueshëm. Në përgjithësi, laboratorët nuk kanë të ngritur një zyrë të sigurimit të cilësisë, me përjashtim të atyre laboratorëve që janë të akredituar dhe që janë në proces akreditimi. Në këto laboratorë mungon edhe auditi i brendshëm për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së produktit. Si rrjedhojë, vetëm një numër i kufizuar i tyre është akredituar ose certifikuar. Laboratorët përdorin si metoda standarde për kryerjen e analizave, p.sh. metoda ISO apo metoda të AOAC, apo të Farmakopeve të ndryshme, ashtu dhe metoda të vjetra klasike për përcaktimin e treguesve të veçantë. Kjo kushtëzohet dhe nga aparaturat dhe mjetet e vjetra të punës që disponojnë laboratorët e ndryshëm. Tendenca është drejt futjes dhe përshtatjes së metodave ISO. Në përgjithësi, në Republikën e Shqipërisë nuk ka një program kombëtar për përmirësimin e cilësisë dhe të sasisë së analizave që kryejnë laboratorët e ndryshëm fiziko kimike, që është i domosdoshëm për një performancë më të mirë laboratorike, cilësi më të mirë

të dhënash, produkte më të sigurta dhe përfshirje më të madhe në programe të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare shkencore ose monitorimi.

Laboratorët e kontrollit të kimikateve i sigurojnë standardet e punës dhe gjithë metodikat standarde pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS) që është organizmi kombëtar i standardizimit në Republikën e Shqipërisë në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE). DPS është i vetmi institucion publik në Shqipëri i çertifikuar sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001:2008. Me përjashtim të rasteve kur është specifikuar agjenci tjetër akreditimi, të gjithë laboratorët e akredituar kanë bërë akreditim brenda vendit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, që është i vetmi organizëm kombëtar i akreditimit i njohur nga qeveria për të vlerësuar kompetencën teknike të organizmave të vlerësimit të konformitetit që kryejnë aktivitete të tillë si: testim, kalibrim, çertifikim dhe inspektim, qofshin në sektorin publik apo privat, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në përgjithësi, menaxhimi teknik i laboratorëve nuk është në nivelin e duhur. Në disa laboratorë mungon ose vonon servisi i rregullt i aparaturave, në disa të tjerë mungojnë substancat CRM dhe materialet standarde. Shpesh furnizimi me reagentë dhe kite për laboratorët vohet për shkak të procedurave të tenderimit, në disa laboratorë mungojnë reagentë për shkak të fondeve të limituara, kurse në disa të tjerë ka materiale jashtë përdorimit për shkak të mos-llogaritjes së mirë të nevojave vjetore ose të mos-rakordimeve të tjera teknike.

Në përgjithësi laboratorët nuk kanë procedurë të shkruara për menaxhimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshme si dhe për eliminimin e tyre.

Shpesh laboratorët nuk kanë kushtet e duhura mjedisore për sigurimin e shëndetit të stafit punonjës.

Numri i madh i firmave të aparaturave laboratorike që kanë hyrë në RSh e komplikon sigurimin e servisit periodik të instrumenteve dhe krijon nevojën e sigurimit të serviseve të aparaturave me ndihmën e ndonjë kompanie ndërkombëtare që ofron këtë shërbim kompleks

Nevojiten trajnime të personelit të ri si brenda dhe jashtë vendit, dhe rifreskim i njohurive apo specializim i stafit ekzistues laboratorik.

PARANDALIMI, GATISHMËRIA DHE PËRGJIGJA NDAJ EMERGJENCAVE KIMIKE.

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile i miratuar nga Këshilli i Ministrave Nr. 835, i datës 3.12.2004 është dokumenti më i rëndësishëm i Shtetit Shqiptar për sa i përket emergjencave civile. Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Emergjencave Civile përfshin struktura permanente dhe provizore në nivel qendror, rajonal dhe lokal. Këshilli i Ministrave drejton sistemin kombëtar të emergjencave civile në vend, Ministria e Brendshme zbaton politikën e Këshillit të Ministrave në fushat e planifikimit dhe menaxhimit të emergjencave civile, Komiteti Ndërsëktorial për Emergjencat Civile koordinon veprimet e institucioneve të përfshirë përmes gjithë fazave të përgjigjes ndaj situatave të emergjencave civile.

Si pjesë e këtyre strukturave, çdo ministri, institucion ose drejtori e përfshirë luan aktualisht rol specifik. Planet e Emergjencës Civile krijohen në nivel rajonal dhe në bashkitë më të mëdha, por këto plane janë për të gjitha llojet e emergjencave. Plani Kombëtar është përgatitur bazuar në një metodologji dhe procedurë e cila përfshin studimin e vlerësimit të risqeve, konsultime të gjera, ndarjen e informacionit, kontribut të gjerë të të gjithë institucioneve dhe organizatave të lidhura me emergjencat. **Nuk ka plane të veçanta të jashtme të emergjencës për aktivitete**

industriale, të përgatitur nga autoritetet përgjegjëse në nivel rajonal ose lokal. Disa nga aktivitetet si p.sh. depozitat e naftës, kanë krijuar planet e tyre të brendshme të emergjencës, por këto plane nuk janë në përputhje me kërkesat e Direktivës SEVESO II dhe Aneksit VII të Konventës së Aksidenteve Industriale në Kontekst Ndërkufitar.

MMPAU me asistencë të projektit të KE CARDS 2006- INPAEL, ka hartuar projekt-ligjin “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substancat e rrezikshme”. Ky draft-ligj që transponon plotësisht Direktivën Seveso II, përbën bazën për draftimin e legjislacionit dytësor që do të sigurojë zbatimin e tij. Ky draft-ligj parashikohet të miratohet së shpejti.

Incidentet industriale që kanë ndodhur në Shqipëri vitet e fundit, si shpërthimi i një fabrike demontimi të municioneve në Gërdec, shpërthimi i magazine vaji mineral afër Tiranës në 2011 etj. bënë të qartë se sa e rëndësishme ishte përmbytja e detyrimeve të operatorëve të ndryshëm për përgatitjen e planeve të brendshme të emergjencave si dhe dorëzimi i tyre në MMPAU, së bashku me dokumentacionin shoqërues për sigurimin e lejeve mjedisore. Sektori përgjegjës që lëshon lejet për këta operatorë ka nevojë për rritje kapacitetesh për përcaktimin e duhur të kushteve të lejes për të parandaluar aksidente industriale. Një e metë tjetër që u shfaq ishte e lidhur me mungesën e ekspertizës për të vlerësuar dëmtimet ndaj mjedisit si dhe përgjegjësinë e operatorëve për të bërë rehabilitimin e mjedisit, me synim uljen e ndotjes mjedisore.

Nevojitet një regjistër kombëtar për regjistrimin e aksidenteve që mund të ndodhin për shkak të substancave kimike dhe një institucion i specializuar teknik që kryen mbikqyrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të shfaqjes së një aksidenti.

Ekzistojnë plane për ndërtimin e indikatorëve kombëtarë për shëndetin dhe mjedisin, përfshirë për kimikatet. Instituti i Shëndetit Publik është pika fokale për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (2005) dhe disa aktivitete janë kryer në këtë kuadër, si caktimi i një task force me përfaqësues nga ministritë përkatëse, trajnime etj.

Nuk ka asnjë **qendër informacioni në vend lidhur me helmimet nga kimikatet**, dhe kapacitetet aktuale në terma praktikë janë të kufizuara, veçanërisht për transportin e viktimave në rastin e aksidenteve që përfshijnë kimikatet e rrezikshëm.

Survejanca për aksidentet e shkaktuara nga kimikatet është shumë e dobët sepse ka mungesa koordinimi pavarësisht dokumentacionit dhe legjislacionit ekzistues. Ka një nevojë urgjente për trajnime për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut si dhe në lidhje me konceptet e epidemiologjisë së aplikuar dhe survejancës për të gjithë specialistët që punojnë në fushën e menaxhimit të kimikateve.

Nuk ka një dokument udhëzues lidhur me incidentet nga kimikatet e rrezikshme, mbi menaxhimin e incidenteve, toksikologjinë në përgjithësi, metodat e dekontaminimit, përdorimit të antidotëve apo pajisjeve ndihmëse gjatë ndodhjes së një emergjence kimike, etj. Qendra Kombëtare e Trajnimit duhet të organizojë trajnime në nivel lokal për parandalimin, gadishmërinë dhe përgjigjen ndaj emergjencave kimike për autoritetet kompetente dhe operatorët industrialë. Gjithashtu nevojitet forcimi i kapaciteteve të forcave të ndërhjës nga Ministria e Brendshme, Strukturave të gatshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, forcave të ndihmës së shpejtë, në drejtim të përgjigjes ndaj aksidenteve dhe të përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të përshtatshme për aksidentet industriale.

Nevojitet gjithashtu rritja e ndërgjegjësimin të popullsisë mbi rreziqet e aksidenteve industriale dhe të drejtën e informimit.

NDËRGJEGJËSIMI/ TË KUPTUARIT E PUNONJËSVE DHE PUBLIKUT; TRAJNIMI DHE EDUKIMI I GRUPEVE TË SYNUARA DHE SPECIALISTËVE

Ndërgjegjësimi si dhe trajnimi i grupeve të ndryshme të profesionistëve, si fermerëve, transportuesve, industrialistëve, stafit teknik, si edhe i konsumatorëve, për sigurinë në përdorimin e kimikateve është një hap i rëndësishëm për uljen e këtij risku. Vitet e fundit janë kryer disa aktivitete në lidhje me menaxhimin dhe sigurinë e kimikateve në kuadër të projekteve të ndryshme, kryesisht me mbështetjen e organizatave ndër-qeveritare ose, në disa raste, nga industria. Megjithatë, nuk ka **programe trajnimi të rregullta** si p.sh për puntorët e industrisë dhe bujqësisë, punonjësit e doganave, profesionistët e përgjigjes kimike të shpejtë. MSh është duke përgatitur draft-vendime të reja të bazuara në ligjin për shëndetin dhe sigurinë në punë. Qëllimi i këtyre draft-vendimeve është, mes të tjerash, për të mbushur këtë boshllëk.

Ndërgjegjësimi për rreziqet që paraqesin kimikatet është ende i ulët në të gjitha grupmoshat si dhe në të gjitha nivelet. Ka ende nevojë për ndërhyrje në nivelin universitar për zhvillimin e një kurrikule për sigurinë ndaj kimikateve. Krahas Paketës së Gjelbër, duhet të futet si lëndë e veçantë në shkollat e larta të sistemit Bachelor Higjiena e punës dhe siguria në punë, kjo veçanërisht në shkollat mjekësore dhe ato të tjera profesionale. Kjo do të kontribuojë në ngritjen e nivelit të dijeve të të rinjve lidhur me mbrojtjen në punë nga faktorë dëmtesues të shëndetit, përfshirë edhe kimikatet.

Është i nevojshëm organizimi i kurseve të informimit/ trajnimit me specialistë të shëndetit publik në rrethe lidhur me vlerësimin, menaxhimin e riskut, mbi mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve.

Duhet rritur roli i mediave dhe duhet të zgjerohet komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale për qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe njohurive.

BASHKËPUNIMI DHE PËRFSHIRJA NË ORGANIZATAT, ORGANIZMAT DHE MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Në dhjetor të vitit 2005, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë (KM) krijoi zyrtarisht Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON) si pjesë përbërëse e strukturës së tij organizative. Njësia e koordinimit të ndihmës së huaj e DEBASKON shërben si një 'one stop shop' për donatorët përsa i përket çështjeve strategjike në lidhje me dhënien e ndihmës së huaj. Si e tillë, ajo është përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve madhore koordinuese, si tryezat e rumbullakëta të Qeverisë me donatorët dhe Grupin e Ndihmës së SPI-së, që është një bord këshillues në nivel të përcaktimit të politikave. Departamenti, në bashkëpunim me Sekretariatit Teknik të Donatorëve, ka krijuar tashmë bazë të dhënash të donatorëve, që përmban të dhënat për të gjithë donatorët aktivë që kanë punuar që prej vitit 1994; përfshirë informacionin mbi shlyerjen e ndihmës së huaj. Bashkë me Ministrinë e Financave, DEBASKON bashkë-udhëheq negociatat me donatorët mbi kushtet e bazuara në politika për huatë/kreditë dhe merr pjesë në negociatat e drejtuara nga Ministria e Integritimit Evropian mbi programimin e IPA (Instrumentit për Asistencë Para-aksesimit në BE). Në bashkëpunim me donatorët dhe ministritë e linjës, Departamenti ka krijuar 10 Grupe Pune Sektoriale, qëllimi i të cilave është të sigurojnë bashkërendimin në mënyrë efikase të ndihmës së huaj dhe të mbështesin objektivat strategjike sektoriale.

Në MMPAU ka një drejtori që menaxhon projektet në fushën e mjedisit, e cila koordinon punën me drejtoritë teknike në ministri për të identifikuar nevojat dhe prioritetet për identifikimin e projekteve të ndryshëm që lidhen me menaxhimin e cilësisë së ajrit, ujrave, mbetjeve, kimikateve, ndryshimeve klimatike, ndotjes industriale, në përputhje kjo edhe me kërkesat e marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara.

Megjithatë, aktualisht nuk ka një koordinim në nivel kombëtar lidhur me zbatimin e kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e kimikateve, të integruara në një program kombëtar. Mungojnë procedurat që sigurojnë koordinimin midis agjencive përgjegjëse për zhvillimin e aktiviteteve të asistencës dhe atyre përgjegjëse për mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që me mbështetjen e agjencive ndërkombëtare, të përmirësohen mekanizmat e koordinimit midis institucioneve, dhe të sigurohet një komunikimin më i mirë. Përshtatja praktike me kushtet lokale ndaj kërkesave të marrëveshjeve përkatëse të adoptuara është çështje themelore.

Vështirësitë në zbatimin e kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare lidhen me mungesën e kapaciteteve në numrin e punonjësve dhe e kapaciteteve teknike në institucionet përgjegjëse. Nuk ka një agjenci të menaxhimit të kimikateve që të kryejë detyrat që dalin në zbatim të kërkesave bazë të konventave dhe rregulloreve përkatëse të BE në fushën e kimikateve. Mungojnë projektet e asistencës teknike për zhvillimin e kapaciteteve teknike në nivel kombëtar dhe lokal.

BURIMET DHE NEVOJAT EKZISTUESE PËR MENAXHIMIN E KIMIKATEVE

Ekzistojnë bazat e kapaciteteve për menaxhimin e kimikateve dhe, në një pjesë të mirë, sidomos në institucionet qendrore, stafi ekzistues është i trajnuar. Duhet thënë se specialistët në nivel të ministrive janë përgjithësisht të përgatitur, por përballen me një ngarkesë shumë të madhe pune për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm, duke marrë parasysh detyrimet e shumta ligjore që lidhen me menaxhimin e kimikateve. Fenomen pozitiv në këtë nivel ka qenë qëndrueshmëria relative e stafit gjatë viteve e fundit, gjë që ka bërë të mundur përmirësime dhe plotësime të legjislacionit lidhur me kimikatet dhe përgjigje në kohë ndaj kërkesave të ushtruara ndaj institucioneve qendrore, si psh. detyrimet për raportim dhe veprim në kuadër të përpjekjeve për integrimin europian të vendit. Megjithatë, pavarësisht se stafi ekzistues është i përkushtuar dhe i përgatitur, është nevojë imediate rritja e numrit të stafit në nivel qendror, kualifikimi i stafit të ri dhe krijimi i një **agjencie apo zyre për menaxhimin e kimikateve**.

Pavarësisht përpjekjeve për formimin e personelit të përfshirë në hallkat e ndryshme të menaxhimit të kimikateve dhe burimeve të shumta të përdorura për këtë qëllim vitet e fundit, akoma mbetet shumë punë për të bërë në këtë drejtim. Kjo nevojë shfaqet si pasojë e disa shkaqeve dhe presioneve, si: kërkesat lidhur me bazën e ligjore të hartuar rishtas; kërkesat e reja ligjore lidhur me përpjekjet e Shqipërisë për t'u integruar në Europë, kërkesa të reja ligjore si rezultat i ratifikimit të disa konventave dhe protokolleve mbi kimikatet, krijimi i institucioneve dhe shërbimeve të reja, ndryshime të vazhdueshme të stafeve profesionale, sidomos në nivel lokal.

Nevojiten trainime të stafeve lidhur me realizimin e detyrave lidhur me aspektet përkatëse të menaxhimit të kimikateve që mbulojnë, si:

- Procedurat e vlerësimit të riskut shëndetësor dhe mjedisor;

- Forcimi i kapaciteteve analitike, përmirësimi i performancës dhe shtimi i treguesve që analizohen;
- Nevojitet krijimi i një qendre informacioni për helmimet dhe formimi i stafit përkatës; Menaxhimi i kimikateve nga pushteti vendor në mbështetje të legjislacionit (jo vetëm detyrimet por edhe mënyrat e mjetet e duhura për të arritur mirë-menaxhimin e kimikateve); Vlerësimi i raporteve të sigurisë të aktivitetëve industriale që përbëjnë rrezik për aksidente industriale për shkak të substancave të rrezikshme (rritje e kapaciteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal);
- Parandalimi, gatishmëria dhe përgjigja ndaj emergjencave kimike (për autoritetet kompetente dhe për operatorët industrialë, trainime në nivel lokal); përpjekjet për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (2005) mund të koordinoheshin me ato të institucioneve të tjerë për këtë qëllim;
- Forcimi i bashkëpunimit qeveri - pushtet vendor - biznes për të administruar përdorimin e kimikateve dhe zonat e ndotura;
- Përcaktimi i kushteve në lejet mjedisore (Qendra Kombëtare e Licensimit)

Problem që haset në nivelin e rretheve është ekzistenca e disa lloj inspektorateve: të shëndetësisë, mjedisit, të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe të punës, kompetencat e të cilëve lidhur me kimikatet jo gjithmonë janë të qarta. Vendorsja së fundmi e Inspektoriatit Qëndror pritet të zgjidhë shumë probleme në lidhje me inspektoratet e ndryshme, me qëllimin dhe kompetencat e tyre përkatëse.

Në këtë kuadër është e nevojshme gjetja e një zgjidhjeje për qartësimin dhe/apo koordinimin e kompetencave respektive, gjë që do ndihmohet nga krijimi kohët e fundit e Inspektoratit Qëndror. Në të njëjtën kohë është i nevojshëm plotësimi i bazës ligjore për të institucionalizuar bashkëpunimin mes inspektorateve.

Problem është gjithashtu mungesa e trajnimeve të mjaftueshme në nivel të specialistëve dhe inspektoreve të rretheve, edhe për shkak të mungesës së programeve të organizuara të trainimit, sidomos lidhur me problemet e kimikateve. Nevojitet të ngrihen programe të mirëfillta trajnimesh, të cilat të jenë të qëndrueshëm dhe metodologjikisht të konsoliduar. Nevojiten si programe të plotë për formimin e kuadrit të ri, ashtu edhe programe të shkurtër rifreskues. Në sistemin e shëndetësisë, funksionimi i programeve të trajnimit do mund të mbështetej edhe nga Qendra Kombëtare e Edukimit të Vazhduar, e cila zbaton sistemin e krediteve për stafin shëndetësor.

Mangësi e nevoja të tjera lidhur me rritjen e kompetencës së organeve të menaxhimit të kimikateve janë:

- Nevoja për plotësimin e legjislacionit sekondar dhe hartimin e udhëzuesve përkatës;
- Nevoja për krijimin e bazave të të dhënave p.sh. për kimikatet e përdorur në industri, për kimikatet e rrezikshëm, si biocidet, PMB, për planet e emergjencave, etj.;
- Mungesa e regjistrit të shkarkimeve industriale në mjedis;
- Kontrolli i bizneseve lidhur me klasifikimin, etiketimin e paketimin e kimikateve, kushtet e magazinimit, kujdesin ndaj shëndetit të punonjësve, parandalimin e ndikimit në ekosistemin e zonës ku ndodhet industria, etj.;
- Hartimi i studimeve eko-social-shëndetësore në zonat e banuara pranë instalimeve industriale, etj.

Vitet e fundit ka patur nisma për inkurajimin e partneritetin mes sektorit publik dhe atij privat; si shembuj të këtij partneriteti mund të përmenden aktivitete të përbashkëta trajnuese të

ndërmarrja nga Instituti i Shëndetit Publik dhe kompanitë që tregtojnë produkte biocide. Këto aktivitete kanë qenë efektive si në formimin e specialistëve të rretheve, ashtu edhe në krijimin e një kulture të re të partneritetit të sistemit publik me industrinë.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Parimet udhëheqëse, që janë marrë në konsideratë gjatë procesit të zhvillimit të këtyre rekomandimeve janë përqasja e kujdeshme dhe përqasja e pjesëmarrjes, sipas së cilës të gjitha palët e përfshira kanë pasur mundësinë të kontribuojnë dhe të japin mendimin e tyre duke marrë pjesë në përditësimin e profilit dhe në mbledhjet shumta të mbajtura gjatë procesit të përgatitjes së profilit të rishikuar.

Duke ndjekur analizën e detajuar të aspekteve ligjore, institucionale, teknike të kimikateve në Shqipëri, janë propozuar rekomandimet dhe konkluzionet e mëposhtme për veprime të mëtejshme:

Kuadri ligjor i kimikateve dhe i substancave të rrezikshme në Shqipëri është pjesërisht në harmoni me legjislacionin e BE-së; është shfaqur nevoja për hartimin e një legjislacioni të ri për kimikatet, në veçanti në lidhje me përafrimin e legjislacionit kombëtar me rregulloren e CLP (EC) 1272/2008, dhe atë të REACH (EC)1907/2006. Me propozimin dhe kontributin e Projektit SAICM-QSP “Forcimi i Kapaciteteve për Implementimin e SAICM në Shqipëri”, Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur së fundmi një draft-ligj për biocidet dhe synon të përafrojë plotësisht direktivën 98/8 të BE-së me legjislacionin dytësor përkatës. Ndhimesa teknike do të jetë tejet e nevojshme gjatë kësaj faze. MMPAU është aktualisht duke punuar për përgatitjen e legjislacionit dytësor për kimikatet e rrezikshme dhe do të ketë një ndihmesë të konsiderueshme nga projekti SELEA (Forcimi i Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri) gjatë vitit 2013.

Kuadri ligjor dhe procedurat për menaxhimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve duke përfshirë regjistrimin dhe kontrollin janë plotësuar dhe funksionale; ka akoma shumë punë për t’u bërë përsa i përket plotësimit të boshllëqeve në legjislacion dhe implementimin e tij për kimikate të tjera sic janë kimikatet industriale, biocidet, kimikatet e konsumit. Në vazhden e plotësimit dhe përditësimit të bazës ligjore, duhet të përgatiten **dokumentet udhëzues** përkatës. Nevojitet të përgatitet një “Akt/ligj për kimikatet”, në të cilin do të përfshihen të gjitha aktet ligjore dhe normative, kujdesi shëndetsor, hapat që duhet të ndërmerren për menaxhimin e kimikateve etj.

Përafrimi i legjislacionit Europian duke ndjekur dhe pasqyruar në vazhdimësi ndryshimet dhe të rejat në të për përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues, kërkon ngritjen e rolit të strukturave shtetërore, përfshirjen e organizatave joqeveritare dhe sindikatave të puntorëve që në fillim të ndërmarrjes së iniciativave ligjore e, në veçanti, kur kemi të bëjmë me kimikate të rrezikshme.

Menaxhimi i kimikateve në nivel kombëtar ndërlikohet nga fakti që ministri të ndryshme marrin pjesë në kontrollin e grupeve të ndryshëm të kimikateve në faza të ndryshme të ciklit të jetës së tyre. Gjithashtu ka ndërthurje në një farë shkalle të përgjegjësive për probleme të caktuara. Është nevojë e domosdoshme ngritja e një institucioni koordinues për menaxhimin e kimikateve, siç do ishte zyra e menaxhimit dhe regjistrimit të kimikateve. Në Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA është parashikuar krijimi i kësaj zyre brenda vitit 2015. Kjo zyrë do të shërbejë edhe si sekretariat i një (nën) komiteti ndërsektorial për menaxhimin e kimikateve, i cili është gjithashtu shumë i nevojshëm.

Mekanizmat ekzistues punojnë të ndarë sipas problematikës dhe specifikës së tyre. Ata nuk i mbulojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të kimikateve, të cilat kërkojnë një kooperim dhe koordinim ndërsektorial shumë të mirë. Mungon gjithashtu koordinimi në nivel kombëtar i zbatimit të kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e kimikateve. Është domosdoshmeri krijimi i një komiteti ndër-sektorial për menaxhimin më të mirë të kimikateve. Termat e referencës për funksionimin e këtij komiteti janë përgatitur në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri

Institucionet qëndrore përballen me mangësi dhe probleme siç janë nevoja urgjente për personel të kualifikuar, buxhet i pamjaftueshëm për ndjekjen e problemeve si dhe mungesa në infrastrukturë. Mungesa e **burimeve njerëzore** përbën një problem serioz, që mund të ndikojë konsiderueshëm aftësinë e vendit për të përthithur ndihmesën para-hyrjes në BE dhe përmbushjen e kërkesave për futjen në BE. Është shumë e rëndësishme të rritet numri i anëtarëve të stafit që do të përfshihen në menaxhimin e kimikateve dhe në këtë mënyrë të përgatiten burimet e nevojshme njerzore për krijimin e Zyrës së Kimikateve. Ky proces duhet të zhvillohet gjatë zbatimit të aktiviteteve të tjera intensive që zhvillohen aktualisht dhe që pritet të intensifikohen më shumë në të ardhmen. Është gjithashtu i rëndësishme rekrutimi i **stafit të kualifikuar e cilësor**, të aftë për të përthithur dhe përballuar kërkesat e larta të lidhura me menaxhimin e kimikateve.

Mungojnë kapacitetet e mjaftueshëm gjithashtu në institucionet që duhet të mbledhin dhe shpërndajnë **informacionin**. Për të përmirësuar situatën aktuale mbi menaxhimin e informacionit, është e nevojshme rritja e buxhetit, organizimi i trainimeve dhe rritje e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për informim. Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri është krijuar faqja e internetit www.chemicals.al si mjet për shkëmbimin e informacionit lidhur me menaxhimin e kimikateve

Në Republikën e Shqipërisë nuk ka akoma një **regjistër për kimikatet** që të përmbushë kërkesat e legjislacionit të BE-së. Është i nevojshëm krijimi i **bazave të të dhënave**, si për shembull për kimikatet industriale, për kimikatet e rrezikshme, për planet e emergjencës etj. Në kuadër të Projektit SAICM-QSP po zhvillohet një bazë të dhënash për biocidet që do të përmbajë më vonë edhe klasa dhe çështje të tjera mbi kimikatet.

Mungojnë mekanizma dhe metodologji të miratuara për përcaktimin e vetive të kimikateve, për klasifikimin e tyre sipas rrezikshmërisë si dhe për vlerësimin e riskut të kimikateve për shëndetin dhe mjedisin. Proçeduara e vlerësimit të riskut për substancat e rrezikshme duhet të përkufizohet nga Ministri i Shëndetësisë, ndërsa ajo për vlerësimin e riskut ndaj mjedisit vendoset nga MMPAU. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të riskut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, Këshilli i Ministrave vendos kushtet për prezantimin e këtyre substancave në Shqipëri. Sot për sot, Ministria e Shëndetësisë nuk ka një mekanizëm në vend për vlerësimin e riskut dhe impaktit në shëndet të substancave kimike.

Nuk ka asnjë **qendër informacioni në vend lidhur me helmimet nga kimikatet**. Kemi një numër të mjaftueshëm toksikologësh me kualifikim të mjaftueshëm dhe do nevojitej vetëm trajnim afat-shkurtër në mënyrë që të asistojë “qendra e helmimeve”. Për disa klasa kimikatesh mungon informacioni i nevojshëm dhe udhëzuesit për masat e sigurisë dhe mbrojtjes nga këto lloj kimikatesh.

Deri më tani politikat qeveritare kanë qenë relativisht favorizuese për të marrë informacion nga organizatat jo-fitimprurëse (**OJF**) kombëtare; ato janë më favorizuese për të përdorur ekspertizat dhe përvojat e OJF ndërkombëtare. OJF shpesh luajnë rol aktiv duke bërë lobime

pranë organizmave të ndryshëm vendim marrës në lidhje me legjislacionin mjedisor dhe kohët e fundit edhe për kimikatet, sidomos ata të rrezikshëm. Roli i OJF në informimin e publikut rreth rreziqeve të kimikateve është i konsiderueshëm, por duhet të forcohet akoma më shumë. Forcimi i rolit të OJF-ve sidomos në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit duhet të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit edhe me organizmat qeveritare në nivel qendror dhe lokal. Forcimi i kapaciteteve të tyre, menaxhimi financiar, zhvillimi institucional, partneriteti në projekte të ndryshme me qeverisjen lokale dhe sektorin privat, komunikimi me publikun mbeten ende problematika që kërkojnë vlerësim e zhvillim.

Iniciativat vullnetare të **industrisë** nuk duket të kenë ende ndonjë rol të dukshëm në aktivitetet e menaxhimit të kimikateve në Shqipëri. Megjithatë, si shembull pozitiv në këtë drejtim mund të përmendet vetë-monitorimi i shkarkimeve të ndotësve, aktivitet i detyruar me ligj, që kohët e fundit është vënë në efikasitet sidomos në rastet e industrive që emetojnë ndotje. Gjithashtu, ka nisur të krijohet një përvojë e mirë e bashkëpunimit të sektorit publik me atë privat në fushën e trajnimit të strukturave publike dhe atyre private; si shembuj mund të përmenden trajnime mbi kontrollin e dëmtuesve në shëndet public organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik me kontributin e kompanitë tregtare të produkteve biocide. Projekti SAICM-QSP “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri” ka kontribuar në rritjen e përfshirjes së aktorëve jo-qeveritarë, siç janë organizatat jo-fitimprurëse (OJF) dhe industria. Mekanizmat dhe mënyrat e rritjes së përfshirjes së industrisë dhe biznesit në menaxhimin e kimikateve duhen zhvilluar edhe më tej.

Nuk ka **dokumenta udhëzues** lidhur me incidentet nga kimikatet e rrezikshme, menaxhimin e incidenteve, toksikologjinë në përgjithësi, metodat e dekontaminimit, përdorimit të antidoteve apo pajisjeve ndihmëse gjatë ndodhjes së një emergjence kimike. Rritja e kapaciteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal i autoriteve kompetente për identifikimin dhe vlerësimin e raporteve të sigurisë së aktivitetëve industriale që përbëjnë risk për aksident industrial për shkak të substancave të rrezikshme, përbën një kërkesë të domosdoshme. Kapacitetet ekzistuese në terma praktikë janë mjaft të kufizuara, veçanërisht përsa i përket transportit të vijtimave të aksidenteve që përfshijnë kimikate të rrezikshëm. Qendra Kombëtare e Trajnimit duhet të organizojë trajnime në nivel lokal për **parandalimin, gadishmërinë dhe përgjigjen ndaj emergjencave kimike** për autoritetet kompetente dhe operatorët industrialë. Nevojitet gjithashtu rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë mbi rrezikun e aksidenteve industriale. Një nga problemet e identifikuar është edhe mungesa e një databaze të aktivitetëve industriale që përbëjnë risk për aksidente me natyrë kimike.

Mungon një **regjistër kombëtar për regjistrimin e aksidenteve** që mund të ndodhin nga kimikatet dhe nuk ka një institucion të specializuar teknik që kryen mbikqyrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi të aksidenteve. Mungon akoma një sistem për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave për sasi të llojet e mbetjeve industriale që prodhohen nga aktiviteti industrial pas viteve 1992.

Në kuadër të nevojës për **forcimin e kapaciteteve** mbi menaxhimin e kimikateve në vend nevojitet të ngrihen programe të mirëfillta trajnimesh për inspektorët dhe stafet profesionale, të cilat të jenë të qëndrueshëm dhe metodologjikisht të konsoliduar si në trajtën e programeve të plotë për formimin e kuadrit të ri, ashtu edhe programe të shkurtër rifreskues. Në sistemin e shëndetësisë funksionimi i programeve të trajnimit do ishte mirë të mbështetej edhe nga Qendra Kombëtare e Edukimit të Vazhduar, e cila zbaton sistemin e krediteve për stafin shëndetësor. Programe trajnimi mund të organizohen edhe për biznesin, mbi ruajtjen e sigurt të kimikateve, sigurinë dhe shëndetin në punë, GHS, etj. Ka nevojë urgjente për trajnim mbi vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, si dhe në termat e koncepteve të epidemiologjisë së

aplikuar dhe survejancës për të gjithë specialistët që punojnë në fushën e menaxhimit të kimikateve. Ka ende nevojë për ndërhyrje në nivelin universitar për zhvillimin e një kurrikule për sigurinë ndaj kimikateve. Krahas Paketës së Gjelbër, duhet të futet si lëndë e veçantë në shkollat e larta të sistemit Bachelor siguria dhe shëndeti në punë, veçanërisht në shkollat mjekësore dhe ato të tjera profesionale.

Infrastruktura laboratorike ka nevojë të përmirësohet metodologji dhe teknologji e reja. Një sistem i brendshëm cilësie duhet të vendoset në të gjitha laboratorët dhe laboratorët duhet të akreditohen. Ka nevojë të zhvillohen procedura për menaxhimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshme si dhe për nxjerrjen jashtë përdorimit të mbetjeve të tyre.

Mungon një sistem i sigurt për **administrimin e mbetjeve të rrezikshme** (mbetjeve industrial dhe shtëpiake). Mbetet akoma problem mungesa e ndarjes së mbetjeve në burim. Mbledhësit privatë dhe kompanitë e ndryshme përballen me probleme në mbledhjen e mbetjeve të pastra dhe të ndara. Mungon një landfill industrial në vend për mbetjet e përcaktuara dhe të klasifikuara sipas konventës së Baselit. Ka nevojë për analiza dhe përmirësim të kushteve për ruajtjen dhe përdorimin e kimikateve në shëndetin publik si dhe për më shumë fonde për sigurimin e veshjeve mbrojtëse për puntorët, etj. Trajnimi i stafit për trajtimin me biocide është shumë i rëndësishëm.

Nevojitet një program i përbashkët midis MSh, ISHP dhe Bashkive, i cili të jetë efikas për një **kontroll të integruar të dëmtuesve** (pesteve) në shëndet publik dhe bujqësi. Po kështu, duhen promovuar alternativa natyrore dhe më pak të dëmshme ndaj kimikateve të përdorimit shtëpiak.

Ndërgjegjësimi për rreziqet e kimikateve është ende i ulët. Ndërgjegjësimi si dhe trajnimi i grupeve të ndryshme të profesionistëve, si fermerëve, transportuesve, industrialistëve, stafit teknik, si edhe i konsumatorëve, për sigurinë në përdorimin e kimikateve, është një hap i rëndësishëm për uljen e këtyre risqeve. Mungon bashkëpunimi mes institucioneve dhe organizatave të ndryshme për rritjen e sensibilizimit dhe ndërgjegjësimit. Duhet rritur dhe strukturuar roli i mediave dhe duhet të rritet komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale

Përgjegjësia për ndotjen është një çështje e rëndësishme në pastrimin e zonave të ndotura dhe privatizimit të tyre. Nevojitet një legjislacion specifik për përgjegjësinë për ndotjen industriale të mëparshme dhe qartësimi i përgjegjësisë për ndotjen.

Nevojitet hartimi dhe zbatimi i një **plani kombëtar veprimi** për menaxhimin e kimikateve, çka do mundësojë plotësimin e mangësive të shumta të identifikuara gjatë rishikimit të Profilit Kombëtar.

KAPITULLI 1: INFORMACION KOMBËTAR I PËRGJITHSHËM

Qëllimi i këtij kapitulli është të japi informacion të përgjithshëm për vendin. Janë dhënë karakteristikat gjeografike dhe natyrore të Shqipërisë, duke përfshirë terrenin, klimën, sipërfaqen, ujrat nëntokësore dhe detarë si dhe pyjet, informacion i përgjithshëm mbi demografinë, popullsinë, edukimin, migrimin dhe punësimin në Shqipëri.

Forma e qeverisjes së Shqipërisë është Republikë Parlamentare me pushtetin qendror që ushtrohet nga qeveria dhe pushtetin gjyqësor të ushtruar nga gjykatat. Shqipëria është ndarë në 12 prefektura, 36 rrethe, 374 komuna.

Ekonomia bazohet në iniciativën e lirë, ku 80 % e prodhimit të brendshëm vjen nga sektori privat. Rritja ekonomike vitet e fundit ka qenë mesatarisht 4-5 % në vit.

Sipas të dhënave të INSTAT-it për vitin 2008, industria ka kontribuar me 9.8 % në prodhimin e brendshëm bruto (PBB), sektori bujqësor dhe peshkimi me 18.5% dhe sektori i shërbimeve, duke përfshirë tregëtinë, hotelerinë, transportin, komunikacionin si dhe shërbime të tjera, ka kontribuar me 50.7% në PBB. Industritë kryesore në Shqipëri janë industria e nxjerrjes së naftës dhe gazit, industria e përpunimit, industria e lehtë, industria ushqimore dhe e pijeve, industria e prodhimit të çimentos, metalurgjise dhe minierave. Bujqësia mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë. Zhvillimi i industrisë dhe sektorit minerar në disa rajone të vendit ka shkaktuar prodhimin e mbetjeve sterile dhe kimikateve të cilat janë shkatërruar në vende të cilat nuk i përmbushin kriteret mjedisore.

Sipas të dhënave të INSTAT-it për periudhën 2006-2009 'Tumoret' dhe 'Dëmtimet e jashtme dhe helmimet' ishin përkatësisht shkaktari i dytë dhe i tretë i vdekjeve në Shqipëri mbas sëmundjeve të sistemit të qarkullimit të gjakut, me përkatësisht rreth 85 dhe 30 vdekje/100'000 banorë/vit.

1.1 Karakteristikat gjeografike dhe natyrore



Republika e Shqipërisë shtrihet në Europën Juglindore, në perëndim të Gadishullit Ballkanik, dhe laget nga detet Adriatik (bregdet ranor) dhe Jon (bregdet shkëmbor). Koordinatat e saj gjeografike janë 39°38' (Konispol) dhe 42°39' (Vermosh) shtrirje jug - veri, dhe 19°16' (Ishulli i Sazanit) dhe 21°40' (Fshati Vernik, Korçë) shtrirje perëndim - lindje.

Sipërfaqja e Shqipërisë është 28'748 km² nga të cilat 27'398 km² është tokë dhe 1'350 km² është ujë. Numri i banorëve për vitin 2009 është 3'194'417 banorë dhe dendësia e popullsie 110.03 banorë/km².

Gjatësia e përgjithshme e vijës kufitare është 1'094 km, nga të cilat 657 km kufi tokësor, 316 km kufi detar, 48 km kufi lumor dhe 73 km kufi liqenor. Në veriperëndim Shqipëria kufizohet me Malin e Zi, në verilindje me Kosovën, në lindje me Maqedoninë, në jug dhe juglindje me Greqinë.

Terreni

Shqipëria është kryesisht një vend malor. Afërsisht 3/4 e territorit të saj përbëhen nga vende malore mbi 300 m mbi nivelin e detit. Maja më e lartë është Maja e Korabit (2'751 m).

Pjesa tjetër përbëhet nga rrafshina bregdetare ose kodra të ulëta. Shqipëria dallohet për një shtrirje të njësive strukturore magmatike terrigene e karbonatike me orientim përgjithësisht VP- JL, e shprehur po në të njëjtin drejtim edhe në vargjet malore e kodrinore të vendit. Gjatë gjithë periudhës alpine të re të zhvillimit, pjesa më e madhe e strukturave të Albanideve janë përfshirë nga lëvizje tektonike ngritëse, duke përcaktuar kështu mbizotërimin në Shqipëri të relievit kodrinor— malor, kurse nga uljet tektonike janë formuar ultësirat, gropat dhe fushëgropat midis vargjeve malore dhe kodrinore, të cilat kanë përcaktuar edhe kontrastet e theksuara të natyrës alpine të këtij relievi, me lartësi mesatare 708 m dhe maksimale 2'751m. Vargjet dhe blloqet malore e kodrinore grupohen në tre krahina: Veriore, Qëndrore dhe Jugore, ndërsa ultësira shtrihet në perëndim, gjatë bregdetit Adriatik midis Hanit të Hotit në Veri dhe Vlorës në Jug.

Klima

Pozita gjeografike e Shqipërisë përcakton përfshirjen e territorit në zonën klimatike mesdhetare subtropikale, me dimër të butë dhe të lagësht, verë të nxehtë dhe të thatë dhe me reshje të përqëndruara kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit. Ndikimi detar ndihet mjaft mirë gjatë Ultësirës Bregdetare, kurse drejt Lindjes ai dobësohet, duke u shprehur në uljen e temperaturave dhe pakësimin e sasisë së reshjeve. Në përgjithësi, elementët klimatikë kanë ndryshime të konsiderueshme në krahina të ndryshme të vendit tonë, veçanërisht temperaturat dhe reshjet. Vlerat mesatare vjetore të temperaturave lëkundën nga 17,6 °C (Sarandë) deri në 7°C (Vermosh), me ato të Janarit përkatësisht nga 10°C deri në 3°C dhe ato të Korrikut midis 21°C dhe 17°C. Temperaturat më të ulëta janë regjistruar në Sheqeras (-25,8°C) dhe Voskopojë të Korcës (-25,6°C) dhe në Bizë (-4,7°C), kurse ato më të larta janë vërejtur në Kuçovë (43,9°C), Roskovec të Fierit (42,8°C) dhe në Çiflig të Sarandës (42,4°C). Vendi ynë dallohet për sasinë e madhe të reshjeve, të cilat përqëndrohen kryesisht në veri, perëndim dhe jugperëndim, me një vlerë mesatare vjetore 1'430 mm. Shpërndarja stinore territoriale e tyre paraqitet e ndryshme: pjesa më e madhe (rreth 70%) bie gjatë gjysmës së ftohtë të vitit. Territorët më të lagështa janë Alpet Shqiptare (Boga me 3'094 mm) dhe Kurveleshi në Jug (Nivicë 2'425mm). Zonat malore të vendit janë të pasura në rreshje bore me lartësi mesatare 60-120cm, kurse lartësia më e madhe ka arritur 2-3 m në Vermosh, Bogë, Theth, Valbonë, Curraj të Epërm, Lurë etj.

Ujrat sipërfaqësore: Për shkak të relievit të thyer, *lumenjtë* janë të rrëmbyer dhe kanë forcë të madhe erozioni. Lumenjtë Buna, Drin, Mat, Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë derdhen në Detin Adriatik; Lumi i Bistricës derdhet në Detin Jon. Lumenjtë që derdhen në Detin Adriatik formojnë një sërë lagunash dhe moçalesh bregdetare. Lumenjtë e Shqipërisë janë një burim i rëndësishëm i energjisë hidrike. Lumenjtë kryesorë të Shqipërisë jepen në tabelën 1.A-1.

Tabela 1.A-1: Lumenjtë kryesorë të Shqipërisë dhe karakteristikat përkatëse

Lumenjtë	Gjatësia brenda shtetit (km)	Sipërfaqja (km ²)	Lartësia(m)
Drin	285	14'173	971
Seman	281	5'649	863

Lumenjtë	Gjatësia brenda shtetit (km)	Sipërfaqja (km ²)	Lartësia(m)
Vjosa	272	6'706	855
Shkumbin	181	2'444	753
Mati	115	2'441	746
Erzeni	109	760	435

Burimi: INSTAT

Liqenet kanë origjinë të ndryshme: liqene akullnajore në zonat malore, liqene karstike në zonat kodrinore dhe liqene tektonike, si të Shkodrës, Ohrit dhe Prespës. Liqenet kodrinore dhe malore janë të rëndësishëm nga pikëpamja e ekosistemeve turistike. Ndër liqenet artificialë të ndërtuara për prodhimin e energjisë elektrike hidrike, ata më të mëdhenjtë janë në zonën veriore të vendit ku përmenden liqenet e ndërtuara mbi lumin Drin (Fierza, Vau Dejës, Komani) dhe në lumin Mat (Ulza dhe Shkopeti). Liqene artificialë që përdoren për ujëjitjen e tokave bujqësore janë rezervuari i Gjancit, Thanës, Kurjanit, Bezhanit etj. Liqenet kryesore natyrale dhe artificialë të Shqipërisë jepen në tabelën 1.A-2.

Tabela 1.A-2: Liqenet kryesore të Shqipërisë dhe karakteristikat përkatëse

Liqenet	Sipërfaqe (km ²)	Lartësia mbi nivelin e detit (m)	Thellësia(m)
Liqenet natyrale			
Shkodra	368	5	9
Ohri	362.6	695	287
Prespa	285	853	35
Buntriti	16.3	0	21
Liqenet artificiale			
Fierza	72.6	295	128
Vau i Dejës	24.7	74	52
Ulza	12.5	129	61

Burimi : INSTAT

Ujrat nëntokësore në Shqipëri janë një pasuri natyrore shumë e rëndësishme sepse janë burimi kryesor për ujë të pijshëm. Furnizimi me ujë të pijshëm realizohet duke përdorur burimet ujore nëntokësore të nxjerra me anë të qarkullimit të detyruar. Rrjetet e ujit të pijshëm ofrojnë ujë jo vetëm për përdorim shtëpiak, por edhe për përdorim industrial.

Ujrat detare: Bregdeti shqiptar përbëhet nga vijat bregdetare të detit Adriatik dhe detit Jon. Niveli më i lartë i detit vërehet gjatë muajve nëntor dhe dhjetor, sepse erërat e forta jugore në këtë periudhë e shtyjnë masën ujore në drejtim të veriut, duke shkaktuar rritjen e nivelit të detit. Niveli më i ulët i detit vihet re në muajt korrik dhe gusht, që është edhe periudha më e qetë e vitit.

Pyjet mbulojnë 36% të territorit shqiptar. Ato përbëhen nga pyje të lartë (45.7%) dhe korije (54.3%). Sipas funksioneve të tyre, pyjet ndahen në pyje prodhuese (86.0%) dhe pyje mbrojtëse (14.0%). Gjithashtu mund të dallojmë mes pyjeve natyrore, që përbëjnë 91.2% dhe pyjeve ose plantacioneve artificiale (të krijuara nga njeriu) me 8.8%. Pyjet në Shqipëri përdoren për prodhim dhe mbrojtje, për të plotësuar nevojat e konsumatorëve për dru (në industrinë e drurit, ndërtim, etj.) dhe për dru zjarri, si dhe për funksione të tjera (kontroll i erozionit, ruajtja e biodiversitetit, çlodhje, turizëm, gjah, sporte, etj.).

Sipërfaqja e përgjithshme e fondit pyjor për vitin 2009 ishte 1'071'880 hektarë, me një vëllim të përgjithshëm të lëndës drusore rreth 76 milionë m³. Volumi i lëndës drusore në pyje shtetërore të shitur për vitin 2009 ishte 92'881m³, nga ku 25'959m³ ishin lëndë punimi dhe

66'922 m³ ishin dru zjarri. Ndërsa në pyjet komunale volumi i lëndës drusore të shitur në total ishte 9'976 m³.

1.2 Demografia

Tabela 1.A-3: Të dhëna të përgjithshme

Gjuha zyrtare	Shqip
Popullsia në Total (2011)	3'194' 417 banorë
Dendësia e popullsisë	110.03 banorë/km ²
Numri i Lindjeve në 2009	29'189
Popullsia urbane	1'498'508
Popullsia rurale	1'301'630
Numri i Vdekjeve, 2009	15'662
Martestat	17'875
Jetëgjatësia Mesatare (vite)	75.3
Femra-	77.8
Meshkuj-	72.9
PBB, 2008	1'088'132 mln lekë
Shkalla e papunësisë, 2009	13.8%
Niveli i punësimit, 2009	53.4%
Numri i mjeteve të transportit rrugor	397'981
Aksidentet rrugore, 2009	1'800
Numri i nxënësve 2008-2009	187'000
Numri i studentëve 2008-2009	29'000

Burimi: INSTAT

Tabela 1.A-4: Grupmoshat përfshirë në arsim sipas nivelit arsimor në vitin 2008, në %

Parashkollor	Arsimi bazë		Arsimi i Mesëm	Arsimi i Lartë
	Niveli i parë	Niveli i dytë		
53	93	97	73	30

Burimi: INSTAT

Tabela 1.A-5: Të dhëna demografike për periudhën 2006-2009

	Lindjet			Vdekjet			Martestat
	Femra	Meshku j	Total	Femra	Meshkuj	Total	
2006	15'979	18'250	34'229	7'600	9'082	16'682	21'332
2007	15'524	17'639	33'163	6'448	8'080	14'528	22'371
2008	17'138	19'113	36'251	7'015	8'911	15'926	21'290
2009			29'189			15'662	17'875

Burimi: INSTAT

Tabela 1.A-6: Popullsia mesatare vjetore ('000)

	2006	2007	2008	2009
Popullsia	3'142	3'161	3'182	3'194
0-15 vjec	793	775	762	747
15-59	1'963	2'049	2'126	2'147
60+	386	337	294	300

Burimi: INSTAT

Tabela 1.A-7: Popullsia sipas qarqeve, viti 2009

Qarku	Gjithsej	Meshkuj	Femra
-------	----------	---------	-------

Berat	170'815	86'098	84'717
Dibër	140'007	67'761	72'246
Durrës	310'442	153'219	157'223
Elbasan	343'054	173'818	169'236
Fier	374'005	188'759	185'246
Gjirokastrë	102'531	51'709	50'822
Korçë	257'530	128'650	128'880
Kukës	79'289	38'640	40'649
Lezhë	158'800	77'252	81'548
Shkodër	246'016	124'160	121'856
Tiranë	800'199	409'128	391'071
Vlorë	211'734	104'828	106'906

Burimi: INSTAT

Migrimi: Popullsia shqiptare konsiderohet një popullsi e re. Pas vitit 1990 ajo njohu dukuri të reja siç ishte migracioni, që ndikoi mjaft si në strukturën ashtu edhe në ritmet e rritjes së saj. Lëvizja e lirë dhe e pakontrolluar e popullsisë brenda vendit ka ndikuar në ndryshimin e raportit të popullsisë qytetare me atë fshatare. Dallojmë dy tipa të ndryshëm të migrimit: migrim në distanca të gjata, i drejtuar në polet kryesore ekonomike në qendër të vendit; migrim në distanca disi të shkurtra në drejtim të bregdetit, i cili është një rajon imigrimi dhe emigrimi. Imigrantët e prefekturave të Tiranës dhe të Durrësit përbënin përkatësisht 23% dhe 18% të popullsisë së përgjithshme banuese në vitin 2001. Në prefekturat e Vlorës, Lezhës dhe Fierit, ky tregues ishte përkatësisht 9%, 7% dhe 6%, ndërsa në prefekturat e tjera ky tregues ishte në një nivel të papërfillshëm, nën 3%. Pothuajse të gjitha prefekturat me një bilanc pozitiv migrator kanë pësuar një rritje të popullsisë urbane, p.sh. 62% të imigrantëve në Durrës dhe 62% e atyre të Elbasanit janë vendosur në zonat urbane.

Pas vitit 1990 rreth 1/5 e popullsisë, ose rreth 0.75 milion individë, jetojnë jashtë Shqipërisë si emigrantë.

Punësimi

Në Shqipëri gjatë vitit 2009 rezultojnë 16.6% të punësuar në sektorin shtetëror, rreth 43.7% në sektorin privat bujqësor dhe 39.8% në sektorin privat jo bujqësor. Të dhënat mbi punësimin jepen në tabelat 1.A-8 dhe 1.A-9.

Tabela 1.A-8: Tregues të forcave të punës ('000) për periudhën 2007-2009

Treguesi	2007	2008	2009
Popullsia (në fund të vitit)	3'170	3'193	3'195
Popullsia në moshë pune	2'106	2'052	2'150
Forcat e punës	1'082	1'290	1'346
Niveli i punësimit (%)	56.4	53.8	53.4
Të punësuar	1'198	1'123	1'160
Të papunë	185	168	185
Shkalla e papunësisë (%)	13.2	12.5	13.6
-meshkuj	11.2	10.4	11.5
-femra	16.3	15.9	16.7

Burimi: INSTAT

Tabela 1.A-9: Të papunë të regjistruar sipas grupmoshës

Grupmosha	2006	2007	2008	2009
15-19	11'250	10'616	10'220	9'073
20-24	24'542	21'887	20'920	20'199
25-34	35'577	34'053	31'670	32'363
35+	78'433	76'315	77'789	80'433
Gjithsej	149'794	142'871	140'599	142'068

1.3 Struktura politike

Forma e qeverisjes së Shqipërisë është republikë parlamentare. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës është kryetar i shtetit. Presidenti zgjidhet nga parlamenti për një mandat katërvjeçar dhe gëzon të drejtën dhe për një mandat të dytë. Kryeministri është Kryetari i Qeverisë, e cila përbëhet nga 15 ministri.

Pushteti qëndror ushtrohet nga Qeveria, ndërsa pushteti vendor ushtrohet nga organet vendore, ku përfshihen bashkitë dhe komunat. Pushteti legjislativ ushtrohet nga parlamenti dhe qeveria. Kuvendi i Shqipërisë përbëhet nga 140 deputetë që përfaqësojnë koalicionet “Aleanca e Ndryshimit” me 70 deputetë, “Bashkimi për ndryshim” me 66 deputetë dhe “Aleanca Socialiste për Integrim” me 4 deputetë.

Pushteti gjyqësor ushtrohet vetëm nga gjykatat dhe prokuroritë, në përputhje me Kushtetutën dhe kompetencave që u ngarkohen atyre me ligj. Gjyqtarët kanë kompetencë të shqyrtojnë të gjitha çështjet penale, penale ushtarake, civile, administrative si dhe çdo çështje tjetër të përcaktuar me ligj, ndërsa prokurorët kanë për detyrë të marrin pjesë në gjyqe penale dhe jo civile. Sistemi shqiptar i drejtësisë përbëhet nga Gjykatat e Faktit, Gjykatat e Apelit, Gjykata e Lartë.

Në pushtetin qëndror, çështjet e mbrojtjes të mjedisit, shëndetit si dhe përdorimit të tokës trajtohen nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU), Ministria e Shëndetësisë (MSh) dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), të cilat hartojnë politikat, strategjitë dhe planet përkatëse.

Sipas Ligjit Nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, përgjegjësitë kryesore të qeverisjes vendore në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë: të hartojnë plane vendore për mbrojtjen e mjedisit, duke integruar mbrojtjen e mjedisit në planet e rregullimit të territorit, të përcaktojnë vendet e grumbullimit e të përpunimit të mbeturinave prodhuese dhe jetësore në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit, të organizojnë depozitimin e mbetjeve dhe të lëndëve të rrezikshme dhe ruajtjen e zonave të gjelbra në qendrat qytetëse dhe rreth tyre, të administrojnë mbeturinat qytetëse, impiantet e trajtimit të ujrave të ndotura dhe të mbeturinave të ngurta, ruajtja dhe zhvillimi i pyjeve, kullotave dhe burimeve natyrore me karakter vendor.

Ndarja administrative

Shqipëria ndahet administrativisht në 12 qarqe, 36 rrethe, 374 komuna/ bashki.

Lokalizimi i grupeve etnike


Shqiptarët janë grupi etnik më i madh në Shqipëri, afro 98 %.

Shqiptarët ndahen në dy grupe mëdha gjuhësore: gegët dhe toskët që përveç disa ndryshimeve në gjuhë dallojnë edhe në kulturë dhe në besimin fetar. Toskët shtrihen në Jug të vendit dhe ndahen në Myslimanë (Suni dhe Bektashi) dhe në të krishterë ortodoksë, kurse Gegët shtrihen

Tabela 1.A-10: Ndarja administrative

Qarku Prefecture	Rrethi District	Nr. i Bashkive No. Municipality	Bashki Municipality	Nr. Qyteteve No. Cities	Qytete City	Komuna Comunes	Fshatra Vilages
Gjithsej/Total		65		72		308	2,980
1 BERAT		5		5		20	245
	Berat	2	Berat, Urë Vajguore		Berat, Urë Vajguore	10	122
	Kuçovë	1	Kuçovë		Kuçovë	2	18
	Skrapar	2	Çorovodë, Poliçan		Çorovodë, Poliçan	8	105
2 DIBËR		4		6		31	280
	Diber	1	Peshkopi		Peshkopi	14	141
	Bulqizë	1	Bulqizë		Bulqizë, Krastë	7	63
	Mat	2	Burrel, Klos		Burrel, Klos, Ulëz	10	76
3 DURRËS		6		6		10	106
	Durrës	4	Durrës, Shijak		Durrës, Shijak, Manzhë, Sukth	6	62
	Krujë	2	Krujë, Fushë-Krujë		Krujë, Fushë-Krujë	4	44
4 ELBASAN		7		6		43	396
	Elbasan	3	Elbasan, Cërrik, Belsh		Elbasan, Cërrik	20	177
	Peqin	1	Peqin,		Peqin	5	49
	Gramsh	1	Gramsh		Gramsh	9	95
	Librazhd	2	Librazhd, Prrenjas		Librazhd, Prrenjas	9	75
5 FIER		6		6		36	278
	Fier	3	Fier, Patos, Roskovec		Fier, Patos, Roskovec	14	117
	Lushnjë	2	Lushnje, Divjakë		Lushnje, Divjakë	14	121
	Mallakastër	1	Ballsh		Ballsh	8	40
6 GJIROKASTËR		6		6		26	271
	Gjirokastër	2	Gjirokastër, Libohovë		Gjirokastër, Libohovë	11	96
	Tepelenë	2	Tepelenë, Memaliaj		Tepelenë, Memaliaj	8	77
	Përmet	2	Përmet, Këlcyrë		Përmet, Këlcyrë	7	98
7 KORÇË		6		6		31	345
	Korçë	2	Korçë, Maliq		Korçë, Maliq	14	153
	Kolonjë	2	Ersekë, Leskovik		Ersekë, Leskovik	6	76
	Devoll	1	Bilisht		Bilisht	4	44
	Pogradec	1	Pogradec		Pogradec	7	72
8 KUKËS		3		3		24	187
	Kukës	1	Kukës		Kukës	14	89
	Has	1	Krumë		Krumë	3	30
	Tropojë	1	Bajram Curri		Bajram Curri	7	68
9 LEZHË		5		9		16	168
	Lezhë	1	Lezhë		Lezhë, Shëngjin	9	62
	Mirditë	2	Rrëshen, Rubik		Rrëshen, Rubik, Kurbnesh, Reps	5	80
	Kurbin	2	Laç, Mamurras		Laç, Mamurras, Milot	2	26
10 SHKODËR		5		6		28	272
	Shkodër	2	Shkodër, Vau-Dejës		Shkodër, Vau-Dejës	15	141
	Malsi e Madhe	1	Koplik		Koplik, Bajzë	5	56
	Pukë	2	Pukë, Fushë-Arrëz		Pukë, Fushë-Arrëz	8	75
11 TIRANË		5		6		24	233
	Tiranë	3	Tiranë, Kamëz, Vorë		Tiranë, Kamëz, Krrabë, Vorë,	16	167
	Kavajë	2	Kavajë, Rrogozhinë		Kavajë, Rrogozhinë	8	66
12 VLORË		7		7		19	199
	Vlorë	4	Vlorë, Himarë, Orikum, Selenicë		Vlorë, Himarë, Orikum, Selenicë	9	99
	Sarandë	2	Sarandë, Konispol		Sarandë, Konispol	7	62
	Delvinë	1	Delvinë		Delvinë	3	38

në Veri dhe ndahen në Myslimanë (shumica dërmuese suni dhe pakica bektashi) dhe në të krishterë katolikë.



Pakica kombëtare më e madhe që jeton në territorin e Republikës së Shqipërisë është pakica *greke*. Popullsia e saj, sipas të dhënave nga Regjistrimi i Përgjithshëm i Popullsisë dhe i Banesave i vitit 1989 ishte 58'758 banorë. Pjesa dërmuese e saj jeton në jug të vendit, në 40 fshatra të rrethit Gjirokastrë, 35 fshatra të Sarandës, 16 fshatra të Delvinës dhe 3 fshatra të Përmetit.

Vllahët/arumunët zyrtarisht në Shqipëri janë të njohur si vogëlsi gjuhësore, të ngjashëm me *Romët*. Popullsia me origjinë vllahe/arumune kryesisht është vendosur në Shqipërinë jugore dhe në Shqipërinë e mesme. Vllahët kanë ruajtur zakonet dhe traditat e tyre.

Një minoritet fare i vogël i *Malazezëve* jeton në Veri të Shkodrës. *Maqedonasit* jetojnë në nëntë fshatra rreth Liqenit të Prespës në Korçë si dhe në disa fshatra të tjera në rrethin e Dibrës. Numri i tyre në Shqipëri mund të luhatet nga 5'000-10'000. Nga pikëpamja administrative, të 9 fshatrat minoritare përbëjnë një komunë me emrin komuna e Liqenasit sipas emrit të fshatit Liqenas që është më i madhi.

1.4 Sektorët e zhvillimit

Ekonomia shqiptare bazohet në iniciativën e lirë, ku 80% e produkteve të brendshme vijnë nga sektori privat. Investimet publike të viteve të fundit kanë pësuar rritje në raport me PBB, dhe kanë qënë ndjeshëm shumë më të larta krahasuar me deficitin total. Shumica e këtyre investimeve publike janë financuar nga të ardhurat shtetërore.

Rritja ekonomike e Shqipërisë këto vitet e fundit rezulton të jetë mesatarisht 4- 5 % në vit, duke shënuar rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Rritja e PBB për frymë ka ndikuar pozitivisht në rritjen e standardit të jetesës. Gjatë vitit 2009 është siguruar një rritje pozitive ekonomike prej 3.3% kundrejt PBB.

Tabela 1.B-1: Produkti i brendshëm bruto për periudhën 2005-2008

Produkti i brendshëm bruto	2005	2006	2007	2008
PBB me çmime aktuale	814'797	882'200	967'670	1'088'132
Rritja vjetore e PBB me çmime konstante krahasuar me vitin e mëparshëm, në %	5.7	5.4	5.9	7.7
PBB për frymë në USD	2'597	2'854	3'385	4'076

Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas sektorëve ekonomikë është: tregtia 47.1%, industria 9.3%, hoteleri-bare-restorante 14.8%, transporti e komunikacioni 9.6%, shërbime të tjera 13.3%, ndërtimi 4.6%, bujqësia e peshkimi 1.2%.

Tabela 1.B-2: Pasqyrë e sektorëve ekonomikë kombëtarë

Sektorët ekonomikë kombëtare	Nr. punësuarve%	Nr. ndërmarrjeve	Kontributi në PBB, mln. lekë	Kontributi në Vlerën e Shtuar Bruto, në %
Bujqësia, gjuetia dhe pyjet	44.7	1'702	18.5	19.3
Industria	9.4	9'964	9.8	11.7
-Industria nxjerrëse			1.1	
-Industria përpunuese			8.7	
Ndërtim	8.4	4'245	14.9	11.0
Tregti, hotele dhe restorante	11.7	60'383	21.2	30.5
Transport dhe komunikacion	3.6	10'361	9.6	
Ndërmjetësim financiar				14.1
Shërbime të tjera	22.2	14'032	25.9	13.4

Burimi: INSTAT

Tabela 1.B-3: Struktura e sektorëve kryesorë ekonomikë sipas madhësisë (sipas numrit të punonjësve)

Aktiviteti ekonomik	Gjithsej	Grupuar sipas numrit të të punësuarve			
		1-4	5-9	10-49	50+
Prodhuesit e të mirave	15'911	12'087	1'786	1'637	401
Bujqësia e peshkimi	1'702	1'591	57	43	11
Industria	9'964	8'051	878	752	283
Ndërtimi	4'245	2'445	851	842	107
Prodhuesit e shërbimeve	84'776	79'479	2'992	1'863	442
Tregtia	44'709	42'699	1'307	629	74
Hotele, bare, restorante	15'674	14'829	698	131	16
Transporti e komunikacioni	10'361	9'931	222	166	42
Shërbime të tjera	14'032	12'020	765	937	310
Gjithsej	100'687	91'566	4'778	3'500	843

Burimi: INSTAT

Tabela 1.B-4: Struktura e eksport – importit sipas grupmallrave në %

Grup-malli	Eksport				Import			
	2006	2007	2008	2009	2006	2007	2008	2009
Ushqime, pije, duhan	7.9	7.3	6.4	7.3	17.9	16.2	16.6	17.3
Minerale, lëndë djegëse, energji elek.	7.5	15.4	18.1	20.0	13.9	16.7	17.9	14.4
Produkte kimike e plastike	0.7	0.8	1.0	1.6	11.1	10.5	10.3	11.8
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.9	2.1	1.5	1.5	2.2	2.1	1.6	1.6
Prodhime druri dhe letre	3.2	3.1	3.2	3.3	3.6	3.5	3.4	4.0
Tekstile dhe këpucë	54.8	48.4	43.4	46.8	11.7	10.4	9.0	9.2
Materiale ndërtimi dhe metale	17.1	15.8	20.0	12.5	16.0	15.8	15.4	15.5
Makinëri pajisje dhe pjesë këmbimi	3.8	4.0	4.1	4.7	20.2	20.9	22.1	22.8
Të tjera	3.0	3.0	2.3	2.3	3.5	3.7	3.7	3.4
Gjithsej	100	100	100	100	100	100	100	100

Burimi: INSTAT

Tabela 1.B-5: Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe aktivitetit ekonomik, 2010

Qarqet	Gjithsej	Prodhues it e të mirave	Bujqësia e peshkimi	Industria	Ndërtimi	Prodhuesit e shërbimeve	Tregtia	Hotele, kafe, restorante	Transporti e komunikacioni	Shërbime të tjera
Berat	4'311	747	79	559	109	3'564	2'136	598	436	394
Dibër	2'010	386	33	261	92	1'624	730	319	371	204
Durrës	12'233	2'110	247	1'215	648	10'123	5'573	1'956	1'298	1'296
Elbasan	6'842	1'026	112	734	180	5'816	3'012	960	1'028	816
Fier	9'329	1'509	223	978	308	7'820	4'505	1'336	1'009	970
Gjirokastrë	2'861	566	65	377	124	2'295	1'184	441	319	351
Korçë	6'556	1'046	114	771	161	5'510	3'064	842	856	748
Kukës	915	164	21	79	64	751	400	125	99	127
Lezhë	2'772	575	102	321	152	2'197	1'157	434	263	343
Shkodër	6'088	995	203	596	196	5'093	2'744	1'101	586	662
Tiranë	38'361	5'054	130	3'230	1'694	33'307	16'856	6'111	3'217	7'123
Vlorë	8'409	1'733	373	843	517	6'676	3'348	1'451	879	998
Gjithsej	100'687	15'911	1'702	9'964	4'245	84'776	44'709	15'674	10'361	14'032

Burimi: INSTAT

Industria: Sektori i industrisë ka kontribuar në mënyrë të qëndrueshme me 11% të PBB. Varësia e përhershme e Shqipërisë ndaj nxjerrjes së mineraleve vjen si pasojë e ekzistencës së shumë rezervave që mund të shfrytëzohen për qëllime tregtare. Depozitat e kromit, bakrit dhe nikelit janë hapur prej kohësh, por pajisjet dhe metodat e industrisë së minierave janë tashmë të vjetëruara dhe shumë punime janë braktisur, megjithatë Shqipëria zë një vend të rëndësishëm në Europë për prodhimin e kromit.

Gjithashtu aktivitete të tjera industriale që operojnë në vendin tonë janë ato të industrisë nxjerrëse të naftës dhe gazit natyror, industria përpunuese, industria e lehtë, industria ushqimore dhe pijeve, prodhimi i çimentos si dhe metalurgjia.

Tabela 1.B-6: Volumi i produkteve kryesore industrial në '000 ton

Kodi NP ¹	Industria/ Prudukti	2006	2007	2008	2009
C	Industria nxjerrëse				
11.10.10	Naftë bruto	316	281	216	260
11.10.20	Gaz natyror (mln m ³ N)	11.1	10.4	6.2	7.9
D	Industria përpunuese				
DA	Industria ushqimore e pije				
15.13.12	Produkte mishi	10	10	12	11
15.61.21	Miell	388	191	141	129
15.81.11	Bukë	76	95	101	89
15.96.10	Birrë, mijë hl	348	365	330	249
	Lëndë djegëse				
23.20.11	Benzinë	32	23	16	
23.20.15	Gazoil	99	81	75	
23.20.17	Solar, destilat, mazut	78	85	73	
23.20.32	Koks naftë	64	59	47	
23.20.32	Bitum naftë	83	69	92	
DI	Fabrika përpunim mineralesh jo metalikë				
26.51.12	Çimento	525	889	918 ²	1'108 ²
DJ	Metalurgjia				
27.10.40	Çelike të petëzuar	114	136	194	216
E	Prodhim energji elektrike				
40.10.10	Energji elektrike, mln/kwh	5'551	2'947	3'850	5'230

Burimi: INSTAT

Tabela 1.B-7: Prodhimi i mineraleve për vitet 2007-2010, në '000/ton

Emërtimi	2007	2008	2009	2010
Mineral kromi	187	230	298	305
Mineral bakri	98	105	114	121
Mineral Fe - Ni	354	404	35	35
Gurë	1'346	4'258	6'377	7'566
Argjila	1'097	923	4'309	4'522
Të tjera	425	425	1'200	1'304

Tabela 1.B-8: Punësimi në sektorin minerar 2007-2010

¹ Nomenklatura e Produkteve sipas INSTAT

² E vlerësuar

Emërtimi	2007	2008	2009	2010
Albkromi	60	56	54	50
Albbakri	50	41	38	38
Qymyret	68	71	68	70
Fe-Ni, Ni, Si, të ndryshme	70	65	65	66
Koncesionet	1'270	1'300	1'350	1'565
Privatet	2'808	2'852	2'912	2'900
Gjithsej	4'326	4'385	4'487	4'689

Burimi: METE

Bujqësia mbetet një nga sektorët më të rëndësishëm për ekonominë e vendit. Kontributi i saj është ulur me kalimin e viteve. Familjet që jetojnë në zonat rurale vazhdojnë të kenë peshën më të madhe në ekonominë e vendit; 51.4% e popullsisë banon në zona rurale, ku bujqësia është aktiviteti kryesor për nxjerrjen e të ardhurave për jetesë. Mesatarja reale e normës së rritjes së prodhimit bujqësor gjatë pesë viteve të fundit llogaritet të jetë rreth 3 % në vit

Përdorimi i tokës

Tabela 1.C-1: Struktura e tokës (në 1000 ha)

Lloji i tokës	1998	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
Tokë gjithsej	2'875	2'875	2'875	2'875	2'875	2'875	2'875	2'875	2'875	2'875	2'875
Tokë bujqësore	699	699	699	699	699	699	699	699	698	697	696
%	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24	24
Pyje	1'026	1'026	1'024	1'041	1'041	1'041	1'041	1'043	1'043	1'040	1'043
%	36	36	36	36	36	36	36	36	36	36	36
Livadhe e kullota	445	445	440	441	422	423	423	421	421	484	505
%	15	15	15	15	15	15	15	15	15	17	18
Toka të tjera	703	703	712	692	713	712	712	712	713	654	631
%	25	25	25	25	25	25	25	25	25	23	22

Burimi: MBUMK

Tabela 1.C-2: Sipërfaqja e ujitur (ha)

Rrethi	2006	2007	2008	2009
Berat	3'170	1'508	1'768	10'180
Dibër	12'923	13'405	14'700	16'016
Durrës	3'240	3'308	9'120	13'637
Elbasan	14'195	14'089	9'492	20'699
Fier	18'200	21'299	22'448	47'398
Gjirokastrë	4'598	4'025	4'058	10'045
Korcë	12'178	11'183	15'765	23'291
Kukës	5'808	4'487	5'254	7'861
Lezhë	3'969	4'497	6'005	8'328
Shkodër	11'433	11'853	12'712	15'988
Tiranë	2'496	6'355	5'458	10'864
Vlorë	10'460	10'521	11'150	20'584
Totali	102'670	106'530	117'930	204'891

Burimi: INSTAT

Tabela 1.C-3: Njësitë ekonomike bujqësore

Lloji i njësive	2006	2007	2008	2009
Me bimë dhe blegtori	328'668	331'404	298'496	305'378
Me bimë pa blegtori	39'870	37'508	57'676	48'108
Me bimë arash	366'068	364'917	352'766	350'067
Me pentari	149'636	148'660	144'578	151'784
Me tokë djerrë	123'510	113'384	115'014	105'133

Burimi: INSTAT

Tabela 1.C-4: Numri i fermave blegtorale

Lloji i fermave blegtorale	2006	2007	2008	2009
Me gjedhë	256'356	270'930	226'442	231'055
Me të dhirta	378'484	35'380	261'175	26'275
Me të imta	69'045	69'232	55'942	54'941
Me derra	29'448	44'841	42'036	39'069
Me shpendë	289'527	296'593	273'073	279'552
Me kuaj/gomerë	108'851	108'821	92'299	87'540

Burimi: INSTAT

Tabela 1.C-5: Prodhimi bujqësor

Viti	Drithërat	Sasia '000/ton	Sipërfaqja prodhuese '000/ha
2008	Drithëra buke	608.5	149.1
	Grurë	335.0	83.4
	Misër	245.0	49.0
	Thekër	3.1	1.4
	Elb	3.6	1.4
	Tagjira	21.8	13.9
	Perime e bostan	715.4	29.6
	Patate	190	9.8
	Fasule	21.8	14.3
	Duhan	1.3	1.1
	Luledielli	2.2	1.4
	Sojë	0.6	0.3
	Foragjere të njoma	5.333	194
	Total	2'153.6	548.7
2009	Drithëra buke	629.9	146.1
	Grurë	333.1	82.8
	Misër	265.1	47.6
	Thekër	2.2	1.1
	Elb	4.5	1.7
	Tagjira	25	13
	Perime e bostan	730	30.3
	Patate	200	9.1
	Fasule	23	14
	Duhan	1.6	1.2
	Luledielli	2.3	1.2
	Sojë	0.5	0.3
	Foragjere të njoma	5.326	200
	Total	2'222.5	548.4

Burimi: INSTAT

Tabela 1.C-6: Përdorimi i pesticideve në bujqësi (ton)

	2005	2006	2007	2008	2009
Pesticide	183.4	283.7	226.7	232.3	293.6

Burimi: MBUMK

Spektori i peshkimit është pak i zhvilluar në Shqipëri. Krahësuar me mesataren prej 15.1 kg për frymë në vit të konsumit të produkteve të peshkut për vendet mesdhetare, në Shqipëri konsumi është relativisht i ulët, me rreth 3.3 kg për frymë në vit. Peshkimi në laguna detare (me sipërfaqe 10'000 ha) është i shpeshtë dhe përfitohen nga 42 deri në 97 kg produkt për hektar. Industria e përpunimit të peshkut po zgjerohet.

Energjia: Shqipëria është e pasur me burime të ndryshme energjie, nga nafta dhe gazi, qymyri dhe karburante fosile të tjera, deri te fuqia hidrike, biomasa natyrore e pyjeve dhe të tjera burime energjie të rinovueshme. Hidro-energja përbën mbi 97% të energjisë elektrike të prodhuar. Aktualisht shfrytëzohen vetëm 30% e burimeve hidrike. Spektori i energjisë kontribuon me afërsisht 10% të PBB nëpërmjet kompanive më të mëdha të energjisë: KESH, Shpërndarësi CEZ dhe Albpetrol si dhe kompani të tjera të cilat kanë marrëveshje të lëndëve djegëse (depot e lëndëve djegëse, rrymave të naftës dhe gazit, etj.), ARMO dhe rreth 50 kompani anonime të cilët tregtojnë nënprodukte të naftës dhe gazit.

Burimet e energjisë elektrike në vitet e fundit janë rritur me futjen në efikasitet të hidrocentraleve të reja koncesionare të ndërtuara në 2-3 vitet e fundit. Megjithatë numrin e madh të kontratave koncesionare të realizuara dhe futjen në prodhim të disa hidrocentraleve të ndërtuara nga sektori privat, përsëri pesha që prodhimi nga sektori privat zë në prodhimin e përgjithshëm kombëtar të energjisë elektrike është e vogël, vetëm rreth 2%. Aktualisht numri i HEC-eve të vogla e të mesme të vëna në punë deri në fund të vitit 2010 është 51 në pronësi të 19 shoqërive koncesionare apo private me fuqi të përgjithëshme të instaluar prej 25.9 MW nga 1460 MW që është kapaciteti total i HEC-eve në vendin tonë.

Prodhimi vjetor i energjisë elektrike në 27 vitet e fundit ka varjuar nga një minimum prej 2'940 GWh në vitin 2007 në 7'743 GWh të realizuar në vitin 2010, që përbën edhe rekordin historik të arritur në prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet në vendin tonë. Pra nga pikëpamja energjitike, ky vit u shoqërua me një prodhim të jashtëzakonshëm të energjisë elektrike; nga pikëpamja hidrologjike viti 2010 gjithashtu vlerësohet si një vit me reshje të jashtëzakonshme dhe prurje të lumenjve që përsëriten një herë në 50 vjet.

Nga pikëpamja mjedisore ky vit u shoqërua me përmbytje në shumë rajone të vendit por në mënyrë të veçantë në ultësirën e Shkodrës dhe Lezhës.

Mbi 85% e prodhimit kombëtar të energjisë elektrike realizohet vetëm nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin, prurjet minimale e maksimale të të cilit në vite kanë luhatur të jashtëzakonshme; prurja maksimale mbi atë minimale e këtij lumi që zotëron një pellg ujëmbledhës prej rreth 12'000 km² ndryshon më se 150 herë .

Është shumë e qartë varësia totale e furnizimit të vendit me energji elektrike nga kushtet klimatike. Ndryshimet klimatike periodike sjellin influencë të jashtëzakonshme në menaxhimin e furnizimit me energji elektrike dhe shpesh me pasoja serioze ekonomike e sociale.

Për të minimizuar këtë spontanitet në planifikimin e furnizimit me energji elektrike, zakonisht ndërtimi i burimeve hidroenergjetike shoqërohet me diversitetin e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet ndërtimit të burimeve konvencionale me energji të planifikueshme, siç janë termocentralet ose furnizimit me energji nga importi.

Nisur nga sa më lart, vitet e fundit janë bërë investime serioze për diversifikimin e burimeve të energjisë elektrike me burime termike si dhe me rritjen e kapaciteteve të rrjetit të transmetimit dhe të inter-koneksionit. Kështu, në vitin 2011 ka përfunduar ndërtimi i TEC-it të Vlorës me fuqi të instaluar 97 MW. Gjatë vitit 2011 gjithashtu përfundoi ndërtimi dhe futja nën tension e linjave ajrore të transmetimit me tension 400 kV dhe kapacitet transmetues 1'000 MW, Tiranë-Podgoricë dhe Tiranë-Elbasan, për të bërë të mundur inter-koneksionin ndërshtetëror me vendet e rajonit. Në vitin 2011 përfundoi edhe ndërtimi i nën-stacionit 400/220/110 kV në Kashar, i cili mundëson një shpërndarje të balancuar të energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Po punohet për projektin e ndërtimit të linjës së inter-koneksionit me tension 400 kV Tiranë-Prishtinë si dhe të linjës 400 kV Elbasan-Bitola (Maqedoni).

Sistemi energjitik ka në përdorim sasi shumë të mëdha të vajit mineral, mbi 13'000 ton. Sasia e vajit në transformatorë shkon nga 70 kg deri në 100 ton për transformator. Numri total i transformatorëve të të gjithë kapaciteteve në përdorim, të vendosur në të gjithë objektet energjitike sipas 'Inventarit paraprak për identifikimin e PCB-ve' të vitit 2006 është rreth 12'000 copë. Rreth 98% e numrit total të transformatorëve me kapacitet të ulët të shpërndarjes së energjisë që i përkasin kompanisë CEZ Shpërndarje janë të vendosur në kabina të vogla elektrike dhe shërbejnë për furnizimin e konsumatorëve familjarë. Rreth 4 % e numrit të përgjithshëm të transformatorëve është vendosur në nën-stacione, nga ku rreth 300 transformatorë i përkasin kompanisë CEZ Shpërndarje, 164 transformatorë i përkasin KESH sh.a. dhe 60 transformatorë me kapacitet mjaft të madh i përkasin OST sh.a. Vjetërsia mesatare e transformatorëve është 27 vjet.

Gjithashtu në Objektet e Ushtrisë Shqiptare ka një sasi paisjesh elektrike që përmbajnë vaj, por këta transformatorë janë të fuqisë së ulët, që shkon deri në 560 kV, si rrjedhojë dhe sasia e vajit në këta transformatorë është relativisht e vogël, duke varjuar nga 20 deri 900 kg.

Nga viti 2008 deri më 2010 janë magazinuar në depo të veçanta pranë njësive të gjenerimit të KESH rreth 35'795 kg vaj, i cilësuar nga analizat e kryera si vaj jashtë shfrytëzimit.

Reparti i rigjenerimit të vajit në Tiranë trajton vajin e transformatorëve të dëmtuar dhe që ka humbur cilësitë e tij; është një repart që funksionon prej 40 vitesh dhe që paraqet probleme të ndotjes së mjedisit. Kompania po punon për hartimin e projektit të rehabilitimit të këtij reparti brenda një afati sa më të shkurtër.

Transporti ka ndikim direkt në cilësinë e mjedisit në përgjithësi dhe zonave urbane në veçanti. Sektori i transportit është një nga burimet kryesore të emetimit të gazeve serrë, dhe gjithashtu rrit në nivele të konsiderueshme ndotjen e ajrit.

Transporti ajror civil ndërkombëtar kryhet nëpërmjet aeroportit "Nënë Tereza" në Rinas, i vetmi aeroport që kryen transport të këtij lloji. Gjatë vitit 2010 në këtë aktivitet kanë operuar 18 shoqëri ajrore, nga të cilat 16 të huaja dhe 2 të përbashkëta. Numri i fluturimeve dhe ai i pasagjerëve të transportuar në vitin 2010 ishte përkatësisht 2.8 % dhe 10.2 % më i lartë se në vitin 2009. Numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar aeroportin e Rinasit në hyrje dhe dalje për vitin 2010 ka qënë 1'536'822 pasagjerë.

Transporti detar në Shqipëri kryhet nëpërmjet 4 porteve : Durrësi, Vlora, Saranda dhe Shëngjini. Volumi i ngarkim- shkarkimit të porteve në vitin 2010 ishte 0.5 % me i ulët se ai i vitit 2009. Porti më i madh dhe më i rëndësishëm është ai i Durrësit, i cili për vitin 2010 realizoi 81.8 % të volumit të përgjithshëm të ngarkim - shkarkimit të porteve. Transporti detar ndërkombëtar i pasagjerëve ka shënuar një ulje prej 3.5 % në 2010 në krahasim me vitin 2009.

Gjatësia e linjës hekurudhore në shfrytëzim në vitin 2010 është 399 kilometra. Transporti hekurudhor në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009 ka shënuar një rritje të volumit të punës në transportin e mallrave prej 17.5 %. Në transportin e pasagjerëve, në 2010 pati rënie të volumit të punës prej 33.3 % krahasuar me 2009.

Volumi i transportit të naftës me tubacion, i shprehur në ton-kilometra në vitin 2010 ka pësuar një ulje prej 68.4 % në krahasim me vitin 2009.

Përdorimi gjithnjë e më shumë i transportit rrugor privat është shoqëruar me një numër të madh mjetesesh rrugore të cilat kanë shënuar një rritje prej 5.5 % në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009. Në veçanti numri i veturave të pasagjerëve në vitin 2010 është rritur 4.7 % në krahasim me vitin 2009.

Numri i aksidenteve në trafikun rrugor ka shënuar rritje në vitin 2010, në krahasim me 2009 duke çuar në rritje të numrit të aksidentuarve prej 13 %.

Turizmi është rritur në shkallë të konsiderueshme gjatë dy viteve të fundit dhe infrastruktura turistike është përmirësuar ndjeshëm. Rritja është vërejtur si në numrin e njësive të strehimit, ashtu edhe në standardin e shërbimeve. Gjatë vitit 2010 kanë vizituar Shqipërinë rreth 2.9 milion turistë. Numri i hoteleve që kanë mirëpritur vizitorët e huaj për vitin 2010 ishte 290 hotele. Të ardhurat e turizmit në PBB llogariten të jenë 3.8-4% ose rreth 45 miliardë lek, ndërsa kontributi i turizmit në ekonominë shqiptare është rreth 11%. Krahas turizmit bregdetar, po inkurajohen gjithnjë e më shumë produktet e reja turistike, si turizmi rural, që përfshin ekoturizmin, agroturizmin, turizmin sportiv e malor dhe atë kulturor.

Ndërtimi: Gjatë vitit 2010 janë miratuar leje ndërtimi për objekte të llojeve të ndryshme me një vlerë prej 229 miliard lekë. Këtë vit numri i lejeve të miratuara për ndërtesa u rrit 20.3% në krahasim me vitin 2009. Në vitin 2010 numri i lejeve për banesa zinte 69.5 % të numrit total të lejeve për ndërtesa. Prefekturat Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Vlorë vazhdojnë të kenë kërkesat më të mëdha për leje ndërtimi. E veçantë për prefekturat Tiranë e Durrës është kërkesa për objekte me shumë kate, kryesisht për banesa dhe ndërtesa tregtare. Pjesa më e madhe e ndërtimeve, si ndërtesa banimi, hotele, ndërtesa tregtare, ndërtesa industriale etj, janë të financuara kryesisht nga investitorë privatë. Objektet social-kulturore, shëndetësore, infrastruktura janë financuar kryesisht nga investitorë shtetëror. Investitorët privatë janë më të interesuarit për në sektorin e ndërtimit

1.5 Shkarkimet e sektorëve kryesorë të ekonomisë

Shkarkimet nga sektorët ekonomikë kryesorë për 2008 janë dhënë në tabelën 1-E

Tab. 1- E. Shkarkimet e ndotësve në ajër sipas makrosektorëve, viti 2008

Ndotësit	Njësi	Makrosektorët											Totali
		Djegia në Industrinë e energjisë	Implantet djegëse jo-industriale	Djegia në industrinë prodhuese	Proceset e prodhimit	Nxjerrja dhe shpërndarje e lëndës djegëse fosile	Përdorimi i tretësve dhe produkteve të tjera	Transporti rrugor	Burime të tjera të lëvizshëm	Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve	Bujqësia	Burime të tjera	
PCB	kg	0.0	1.0	0.1	1.8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	3.0
SOx	mg	9'905	12'689	3'235	141.5	0,0	0,0	2'451	8'182	0.0	6.3	-	36'609
NOx	mg	366.8	1'178	1'687	435.1	0,0	0,0	16'305	9'117	0.0	36.6	26.8	29'152
PM ₁₀	mg	438.5	7'385	258.3	3'865	0,2	0,0	2'488	601.6	0.0	2'484	3'359	20'879
PM _{2,5}	mg	315.1	7'086	169.8	2'585	0,0	0,0	2'382	547.0	0.0	464.4	3'023	16'571
CO	mg	41.0	50'983	2'052	26'061	0,0	0,0	66'620	635.3	0.9	948.7	56'833	204'174
VOC	mg	6.3	10'192	112.0	897.2	1'601	11'240	7'544	414.9	105.1	43.4	99'590	131'745
NH ₃	mg	0.0	43.4	0.0	0.0	0.0	0.0	152.1	0.4	82.5	23'431	-	23'709
CO ₂	mg	211'376	1'474'099	538'774	547.601	86.6	0.0	2'462'965	234'811	0.0	0.0	793'058.2	6'262'771
CH ₄	mg	7.5	8'003	13.5	11.6	1'135	0.0	0.0	9.1	11'366	67'454	3'897	91'896
N ₂ O	mg	0.8	62.7	7.8	1.2	0.0	0.0	136.9	59.2	194.8	14'599	62.6	15'125
As	kg	10.9	12.6	25.8	3.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.0	53.7
Cd	kg	3.3	10.9	8.3	46.0	0.0	0.0	7.5	0.5	0.0	0.8	-	77.2
Cr	kg	37.2	106.9	51.6	23.0	0,0	0,0	37.3	2.3	0,0	3.9	-	262.2
Cu	kg	30.8	118.7	67.6	4.6	0.0	0.0	1'267	77.6	0.0	0.0	-	1'566
Hg	kg	0.4	8.3	102.6	11.5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	-	122
Ni	kg	2'581	1'693	280.4	161.0	0.0	0.0	52.2	3.2	0.0	3.3	-	4'773
Pb	kg	12.6	490.2	113.6	2'584	0.0	0.0	0.8	0.0	0.0	15.1	-	3'216
Zn	kg	145.5	980.1	441.8	828.0	0.0	0.0	745.2	45.7	0.0	0.5	-	3'186
PCB	kg	0.0	1.0	0.1	1.8	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	3.0
C ₆ H ₆	kg	0.3	37.9	6'740	441.6	2'159	0.0	404.3	0.0	242.1	8.0	-	10'033
BAP	kg	0.0	2'149	9.2	3.9	0.0	0.0	24.0	1.4	0.0	127.6	608.9	2'924
BBF	kg	0.0	2'073	9.0	0.0	0.0	0.0	30.4	2.3	0.0	76.6	608.9	2'800

Ndotësit	Njësi	Makrosektorët											Totali
		Djegia në Industrinë e energjisë	Implantet djegëse jo-industriale	Djegia në industrinë prodhuese	Proceset e prodhimit	Nxjerrja dhe shpërndarje e lëndës djegëse fosile	Përdorimi i tretësve dhe produkteve të tjera	Transporti rrugor	Burime të tjera të lëvizshëm	Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve	Bujqësia	Burime të tjera	
BKF	kg	0.0	1'296	3.0	0.0	0.0	0.0	26.2	0.0	0.0	38.3	338.3	1'701
INP	kg	0.0	1'535	4.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	51.0	473.6	2'064
HCB	kg	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1.3	1.4

Burimi: Raporti për inventarin e ndotësve të ajrit në Shqipëri në kuadër të konventës CLRTAP (MMPAU)

1.6 Vlerësimi

Periudha e tranzicionit në Shqipëri gjatë viteve '90 ka ndikuar në mbylljen e shumë ndërmarrjeve të prodhimit industrial dhe minerar. Mbetjet dhe kimikate të gjeneruara nga aktivitetet janë të depozituara në dampa apo në magazina për një kohë të gjatë, duke krijuar kështu zona shumë të ndotura, të cilat kanë një ndikim negativ në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve që jetojnë pranë këtyre zonave.

Gjithashtu lëvizja e lirë dhe e pakontrolluar e njerëzve drejt zonave urbane pas viteve '90 ka ndikuar në rritjen e popullsisë dhe, për pasojë, dhe në rritjen e sasisë së mbetjeve urbane dhe të mbetjeve kimikate. Shumë prej familjeve që kanë migruar nga një vend në tjetrin janë sistemuar në godina të cilat ndodhen në zonat e ndotura, duke përbërë problem për shëndetin e tyre dhe, njëkohësisht, për menaxhimin e kimikateve që ndodhen në këto zona.

Përsa i përket menaxhimit të kimikateve, qeverisja vendore është përcaktuar si përgjegjëse për organizimin e depozitimit të mbetjeve dhe të lëndëve të rrezikshme.

Agjencitë Rajonale të Mjedisit të ngritura në nivel prefekturash dhe në varësi të MMPAU janë organe të specializuara për monitorimin dhe kontrollin e mjedisit dhe të elementëve të tij. Inspektorati i Mjedisit ushtron kontroll të vazhdueshëm ndaj veprimtarive ndotëse, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit të legjislacionit mjedisor.

Zhvillimi në sektorin industrial dhe minerar në disa rajone të vendit tonë ka ndikuar në gjenerimin e mbetjeve të sterileve dhe kimikateve, të cilat hidhen në vend-depozitime që nuk plotësojnë kushtet mjedisore.

Lëvizja e popullsisë dhe rritja e ndërtimeve në zonat urbane ka ndikuar në uljen e sipërfaqes së tokës së gjelbëruar dhe për prodhim bujqësor. Këto fenomene janë pasuar edhe me rritjen e volumit të mbetjeve inerte.

Migrimi i popullsisë dhe rritja e ndërtimeve në zonat urbane ka pasur një impakt në uljen e sipërfaqeve të tokave me bimësi si dhe tokave për prodhim bujqësor.

Sipas të dhënave të INSTAT-it për periudhën 2006-2009 'Tumoret' dhe 'Dëmtimet e jashtme dhe helmimet' ishin përkatësisht shkaktari i dytë dhe i tretë i vdekjeve në Shqipëri mbas sëmundjeve të sistemit të qarkullimit të gjakut, me përkatësisht rreth 85 dhe 30 vdekje/100'000 banorë/vit.

KAPITULLI 2: PRODHIMI, IMPORTI, EKSPORTI, RUAJTJA, TRANSPORTI, PËRDORIMI DHE ASGJËSIMI I KIMIKATEVE

Qëllimi i këtij kapitulli është të japë informacion bazë rreth situatës ekzistuese të kimikateve në vend përgjatë gjithë ciklit jetësor të tyre.

Janë dhënë informacione rreth prodhimit të kimikateve nga industria, si dhe të dhëna mbi importin dhe eksportin e kimikateve. Gjithashtu janë dhënë informacione rreth produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB), si dhe një përshkrim i shkurtër i procedurës së regjistrimit të PMB, janë paraqitur të dhëna rreth përdorimit të kimikateve, në veçanti për PMB, si dhe janë përshkruar disa vështirësi në përdorimin e biocideve. Ruajtja dhe transporti janë trajtuar shkurtimisht për shkak të mungesës së të dhënave.

Zhvillimet politike dhe social - ekonomike mbas viteve '90 kanë luajtur një rol të rëndësishëm në gjithë situatën e menaxhimit të kimikateve në Shqipëri. Këto ndodhi janë të lidhura ngushtësisht me mbylljen masive të ndërmarrjeve prodhuese, me stoqet e kimikateve të papërdorura dhe me zonat e ndotura. Në këtë kapitull janë përmbledhur veprimet për rehabilitimin e disa zonave më të ndotura, si dhe përpjekjet për identifikimin dhe priorizimin e zonave të tjera të ndotura (hotspot).

Në Shqipëri nuk ekziston një sistem i sigurt i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme të prodhuara nga industria apo produktet shtëpiake. Nëpërmjet ndihmës nga jashtë, sasi të konsiderueshme të kimikateve të papërdorura të rrezikshme janë eksportuar jashtë vendit për asgjësim.

Vetëm sasi të vogla të xhamit, hekurit skrap, letrës, plastikës dhe aluminit ndahen për riciklim apo me qëllim eksporti. Aktualisht sektori më i zhvilluar i riciklimit është ai i metaleve. Nuk ekzistojnë ambjente për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme kimike, me përjashtim të një inceneratori për mbetjet spitalore.

2.1 Informacion i përgjithshëm

Para viteve '90, si rezultat i politikës së prodhimit të çdo gjëje në vend, prodhimi i pesticideve, i plehrave kimike, i sodës, i acidit sulfurik, i glicerinës, etj., kishte një përparësi të veçantë. Kimikatet nevojiteshin për të mbajtur bujqësinë dhe industrinë me lëndë të parë, aktivitete këto që mbulonin nevojat e vendit dhe pjesërisht ato për eksport. Kushtet makroekonomike në vend nga fillimi i reformës në fillim të viteve '90 deri në ditët e sotme janë karakterizuar nga procese dinamike, të lidhura me një rënie të konsiderueshme të prodhimit të kimikateve, nga politika monetare të kufizuara, etj. Kjo ka ardhur si pasojë e ngadalësimit të reformave strukturale (privatizimit) dhe kushteve të tjera të jashtme specifike: furnizimi gati total nga importi nga vendet fqinjë e nga vende të tjera me ekonomi të zhvilluar, çperpjestimi midis importit të vazhdueshëm dhe të ndonjë mundësie për eksport të lëndëve të para ose të gjysëm-produkteve, etj.

Gjendja paraqitet optimiste duke parë edhe reagimin e investitorëve privatë, të cilët, duke parë efektivitetin e prodhimit të disa kimikateve për të cilat lëndet e para gjenden në vend, po parashikojnë realizimin e disa investimeve me interes. Kjo do të bëjë që vendi ynë të hyjë në fazën tjetër të tranzicionit ekonomik, ku ekonomia kombëtare të jetë më afër treguesve ekonomikë të vendeve të tjera me ekonomi në tranzicion.

Periudha pas viteve '90, përveç uljes së prodhimit të industrisë kimike, u shoqërua me shkatërrimin e disa ndërmarrjeve kimike, të cilat u shndërruan në zona të ndotura shumë shqetësuese dhe me risk të lartë për shëndetin e njerëzve dhe mjedisin rrethues. Në sajë të përpjekjeve të shumta ndërkombëtare dhe kombëtare, një pjesë e mirë e këtyre pikave të

nxehta mjedisore tashmë janë rehabilituar, por vazhdon identifikimi dhe veprimi në zona të tjera më pak kritike.

2.2. Prodhimi, importi dhe eksporti i kimikateve

2.2.1 Kimikatet industriale

Rënia më e madhe e prodhimit të industrisë kimike në vend pas viteve '90 u vu re në industrinë e prodhimeve të acidit sulfurik, nitrik, fosforik, të sodës kaustike (hidroksidit të natriumit), sodës Solvej (karbonatit të natriumit), të superfosfatit, të plehrave azotike, të prodhimit të naftës e të gazit, të SiO_2 , të glicerinës, SO_2 , CO_2 etj. Rënie të ndjeshme pati në prodhimin e makinerive dhe në industrinë e përpunimit të metaleve, si dhe në industrinë e përpunimit të drurit dhe atë metalurgjike.

Megjithatë, gjatë këtyre viteve një pjesë e kësaj industrie filloi të riaktivizohet, si nëpërmjet privatizimit të objekteve të industrisë së lehtë, asaj të drurit, kimike, mekanike, të disa sektorëve minerare në kariera (gurore), ashtu dhe nëpërmjet dhënies në konçesion të disa minierave të kromit, të bakrit dhe të qymyrit, të disa uzinave të prodhimit të çelikut, ferro-kromit, etj.

Sot vendi ynë ka të zhvilluar industrinë e çimentos, pjesërisht atë metalurgjike, industrinë e prodhimit të mallrave të konsumit të gjerë, të cilat kanë nevojë për lëndë të parë e ndihmëse kimike, që kryesisht importohen dhe në pak raste prodhohen, por që kërkojnë treg për eksport, si të O_2 , N_2 , etj. Rimëkëmbje kanë marrë kohët e fundit dhe industria e prodhimit të materialeve plastike, sfungjerit, polistirenit, detergjenteve, bojërave, vajrave lubrifikante, etj.

Shqipëria importon pesticide, plehra kimike, kimikate të llojeve të ndryshme për detergjentët, vajrat lubrifikante, pastrimin kimik, ndërtimin, etj.

Informacionet për sasinë e prodhimit, importit dhe eksportit të substancave kimike në periudhën e përgatitjes së rishikimit të parë të Profilit Kombëtar janë siguruar nga Instituti i Statistikave, Drejtoria e Doganave, drejtoritë në ministritë e linjës dhe prodhuesit private.

Në tabelën 2.A-1 është treguar numri i ndërmarrjeve të prodhimit të kimikateve dhe produkteve kimike sipas të dhënave të INSTAT për periudhën 2006-2008.

Tabela 2.A-1: Numri i ndërmarrjeve të prodhimit të kimikateve dhe produkteve kimike

Viti	Ndërmarrje kimike					
	Mikro	Të vogla	Të mesme	SMEs	Të mëdha	Gjithsej
2006	31	10	4	46		46
2007	44	17	4	65		65
2008	50	17	4	71		71

Burimi: Instat

Në tabelën 2.A-2 jepen të dhënat e importit të kimikateve sipas kapitujve të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave (NKM) (e përditësuar çdo vit), bazuar në versionin e Nomenklaturës së Kombinuar të Bashkimit Europian (CN 20XX (viti)). Të dhënat e eksport-importit janë të bazuara në deklaratimet doganore. Si rregull, këto të dhëna janë të influencuara nga ndryshimet në nivelin e tarifave doganore.

Tabela 2.A-2. Sasia e importeve të kimikateve sipas kapitujve NKM, në ton

Kapituj t NKM ³	Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010
27	Lëndë të djegshme minerale, vajra minerale dhe produkte të distilimit të tyre, substanca bituminoze, dyllërat minerale	505'18 7	613'35 1	663'00 8	802'92 5	858'79 7
28	Kimikate inorganike, komponime organike ose inorganike të metaleve të çmuar, të elementeve radioaktive, të metaleve të tokave të rralla dhe të izotopeve	30'535	31'956	29'417	33'090	30'553
29	Kimikate organike	2'009	2'072	1'850	2'381	1'786
30	Produkte farmaceutike	3'638	4'504	3'571	4'509	4'246
31	Plehërues	84'988	94'221	74'626	79'195	81'151
32	Ekstraktet ngjyrosëse dhe tanike, taninet dhe derivatet e tyre, ngjyrosësit, pigmentet dhe lëndet e tjera ngjyruese, bojërat dhe llustruesit; stukot dhe ngjitësit; bojërat e shkrimt	20'235	25'622	25'629	23'699	24'585
33	Vajrat esenciale dhe rrëshirat; preparatet e parfumerisë, kozmetikes dhe të tualetit	5'145	5'900	6'235	6'354	6'910
34	Sapunet, agjentet tensioaktivë, preparatet larëse, preparatet lubrifikuese, dyllërat artificiale, dyllërat e përgatitur, produkte për pastrim dhe luçidim, qirinjtë dhe produktet e ngjashme, plastelinat	37'114	37'706	36'461	42'820	44'988
35	Substanca albuminoze, amidon i modifikuar, ngjitës, enzima	1'636	1'763	1'465	2'000	2'094
36	Eksplodivet, prodhimet piroteknike, shkrepset, lidhjet piroforike, substancat e ndezshme	1'482	2'289	3'021	3'496	1'559
37	Produktet fotografike ose kinematografike	385	352	293	277	308
38	Produkte të ndryshme kimike	24'628	26'748	42'068	36'545	16'592

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Tabela 2.A-3 tregon vëllimet e eksporteve të kimikateve dhe produkteve të kimikateve të prodhuara nga ndërmarrjet e vogla e të mesme drejt BE dhe vendeve të tjera.

Tabela 2.A-3: Eksportet në vëllim drejt BE-së dhe vendeve të tjera, në ton

Industritë e klasifikuara sipas NACE ⁴ , rev.1.1	Drejt BE-së			Në pjesën tjetër të botës			
	2006	2007	2008	2006	2007	2008	Shtetet
24.13	688	606	380	65	70	172	Greqi, Bullgari, Maqedoni
24.14	4'861	4'395	7'060	41	45	55	Greqi, Itali, Turqi
24.15	0			215		85	Kosovë, Hungari, Mali i Zi
24.51	47	98	140	115	123	45	Serbi, Maqedoni, Greqi
24.52		1	1	5	32	30	Serbi & Mali i Zi, Kosovë, Bullgari
24.16	61	172	399	896	686	1'231	Turqi, Kosovë, Greqi
24.2	1	2		8	18	8	Kosovë, Itali
24.3	4	25	34	563	864	2'148	Kosovë, Serbi & Mali i Zi

24.13. Prodhimi i kimikateve me bazë inorganike

24.14. Prodhimi i kimikateve të tjera me bazë organike

24.15. Prodhimi i plehrave kimike dhe komponimeve të azotit

³ Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave

⁴ NACE – Klasifikimi i aktiviteteve ekonomike në Komunitetin European (Classification of Economic Activities in the European Community)

- 24.51. Prodhimi i sapunit dhe detergjenteve, pastruesve
- 24.52. Prodhimi i parfumeve dhe produkteve të tualeteve
- 24.16. Prodhimi i plastikës në formën primare
- 24.2. Prodhimi i pesticideve dhe produkteve të tjera agro-kimike
- 24.3. Prodhimi i bojërave, varakeve dhe veshësve të ngjashëm, bojërave të printimit

Në periudhën 2006-2008, eksportet e industrive të klasifikuara në 24.13 (kimikate me bazë inorganike) drejt BE janë ulur, ndërsa eksportet e grupeve 24.51 (sapune dhe detergjentë) and 24.16 (plastikë në formë primare) janë rritur.

2.1.2. Kimikatet për bujqësi

Produktet për mbrojtjen e bimëve (PMB)

Deri në vitet '90, ka patur prodhim të PMB: janë prodhuar insekticide, kryesisht të grupeve kimike karbamate (Sevin) dhe klororganike (Lindan), në formulime deri në 5 % për trajtim të tokës dhe pluhurosje të bimëve, fungicidet Zineb 20 % dhe sqfur pluhur, që janë përdorur me pluhurosje (polverizim) si dhe pasta bordoleze dhe polisulfuri i kalciumit me përdorim spërkatje të bimëve. Pas viteve '90 u ndërpre prodhimi i PMB.

Problemet në prodhimin bujqësor janë reflektuar negativisht në prodhimin vendas, por importi i PMB ka pasur një rritje të ndjeshme gjatë 5 viteve të fundit, siç tregohet edhe në tabelën 2.A-4. Tregu i PMB dhe bazat e reja normative janë reflektuar pozitivisht në menaxhimin e PMB. Çmimi i lartë i ka kufizuar ato në përdorim dhe nga ana tjetër importi dhe prodhimi vendas janë kufizuar në lloje sipas direktivave europiane dhe eksperiencave në vendet e BE.

Nisur dhe nga vetë ecuria e zhvillimit të bujqësisë si nga pikëpamja ekstensive (shtimi i sipërfaqeve të mbjella, sidomos me pemëtari dhe sera) ashtu dhe intensive (mbjellja e kulturave me rendiment të lartë dhe që kërkojnë shumë inpute bujqësore), parashikohet që brenda 2-3 viteve të ardhshme do të ketë dyfishim të importeve të PMB-ve krahasuar me vitet 2001-2004.

Tabela 2.A-4: Të dhënat mbi importin e PMB-ve për vitet 2005-2009

Emërtimi	Importi sipas viteve në litra apo kg				
	2005	2006	2007	2008	2009
Akaricide	2'000	2'500	2'000	5'200	3'600
Insekticide	40'000	44'500	51'500	101'000	40'800
Dezinf. Tokë (Insekt.)	80'000	60'000	43'800	180'000	68'400
Insekticide fumigantë	4'000	3'000	2'500	10'000	2'000
Nematocide	1'500	1'000	1'500	4'000	6'100
Fungicide	80'000	110'000	124'100	180'000	142'200
Moluskicide	9'000	7'000	5'500	30'000	6'000
Rodenticide	5'500	4'500	3'000	6'500	5'000
Herbicide	25'000	23'000	20'000	56'000	39'200
Shuma	337'000	355'000	253'900	572'700	313'300

Lëndët vepruese në përmbajtje të PMB-ve

Në VKM 1555, dt.12.11.2008 është e përcaktuar së një PMB regjistrohet nëse lënda/lëndet vepruese në përmbajtje të saj përfshihen në shtojcën II të kësaj VKM. Përfshirja e lëndëve vepruese në shtojcën II të VKM-së së regjistrimit (që i korespondon shtojcës i të direktivës 91/414/EEC), për një periudhë deri në 10 vjet, si dhe modifikimet dhe heqjet e tyre, përditësohen me urdhër të përbashket të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë, të ministrit që mbulon fushën e shëndetësisë, si dhe të ministrit që mbulon fushën e mjedisit.

Lista e produkteve për mbrojtjen e bimëve të regjistruara për tregtim dhe përdorim në Republikën e Shqipërisë publikohet nga MBUMK sa herë pëson ndryshime, sipas modelit të

tabelës 2.A-5. Kjo listë nuk përmban lëndë vepruese në përmbajtje të PMB dhe që janë të ndaluara sipas Direktivës 79/117/EEC si dhe që nuk janë përfshirë në shtojcën I të Direktivës 91/414/EEC. Këta direktiva europiane janë shumë orientuese, sidomos në kushtet e mungesës së kapaciteteve të mirëfillta në vend për vlerësimin e riskut për shëndetin, shëndetin në punë dhe mjedisin.

Plehrat kimike

Bujqësia shqiptare siguron nëpërmjet importit nga shtete të ndryshme plehra kimike si: nitrati dhe urea nga Urahina dhe Rusia, superfosfati nga Egjipti, diamonium fosfati (DAP) nga Tunizia, ndërsa plehrat e përziera (N.P.K) nga Europa, (Gjermania, Italia, Austria, Greqia, Norvegjia, Finlanda, Spanja, Ukraina) dhe Lindja e Mesme (Izraeli). Për bujqësinë në vendin tonë importohen rreth 86'900 ton plehra kimike, prej të cilëve 11'115 ton plehra kimike të përbërë (N.P.K) dhe 75'785 ton plehra masivë; numërohen gjithsej 183 formula të veçanta. Produkte organike me bazë acide humike importohen rreth 2 ton, 13 formula. Plehrat masive të thjeshtë me një element zënë 80 %, plehrat komplekse dhe të përziera zënë 15.8 %, kurse plehrat e lëngshme 4.2 % të sasisë së përgjithshme të plehrave kimike. Importet e plehrave kimike për periudhën 2006-2010 jepen në tabelën 2.A-6.

Tabela 2.A-6: Importi i Plehrave Kimike në Shqipëri për periudhën 2006-2010, në ton

Emërtimi	Importi i plehrave në ton				
	2006	2007	2008	2009	2010
Plehra azotike	25'873	61'316	42'787	53'728	56'999
DAP (Diamon Phosphat)	98	336	488	124	1.1
Superfosfat	11'407	19'348	18'917	10'307	9'905
Plehra komplekse	9'656	16'680	16'455	15'527	13'950
N, P, K+mikroelement	220	397	4'610	564	558
Plehra kimike gjithsej	47'254	98'077	83'256	80'249	81'414

2.1.3 Biocidet për përdorim në shëndet publik

Importi i biocideve bazohet në Urdhërin Nr.365, dt.3.8.2012 të Ministrit të Shëndetësisë “Për aprovimin e listës dhe përdorimin e substancave të përdorura si dizifektantë, dizinsektues dhe rodenticide në shëndetin publik”, <http://www.moh.gov.al/images/shendet/3b.pdf>; Biocidet mundet të importohen vetëm pasi subjekti importues të pajiset me Autorizimin e Importit nga Ministria e Shëndetësisë. Dokumentat e nevojshme për marrjen e autorizimit mund të gjenden në faqen e websitit <http://www.moh.gov.al/index.php/shendeti-publik>. Ministria e Shëndetësisë publikon periodikisht një listë të përditësuar të përbërësve aktivë të produkteve që lejohet të importohen dhe tregtohen në Shqipëri. Lista e përditësuar e lëndëve aktive të lejuara mund të gjendet në <http://www.moh.gov.al/faqet/shendetipublik/>.

2.2 Përdorimi i kimikateve sipas kategorive

2.2.1 Kimikatet industriale

Vaji i transformatorëve është elementi kryesor në të gjitha objektet e sistemit energjistik, i cili mund të ndotë mjedisin përreth. Keto objekte kanë në përdorim sasi shumë të mëdha të vajit mineral, rreth 13'000 ton. Sasia e vajit shkon nga 50 kg deri në 90'000 kg për transformator.

Mbështetur në të dhënat e inventarit paraprak të PCB-ve, të kryer në vitin 2005 në kuadër të përgatitjes së Planit Kombëtar të Veprimit për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e NOQ dhe të dhënave të siguruar nga OST sh.a dhe Ministria e Mbrojtjes në gusht 2010 në kuadër të përgatitjes së Planit Kombëtar të Veprimit për Protokollin e NOQ të CLRTAP, rezultoi se numri i transformatorëve të të gjithë kapaciteteve në përdorim, të vendosur në të gjithë objektet është rreth 12'000 copë.

Tabela 2.A-5: Lista e PMB të regjistruara për t'u importuar dhe tregtuar në Republikën e Shqipërisë (Gusht 2011, shembull)

EMRI TREGTAR	LËNDA AKTIVE	Klasifikimi	Aplikuesi	Nr. dhe data regjistrimit	
1. ABA-MEX	Abamectinë	Acaricid	Willowood Limited	277	23/02/2007
2. ACROBAT WG	Dimetomorph+Mancozeb	Fungicid	BASF	168/2	18/03/2011
3. ACTARA 25 WG	Thiamethoxam	Insekticid	Syngenta	164/1	25/05/2005
4. AFALON 45 SC	Linuron	Herbicid	Mahkteshim-Agan	338	21/11/2007
5. AKTELLIC 50 EC	Pirimiphos Methyl	Insekticid	Syngenta	5/2	14/11/2008
6. ALLIETTE FLASH	Fosetil aluminium	Fungicid	BAYER AG	65/1	14/11/2008
7. AMISTAR OPTI	Azoxystrobin+Chlorothalonil	Fungicid	Syngenta	337	21/11/2007
8. ANTRACOL 70 P	Propineb	Fungicid	BAYER AG	73/1	23/02/2007
9. AVAUNT 15 SC	Indoxacarb	Insekticid	Du Pont	284	23/02/2007
10. BAKRENI ANTRACOL WP 63	Propineb+Oxiklorur Cu	Fungicid	BAYER AG	43	01/02/2006
11. BASAMID GRANULAR	Dazomet	Insekticid-Nematocid	Certis Europe	53/1	09/06/2008
12. Bi – 58	Dimethoat	Insekticid	BASF	54/1	30/10/2006
13. BASTA 15	Glufosinate ammonium	Herbicid	BAYER AG	278	26/02/2010
14. BORDO MICRO	Cu metalik	Fungicid	IQV SA	140	11/11/2009
15. BRAVO 500 SC	Chlorothalonil	Fungicid	Syngenta	154/1	14/11/2008
16. BRIK 24 EC	Myclobutanil	Fungicid	FARMA-CHEM S.A.	313	25/05/2007
17. CABRIO TOP	Metiram+Pyraclostrobin	Fungicid	BASF	40/1	18/03/2011
18. CALIPSO SC 480	Thiacloprid	Insekticid	BAYER AG	197	24/12/2003
19. CALLISTO 48 SC	Mesotrione	Herbicid	Syngenta	156/2	14/11/2008
20. CANTUS	Boscalid	Fungicid	BASF	53	12/02/2008
21. CAPTAN 80 WG	Captan	Fungicid	Arysta LifeScience	32/2	26/5/2011
22. CAZA 20 SL	Imidacloprid	Insekticid	FARMA-CHEM S.A.	6	25/05/2007
23. CHAMPION WP	Hidroksid Cu	Fungicid	Nufarm GmbH & Co KG	239/1	18/03/2011
24. CHORUS 50 WG	Cyprodinil	Fungicid	Syngenta	155	14/11/2008
25. CLORTOSIP WP	Chlorothalonil	Fungicid	SIPCAM	14/1	30/10/2006
26. CONFIDOR SL 200	Imidacloprid	Insekticid	BAYER AG	233/1	18/03/2011
27. COPROXIDE	Hidroksid Cu	Fungicid	VAPCO	322	21/11/2007
28. CURTINE V	Mancozeb+Cymoxanil	Fungicid	VAPCO	172/1	23/02/2007

Pjesa më e madhe e tyre (rreth 96%) i përkasin Kompanisë private CEZ Shpërndarje, janë me kapacitet të ulët, të vendosur në kabina të vogla elektrike që shërbejnë për furnizimin e konsumatorëve familjarë.

Pjesa tjetër e transformatorëve është vendosur në nënstacione elektrike, rreth 300 prej tyre i përkasin CEZ Shpërndarje, 165 i përkasin KESh-it dhe 60 transformatorë me sasi shumë të mëdha vaji i përkasin OST. Në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes 35 transformatorë përmbajnë afërsisht 14'000 kg vaj transformatorësh, ndërsa 60 transformatorë të OST përmbajnë rreth 1'400'000 kg vaj transformatorësh. Rreth 50% e sasisë së përgjithshme të transformatorëve janë prodhuar para vitit 1990 (rreth 6'000 copë) dhe vjetërsia mesatare e transformatorëve është rreth 27 vjet.

Vaji rezervë i transformatorëve ruhet në fuçi metalike të mbyllura dhe në ambiente të sigurta.

Në varësi të OST operon Reparti i Rigjenerimit të Vajit të transformatorëve të dëmtuar apo që kanë humbur cilësitë për të gjithë sistemin energjistik, por vaji që trajtohet nuk testohet/analizohet paraprakisht për praninë e PCB-ve, në mënyrë që të shmangej ndotja e tërthortë. Ky është një repart që funksionon prej 40 vitesh dhe që paraqet probleme të ndotjes së mjedisit. Kompania po punon për hartimin e projektit të rehabilitimit të këtij reparti brenda një afati sa më të shkurtër.

2.2.2 Kimikatet për bujqësi

Produktet për mbrojtjen e bimëve (PMB)

Rregullat e përgjithshme që duhen zbatuar gjatë përdorimit të PMB-ve janë të përcaktuara në legjislacionin e mbrojtjes së bimëve, në VKM Nr. 1188, dt. 20.8.2008 "Për miratimin e rregullave për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e PMB". Në këtë VKM specifikohen, ndër të tjera, masat paraprake që merren në vendet që trajtohen, rregullat për përgatitjen e tretësirës spërkatëse, kriteret e përdorimit të herbicideve, zonat ku ndalohet përdorimi i tyre, kujdesi për mbrojtjen e insekteve të dobishme, sidomos bletëve dhe insekteve pjalmues, trajtimi i solucioneve spërkatëse të mbetura pas punës, si dhe i ambalazheve të PMB-ve të përdorura, etj.

Përdorimi i PMB-ve në vendin tonë është bazuar plotësisht në importimin e tyre. Të dhënat e përdorimit të PMB-ve për vitet 2004-2010, jepen në grafikun e Figurës 2.1.




Figura 2.1: Përdorimi i PMB gjatë periudhës 2004-2010, në ton/vit

Plehrat kimike

Përdorimi i plehrave minerale, organo-minerale dhe produkteve organike lidhet ngushtë jo vetëm me rezultatet e analizës së tokës, por edhe me ligjet e lëvizjes së lëndëve ushqyese aktive dhe mikro-ushqyese, për shkak të difuzionit të ujrave nëntokësore dhe lëvizjes gravitacionale të ujrave sipërfaqësore. Por, përveç kësaj, përdorimi i tyre kushtëzohet edhe

nga cilësitë specifike të secilës kategori. Kështu plehtrat azotike janë shumë të lëvizshëm, ndërsa plehtrat potasike lidhen mirë me strukturën e tokës, kurse fosforitet nuk lëvizin.

Deri në 1990 ishin përfunduar 5 cikle të kontrollit të prodhimit agrokimik. Analizat agrokimike behen vetëm atëherë kur prodhuesi dëshiron, pasi paguan shpenzimet për analizat dhe rekomandimet për plehëruesit. Ka një rënie të numrit të analizave që kryhen për shkak të mungesës së koordinimit në sistemin e MBUMK, ku nga programi PHARE janë bërë analiza pa pagesë. Numri i kufizuar i analizave të kryera nuk bën të mundur nxjerrjen e konkluzioneve të përgjithshme në shkallë kombëtare, por qartëson se ka tendenca të vazhdueshme negative.

Tabela 2.C-1: Përdorimi i plehrave kimike, vitet 1998-2009

Viti	Fermt që plehërojnë	Plehtrat kimike (ton)	Ure	Nitrat amoni	Superfosfat i diamoni	Superfosfat	Të tjera
1998	372'507	124'052	25'875	48'674	7'075	42'428	-
1999	377'000	121'575	27'512	47'709	7'743	38'611	-
2000		129'108	25'939	50'186	12'871	40'112	-
2001	332'516	114'604	30'415	44'773	39'416	-	-
2002	332'113	119'726	33'896	46'293	39'537	-	-
2003	336'425	119'903	31'676	44'687	43'540	-	-
2004	343'625	129'231	35'794	44'401	25'928	22'354	754
2005	345'117	133'330	35'952	46'582	27'535	22'518	743
2006	341'327	109'622	30'789	35'515	22'952	19'419	947
2007	333'450	111'567	32'116	36'037	23'957	17'285	2'172
2008	313'489	103'637	28'935	33'689	20'696	17'493	2'824
2009	324'494	120'472	35'564	38'464	24'710	20'084	1'650

Burimi i informacionit: MBUMK, INSTAT

Sipas të dhënave të tabelës 2.C-1 shihet se përdorimi i plehrave kimike është thuajse në të njëjtat nivele gjatë periudhës 1998-2009, pavarësisht ndryshimeve jo të dukshme brenda strukturës së tyre. Përfshirja përbën grupi "të tjera", ku përfshihen plehtrat kimike komplekse dhe ato humike, të përdorura pas vitit 2004 e në vazhdim në doza relativisht shumë më të vogla se ato të zakonshmet, por me ndikim shumë të madh. Kjo për faktin se ato janë plehra të përqëndruara dhe me përmbajtje mikroelementësh, që përdoren kryesisht tek kulturat bujqësore intensive si perimet, pemëtaria dhe vreshti. Kjo është dhe tendenca e sotme e përdorimit të tyre, pasi japin efekt të lartë dhe të shpejtë tek bimët.

2.2.3 Biocidet për përdorim në shëndetin publik

Përdorimi i pesticideve për qëllime të mbrojtjes së shëndetit publik përpara vitit 1993 ishte përgjegjësi e sistemit të shëndetësisë. Pas këtij viti, përmes VKM Nr. 369, dt. 26.7.1993 "Për riorganizimin e shërbimit të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit (DDD)" ky shërbim kaloi në varësi të pushtetit lokal. Shërbimi DDD ende kryhet nga Drejtoritë e Shëndetit Publik të rretheve, për kontrollin e shpërthimeve të epidemive të sëmundjeve infektive, bazuar në Ligjin Nr. 7761, dt. 19.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse".

Spektori i shërbimit DDD pranë bashkive ka për detyrë të mbulojë këtë shërbim në çerdhe, kopshte, shkolla, vendstrehime, lulishte, parqe, puseta dhe mjedise publike. Shërbimi DDD i Bashkisë së Tiranës, që është dhe bashkia më e madhe në vend, është në varësi të Ndërmarrjes Nr.3 të punonjësve të qytetit. Nga ana e kësaj drejtorie bëhet dy herë në vit deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi i ambienteve publike të qytetit, siç janë shkollat,

kopshtet dhe çerdhet, të cilat në total arrijnë shifrën 147, si edhe në rastet kur ka ankesa nga këto institucione publike. Ndërhyrjet për blatat ose furrat në kuzhinat e kopshteve dhe çerdheve bëhen dy herë në vit, ndërsa për brejtësit ndërhyhet një herë në vit.

Kjo drejtori është përgjegjëse edhe për zbatimin e shërbimit DDD në ambientet e tjera publike të përbashkëta të qytetit, siç është lumi Lana, lulishtet, ambientet e gjelbëruara, parqet e vogla të lagjeve, etj., por kjo gjë nuk realizohet për mungesë fondesh dhe personeli të specializuar.

Buxheti për aplikimin e DDD, veç rrogave të punonjësve, është 15'000 Euro në vit, që është krejtësisht i pamjaftueshëm. Sipas kësaj drejtorie, aktualisht janë 6 punonjës që merren me aplikimin e lëndëve biocide, por nevojiten edhe rreth 30 të tjerë, për të përballuar situatën emergjente që paraqitet nga brejtësit dhe insektet e ndryshme shqetësues. Nevojiten gjithashtu më shumë fonde për blerjen e lëndëve biocide, si edhe të materialeve manipuluese, veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse të punonjësve etj. i nevojshëm është edhe trajnimi i punonjësve që manipulojnë lëndët biocide.

Nevojitet një projekt i përbashkët midis MSh, ISHP dhe Bashkive, në kuadër të të cilit të hartohet një program për kontrollin e integruar të dëmtuesve të të gjithë ambienteve publike të qyteteve, lulishteve, ambienteve të gjelbëruara, kanalizimeve, vendeve me mbeturina inerte dhe plehra.

Përdorimi i biocideve është i domosdoshëm, por nuk duhet abuzuar me to. Pushteti vendor duhet të identifikojë zonat ku kanë nevojë për ndërhyrje, qofshin këto terrene të mbyllura apo të hapura.

Dizinfektimi nuk duhet parë si procesi i shpëtimit nga insektet, brejtësit., etj, por pushteti vendor duhet të rrisë investimet në këto terrene, në mënyrë që të minimizohen zonat e ndotura, e për pasojë edhe përdorimi i kimikateve për këtë qëllim.

2.3 Ruajtja e kimikateve

2.3.1 Kimikatet industriale

Në sistemin e METE janë të përfshirë disa objekte, ku ruhen kimikate të ndryshëm: Ish Kombinati Energjetik, Kompleksi i Laçit, Laboratori i UB Rubik, UPAF, Laboratori Qendror i Gjeologjisë, Degët Rajonale Tropojë, Rubik, Pukë. Kimikatet e ruajtura në këto mjedise janë të dala jashtë përdorimit (shiko pikën 2.5).

2.3.2 Kimikatet për bujqësi

Produktet për mbrojtjen e bimëve

Rregullat e përgjithshme që duhen zbatuar gjatë ruajtjes dhe magazinimit të PMB-ve janë të përcaktuara në VKM. Nr. 1188, dt. 20.8.2008 "Për miratimin e rregullave për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e PMB". Në këtë vendim përcaktohen kriteret që duhet plotësojnë objektet që përdoren për ruajtjen me shumicë e pakicë të PMB-ve, rregullat dhe dokumentacioni që duhet të plotësohet gjatë magazinimit, mënyra se si ruhen PMB-të e ndryshme, etj. Magazinat aktuale të tregtimit me shumicë të PMB-ve janë paraqitur në tabelën 2.D-1.

Plehrat kimike

Rregullat për magazinimin e plehrave kimike pershkruhen në Ligjin Nr. 10390, dt. 3.3.2011 "Për plehrat e përdorimit për bimësinë". Të gjitha llojet e plehrave, pas prodhimit apo sjelljes nga importi, depozitohen dhe ruhen në mjedise të mbyllura, të mbrojtura nga lagështira, dyshemeja e të cilave duhet të jetë e shtruar me paleta druri. Në këto mjedise nuk duhet të

ketë mallra të tjera. Mjediset për magazinimin dhe tregtimin e plehrave duhet të jenë të miratuara nga Inspektorati Sanitar Shtetëror i rrethit.

Tabela 2.D-1: Magazinat e tregtimit me shumicë të PMB (dhe biocideve*)

Emri i Subjektit	Adresa (vendndodhja)	
	E zyrave	E magazinave
AGROKONI	Tiranë	Marikaj, Tiranë
BRUKA AB Shpk	Divjakë, Lushnje	Divjakë, Lushnje
MELDI Shpk *	Tiranë	Bilisht, Devoll
RESMI FERKO	Fier	Fier
A & K 2001	Durrës	Durrës
SOFOKLI SHETI	Tiranë	Sauk, Tiranë
ARLI INTERNATIONAL *	Maminas, Durrës	Maminas, Durrës
PERLA- AGRO *	Elbasan	Elbasan
AGRO HELP SA *	Sukth, Durrës	Sukth, Durrës
Agro Blend *	Vorë, Tiranë	Vorë, Tiranë
AGROINPUT JAZXHI *	Tiranë	Kashar, Tiranë
LILA Shpk *	Tiranë	Syzez, Berat
ALBASEED	Sarandë	Sarandë, Lushnjë
AGRO-HELP Shpk	Sukth, Durrës	Sukth, Durrës
ALFA- LIDRA	Bilisht, Devoll	Bilisht, Devoll
LICO Shpk	Tiranë	Bilisht, Devoll
PEGASUS-VET	Gjirokastrë	Gjirokastrë
SELIM ISTREFI	Durrës	Durrës
MARASH MICI	Shkodër	Shkodër
AGROPROGRES	Tiranë	Tiranë
AGROINPUT Shpk	Lushnje	Lushnje
ENVER ISUFI	Tiranë	Marikaj, Tiranë

Burimi: I.Bici, Manual i PMB-ve, 2011

2.3.3 Biocidet për përdorim në shëndetin publik

Nga një inventarizim që kreu Ministria e Shëndetësisë në vitin 2010 rezultoi se në magazinat e DShP ishin gjendje rreth 7'000 kg lëndë biocide, ndërsa në magazinat e bashkive të rretheve ndodheshin rreth 4'600 kg lëndë biocide. Këto lëndë janë insekticide, (kryesisht delthamethrine, e njohur si K-othrine), dezinfektantë (kryesisht hipoklorite) dhe raticide. Me përjashtim të një sasive lindani prej 30 kg, e cila është e skaduar dhe e palejueshme për përdorim, kimikatet e tjerë janë të lejuar dhe të përdorshëm.

Në DShP-të e rretheve përgjithësisht nuk ka kushte të mira të magazinimit dhe ruajtjes së lëndëve biocide, ndonjëherë është konstatuar ruajtja e tyre brenda godinave ku punon personeli i DShP-ve.

2.4 Transporti i Kimikateve

Legjislacioni për transportin e kimikateve përfshin:

- VKM Nr. 1188, datë 20.8.2008 “Për miratimin e rregullave për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e PMB-ve”,
- VKM Nr. 798, datë 29.9.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.
- Ligji Nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për Përpunimin, Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe Nënprodukteve të tyre”;

- VKM Nr. 129, dt. 28.3.1999 “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejes e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”;
- Ligji Nr. 9876, datë 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e Biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”;
- Ligji Nr. 10390, datë 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”;

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT) liçenson subjekte që transportojnë mallrat e rrezikshme, të klasifikuar dhe shënuar si të rrezikshme nga Marrëveshja Europiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), transporti i të cilave në rrugë është i ndaluar, ose i lejuar vetëm në kushtet e caktuara nga kjo marrëveshje. Në rastin e transportit rrugor të mallrave të rrezikshme janë përcaktuar **kriteret e liçencimit**, ku kërkesa për kompetencë profesionale plotësohet përveç zotërimit të Çertifikatës së Kompetencës Profesionale sipas veprimtarive përkatëse ose zotërimit të diplomës universitare në inxhinieri mekanike ose ekonomik, edhe me zotërimin e Çertifikatës së Trajnimit si Këshilltar i Sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme.

Neni 31 “Transporti i mallrave të rrezikshme brenda vendit “ i Udhëzimit Nr. 15, datë 24.7.2007 të MPPT “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” rregullon veprimtarinë e transportit të mallrave të rrezikshme brenda vendit, që ushtrohet vetëm nga subjekte që kanë çertifikatën e mallrave të rrezikshme. Kjo çertifikatë lëshohet për çdo subjekt fizik ose juridik që kërkon të kryejë transport mallrash të rrezikshme brenda vendit dhe që zotëron Çertifikatën e Aprovuar për Mjetet që Transportojnë Mallra të Rrezikshme të Caktuara (sipas ADR-Marrëveshja europiane për transport rrugor ndërkombëtar të materialeve të rrezikshme), të lëshuar nga DPSHTR (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor) dhe Çertifikatën e Kontrollit të Pajisjes së Transportueshme për Mallra të Rrezikshme të lëshuar nga Inspektorati i Enëve nën Presion.

Lista e subjekteve të liçensuar për transportin e mallrave të rrezikshme është e identifikuar nga MPPT.

2.5. Menaxhimi i mbetjeve kimike

Nuk ka një sistem të sigurt në vend për administrimin e mbetjeve të rrezikshme të prodhuara nga industritë dhe ato shtëpiake. Mbetjet e rrezikshme që gjenerohen nga sektori industrial si dhe nga mbetjet bashkiake depozitohen së bashku me mbetjet urbane në vend-depozitimet e caktuara duke paraqitur kështu një rrezik të madh për mjedisin dhe shëndetin njerëzor. Në kuadër të përmbushjes së objektivave për një administrim më të mirë të mbetjeve, MMPAU ka hartuar Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010 – 2025, në bashkëpunim me projektin “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor”.

Gjeneruesit kryesorë të mbetjeve industriale kanë qenë industria kimike, metalurgjike, minerare, e naftës, industria e lehtë, ushqimore, kimikatet e përdorura për pleherime etj. Ndërmarrjet me sasira të mëdha mbetjesh nga kimikatet stok mbeten ish-Kombinati Metalurgjik Elbasan, Uzina e Plehrave Azotike në Fier, Uzina e Superfosfatit në Laç, etj.

Sasitë e sterileve nga shfrytëzimi minerar, për mineralet kryesore deri në fund të vitit 2007 janë paraqitur në tabelën 2.F-1.

Këto sterile ndodhen pranë vendburimeve të mineraleve si më sipër, në forme stoqesh.

Sipas METE, mbetjet e ngurta të gjeneruara nga industria e pasurimit dhe shkrirjes së bakrit, kromit, hekur-nikelit (sterilet e flotimit, skorjet, pluhurat e furrës, etj) rezultojnë të jenë rreth 28 milion ton.

Tabela 2.F-1: Volumet e materialeve sterile nga shfrytëzimi i minierave

Materiali steril nga shfrytëzimi i minierave	Volumi, m ³
Sterilet e minierave të kromit	28'023'660
Sterilet e minierave të bakrit	18'000'000
Sterilet e minierave të qymyreve	23'081'530
Sterilet e mineraleve të hekur-nikelit	1'112'183

* Burimi : METE

Të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve, në lidhje me sasitë e mbetjeve të ngurta industriale të eksportuara dhe importuara gjatë viteve 2005-2008 nga/në territorin e Republikës së Shqipërisë jepen në tabelën 2.F-2. Sasia e artikujve të eksportuar gjatë asaj periudhe ishte rreth 1'810'737 ton, ku 95% të kësaj sasie e përbënte eksporti i artikullit “minerale, skorje dhe hi”. Sasia në total e artikujve të importuar gjatë kësaj periudhe ishte 288'124 ton, ku 48% të kësaj sasie e zinte letër kartoni, artikuj të pulpit të letrës, e pasuar me 32% nga mbetjet dhe hedhurinat nga industria ushqimore.

Tabela 2.F-2. Të dhëna mbi eksport-importin e mbetjeve për periudhën 2005-2008, në ton

Artikulli	2005		2006		2007		2008	
	Eksport	Import	Eksport	Import	Eksport	Import	Eksport	Import
Mbetjet dhe hedhurinat nga industria ushqimore	1'995	22'601	23	27'217	2'771	37'791	1'450	38'317
Minerale, skorje dhe hi	205'384	0	355'374	461	670'849	3'308	510'090	4'413
Mbetje ose kthim letrë ose kartoni	1'015	76	358	194	4'577	101	5'339	543
Letër kartoni, artikuj të pulpit të letrës, letrës së kartonit	9'042	39'030	11'187	46'181	14'236	50,204	15'312	53'687
Librat, gazetet, revistat, pikturat, dorëshkrimet, shtypshkrimet dhe skicat	73	1'432	102	1'349	119	1'895	54	2'150
Leshi, qimet e kafshëve, qime kali etj	344	178	194	270	147	393	312	540
Fibra të tjera tekstile bimore, fill prej letrë dhe pelhura të endura me fill prej letrë	--	78	0	46	1	19	-	36
Mbushje shajaku dhe pelhura të pa-endura, fije speciale, spango, litarë, kavo dhe artikujt e tyre	33	6'237	178	5'016	85	4'595	93	4'236

Gjatë viteve 2008-2009 rreth 27'780 ton mbetje të rrezikshme u eksportuan në Suedi për asgjësim, prej të cilave 13.6 ton ishin karburant raketash, 0.2 ton dikloretan dhe rreth 16 ton oksidues AK-20F. Ky projekt u realizua sipas marrëveshjes teknike të datës 25.7.2008 ndërmjet Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Europian në Shqipëri, Ministrisë së Mbrojtjes dhe kompanisë suedeze Sakab AB.

Në Prill 2012 Ministria e Mbrojtjes nënshkroi një Marrëveshje Teknike me OSBE për eliminimin e kimikateve që gjenden në inventarin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Kjo marrëveshje është bërë në kuadrin e çmilitarizimit si dhe shkatërrimit të municioneve të tepërta dhe kimikateve të rrezikshme që krijoheshin prej tyre. Kjo nismë është e nxitur edhe nga ngjarje dhe aksidente me ndjeshmëri dhe rrezikshmëri të lartë civile si dhe dëme të mëdha ekonomike e shpesh herë dhe njerëzore, siç ishte dhe incidenti i Gërdecit. Sipas kësaj marrëveshje, ku një rol të rëndësishëm kanë Republika Çeke dhe Turqia, do të shkatërrohen rreth 83 ton kimikate nga një kompani e kontraktuar nga OSBE. Ky projekt

është zhvilluar në vazhdim edhe të projekteve të tjerë të ngjashëm për shkatërrimin e kimikateve me prejardhje ushtarake.

Stoqet e kimikateve të vjetra, mbetjet e kimikateve dhe vende të ndotura

METE ka në varësi disa objekte për ruajtjen e kimikateve. Disa nga objektet në varësi të METE, ku ende ruhen kimikate të vjetra, jepen në tabelën 2.G-1. Në to ruhen kimikate të vjetër për industrinë si dhe për qëllime laboratorike. Ndër magazinat më të mëdha ekzistuese në varësi të kësaj ministrie është ajo e NFIM (Ndërmarrja e Furnizimit të Industrisë së Minierave) në Balëz, Elbasan, ku pas viteve '90 janë ruajtur kimikate kryesisht të sistemit të ekonomisë, por edhe të sistemeve të tjerë, psh të shëndetësisë. Magazina përmban disa godina, një prej të cilave në gjendje të mirë. Vendi menaxhohet dhe ruhet, mgjatë ndodhet pranë pronave të banuara dhe pranë një shkolle, si dhe një dege të lumit Shkumbin, duke paraqitur kështu rrezik potencial për shëndetin dhe mjedisin.

Tabela 2.G-1: Stoqe të kimikateve në magazinat e sistemit të ekonomisë

Magazina të kimikateve të vjetra	Vendndodhja	Përmbajtja kryesore e kimikateve apo mbetjeve	Madhësia e stokut (vlerë e përafërt), në kg
Magazinat e NFIM	Balëz, Elbasan	Cianure, kimikate te ndryshme	15'000
Ish kombinati Energjistik	Elbasan	Kimikate për përdorime laboratorike	300
Kompleksi i Laçit	Laç	Kimikate për përdorime laboratorike	60
Laboratori i UB Rubik	Rubik	Kimikate për përdorime laboratorike	70
Uzina e Prodhimeve Azotike, Fier	Fier	Acid formik, V ₂ O ₅ , TS 605, karbonat kaliumi	93'300
Dega Rajonale Tropojë	Tropojë	Kimikate për përdorime laboratorike	18'300
Laboratori Qëndror i Gjeologjisë		Kimikate për përdorime laboratorike	5'000
Dega Rajonale Rubik	Rubik	Kimikate për përdorime laboratorike	280
Dega Rajonale Pukë	Pukë	Kimikate për përdorime laboratorike	230

Burimi: METE

Në vitin 2010 rreth 90 ton kimikate u ripaketuan dhe larguan nga kjo magazinë nga kompania e kontraktuar greke Environmental Protection Engineering S.A (EPE) për në Gjermani, Belgjikë dhe Greqi. Operacioni i pastrimit kushtoi rreth 476'000 USD dhe u financua nga Qeveria Hollandeze, Qeveria Shqiptare dhe OSBE.

NFIM Elbasan vazhdon të përdoret për grumbullimin e kimikateve nga ish ndërmarrjet ekonomike; pas largimit të sasisë së parë, në depot e kësaj ndërmarrje janë depozituar kimikate të tjerë, psh nga ish Ndërmarrja Kimike Durrës, nga Shërbimi Gjeologjik dhe METE po përgatitet që të dërgojë atje edhe kimikate nga ish Azotiku Fier. METE po bën përpjekje për gjetjen e donatorëve për largimin e kimikateve që po grumbullohen në magazinat e NFIM Elbasan.

Rehabilitimi i vatrave me mbetje toksike

Gjatë 10 viteve të fundit është bërë një punë shumë e madhe nga MMPAU për identifikimin e donatorëve dhe mobilizimin e fondeve për identifikimin, prioritizimin, kryerjen e studimeve të realizueshmërisë për pastrimin e vatrave të ndotura problematike në vend.

Zona e Porto-Romanos Durrës është konsideruar që në vitet '90 zonë e ndotur problematike. Në këtë zonë ku para viteve '90 funksiononte Ndërmarrja Kimike, kishte përmbajtje të lartë të substancave të rrezikshme, si heksaklorcikloheksan dhe krom (VI). Këta ndotës cënonin rëndë shëndetin e banorëve të kësaj zone dhe kishin përkeqësuar cilësinë mjedisore në atë zonë. Nga një mision i UNEP në vitin 2004, kjo zonë u cilësua si një nga

vatrat e ndotura më të rrezikshme në Ballkan. Zbatimi i projektit “Rehabilitimi i zonës së nxehtë të Porto Romanos” ka qenë përgjegjësi direkte e MMPAU, e cila me mbështetjen e Bankës Botërore realizoi pastrimin dhe kthimin e 78’000m² sipërfaqe të ndotur në tërësisht të pastra. Zbatimi i këtij projekti me vlerë 5 milion USD të dhuruara nga granti i Qeverisë Hollandeze, punimet e të cilit nisën në pranverë të vitit 2010 dhe përfunduan në qershor 2011, bëri të mundur rehabilitimin e 3 pikave të nxehta të kësaj zone. U bë i mundur largimi dhe inkapsulimi i 60’000 m³ dhera të ndotur në një kapsulë izolimi, e para kjo për mbetje të rrezikshme e ndërtuar në Shqipëri. Është përpiluar një plan menaxhimi, monitorimi dhe mirëmbajtje për periudhën pas rehabilitimit të zonës. Me një grant tjetër prej 1 milion USD u bë i mundur ripaketimi dhe largimi i stoqeve të kimikateve në magazinat në Bishtin e Pallës.

Një nga pikat e nxehta mjedisore të identifikuar në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve në vendet e Ballkanit Perëndimor për t’iu adresuar problemeve mjedisore përmes rehabilitimit të pikave të nxehta mjedisore me prioritet të lartë” në vendin tonë ishte stacioni trenit i Bajzës në Shkodër, ku në vitet 1991-1992 qenë transportuar nga Gjermania kimikate të rrezikshme. Një pjesë e mirë e tyre u kthyen në Gjermani në vitin 1993; pjesa tjetër e kimikateve u lanë aty në harresë për një kohë të gjatë, duke rrezikuar seriozisht ekosistemin përreth. Nga investigimet e kryera në vitin 2008 u vu re që në Bajzë ishin depozituar rreth 80 ton fluorsilikat natriumi dhe mbetje lëkurash. Një pjesë e këtyre mbetjeve u eksportua në Mbretërinë e Bashkuar dhe pjesa tjetër u dërgua në një vend-depozitimi në Shqipëri. Magazinat në Balëz, Elbasan u identifikuan si zonë e nxehtë mjedisore nga PNUD (2008) . Aty ishin depozituar rreth 216 ton mbetjesh të ndryshme kimike si dichloromethane, kripra arseniku , cianide, nitrat amoni, hidroksid amoni etj.

Operacioni i pastrimit përfundoi në shtator 2009; kostoja e tij (2008-2009) ishte 316’000 USD dhe u mbulua nga Qeveria e Hollandës dhe Qeveria Shqiptare.

Në kuadër të këtij projekti, me vlerë totale 2 milion Euro, u identifikuan dhe u rehabilituan pikat e nxehta mjedisore NFIM Balëz në Elbasan, minierat Reps dhe Rrëshen. Gjithashtu në kuadër të këtij projekti u zhvilluan aktivitete që synuan rritjen e kapaciteteve me fokus menaxhimit të kimikateve, cilësisë së ujërave, cilësisë së ajrit, minierave dhe riskut. Në vazhde të përpjekjeve të MMPAU për adresimin e problematikës së vatrave të ndotura mjedisore, ka përfunduar në vitin 2011 zbatimi i projektit të MMPAU dhe PNUD “Identifikimi dhe priorizimi i pikave të nxehta mjedisore në Shqipëri” me vlerë rreth 1.3 milion USD, financuar nga Qeveria e Hollandës. Ky projekt asistoi Qeverinë Shqiptare për të arritur objektivat e saj afatmesme lidhur me rehabilitimin e zonave të ndotura për eliminimin e materialeve toksike brenda standardeve bazë të sigurisë. Në kuadër të këtij projekti përfundoi në vitin 2011 «Studimi paraprak mjedisor i 35 pikave të nxehta mjedisore në Shqipëri». Ky studim ka përcaktuar një listë të shkurtër të 14 hot spoteve prioritare, sipas Tabelës 2.G-2, të cilat kanë nevojë emergjente për ndërhyrje rehabilituese.

Bazuar në këtë studim:

- Janë përgatitur raportet e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe 10 plane për rehabilitimin e pikave të nxehta prioritare;
- Është bërë njoftimi paraprak i komunitetit për aktivitetet e ardhshme rehabilituese në kuadër të konventës së Aarhusit dhe të ligjit për “Vlerësimin e ndikimit në mjedis”;
- Është rënë parimisht dakort me METE për zona të tjera objekt për kryerjen e vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Është organizuar mbledhja paraprake me donatorët me qëllim financimin e ardhshëm të rehabilitimit të hot spoteve prioritare;
- Ka përfunduar krijimi i një baze të dhënash në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve për pikat e nxehta mjedisore në Shqipëri: <http://hotspotsproject.org/>;

- Janë përgatitur dokumentat tenderuese për kryerjen e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe për 4 hot spote të tjera.

Tabela 2.G-2: Lista e hotspotëve prioritarë për rehabilitim

Nr	Hotspotet	Ndotësit kryesorë	Sipërfaqja
1	Miniera e Bitinckës në Korçë	Dampa të mineraleve të Fe-Ni (hekur – nikel)	2-2.5 ha
2	Guri i Kuq, Pogradec;	Dampa të Fe-Ni	3 ha
3	Alba Film në Tiranë	Kimikate të ndryshme toksike	2 ha
4	Ndërmarrja e Baterive në Berat	Bateri që përmbajnë Pb (plumb)	2 ha
5	Ish ndërmarrja Dajti në Tiranë	Cianure	10 m ²
6	Uzina Metalurgjike në Elbasan	Mbetje të Ferro – Kromit	11 ha
7	Ndërmarrja Tekstile në Berat	Amonium	0.6 ha
8	Miniera e Fe-Ni, në Përrenjas	Mbetje të Fe-Ni	23 ha
9	Magazina në Rrëshen	Pesticide	0.2 ha
10	Vend-depozitimi i mbetjeve në Fushë Arrëz	Mbetje të mierave që përmbajnë bakër	20-30 ha
11	Uzina e fosfateve në Laç	Mbetje të kimikateve, sterile minerare	38 ha
12	Fabrika e Bakrit në Laç	Mbetje të kimikateve	12 ha
13	Magazina Bujqësore në Lushnjë	Mbetje të pesticideve	2'000 m
14	Miniera në Rehovë	Mbetje të minierës që përmbajnë Cu, Fe, CuFeS ₂	1km ²

Përgjegjësia për ndotjen është një çështje e rëndësishme në pastrimin e zonave të ndotura dhe privatizimit të tyre. Nuk ka një legjislacion specifik për përgjegjësinë për ndotjen industriale të mëparshme dhe nuk është e qartë se kush duhet të paguajë. Gjatë privatizimit blerësi mund të diskutojë me MMPAU dhe METE se kush duhet të paguajë. Ministritë mund të bien dakord që qeveria të mbulojë një pjesë të shpenzimeve. Gjithashtu përgjegjësitë mund të ndahen midis qeverisë dhe pronarit.

Kur flasim për hot-spote zakonisht i referohemi vetëm zonave të ndotura që janë si rezultat i industrisë së zhvilluar para viteve '90, braktisjes së këtyre objekteve, popullimit në zonat industriale për shkak të lëvizjeve demografike të pakontrolluara, etj., por nuk duhet harruar edhe një fakt shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me krijimin e hot-spoteve të reja. Në të gjithë vendin, me përjashtim të ndonjë rasti sporadik, janë të pranishëm hot-spote në formën e shesh-depozitimeve të cilat janë jashtë kushteve higjeno-sanitare e mjedisore e për fat të keq pranë lumenjve e përrenjeve. Në këto sheshe, kimikatet dhe lëndët toksike që krijohen gjatë kompostimit të mbetjeve infiltrojnë në ujërat nëntokësore e sipërfaqësore duke shkaktuar ndotje të të gjithë ekosistemit e zonës. Gjithashtu problem përbëjnë edhe shkarkimet e industrive aktuale. Mungesa e monitorimit periodik nga kompanitë private apo nga institucionet shtetërore dhe e kontrollit të mjaftueshëm përbëjnë premise për krijimin e hot-spoteve të reja.

Në këto kushte duhet të rritet përgjegjësia e strukturave shtetërore jo vetëm në evidentimin, monitorimin si fazë parandaluese, por edhe në nxitjen e politikave miqësore me mjedisin, “Zhvillimit të qëndrueshëm”, deri tek zbatimi i parimit ‘ndotësi paguan’.

Strukturat vendore duhet të ndërhyjnë nëpërmjet planeve e programeve vendore të administrimit të mjedisit urban, për të mos lejuar urbanizimin e zonave të tilla, që mund të jenë përcaktuar si hot-spote apo që mund të kenë tendencën për të qenë të tilla.

Implantet për rifitimin dhe riciklimin e kimikateve

Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme në Shqipëri është shumë i dobët dhe pjesa më e madhe e grumbullimit të mbetjeve kryhet nga sektori privat, gjithashtu, edhe implantet e riciklimit janë në pronësi të sektorit privat. Sigurimi i këtyre aktiviteteve dhe sistemi i menaxhimit janë ende në fillimet e tyre dhe varen nga disponueshmëria e materialeve të riciklueshme me një cilësi të mirë. Në shumicën e rasteve industria e riciklimit varet nga lëndët e para të riciklueshme që importohen në Shqipëri.

Ekziston një politikë dominuese dhe e përhapur e hapjes së gropave dhe e grumbullimit të mbetjeve në to. Instrumentet ekonomike për administrimin e mbetjeve janë të pakta dhe me vlerë të pakonsiderueshme.

Ekzistojnë disa kompani private riciklimi, të cilat grumbullojnë e përpunojnë tipe të ndryshme mbetjesh: skrap, letër, plastikë, tekstile, goma të përdorura. Ka rreth 12'000 grumbullues individualë informalë dhe rreth 100 kompani grumbulluese për mbetje të ndryshme të riciklueshme. Mbetet problem mungesa e ndarjes së mbetjeve që në burim. Grumbulluesit individualë dhe kompanitë hasin vështirësi në gjetjen e mbetjeve të pastra dhe të ndara. Pjesa më e madhe e mbetjeve të riciklueshme vjen nga mbetjet urbane, dhe pjesërisht nga sektori industrial.

Sektori i riciklimit të letrës, plastikës dhe qelqit nuk janë të zhvilluara si një sistem funksional; vetëm sasi të vogla të qelqit, skrapit të hekurit, letrës, plastikës, dhe kanaçeve të aluminit ndahen për qëllime riciklimi apo eksporti. Për momentin, sektori i riciklimit të metalit është më i zhvilluari. Në vend gjenden rreth 60 aktivitete ricikluese për rryma të ndryshme mbetjesh, por më të rëndësishmit janë 1 implant i madh i prodhimit të çelikut, dy fonderi të vogla të aluminit dhe metaleve me ngjyra të cilat përdorin si lëndë të parë mbetjet e metaleve të grumbulluara, 2 impiante për riciklimin e baterive të përdorura, 2 impiante për riciklimin e letrës dhe 2 për riciklimin e plastikës.

Për të mbajtur nën kontroll mbetjet që importohen për qëllim riciklimi është miratuar “Lista e Gjelbër”, me VKM Nr. 825, dt. 13.10.2010 “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”.

Implantet për nxjerrjen jashtë përdorimit të kimikateve dhe mbeturinave të tyre

Nuk ka ndonjë implant për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme kimike, me përjashtim të një incineratori për djegien e mbetjeve spitalore të instaluar në afërsi të mjediseve të spitalit “Nënë Tereza” në Tiranë. Ky incinerator nuk punon në mënyrë të vazhdueshme dhe me kapacitet të plotë. Një sasi e konsiderueshme e këtyre mbetjeve të pa-asgjësuar në implant digjen në ambiente të hapura ose depozitohen bashkë me mbetjet urbane.

Nuk ka implant industrial apo landfill për trajtimin e mbetjeve të tjera të përcaktuara dhe klasifikuara sipas udhëzimeve të Konventës së Bazelit nuk ka në vendin tonë.

Mbetet ende problem mbledhja dhe shpërndarja e informacionit për sasi dhe llojet e mbetjeve industriale të reja që gjenerohen nga aktiviteti i subjekteve industriale të licensuara pas vitit 1992.

Një nga objektivat e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010 – 2025, dhe projektit “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor” është edhe menaxhimi i mirë i mbetjeve nëpërmjet ndërtimit të disa vend-depozitimeve të reja të mbetjeve në përputhje me standardet mjedisore në disa rajone si dhe disa të tjerë që janë në proces. Vend-depozitimet e planifikuara për t’u vënë në shfrytëzim paraqiten në tabelën 2.G-3.

Tabela 2.G-3: Vend-depozitimet e planifikuara për t'u vënë në shfrytëzim

Nr	Vend-depozitimi	Sipërfaqe	Kapaciteti	Gjendja
1	Bestrova 1 (Vlorë)	12 ha	1'044'690 m ³	Ka përfunduar studimi
2	Bushat (Shkodër)	12 ha	1'000'000 m ³	Ka filluar ndërtimi
3	Bajkaj (Delvinë)	5 ha	-	Ka përfunduar studimi i fizibilitetit
4	Sharrë (Tiranë)	15 ha	2'900'000 ton	Ka filluar shfrytëzimi
5	Korçë	10 ha	-	Ka përfunduar studimi i fizibilitetit
6	Rubik (landfill industrial)	5'000 m ²	3'500 ton/vit	Ka përfunduar
7	Peshkopi	8'000 m ²	-	Ka përfunduar studimi i fizibilitetit

*Burimi: MPPT

2.6 Kimikatet e prodhuara në mënyrë të paqëllimshme

Inventari i parë i NOQ-ve të prodhuara në mënyrë të paqëllimshme në Shqipëri është bërë në kuadër të punës së kryer për përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimtimit për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e NOQ-ve, financuar nga GEF me UNDP si agjenci zbatuese dhe bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare, gjatë periudhës 2004-2006. Ky inventar u përgatit në përputhje me Manualin e UNEP për Identifikimin dhe Vlerësimin Sasior të Shkarkimeve të Dioksinave dhe Furaneve.

Djegia e pakontrolluar rezultoi burimi kryesor i shkarkimeve në ajër të PCDD/F-ve të çliuara në Shqipëri për vitin 2004, duke zënë 73.5% të totalit të shkarkimeve. Në kategorinë e proceseve të djegieve të pakontrolluara ishin marrë në shqyrtim vetëm djegia e mbetjeve urbane dhe zjarret aksidentale.

Djegia e mbeturinave spitalore ishte burimi i dytë më i madh i shkarkimeve, duke zënë 23.8% të totalit të shkarkimeve të PCDD/F. Shkarkimet e sektorit të transportit duket se kontribuonin me 5.6% në shkarkimet totale të PCDD/F në ajër. Shkarkimet nga kategoritë e tjera rezultuan të pandjeshme.

Si përgjigje e rezultateve alarmante të inventarizimit të kryer, ku u vu re një kontribut i rëndësishëm i djegies së mbeturinave spitalore në emisionin e përgjithshëm të dioksinave e furaneve, u miratua me dt. 30.11.2007 nga Ministri i Mjedisit dhe Ministri i Shëndetësisë rregullorja Nr. 6, "Për administrimin e mbetjeve spitalore". Sipas kësaj rregullore, prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për grumbullimin, ndarjen, ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, administrimin, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin në mënyrë të përshtatshme të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre, për të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre dhe për shpenzimet përkatëse. Impiantet për djegien e mbetjeve spitalore duhet të respektojnë kushtet e djegies dhe normat e shkarkimeve në ajër të përcaktuara në pikën 5.1.2 "Linja për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe spitalore" të VKM-së Nr. 435, dt.12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".

2.7 Vlerësimi

Ruajtja dhe përdorimi i kimikateve

Pavarësisht nga përpjekjet e shumta të MMPAU dhe institucioneve të tjera për përmirësimin e kushteve të ruajtjes së kimikateve, ka ende punë për të bërë në këtë drejtim. Ka ende raste, p.sh. në sistemin e shëndetësisë, kur ruajtja e kimikateve të rrezikshme bëhet në mjedise të papërshtatshme dhe duke përbërë rrezik për jetën e njerëzve. Nevojitet një shqyrtim i hollësishëm i kushteve të ruajtjes së kimikateve për përdorim në shëndet publik, që duhet të shoqërohet me rekomandimet dhe masat e nevojshme.

Duhet gjetur mekanizmat për të shtuar numrin e analizave të tokave për përmbajtjen e mikroelementëve dhe ushqyesve, në mënyrë që të rritet efektiviteti i përdorimit të plehrave kimike dhe të ulet përdorimi i tepërt i panevojshëm i tyre. Duhet forcuar koordinimi brenda sistemit të bujqësisë, për përdorimin më të mirë të mundësive ekzistuese, si program PHARE.

Pavarësisht nga detyrimet ligjore të ministrive të linjës për zhvillimin e **metodologjive për vlerësimin e riskut shëndetësor e mjedisor**, nuk është bërë pothuaj asgjë në këtë drejtim.

Është i nevojshëm përmirësimi i kushteve të përdorimit të kimikateve për shëndetin publik; nevojiten më shumë fonde për blerjen e lëndëve biocide, si edhe të materialeve manipuluese, veshjeve mbrojtëse të punonjësve etj. Shumë i nevojshëm është edhe trajnimi i stafeve që kryejnë trajtimet me biocide.

Nevojitet një projekt i përbashkët midis MSh, ISHP dhe Bashkive, i cili të jetë efikas për një program të kontrollit të integruar të dëmtuesve (pesteve) të të gjitha ambienteve publike të qyteteve, lulishteve, ambienteve të gjelbëruara, gjelbërimit, kanalizimeve, vendeve me mbeturina inerte dhe hedhurina. Përdorimi i biocideve është i domosdoshëm, por nuk duhet abuzuar me to. Pushteti vendor duhet të identifikojë zonat ku ka nevojë për dizinfektim, qofshin këto terrene të mbyllura apo të hapura. Pushteti vendor duhet të rrisë investimet në këto terrene në mënyrë që të parandalohen dhe/apo minimizohen zonat e ndotura e për pasojë edhe përdorimi i biocideve në mjedis.

Administrimi i mbetjeve

Mbetet ende problem mbledhja dhe shpërndarja e informacionit për sasi dhe llojet e mbetjeve industriale të reja që gjenerohen nga aktiviteti i subjekteve industriale të licensuara pas vitit 1992.

Nuk ka një sistem të sigurt për administrimin e mbetjeve të rrezikshme (atyre të prodhuara nga industritë dhe ato shtëpiake). Mbetjet e rrezikshme që gjenerohen nga sektori industrial si dhe nga mbetjet bashkiake depozitohen së bashku me mbetjet urbane në vend-depozitimet e caktuara duke paraqitur kështu një rrezik të madh për mjedisin dhe shëndetin njerëzor. Ekziston një praktikë dominuese dhe e përhapur e hapjes së gropave dhe e grumbullimit të mbetjeve në to. Instrumentet ekonomike për administrimin e mbetjeve janë të pakta dhe me vlerë të pakonsiderueshme.

Ka nevojë për një zgjidhje të vazhdueshme për problemin e asgjësimit të kimikateve të papërdorura

Mbetet problem mungesa e ndarjes së mbetjeve që në burim. Grumbulluesit individualë dhe kompanitë hasin vështirësi në gjetjen e mbetjeve të pastra dhe të ndara. Pjesa më e madhe e mbetjeve të riciklueshme vjen nga mbetjet urbane, dhe pjesërisht nga sektori industrial.

Në vend mungon një landfill industrial qendror për trajtimin e mbetjeve të përcaktuara dhe klasifikuara sipas udhëzimeve të Konventës së Bazelit.

Nuk ka ndonjë impiant për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme kimike, me përjashtim të një incineratori për djegien e mbetjeve spitalore të instaluar në afërsi të mjediseve të spitalit “Nënë Tereza” në Tiranë. Ky incinerator nuk punon në mënyrë të vazhdueshme dhe me kapacitet të plotë. Një sasi e konsiderueshme e këtyre mbetjeve të pa-asgjësuar në impiant digjen në ambiente të hapura ose depozitohen bashkë me mbetjet urbane. Në kuadër të përmbushjes së objektivave për një administrim më të mirë të mbetjeve, MMPAU ka hartuar Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010 – 2025, në bashkëpunim me projektin “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor”.

Vatrat e ndotura mjedisore

MMPAU ka bërë një punë të mirë për identifikimin, prioritizimin dhe studimin e vatrave të ndotura mjedisore. Vatra më problematike e Porto-Romanos dhe vatra të tjera të ndotura janë pastruar me ndihmën e UNDP dhe me kontributin e Qeverisë së Hollandës. Në vazhdim të përpjekjeve të MMPAU për identifikimin dhe pastrimin edhe të vatrave të tjera problematike, është bërë edhe një studim paraprak i 35 vatrave të nxehta mjedisore në Shqipëri dhe është përcaktuar një listë e shkurtër prej 14 vatrash ndotjeje prioritare për ndërhyrje rehabilituese.

Përgjegjësia për ndotjen është një çështje e rëndësishme në pastrimin e zonave të ndotura dhe privatizimit të tyre. Nuk ka një legjislacion specifik për përgjegjësinë për ndotjen industriale të mëparshme dhe nuk është e qartë se kush duhet të paguajë.

Tabela 2.J: Prioritetet dhe veprime të mundshme: Prodhimi, importi, eksporti, ruajtja, transporti, përdorimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit

Çështjet prioritare (renditur nga prioriteti më i lartë te ai më i ulët)	Niveli i kapaciteve ekzistuese	Përmbledhje e anëve të forta, mangësive dhe nevojave për kapacitete	Veprime të mundshme	Aktorët e mundshëm
Menaxhimi i mbetjeve të kimikateve të rrezikshme	I ulët	Mbetjet e rrezikshme depozitohen bashkë me mbetjet urbane	Krijimi i një sistemi për administrimin e mbetjeve të rrezikshme, përfshirë impiant(e) për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme. Ndërtimi i një landfilli industrial për mbetjet e kimikateve. Ndarja e mbetjeve në burim	MMPAU, METE, industria
Hartimi apo përshtatja e metodave për përcaktimin e vetive të kimikateve, për klasifikimin e tyre sipas rrezikshmërisë, si dhe i procedurave për vlerësimin e riskut shëndetësor dhe mjedisor nga kimikatet e rrezikshme	I ulët	Mungojnë metodat e miratuara për vlerësimin e vetive të kimikateve, si psh toksiteti, kancerogeniteti, lidhur me klasifikimin, si dhe procedurat e miratuara për vlerësimin e riskut të kimikateve të rrezikshme	Hartimi apo përshtatja dhe miratimi i metodave të vlerësimit të vetive të kimikateve për klasifikimin e tyre; Hartimi apo përshtatja dhe miratimi i procedurave për vlerësimin e riskut nga kimikatet e rrezikshëm	MSh, MMPAU
Program për kontrollin e integruar të dëmtuesve (pest) në shëndet publik	I ulët	Mungojnë përpjekjet për kontrollin e integruar të dëmtuesve në shëndet publik	Projekt i përbashkët ndër-institucional	MSh, ISHP, bashkitë, kompani infestuese private
Inventar për mbetjet industriale që gjenerohen nga subjektet industriale	I mesëm	Mungesa e një inventari të mbetjeve industriale	Vendosja e metodologjise dhe procedurave për raportimin dhe kontrollin Krijimi i inventarit të	MMPAU, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, industria

Çështjet prioritare (renditur nga prioriteti më i lartë te ai më i ulët)	Niveli i kapacite teve ekzistuese	Përmbledhje e anëve të forta, mangësive dhe nevojave për kapacitete	Veprime të mundshme	Aktorët e mundshëm
			mbetjeve industriale	
Përmirësimi i shërbimit DDD dhe i menaxhimit të lëndëve biocide	I mesëm	Kushtet e ruajtjes dhe ato të përdorimit të produkteve biocide janë shpesh të papërshtatshëm. Mungojnë njohuritë e mjaftueshme të personelit.	Hartimi dhe miratimi i legjislacionit përkatës Ngritje apo forcim i kapaciteteve; Investime lidhur me kushtet e ruajtjes dhe përdorimit.	MSh, pushteti lokal

KAPITULLI 3: INSTRUMENTAT LIGJORE DHE MEKANIZMAT JO-RREGULLATORE PËR MENAXHIMIN E CIKLIT TË JETËS SË KIMIKATEVE

Qëllimi i këtij kapitulli është të sigurojë një përmbledhje të instrumentave ligjore ekzistues dhe të mekanizmave jo-rregullatore për menaxhimin e kimikateve, përfshirë nënproduktet e paqëllimshme dhe toksinat me origjinë natyrale; të ndërmarrë një analizë të përgjithshme për përshtatshmërinë e këtij legjislacioni dhe të adresojë aspektet e zbatimit dhe detyrimit për zbatim dhe të identifikojë anët e forta, dobësitë dhe mangësitë. Në këtë kapitull janë identifikuar gjetet kryesore sa i përket boshllëqeve në legjislacion, veçanërisht zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit, duke dhënë edhe konkluzionet përkatëse.

Në përgjithësi, cikli i jetës së kimikateve përbëhet nga fisa faza, duke filluar nga prodhimi, formulimi, ruajtja, transportimi, shpërndarja, tregëtimi, përdorimi, trajtimi, deri në asgjësimin përfundimtar të tyre. Kjo është ndër arsyt kryesore përse duhet të ketë një bashkëpunim ndër-institucional në menaxhimin e kimikateve. Duhet që nëpërmjet këtij bashkëpunimi të hartohen ligje, akte nënligjore dhe standarde për menaxhimin e kimikateve përgjatë gjithë ciklit të jetës së tyre. Mungesa e kapaciteteve lidhur me aspektet ligjore dhe ato teknike ka bërë që legjislacioni ekzistues në përgjigje të kërkesave të vendit të ketë boshllëqe, të cilat duhen plotësuar; p.sh. mungon përshkrimi i detajuar lidhur me kontrollin dhe monitorimin e kimikateve, çfarë e vështirëson zbatimin e legjislacionit ose çon në mospërputhshmëri me kërkesat e tij.

3.1 Përmbledhje e instrumentave ligjore që adresojnë menaxhimin e kimikateve

Një përmbledhje e instrumentave ligjore mbi menaxhimin e kimikateve në Shqipëri jepet në tabelën 3.A.

Tabela 3.A Përmbledhje e të gjitha instrumentave ligjore që lidhen me menaxhimin e kimikateve

Instrumentat - ligjore (tipi, referenca, viti)	Ministria ose organi përgjegjës	Kategoria e kimikateve, tipi i nënprodukteve, ose tipi i mbetjeve	Periudha e mbulimit të ciklit të jetës së kimikateve	Qëllimi i instrumentave ligjore	Neni përkatës/parashikimet
Ligji Nr. 9108, dt.17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”	MMPAU,MSH METE	Substancat dhe preparatet kimike	Prodhim, tregtim, ruajtje.	Të vendosë të drejtat dhe detyrimet e personave juridikë ose fizikë në përcaktimin e vetive, klasifikimin e sub dhe prep. kimike për regjistrimin, inventarizimin, njoftimin, menaxhimin dhe tregtimin e tyre.	Kapitujt III, VIII të ligjit, Neni 9 përcakton detyrimet për regjistrim, Neni 10 përcakton aplikimin për regjistrim, neni 22 regjistrimi sipas llojit, sasisë, vetive të substancës dhe të preparatit, Nenet 7, 8, 13 të ligjit 9108/03 përcaktojnë vlerësimin e substancave dhe preparateve kimike, Neni 5 i ligjit 9108/2003 përcakton klasifikimin e substancave dhe preparateve kimike sipas vetive të tyre. Kapituj V dhe VI përcaktojnë hedhjen në treg të substancave dhe preparateve të rrezikshme dhe autorizimin për menaxhimin e substancave dhe preparateve të

VKM Nr.824, dt.11.12.2003 “Për klasifikimin, etiketimin, ambalazhimin dhe ruajtjen e substancave kimike”	MMPAU MSh METE MB	Substancat dhe preparatet kimike	Menaxhim i kimikateve	Përcaktohen rregullat e klasifikimit të paketimit dhe etiketimit në Shqipëri me synim parandalimin e aksidenteve, mbrojtjen e shëndetit dhe jetës së njerëzve që merren me menaxhimin e substancave kimike të rrezikshme.	rrezikshme
Ligji Nr. 10431 dt.9.6.2011.“Për mbrojtjen e mjedisit” transponon disa direktiva si Direktiva IPPC, LPC, Seveso II, PRTR, etj. Hyn në fuqi në janar 2013.	MMPAU	Mbrojtja e ajrit, ujit dhe biodiversitetit , ndryshimet klimaterike kontrolli i ndotjes, parandalimi i aksidenteve madhore që përfshijnë substanca të rrezikshme, menaxhimi i integruar i mbetjeve, kimikate, Substancat ozon-holluese, NOQ	Menaxhimi e mjedisit në tërësi	Të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, mbron përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore, siguron kushte materiale për zhvillim të qëndrueshëm dhe një mjedis ekologjikisht të pastër.	
Ligji Nr.10448, dt. 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” transponon direktivat Parandalimit dhe Kontrollit të Integruar të Ndotjeve (IPPC) dhe Impiantet e Mëdha të Djegies.	MMPAU QKL, etj	Mbrojtja e mjedisit si një i tërë	IPPC, parandalimin e ndotjes në ajër, ujra, menaxhim i i mbetjeve dhe kimikateve, parandalimin e aksidenteve nga substancat e rrezikshme gjatë zhvillimit të një aktiviteti industrial	Vendosjen e kushteve në lejet mjedisore lidhur me parandalimin e ndotjes në ajër, ujra, menaxhimi i mbetjeve dhe kimikateve	Neni 3.i përcakton vlerat kufi të shkarkimeve; Në anekset 1-9 e këtij ligji parashikohen gjithashtu lista treguese e substancave kryesore ndotëse të cilat duhet të

Hyn në fuqi në janar 2013.					merren në konsideratë për të fiksuar vlerat limite të emisioneve, Vlerat Limite të Emisioneve të pluhurit, Vlerat Limite të Emisioneve për SO ₂ për lëndë djegëse të ndryshme, Vlerat Limite të Emisioneve për NO _x Metodat për vendosjen e vlerave limite të emisioneve për impiante me njësi djegieje të kombinuar, Metodat për matjen e emisioneve nga Impiantet e Mëdha të Djegies.
Projektligji “Për vlerësimin strategjik mjedisor”	MMPAU	Mbrojtja e mjedisit	Parandalimin e ndotjes së mjedisit përpara zhvillimit të tij		Pritet shqyrtimi dhe miratimi në KM,
Ligj Nr. 10440, dt. 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”	MMPAU	Mbrojtja e mjedisit	Parandalimin e ndotjes së mjedisit përpara zhvillimit të tij	Përcakton rregullat, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrat për identifikimin, saktësimin dhe vlerësimin e ndikimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të projektit ose veprimtarisë, për të siguruar shqyrtim cilësor teknik dhe juridik të kërkesës dhe marrjes së vendimit nga organet përkatëse. Përcakton veprimtaritë që i nënshtrohen VNM	Hyn në fuqi në janar 2013.
“Për miratimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve”, miratuar	MMPAU AKM MSh METE MPPT	Mbetjet	Menaxhim i integruar i mbetjeve	Përcakton drejtimin e politikës së Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve deri në vitin 2025 e ndarë në 3 faza operationale me nga 5 vjet secila.	

me VKM Nr. 175, dt. 19.1.2011.	MBUMK Operatorët që ushtrojnë aktivitete ekonomike			Paraqet mekanizmat kryesorë për investimet në sektorin e mbetjeve Siguron grumbullim të rrymave të mbetjeve të ndara nga njëra-tjetra dhe të shtrirë në të gjithë Shqipërinë, për letrën, qelqin, metalin dhe plastikën; Synon këshillimin e bizneseve mbi minimizimin e mbetjeve si dhe zhvillimin e tregjeve për riciklimin e materialeve në mënyrë që riciklimi të bëhet i mundur dhe kostot e tij të reduktohen.	
Ligji Nr. 10463, dt. 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve“	MMPAU AKM MSh METE MPPT MBUMK Operatorët që ushtrojnë aktivitete ekonomike	Mbetjet	Menaxhim i integruar i mbetjeve	Të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisor të mbetjeve nëpërmjet (i) parandalimit ose pakësimit të ndikimeve negative nga gjenerimi dhe menaxhimi i mbetjeve, (ii) pakësimit të ndikimeve të përgjithshme nga përdorimi i burimeve, si dhe (iii) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre.	
VKM Nr.825, dt. 13.10.2010 “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”	MMPAU DP Doganave	Mbetjet jo të rrezikshme, Lista e Gjellbër	Importimi i mbetjeve	VKM lejon importimin vetëm ato mbetje për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi, që nuk janë mbetje të rrezikshme.	
Draft-VKM për incinerimin e mbetjeve	MMPAU AKM Njësitë e qeverisjes vendore, Operatorët	Mbetjet që shkojnë ose që nuk pranojnë për incinerim	Asgjësimi i mbetjeve	Përcakton kërkesa të detajuara për incinerimin dhe bashkë-incinerimin e mbetjeve, duke synuar parandalimin sa më shumë të jetë e mundur ose kufizimin e efekteve negative në mjedis dhe rreziqeve që rezultojnë për shëndetin e	VKM në proces miratimi

				njeriut nga ndotja e shkaktuar nga shkarkimet nga këto procese në ajër, tokë, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.	
Draft- VKM “Për landfillin e mbetjeve”.	MMPAU AKM METE MPPT Njësitë e qeverisjes vendore Operatorët	Mbetjet që shkojnë ose që nuk pranojnë në landfill	Asgjësimi i mbetjeve	Përcaktimin e kërkesave të sakta teknike dhe operacionale për mbetjet dhe landfillet, të masave dhe procedurave për parandalimin ose pakësimin sa më shumë të jetë e mundur të efekteve të mundshme negative në mjedis, në veçanti ndotjen e ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore, tokës dhe ajrit, si edhe në mjedisin global, përfshirë efektin serrë, si edhe çdo lloj rreziku që mund të shkaktohet ndaj shëndetit të njeriut, nga asgjësimi në landfill i mbetjeve, gjatë gjithë ciklit të jetës së landfillit.	VKM në proces miratimi
Draft-VKM për “Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike”. VKM në proces miratimi	MMPAU AKM Njësi e qeverisjes vendore Operatorët	Mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike	Prodhuësit që hedhin në treg Pajisjet Elektrike dhe Elektronike, me qëllim që të minimizojnë hedhjen e MPEE në të njëjtin vend me mbetjet shtëpiake të përziera, për të lehtësuar grumbullimin e tyre të diferencuar, i etiketojnë ato me simbolin e përcaktuar në aneksin IV të draft VKM për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike.	Ky vendim ka si qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit përmes minimizimit të ndikimeve negative nga mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike.	Aneks 2.2 i Draft VKM për MPEE; pika V, VI, VII dhe VIII
Draft-VKM për “Ambalazhet dhe mbetjet nga	MMPAU AKM Njësi e	Mbetjet nga ambalazhet		Ky vendim ka si qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe shëndetit të njeriut përmes	

ambalazhet”. VKM në proces miratimi	qeverisjes vendore Operatorët			minimizimit të ndikimeve negative nga ambalazhet dhe mbetjet e tyre.	
Draft-VKM “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”. VKM në proces miratimi	MMPAU AKM Njësi e qeverisjes vendore Operatorët	Mbetjet nga bateritë dhe akumulatorët	Draft VKM “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre” përcakton rregulla për hedhjen në treg të baterive dhe akumulatorëve, ndalimin e hedhjes në treg të baterive dhe akumulatorëve që përmbajnë substanca të rrezikshme. Projektvendimi do të zbatohet për të gjitha llojet e baterive dhe akumulatorëve, pavarësisht formës, volumit, peshës, përbërjes së materialit ose përdorimit.	Ky vendim ka si qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit përmes minimizimit të ndikimeve negative nga bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre. Gjithashtu kjo draft VKM synon të maksimizojë grumbullimin e diferencuar të mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve, nxisë një nivel të lartë riciklimi të baterive si dhe të pakësojë sasinë e mbetjeve të baterive dhe akumulatorëve që asgjësohen së bashku me mbetje të përziera bashkiake.	Pika V e draft VKM specifikon kërkesat lidhur me përmbajtjen e metaleve të rëndë dhe kërkersat për etiketim tek bateritë për t’u hedhur në treg. Kërkesat për trajtimin dhe riciklimin përshkruhen më në detaje në aneksin III të draft VKM.
Draft-VKM “Për miratimin e rregullores për administrimin e vajrave të përdorura”. VKM në proces diskutimi me ministritë e linjës	MMPAU AKM Njësi e qeverisjes vendore Operatorët	Mbetjet e vajrave të përdorura	Parashikon masa për gjithë ciklin e jetës së vajrave të përdorura	Synon vendosjen e rregullave për menaxhimin e vajrave të përdorura që nga importi, prodhimi, përdorimi dhe asgjësimi i tyre.	
VKM Nr. 798, dt. 29.9.2010, për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”.	MMPAU MSh, organet e pushtetit vendor	Mbrojtja e shëndetit human dhe mjedisor	Prodhimi, regjistrimi, trajtimi, leja mjdisore, monitorimi	Kjo rregullore zbatohet nga të gjithë personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas dhe të huaj: - veprimtaritë e të cilëve krijojnë mbetje spitalore; - kur janë zotërues të mbetjeve, të	Kreu II, III, IV, V, Shtojca 1: llojet e mbetjeve spitalore të rrezikshme Shtojca 2.a: Etiketa e kontejnerëve

				licencuar për grumbullimin, ruajtjen, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore.	Shtojca 3: Metoda për trajtimin dhe asgjësimin Shtojca 4: Kushtet që duhet të respektojnë transportimi i mbetjeve spitalore infektuese Shtojca 5: Standarde teknike për incenerimin dhe autoklavimin e mbetjeve spitalore
VKM Nr. 99, dt. 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve”	MMPAU, MSh, METE, Doganat	Mbetje	Klasifikim i mbetjeve	Katalogu Shqiptar i Mbetjeve është në përputhje të plotë me Katalogun European të Mbetjeve, sipas Aneksit A, bashkëngjitur këtij vendimi si pjesë e tij dhe që përmbledh Shtojcat I, II, III dhe IV, në të cilat jepen përkatësisht: a) Shtojca I: klasifikimi i mbetjeve; b) Shtojca II: vetitë dhe karakteristikat e mbetjeve të rrezikshme; c) Shtojca III: kategoritë e mbetjeve të gjeneruara, të listuara sipas natyrës së tyre (III.A) dhe aktivitetit që i gjeneron ato (III.B); d) Shtojca IV: përbërësit e mbetjeve të Shtojcës III.B që i bëjnë ato të rrezikshme, kur ato manifestojnë vetitë e përshkruara në Shtojcën II.	
Ligji Nr. 10266 dt. 15.4.2010, për disa ndryshime dhe shtesa e Ligjit Nr. 8897 dt. 16.5.2002 “Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja”	MMPAU, MSh, MPPT, Pushteti vendor	Mbrojtja e ajrit		Ky ligj ka për qëllim të garantojë të drejtën e shtetasve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, të mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit shqiptar nga ndotja e ajrit, duke: a. Përcaktuar dhe vendosur objektiva për cilësinë e ajrit të ambientit që synojnë shmangien, parandalimin ose uljen e pasojave të dëmshme mbi shëndetin dhe	Neni 3 i ligjit përcakton treguesit mjedisorë bazë të gjëndjes së ajrit, si më poshtë: - të dioksidit sulfurit; - të dioksidit azotit - të lëndëve të imta grimcore si bloza (duke përfshirë PM ₁₀) - të lëndëve grimcore

				mjedisin; b. Vlerësuar cilësinë e ajrit të ambientit mbi bazën e metodave dhe kriterëve që përdoren në komunitetin europian; c. Marrë informacionin e mjaftueshëm mbi cilësitë e ajrit të ambientit dhe për të siguruar disponueshmërinë e këtij informacioni për publikun, midis të tjerash me anë të pragjeve sinjalizuese; d. Ruajtur cilësinë e ajrit të ambientit, kur ajo është e mirë dhe për ta përmirësuar atë në raste të tjera.	në gjëndje pezull - të plumbit (aerosol) - të ozonit; Neni 6, Kufizimet - 1. Kufizimi i shkarkimeve në ajër realizohet nëpërmjet vendosjes dhe zbatimit të detyrueshëm të normave të shkarkimeve. Neni 9, Normat e shkarkimeve nga burimet e lëvizshme
VKM Nr. 803, dt. 4.12.2003 “Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit”	MMPAU, MSh, AKM	Cilësia e ajrit	Monitorimi i cilësisë së ajrit, indikatorët përkatës	Përcakton vlerat limite (nivelet maksimale të lejueshme) të cilësisë së ajrit për ndotësit më të rëndësishëm dhe më të ndeshur në praktikë në ajrin urban, LNP, PM ₁₀ , PM _{2,5} ; SO ₂ , NO ₂ , Pb, ozoni, CO, benzeni	
VKM Nr.435, dt.12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”	MMPAU	Mbrojtja e ajrit	Shkarkimet në ajër nga aktivitetet industriale	Vendos normat e shkarkimeve në ajër nga subjektet të cilat fillojnë veprimtarinë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi	
Udhëzimi Nr. 6527, dt. 24.12.2004 ”Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre”, i amenduar me	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, AKM, bashkitë, komunat etj	Mbrojtja e cilësisë së ajrit		Qëllimi kryesor i këtij udhëzimi është përcaktimi i kufijve të lejueshëm të elementëve ndotës të ajrit në mjedis, që shkarkohen me gazet, nga përdorimi dhe trafiku i automjeteve rrugore.	Anekset përkatëse përcaktojnë normat e lejuara

Udhëzim Nr.12, dt. 15.6.2010 “Për amendamentet e shtuar dhe për Udhëzimet Nr.6527 i 24.12.2004 i shoqëruar me manualin e kontrollit të mjeteve"					
Ligji Nr. 8450, dt.24.2.1999, “Për përpunimin, për transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nën-produkteve të tyre” i ndryshuar me ligjin Nr. 9218,dt.8.4.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8450,dt.24.2.1999	METE, Inspektorati Qëndror Teknik, QKL	Produkte të naftës	Përpunim, transport, tregëtim	Krijimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor rregullues, procedurat e dhënies së lejes dhe autorizimeve dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës dhe gazit	
VKM Nr. 129, dt.28.3.1999 “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejes e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nën-produkteve të tyre”	METE, QKL, IQT			Krijimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor rregullues, procedurat e dhënies së lejes dhe autorizimeve dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës dhe gazit	

Urdhër i përbashkët Nr.6, dt.9.10.2007, “Për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse”, në përputhje me kërkesat e Direktivës 98/70/KE	METE, Inspektoriati Qëndror Teknik	Produkte të naftës	Përpunim, transport, tregtim	Synon kontrollin e subjekteve që përpunojnë, transportojnë dhe tregtojnë lëndë djegëse, nëpërmjet mbledhjes dhe ruajtjes së të dhënave për cilësinë e lëndëve djegëse	
Urdhëri i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës Nr.166, dt.1.7.2004, "Për kontrollin e cilësisë, mënyrën e marrjes së mostrës, sasinë e saj, pagesat dhe dokumentacionin përkatës si dhe për kontrollin e respektimit të normave e kushteve teknike në instalimet e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre"	METE, Inspektoriati Qëndror Teknik	Produkte të naftës	Prodhim, përpunim, transport, tregtim	Synon kontrollin e subjekteve që përpunojnë, transportojnë dhe tregtojnë lëndë djegëse, lidhur me respektimin e normave e kushteve teknike në instalimet e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre	
Ligji Nr. 9876, dt. 14.2.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”	METE, AKBN, Inspektoriati Qëndror Teknik	Biokarburantet	Prodhim, transport, tregtim	Synon promovimin e prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për zëvendësimin e nënprodukteve të naftës për sektorin e transportit, për të kontribuar në përmbytjen e angazhimeve të ndërmarra, në kuadër të Protokollit të Kiotos për ndryshimet klimatike, si dhe për të siguruar furnizimin e promovimin me burime energjetike të rinovueshme, nëpërmjet nxitjes e kultivimit të bimëve	Sipas nenit 4 të këtij ligji, gjatë ushtrimit të veprimtarive të prodhimit dhe të përdorimit të biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, synohen masa për nxitjen e përdorimit të biokarburanteve dhe e

				energjetike, për të mbrojtur mjedisin.	lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, kontribut në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, etj.
VKM Nr.147, dt. 21.3.2007, “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diezel”	METE, IQT, Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Lëndët djegëse, karburantet	Prodhim, tregtim, ruajtje	Synon kontrollin e cilësisë së lëndës djegëse për përmbajtjen e plumbit dhe squfurit. Në territorin e Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm tregtimi i benzinës pa plumb, që, në nomenklaturën e mallrave, përshkruhet në kodet CN 27101141, 27101145, 27101149, 27101151 dhe 27101159 dhe që plotëson kërkesat e përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi	Specifikohen kërkesat për përmbajtjen e squfurit në lëndët djegëse sipas afateve kohore të përcaktuara
Ligji Nr.9126 dt.29.7.2003 “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”	METE, RISHM	Lëndët eksplozive	Prodhimi, magazinimi, përdorimi, kontrolli, asgjësimi, transferimi dhe mënyra e tregtimit të lëndës plasëse për përdorim civil	Ka si qëllim përcaktimin e procedurave, rregullave dhe përgjegjësi të administratës shtetërore për prodhimin, magazinimin, përdorimin, kontrollin, asgjësimin, transferimin dhe mënyrën e tregtimit të lëndës plasëse për përdorim civil, për mbrojtjen dhe sigurimin e jetës e të shëndetit të njerëzve, kafshëve, vlerave materiale dhe mjedisit nga lëndët plasëse.	
Vendim Nr.853, dt. 17.12.2004 “Për procedurën e dhënies së lejes së importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarre, për përdorim civil”	Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Financave	Lëndët piroteknike fishekzjarre, për përdorim civil	Importi, eksporti dhe prodhimi		

VKM Nr.52 dt. 29.1.2004 “ Mbi procedurat e lëshimit të lejes për përdorimin civil të materialeve eksplozive”.	METE, RISHM	Lëndët eksplozive	Lejedhënia për përdorim civil	Përcakton procedurat e lëshimit të lejes për përdorimin civil të materialeve eksplozive”.	
VKM Nr. 453, dt. 23.6.2005 “Për miratimin e listës së pajisjeve që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese”.	MMPAU, Doganat	Substancat ozonholluese	Prodhimi, eksportimi, Importimi, tregtimi, përdorimi dhe asgjësimi i substancave ozon-holluese		
VKM Nr. 290, dt. 28.4.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr. 453, dt. 23.6.2005 “Për miratimin e listës së pajisjeve, që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese”.	MMPAU, Doganat	Substancat ozonholluese	Importi, tregtimi, përdorimi dhe asgjësimi i substancave ozon-holluese		
Ligji Nr. 10390, dt.	MBUMK	Plehrat kimike		Qëllimi i ligjit ë shtë vlerësimi i plehrave;	Neni 4. Prodhimi,

3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë”				përcaktimi i tipeve të plehrave që përdoren në Republikën e Shqipërisë; kontrolli i prodhimit, të paketimit, të etiketimit, të transportit, të magazinimit dhe të vendosjes në treg të plehrave; përcaktimi i detyrimit për regjistrimin e plehrave që nuk kanë emërtimin "EC Fertilizers"; organizimin dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse. Objektivat: Të mbështesë rritjen e prodhimtarisë në bujqësi; të mundësojë drejtimin e kontrollin e prodhimit dhe vendosjen në treg të plehrave; të ndihmojë në ruajtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve e të kafshëve dhe në mbrojtjen e konsumatorit; të ndihmojë ruajtjen e tokës dhe mbrojtjen e mjedisit.	qarkullimi i lirë dhe vendosja në treg. Neni 5. Transporti, magazinimi dhe mirëmbajtja. Neni 6. Paketimi, etiketimi, certifikata e analizës dhe e origjinës. Neni 7. Plehra të papërshtatshme. Neni 8. Plehrat e nitratit të amonit, me përmbajtje të lartë azoti. Neni 9. Kërkesat dhe kushtet për trajtimin e plehrave. Neni 10. Detyrimet e prodhuesit.
Ligji Nr.9199, dt. 26.2.2004 “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve ‘bio’”	MBUMK	Produktet bio		Qëllimi: a) nxitja e prodhimit organik në vend; b) krijimi i kuadrit ligjor të nevojshëm; c) përcaktimi i kushteve të prodhimit, përpunimit, transportit, certifikimit dhe kontrollit të produkteve bujqësore dhe atyre ushqimore, me prejardhje bimë dhe shtazore, që prodhohen, përpunohen ose/dhe importohen e tregtohen si produkte "Bio".	
VKM Nr. 388, dt. 31.5.2005 “Për përbërjen, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e komisionit shtetëror të prodhimit organik”					

Ligji Nr. 9362, dt. 24.3.2005 “Për shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve, i ndryshuar;	MBUMK	Produkte të Mbrojtjes së Bimëve (PMB)	Një pjesë e dispozitave të këtij ligji rregullon karantinën bimore, ndërsa pjesa tjetër rregullon çështjet e PMB-ve		
VKM Nr. 1188, dt. 20.8.2008 “Për miratimin e rregullave për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e PMB”,	MBUMK	Produkte të Mbrojtjes së Bimëve (PMB)	Importimi, tregtimi, transporti, ruajtja, përdorimi dhe asgjësimi i PMB.	Përcakton rregullat që kanë të bëjnë me monitorimin e PMB të regjistruara që nga importimi deri tek përdorimi dhe asgjësimi i ambalazheve të tij.	
VKM Nr. 1555, dt. 12.11.2008 “Për miratimin e rregullave të regjistrimit dhe të kriterëve të vlerësimit të PMB”, i ndryshuar.	MBUMK, MMPAU, MSh	Produkte të Mbrojtjes së Bimëve (PMB)	Rregullat e regjistrimit të PMB.	Përcakton rregullat për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin (ambalazhimin) e Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve (PMB) Ky vendim rregullon (i) regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB), në formën e tyre tregtare, që do të importohen dhe përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë; (ii) regjistrimin e lëndëve vepruese dhe të përbërësve të tjerë, që përmbahen të PMB-të, kjo në funksion të mbrojtjes së bimëve dhe të produkteve bimore nga parazitët, njëkohësisht pa ndikime në shëndetin e njerëzve, të kafshëve dhe në mjedis. PMB-të nuk mund të futen në treg dhe të përdoren brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përveçse në rastet kur janë të regjistruara,	
VKM Nr. 860, dt.	MMPAU,	NOQ	NOQ e trashëguara nga	Ka si qëllim rehabilitimin e disa zonave të	

20.12.2006, “ Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm ”	METE		industria para viteve 90 dhe monitorimi i rasteve të reja	nxehta mjedisore, disa prej të cilave të ndotura me NOQ, përfshirë edhe largimin për incinerim jashtë vendit të sasive të mëdha të kimikateve të mbetura në magazinat e ish-ndërmarrjeve industriale e bujqësore pas ndryshimit të sistemit në vitet '90.	
VKM Nr. 447, dt. 19.9.1994, “Për ndalimin e përdorimit të asbestit si material termoizolues në të gjitha llojet e ndërtimit	MMPAU, MSh, METE	asbesti		Synon ndalimin e përdorimit të asbestit si material termoizolues në të gjitha llojet e ndërtimit	
VKM Nr. 100, datë 3.2.2008 “Për përcaktimin e substancave të rrezikshme”	MPÇSShB			Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i substancave të rrezikshme, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin në punë nga përdorimi i tyre. Ky vendim është detyrues për të gjithë personat juridikë e fizikë prodhues ose importues, që janë të detyruar të respektojnë normat në vëndin e punës. Në këtë vendim gjen zbatim të pjesshëm Direktiva e Këshillit 90/394/KEE-së dt. 28.6.1990 "Për mbrojtjen e punëtorëve në punë nga lëndët kancerogjene", (direktiva e gjashtë në zbatim të nenit 16 (1) të Direktives 89/391/KKE)	
Ligji Nr. 9707, dt. 5.4.2007 “Për Kontrollin Shtetëror të Veprimtarisë së Import-Eksportit të Mallrave Ushtarake	MM AKShE	Veprimtaritë ndërmjetësues e për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë	Eksportin, importin, kalimin tranzit, transferimin dhe	Ky ligj rregullon veprimtarinë e kontrollit shtetëror mbi eksportin, importin, kalimin tranzit, transferimin dhe veprimtaritë ndërmjetësuese për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë, për sigurimin e interesave	

dhe Mallrave e Teknologjive me Përdorim të Dyfishtë”		me përdorim të dyfishtë		kombëtare të Republikës së Shqipërisë, mbikëqyrjen e respektimit të angazhimeve të saj në traktatet ndërkombëtare për mos-përhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe sistemet e lëshimit të tyre, transferimin e armëve konvencionale, si dhe për zbatimin e masave, që synojnë parandalimin e përdorimit të këtyre mallrave nga terroristët dhe grupe të tjera për qëllime të kundërligjshme.	
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1569, dt. 19.11.2008 “Për miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import eksportit”	MM AKShE		Import, eksport		
Ligj Nr.9323, dt.25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, rishikuar me ligjin Nr.9523, dt.25.4.2006 Ligjin Nr.9644, dt.20.11.2006, Ligjin Nr.10008, dt.27.10.2008, Ligjin Nr.10350, dt.11.11.2010	DRShP, QKKB, MSh, MF, METE, ISKSh, KNB	Prodhimi, importimi, eksporti, reklamimi, përshkrimi, përdorimi, kontrolli i cilësisë dhe inspektimi i barnave		Ky ligj synon vendosjen e rregullave për prodhimin, importin, eksportin, reklamimin, përshkrimin, përdorimin, kontrollin e cilësisë dhe aktivitetet e inspektimit të lidhura me barnat e përdorura për njerzit në Republikën e Shqipërisë.	
Ligj Nr. 10480 dt.17.11.2011 “Për	METE	Mallra jo-ushqimore,	Prodhimi, përdorimi, riparimi i produkteve të	Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet e prodhuesve dhe	- Neni 6:Detyrimet e tjera të prodhuesve dhe

sigurinë e produkteve jo-ushqimore”		produkte të prodhuara	tjer jo-ushqimore	shpërndarësve të produkteve jo-ushqimore. Ky ligj synon të bëjë më të sigurt produktet e konsumit në tregje. Ai merret gjithashtu me kompetencat e autoriteteve të ndryshëm që merren me mbikqyrjen dhe monitorimin e tregut.	shpërndarësve; - Neni 10: Të drejtat dhe detyrimet e autoriteteve përgjegjëse - Neni 14 kompetencat e Inspektoriatit; - Neni 23: Politikat e monitorimit të tregut; - Neni 24: Kontrolli i produkteve që hyjnë në Shqipëri
Ligj Nr.10489, dt. 15.12.2011, Për tregëtimin dhe survejancën e tregut për produktet jo-ushqimore”	METE	Mallra jo-ushqimore, përveç substancave kimike (objekt autorizimi) dhe produktet kozmetike	Gjatë fazës së furnizimit të produkteve dhe kur ato janë hedhur në treg	Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë rolin dhe përgjegjësitë e operatorëve ekonomikë gjatë fazës së hedhjes së produktit në treg. Detyrimet e personave përgjegjës për disa produkte, grupe produktesh apo e atyre produkteve që janë hedhur në treg janë përcaktuar gjithashtu. Ky ligj jep gjithashtu të drejtat kompetencat dhe mënyrën në të cilën janë organizuar autoritetet përgjegjëse si dhe parimet kryesore për kontrollin e produkteve të importuar që bëhet në bashkpunim me autoritet doganore.	

3.2 Detaje shtesë mbi instrumentat ligjore kryesorë që lidhen me kimikatet

Legjislacioni lidhur me substancat kimike në Republikën e Shqipërisë rregullon menaxhimin e substancave dhe preparateve kimike, substancat për mbrojtjen e bimëve, lëndëve eksplozive, lëndëve të gazta dhe të lëngëta që marrin flakë, substancave të rrezikshme, substancave ozonholluese, ndotësit organikë të qëndrueshëm etj.

Në Republikën e Shqipërisë, ligji bazë që rregullon administrimin e substancave dhe preparateve kimike është ligji Nr. 9108, dt. 17.7. 2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”. Ky ligj ka për objekt të tij vendosjen e të drejtave dhe detyrimeve të personave juridikë ose fizikë, në përcaktimin e vetive dhe klasifikimin e substancave dhe preparateve kimike për regjistrimin, inventarizimin, njoftimin, menaxhimin dhe tregtimin e tyre.

Ligji Nr. 9108/03 parashikon rregulla për klasifikimin dhe testimin e substancave dhe preparateve kimike para se ato të hidhen në treg. Sipas këtij ligji, testimi duhet të bëhet me metoda që plotësojnë parimet e mbrojtjes së kafshëve eksperimentale, të cilat vendosen me urdhër nga Ministria kompetente. Sipas këtij ligji, MMPAU mban Regjistrin Kombëtar për substancat dhe preparatet kimike dhe të dhënat për këtë regjistër sigurohen nga ministritë e ngarkuara nga ky ligj.

Në zbatim të ligjit 9108/03 Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM Nr. 824, dt.11.12.2003 “Për klasifikimin, paketimin, etiketimin dhe ruajtjen e sigurtë të substancave dhe preparateve të rrezikshme” i cili, ka për qëllim të rregullojë prodhimin, tregtimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme, duke respektuar legjislacionin shqiptar dhe rregullat ndërkombëtare.

Ligji Nr. 8531, dt. 23.9.1999 “Për shërbimin e kontrollit të plehrave kimike” rregullon kontrollin e plehrave kimike, të importit dhe të vendit, që qarkullojnë në tregun shqiptar, për të siguruar përdorimin e plehrave të sigurta e cilësore, në përputhje me kërkesat për ruajtjen e shëndetit të njerëzve, të kafshëve, të bimëve për mbrojtjen e mjedisit dhe të konsumatorit.

Legjislacioni lidhur me Produktet për Mbrojtjen e Bimëve (PMB) përfshin:

- Ligjin Nr. 9362, dt. 24.3.2005 “Për shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve, i ndryshuar: një pjesë e dispozitave të këtij ligji rregullon karantinën bimore, ndërsa pjesa tjetër rregullon çështjet e PMB. Ky ligj është hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

- VKM Nr. 1188, dt. 20.8.2008 “Për miratimin e rregullave për importimin, tregtimin, transportin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e PMB-ve”: ky akt nënligjor është hartuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

- VKM Nr. 1555, dt. 12.11.2008 “Për miratimin e rregullave të regjistrimit dhe të kriterëve të vlerësimit të PMB-ve”. Hartues të këtij vendimi janë Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Dispozitat e VKM 1555/08 rregullojnë:

1. Regjistrimin e PMB në formën e tyre tregtare që do të importohen dhe përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë;

2. Regjistrimin e lëndëve vepruese dhe të përbërësve të tjerë, që përmbahen tek PMB, kjo në funksion të mbrojtjes së bimëve dhe të produkteve bimore nga parazitët, njëkohësisht pa ndikime në shëndetin e njerëzve, të kafshëve dhe në mjedis.

Sipas ligjit "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "Bio", produktet dhe substancat që mund të përdoren në bujqësinë organike janë vetëm ato të vendosura në listën e plehrave dhe pasuruesëve të tokës, listën e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe listën e produkteve të autorizuar për pastrimi dhe dezinfektim (aneksi II). Po në këtë ligj, në aneksin VII dhe VIII specifikohet ngarkesa e specieve të ndryshme të bagëtive dhe shpendëve për njësi të sipërfaqes në nivelet që nuk kalojnë kufijtë e 170 kg N/ha për vit.

Ligji Nr. 9362, dt. 24.3.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve" dhe ligji Nr. 9908 i vitit 2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9362 dt. 24.3.2005 " "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve" janë në përputhje me direktivën 91/414/CE që trajton vendosjen në treg të produkteve fitofarmaceutike dhe zbatohen në përputhje edhe me rregullat e praktikës së mirë fitosanitare.

Ligji Nr. 9817 "Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural", në nenin 3, pika (d) përcakton mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisi si një nga objektivat e politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural, duke garantuar që bujqësia të ruajë burimet natyrore të saja. Ligji në fjalë mbështet implementimin e katër Rregulloreve bazë të Këshillit të Europës për Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP).

Ligji Nr. 9426 "Për mbarështimin e blegtorisë" i vitit 2005 ndër të tjera trajton praktikën e mira në mbarështimin e kafshëve të fermës, në mënyrë të tillë që t'u sigurohet atyre mirëqënia. Këto praktika, sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, mbajnë parasysh cilësitë natyrore të zonës bujqësore, sigurojnë pjellorinë e përhershme të tokës dhe prodhimin e produkteve blegtorale të sigurta, sigurojnë "Standardet ekologjike" që janë nivelet maksimale të lejuara të ndotjes mjedisore për rritjen e kafshëve të fermës.

Ligji "Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "bio" është i harmonizuar me Rregulloren Nr 2092/91 të BE (që lidhet me mënyrën e prodhimit biologjik të prodhimeve bujqësore dhe prezantimin e tij në produktet bujqësore dhe artikujt ushqimorë).

Ligji Nr.8450, dt. 24.2.1999, "Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre ", i ndryshuar me ligjin nr. 9218, dt. 8.4.2004, përcakton procedurat e dhënies së lejes dhe autorizimeve dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës dhe gazit.

Ligji Nr. 9126 dt. 29.7.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë" ka si qëllim përcaktimin e procedurave, rregullave dhe përgjegjësiave të administratës shtetërore për prodhimin, magazinimin, përdorimin, kontrollin, asgjësimin, transferimin dhe mënyrën e tregtimit të lëndës plasëse për përdorim civil, për mbrojtjen dhe sigurimin e jetës e të shëndetit të njerëzve, kafshëve, vlerave materiale dhe mjedisit nga lëndët plasëse. Në zbatim të ligjit 9126/03 është VKM Nr.52 dt. 29.1.2004 " Mbi procedurat e lëshimit të lejes për përdorimin civil të materialeve eksplozive".

Rregullimi i veprimtarisë së importit, eksportit, tranzitit, transhipit të të gjithë kimikateve të përfshira në konventën kimike, bëhet me aktet normative të poshtëshënuara:

- Ligji Nr. 7747, dt. 29.7.1993 "Për ratifikimin i konventës për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre",
- Ligji Nr. 9092, dt. 3.7.2003 "Për zbatimin e Konventës për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të Armëve Kimike dhe për shkatërrimin e tyre.",

- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 38, dt. 22.1.2004. “Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e bordit të këshilltarëve për zbatimin e konventës kimike për ndalimin e zhvillimit, të prodhimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre”,
- Ligji Nr. 9707, dt. 5.4.2007 “Për Kontrollin Shtetëror të Veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1569, dt. 19.11.2008 “Për miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import eksportit”.

Të gjithë kimikatet që përfshihen në konventën kimike të shkallës parë, dytë, tretë, pajisjet e tjera prodhuese të kimikateve të veçanta të cilat janë të kontrolluara sipas kësaj konvente, mund të inspektohen në çdo kohë nga Organizata e Ndalimit të Armëve Kimike, në zbatim të kuadrit ligjor të mësipërm. Gjithashtu kimikatet e mësipërme raportohen në Organizatën e Ndalimit të Armëve Kimike, ku kjo e fundit në çdo kohë mund të bëjë inspektimin e tyre.

Në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës së Shqipërisë, konventat ndërkombëtare janë të ratifikuara me ligj nga Kuvendi Popullor dhe janë të publikuara në Gazetën Zyrtare si pjesë integrale e legjislacionit kombëtar dhe mbizotërojnë ligjet kombëtare që nuk përputhen me to.

Republika e Shqipërisë ka aderuar në Konventën e Roterdamit për Procedurën e Njoftimit Paraprak të pëlqimit për Kimikate të caktuara të Rrezikshme dhe Pesticideve në Tregtinë Ndërkombëtare nëpërmjet Ligjit Nr. 10277 dt. 13.5.2010. Ky projektligj përforcon nevojën e krijimit të Byrosë së Kimikateve e cila do të realizojë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin edhe nga Konventa e Bazelit dhe Stokholmit, në të cilat vendi është palë. Së bashku me Konventën e Bazelit dhe të Stokholmit, ajo plotëson kuadrin e nevojshëm juridik që rregullon lëvizjen ndërkombëtare të kimikateve të rrezikshme, duke shmangur rreziqe që vijnë prej tyre.

- Konventa e Aarusit “Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendim marrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin”. Data e ratifikimit: 26.10.2000;

- Ligji Nr. 9548, dt. 1.6.2006 “Për aderimin e republikës së Shqipërisë në protokollin për regjistrat e shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve”;

“Konventa për mbrojtjen e mjedisit detar dhe zonës bregdetare të detit Mesdhe”; data e ratifikimit: 16.11.2000. Në kontekstin e kësaj konvente Shqipëria është pjesë e 6 protokolleve të saj të cilat janë:

- Protokolli “Për Parandalimin dhe Eliminimin e Ndotjes së Detit Mesdhe nga Shkarkimet e Anijeve dhe Avionëve ose Djegia në Det”,
- Protokolli “Për Bashkëpunimin në Luftën kundër ndotjes së Detit Mesdhe nga Hidrokarburet dhe Substanca të tjera të Dëmshme në Raste Emergjence”,
- Protokolli “Për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja prej Burimeve e Aktiviteteve të Vendosura në Tokë”
- Protokolli “Për Mbrojtjen e Detit Mesdhe kundër Ndotjes prej Eksplorimit dhe Shfrytëzimit të Shelfit Kontinental, Shtratit të Detit dhe Nëntokës së tij.”,
- Protokolli “Mbi Parandalimin e Ndotjes së Detit Mesdhe nga Lëvizjet Ndërkufitare të Mbetjeve të Rrezikshme dhe Asgjësimin e tyre”.

Po merren masa që Shqipëria të jetë pjesë edhe e protokollit të shtatë për Menaxhimin e Integruar të Zonës Bregdetare në Mesdhe.

Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Konventën e Stokholmit në 5.12.2001 dhe ratifikuar me anë të ligjit Nr. 9263, dt. 29.7.2004 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Stokholmit”.

Duke marrë përsipër detyrimin për ndalimin e përdorimit të pjesës më të madhe të Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm, kufizimin e DDT, si dhe hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit, MMPAU në bashkëpunim me projektin “Përgatitja e planit kombëtar në zbatim të konventës së NOQ” (2004-2006) financuar nga GEF-UNDP, përgatiti Planin Kombëtar të Veprimit për reduktimin dhe eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ). Si rezultat i këtij projekti, në Shqipëri është përgatitur një inventar paraprak i NOQ.

Lidhur me disa çështje të rëndësishme të identifikuara në Planin e Veprimit për NOQ, Shqipëria me mbështetjen e organizmave ndërkombëtare dhe marrëveshjeve bilaterale, ka bërë progres të dukshëm për zgjidhjen e tyre. Në këtë kontekst vlen të përmendet largimi nga vendi i të gjitha pesticideve NOQ. Në vitin 2006 u largua stoku i fundit i pesticideve NOQ. Mbetjet e heksaklorcikloheksanit, përfshirë lindan, të ish-uzinës kimike Durrës u depozituan në një CDF (confined disposal facility), ndërtimi i të cilës u përfundua në vitin 2011.

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën e Ndotjes Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët (CLRTAP) nëpërmjet ligjit Nr. 9425, dt. 6.10.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në Distançë të Largët. Gjithashtu janë ratifikuar edhe katër protokolle të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët”:

– Ligji Nr. 10062, dt. 29.1.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për kontrollin e shkarkimeve të oksideve të azotit apo flukseve të tyre ndërkufitare”, të Konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”;

– Ligji Nr. 10063, dt. 29.1.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30 % të Konventës së vitit 1979 “Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët”;

– Ligji Nr. 10422, dt. 26.5.2011 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin për Financimin Afat-Gjatë të Programit Kooperues për Monitorimin dhe Vlerësimin e Transferimit të Ndotësve të Ajrit në Distançë të Mëdha në Europë” (Gjenevë 1984); miratuar në Këshillin e Ministrave nëpërmjet VKM Nr. 185, dt. 9.3. 2011. Miratuar edhe nga Parlamenti. Pritet të dekretohet nga Presidenti.

– Ligji Nr. 10436, dt. 28.6.2011 “Për aderimin në “Protokollin për reduktimin e mëtejshëm të shkarkimeve të SO₂ (Oslo 1994)”. Miratuar në Parlament me dt. 28.6.2011. Pritet të dekretohet nga Presidenti.

– Ligji Nr. 10476 dt. 3.11.2011 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin “Për pakësimin e acidifikimit, eutrofikimit dhe përqëndrimit të ozonit në shtresën e poshtme të atmosferës” (Gothenburg, Nëntor 1999);

Në Planin Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit 2010-2014 është parashikuar për vitin 2011 ratifikimi i tre protokolleve të tjerë të CLRTAP përkatësisht:

– Protokolli “Mbi Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm (NOQ)” (Aarhus, Qershor 1998);

- Protokolli “Mbi metalet e rënda” (Aarhus, Qershor 1998);
 - Protokolli “Për pakësimin e acidifikimit, eutrofikimit dhe përqëndrimit të ozonit në shtresën e poshtëme të atmosferës” (Gothenburg, Nëntor 1999).
- Procesi i ratifikimit të tre protokolleve të metaleve të rënda, NOQ dhe Gothenburgut është prezantuar në Planin Kombëtar të Veprimit hartuar me mbështetjen e qeverisë Hollandeze, nën Projektin që synon asistimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në ratifikimin dhe implementimin e detyrimeve të tre protokolleve.
- Konventa mbi Efektet Ndërkufitare të Aksidenteve Industriale, nënshkruar më 18.3.1992, ratifikuar më 5.1.1994;
 - Konventa e Bazelit "Mbi kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre përshtatur nga konferenca e të plotfuqishmëve me 22.3.1989. – nënshkruar në Paris me 17.6.1994. Data e ratifikimit: 13.5.1997. Amendamenti i Konventës së Bazelit (Vendimi III/1 i tij). Data e aderimit: Ligji Nr. 9299, dt. 28.10.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimin III/1, amendament i Konventës së Bazelit “Për lëvizjen ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”;
 - Konventa e Stockholmit për ndotësit organikë të qëndrueshëm ratifikuar në 4 Tetor 2004;
 - Aderimi në Konventën e Roterdamit nëpërmjet Ligjit Nr. 10277, dt.13.5.2010 “për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Roterdamit për Procedurën e Njoftimit Paraprak të pëlqimit për Kimikate të caktuara të Rrezikshme dhe Pesticideve në Tregtinë Ndërkombëtare”;
 - Konventa e Aarhusit “Për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendim marrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin”. Data e ratifikimit: 26.10.2000;
 - Ligji Nr. 9548,dt. 1.6.2006 ”Për aderimin e republikës së Shqipërisë në protokollin për regjistrat e shkarkimit dhe të transferimit të ndotësve”;
 - Konventa për mbrojtjen e mjedisit detar dhe zonës bregdetare të detit Mesdhe”; data e ratifikimit: 16.11.2000. Në kontekstin e kësaj konvente, Shqipëria është pjesë e 6 protokolleve të saj, të cilët janë:
 - Protokolli “Për parandalimin dhe eliminimin e ndotjes së Detit Mesdhe nga shkarkimet e anijeve dhe avionëve ose djegia në det”;
 - Protokolli “Për bashkëpunimin në luftën kundër ndotjes së Detit Mesdhe nga hidrokarburet dhe substanca të tjera të dëmshme në raste Emergjence”;
 - Protokolli ”Për Mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja prej burimeve e aktiviteteve të vendosura në tokë”;
 - Protokolli ”Për mbrojtjen e Detit Mesdhe kundër ndotjes prej eksplorimit dhe shfrytëzimit të shelfit kontinental, shtratit të detit dhe nëntokës së tij”;
 - Protokolli ”Mbi parandalimin e ndotjes së detit mesdhe nga lëvizjet ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”.

Po merren masa që Shqipëria të jetë pjesë edhe e protokollit të shtatë “Për Menaxhimin e integruar të zonës bregdetare në Mesdhe”.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Vjenës dhe Protokollin e Montrealit në tetor të 1999 me anë të ligjit Nr. 8463, dt. 10.3.1999 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në

Konventën e Vjenës “Për mbrojtjen e shtresës së ozonit” dhe Protokollin e Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”.

Agjencitë implementuese: Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO) dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, kanë hartuar Programin Kombëtar të Ozonit dhe më pas Programin Kombëtar të Heqjes nga Përdorimi të Substancave Ozonholluese, që është miratuar me Vendimin 39/34 të Komitetit Ekzekutiv të Fondit Shumëpalësh të Protokollit të Montrealit në vitin 2003.

Procesi i auditimit, i kryer nga UNIDO, ka theksuar se pothuaj të gjitha detyrimet e Qeverisë Shqiptare ndaj Protokollit të Montrealit janë realizuar. Detyrimet kryesore ligjore të Qeverisë Shqiptare ndaj Protokollit të Montrealit janë realizuar nëpërmjet Vendimit Nr. 290, dt. 28.4.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 453, dt. 23.6.2005 “Për miratimin e listës së pajisjeve, që përdorin lëndë ozonholluese, të cilat ndalohen të prodhohen e të importohen, si dhe rregullat e procedurat e zëvendësimit të lëndëve ozonholluese në pajisjet ekzistuese”.

– Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr.9480, të miratuar me dt.16.2.2006 ka miratuar Amendamentin e Kopenhagës të Protokollit të Montrealit.

– Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr.9484, të miratuar me dt. 2.3.2006 ka miratuar Amendamentin e Londrës të Protokollit të Montrealit.

– Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 9485, të miratuar me dt. 6.3.2006 ka miratuar Amendamentin e Montrealit dhe Amendamentin e Pekinit të Protokollit të Montrealit.

Aktualisht legjislacioni mjedisor kombëtar po përjeton një periudhë intensive pasurimi e zgjerimi nëpërmjet transpozimit të direktivave konkrete të BE-së për mjedisin. Me asistencë të Projektit të BE CARDS 2006, INPAEL dhe në zbatim të PKZMSA-së 2009-2014 janë përgatitur:

– Ligji Nr. 10431, dt. 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” transponon disa direktiva si Direktiva IPPC, LPC, Seveso II, regjistrat e transferimit dhe të lëshimit të ndotjeve (PRTR), etj.;

– Ligji Nr. 10440, dt.7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” përfshin disa direktiva duke përfshirë direktivën 85/337/EEC për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis, direktiva 97/11/EC dhe 2003/35/EC;

– Ligji Nr. 10448, dt. 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” transponon direktivat e ”Parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjeve (IPPC)” dhe atë të ”Impianteve të mëdha të djegies”;

– Draft-ligji “Për aksidentet industriale” që transponon Direktivën Seveso II;

– Draft-ligji “Për ujrat” që transponon Direktivën Kuadër për Ujrat;

– Ligji Nr. 10463, dt. 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” që transponon Direktivën Kuadër për Mbetjet 2009;

– VKM Nr. 175, dt. 19.1.2011 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbetjeve dhe planit kombëtar të menaxhimit të mbetjeve” për 2010 deri 2025;

– Draft- akt “Për landfillet e mbetjeve” që transponon plotësisht Direktiven e Këshillit të Europës 1999/31/EC e dt. 26.4.1999 “Mbi landfillin e mbetjeve”;

- Draft- akt “Për incinerimin e mbetjeve” që transponon plotësisht Direktivën 2000/76/EC mbi incinerimin e mbetjeve;
- Draft-Vendimi i Këshillit të Ministrave “Për regjistrat e transferimit të ndotësve” që transponon PRTR;
- Draft- akt “Për bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e tyre” që transponon plotësisht Direktivën e baterive dhe akumulatorëve dhe mbetjet e tyre 2006/66/EC;
- Draft- akt “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike” që transponon plotësisht Direktivën Mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike 2002/96/EC;
- Draft akt “Për ambalazhet dhe mbetjet nga ambalazhet” që transponon plotësisht Direktivën e ambalazheve dhe mbetjet nga ambalazhet 94/62/EC;
- Draft-VKM “Për informimin e publikut” që transponon Direktivën 2003/4/EC;
- Draft-VKM “Për standardet e cilësisë së ujit” që transponon Direktivën 2008/105/EC”;
- Draft VKM ”Për menaxhimin e planeve të baseneve ujore”.

Në kuadër të zbatimit të PKZMSA, në iniciativat e saj afatmesme dhe afatgjata 2010-2014, MMPAU ka parashikuar hartimin e akteve të mëposhtme:

- Projekt-akt “Për regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve”, i cili synon të përafrojë plotësisht Rregulloren Nr. 1907/2006 të Këshillit të dt. 18 dhjetor 2006 mbi Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e kimikateve (REACH);
- Projekt-VKM "Për importin dhe eksportin substancave të rrezikshme". Sipas nenit 15 të Ligjit Nr. 9108 dt. 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, kjo VKM do të transpozojë Rregulloren (KE) Nr. 689/2008 të Këshillit dhe të Parlamentit Europian të 17 qershorit 2008 në lidhje me importin dhe eksportin e kimikateve të rrezikshme.
- Projekt- VKM “Lista e substancave të rrezikshme, të cilat nga natyra e tyre paraqesin një rrezik të shëndetit dhe jetës së njeriut dhe mjedisit” vjen në kuadër të Nenit 13 të Ligjit Nr. 9108, dt. 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, i cili do të transpozojë Aneksin XIII dhe XIV të rregulloreve të Këshillit dhe Parlamentit (KE) Nr. 1907/2006 i 18 dhjetorit 2006 në lidhje me Regjistrimin, Vlerësimin dhe Autorizimin e Kimikateve (REACH);
- Projekt-akt “Mbi klasifikimin, etiketimin, paketimin e substancave dhe preparateve kimike”, e cila synon të përafrojë plotësisht Rregulloren (EC) 1272/2008 (CLP) të Parlamentit dhe Këshillit të Europës të 16.12.2008 mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe preparateve;
- Draft-VKM “Për ndotësit organikë të qëndrueshëm”, i cili transponon rregulloren e Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Europës Nr. 850/2004 i 29.4.2004 “Për ndotësit organikë të qëndrueshëm”.

3.3 Kuadri ligjor ekzistues sipas kategorisë së përdorimit, që i adresohet llojeve të kimikateve nga prodhimi/ importi deri tek asgjësimi

Tabela 3.B përshkruan instrumentat ligjor në vend për stadi të ndryshme gjatë ciklit të jetës së kimikateve duke filluar nga prodhimi, formulimi, ruajtja, transportimi, shpërndarja, tregëtimi, përdorimi, mirëmbajtja deri në asgjësimin përfundimtar të tyre. Me poshtë jepet një

përshkrim i detajuar i legjislacionit kombëtar dhe procedurat administrative që mbulojnë ciklin e jetës së kimikateve, të kategorizuara sipas tipit të tyre.

Tabela 3.B Përshkrimi i instrumentave ligjore për menaxhimin e kimikateve gjatë ciklit jetësor të tyre

Kategoria e Kimikateve	Importim	Prodhim	Magazinin/ depozitim	Transportimi	Shpërndarje/ tregtim	Përdorim / Trajtim	Asgjësim
Pesticidet	X	X (ambalazhim)	X	X	X	X	X
Kimikatat Industriale	X	X	X	X	X	X	X
Produktet e naftës	X	X	X	X	X	X	X
Mbetjet kimike	X	X	X	X	X	X	X
Plehrat kimike	X	X	X	X	X	X	X
Produktet kozmetike	-	-	-	-	-	-	-
Farmaceutikët	X	X	X	X	X	X	X
Detergjentët	X	X	X	X	X	X	X
Substanca & përzierje të tjera kimike							

3.4 Përmbledhje e procedurave kryesore administrative për kontrollin e kimikateve

3.4.1 Pesticidet

Produktet e Mbrojtjes së Bimëve

Në ligjin “Për shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve, i ndryshuar, është përcaktuar se vetëm Produktet për Mbrojtjen e Bimëve (PMB) të regjistruara zyrtarisht mund të importohen dhe të përdoren në Republikën e Shqipërisë. Pra, PMB duhet të regjistrohen para se të hyjnë në Republikën e Shqipërisë.

Regjistrimi i PMB-ve bazohet në VKM Nr.1555, dt.12.11.2008 “Për miratimin e rregullave të regjistrimit dhe të kriterëve të vlerësimit të PMB-ve”, ndryshuar me VKM Nr. 791, dt. 24.9.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.1555, dt.12.11.2008”. Kjo VKM ka përshtatur Direktivën 91/414/EEC, të dt.15 korrik 1991 në lidhje me vendosjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve në treg, dhe amendimet e saj, lidhur me përmbajtjen e dokumentacionit të regjistrimit të detajuar në kërkesat dhe të dhënat e plota; rregullat e regjistrimit dhe kërkesat që duhet të plotësojë një PMB për t’u regjistruar; kushtet në të cilat kryhet regjistrimi, modifikimi, anulimi, çregjistrimi, reregjistrimi dhe zgjerimi i fushës së përdorimit të PMB-ve; kriteret e autorizimit dhe përdorimit për qëllime eksperimentale; informacioni për efektet potenciale të rrezikshme për shëndetin e njerëzve ose të kafshëve, për ujrat nëntokësore dhe për mjedisin; rezervimi i të dhënave dhe konfidencialiteti. Kjo VKM ka përshtatur dhe një pjesë të Direktivës 1999/45/EC e 11 shtator 1999 lidhur me klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e PMB-ve.

Institucionet për të kryer aktivitete të caktuara profesionale dhe teknike, veçanërisht ato që lidhen me vlerësimin e dosjeve gjatë procedurës së regjistrimit, për të kryer studime

toksikologjike dhe ekotoksikologjike, për të kryer vlerësime fiziko-kimike dhe analiza biologjike të produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) janë:

Departamenti për Mbrojtjen e Bimëve (DMB) në Universitetin e Bujqësisë, Tiranë; Instituti i Shëndetit Publik (IShP); Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV); Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Biocidet

Nuk ka një procedurë regjistrimi për biocidet. Për këto produkte rregullohet licensimi nga QKL bazuar në VKM Nr. 538, dt. 26.5.2009 për “Licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” si dhe pajisja me autorizim importi për lëndët DDD bazuar në VKM Nr. 415 Dt. 17/08/1993

Lista e substancave që lejohet të përdoret për dizinfektim, dezinfektim dhe deratizim(DDD) në shëndetin publik si dhe kërkesat që duhen plotësuar nga importuesit që të marrin Autorizimin e Importit janë përshkruar në Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë Nr. 365 dt. 3.8.2012 ‘Për miratimin dhe përdorimin e substancave DDD në shëndetin publik’. Dhënia e Autorizimit të Importit bëhet nga sektori Higjienë-Epidemiologjisë në bashkëpunim me IShP dhe miratohet nga drejtori i Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë. Leja e importit për lëndë DDD regjistrohet në regjistër të veçantë. Lista e lëndëve DDD, që lejohen të importohen për përdorim vetëm për shëndet publik, miratohet nga Ministri i Shëndetësisë. Kjo listë rinovohet çdo vit, bazuar në rekomandimet e OBSH-së dhe Direktivat e BE.

Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur aktualisht një Projekt-ligj për produktet biocide, i cili synon të mbrojë shëndetin publik nga organizmat e dëmshëm për shëndetin, përmes shërbimit të specializuar të dezinfektim, dezinfektim dhe deratizimit (DDD). Ky projektligj përcakton rregullat për:

- a. Kontrollin e dëmtuesve (mikroorganizmave patogenë, artropodëve dhe brejtësve) në mjediset publike dhe private.
- b. Regjistrimin, prodhimin, ambalazhimin, transportin, magazinimin, tregtimin dhe përdorimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Shqipërisë për përdorim në shëndet publik në mbrojtje të shëndetit të njerëzve.

3.4.2 Plehrat kimike

Ligji Nr. 10390, dt. 3.3.2011 “Për plehrat e përdorimit për bimësinë” ka për qëllim vlerësimin e plehrave, përcaktimin e tipave të plehrave që përdoren në Republikën e Shqipërisë, kontrollin e prodhimit, të paketimit, të etiketimit, të transportit, të magazinimit dhe të vendosjes në treg të plehrave, përcaktimin e detyrimit për regjistrimin e plehrave që nuk kanë emërtimin "EC Fertilizers" dhe organizimin dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse.

Regjistrimi i plehrave, që nuk kanë emërtimin “EC Fertilizer”, do të bëjë të mundur plotësimin e të gjitha mangësive dhe boshllëqeve, që vihen re në praktikë, si: mundësimin e drejtimit dhe kontrollit të prodhimit dhe vendosjes në treg të plehrave, mundësimin për rritjen e përdorimit dhe cilësisë të plehrave, ndihmën për ruajtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, kafshëve dhe mbrojtjen e konsumatorit, mbështetjen për ruajtjen e tokës dhe mbrojtjen e mjedisit, përcaktimin e kërkesave për plehrat me bazë azoti, si nitrati amoni, me përmbajtje në azot mbi 28 % në peshë si dhe kushtet që duhet të plotësojnë këto plehra, lidhur me testin e rezistencës ndaj shpërthimit.

3.4.3 Substancat kimike & përzierjet të rregulluara nga REACH dhe CLP

REACH

Kapitujt III, VIII të Ligjit Nr. 9108 të dt. 17.7.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike" përcaktojnë respektivisht regjistrimin e substancave dhe regjistrimin dhe njoftimin e substancave të rrezikshme.

Neni 9 dhe 10 përcaktojnë detyrimet për regjistrim dhe aplikimin për regjistrim. Sipas nenit 22 të ligjit 9108/03, prodhuesit, importuesit dhe shpërndarësit e substancave dhe të preparateve të rrezikshme janë të detyruar të regjistrojnë llojin, sasinë, vetitë e substancës dhe të preparatit.

Nenet 7, 8, 13 të Ligjit Nr. 9108/03 përcaktojnë vlerësimin e substancave dhe preparateve kimike, nëpërmjet testimit të substancave dhe preparateve kimike në sistemin e laboratorëve të akredituar, vlerësimin e rrezikut të substancave të rrezikshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Neni 5 i Ligjit Nr. 9108/2003 përcakton klasifikimin e substancave dhe preparateve kimike sipas vetive të tyre. Kapituj V dhe VI përcaktojnë detyrimet për hedhjen në treg të substancave dhe preparateve të rrezikshme dhe autorizimin e personave juridikë ose fizikë, që kryejnë veprimtari tregtare për menaxhimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme.

Lidhur me eksportin e kimikateve, Kapitulli VII i Ligjit Nr. 9180/2003 përcakton detyrimet e importuesve dhe eksportuesve të substancave dhe preparateve të rrezikshme. Sipas nenit 21, importi dhe eksporti i substancave dhe i preparateve të rrezikshme bëhen vetëm me leje të ministrit përkatës.

Zyra e regjistrimit të kimikateve, në bazë të të dhënave të ministrive të ngarkuara nga ky ligj, regjistron aplikimet për importin dhe eksportin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme të caktuara, miratimet e dhëna, si dhe njofton Ministrin e Mjedisit për shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave për këto substanca.

Lidhur me infrastrukturën përkatëse për të ndaluar dhe kontrolluar eksportin dhe importin e kimikateve të rrezikshme të caktuara dhe/ose të ndaluara, duke përfshirë pesticidet:

1. **Autoritetet doganore** kontrollojnë në pikat e kalimit të kufirit shtetëror mallin e deklaruar si substancë dhe preparat i rrezikshëm, për importin dhe eksportin e të cilave kërkohet miratim nga ministria përkatëse e përcaktuar nga ky ligj;
2. **Inspektorati Shtetëror i Mjedisit** bashkëpunon me autoritetet doganore dhe u siguron atyre asistencë me specialistë;
3. **Inspektoriati Sanitar Shtetëror** bashkëpunon me Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe me autoritetet doganore, si dhe u siguron atyre asistencë me specialistë;
4. **Inspektoriati për Mbrojtjen e Bimëve** (inspektoriati fitosanitar) në AKU është përgjegjës për aktivitetet e kontrollit, pra për mbikqyrjen e aktivitetit të mbrojtjes së bimëve në lidhje me PMB.

Inspektori i mbrojtjes së bimëve, pranë AKU, ka të drejtë të bllokojë një PMB, kur analizat e kryera nuk përputhen me treguesit cilësorë, të deklaruar për këtë PMB apo kur ajo nuk është e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi për regjistrimin e PMB.

Përafrimi i legjislacionit në fushën e kimikateve ka mbetur prapa, por në fillim të vitit 2013 pritet të zbatohet projekti SELEA për përafrimin e legjislacionit, ku janë parashikuar edhe përafrimi i legjislacionit në fushën e kimikateve. Mekanizmat për kontrollin e kimikateve industriale të parashikuara në ligjin "Për substancat dhe preparatet kimike" nuk janë ngritur.

Nuk është ngritur ende Zyra e Regjistrimit të Kimikateve, e cila në Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA 2009-2014 për adresimin e prioriteteve afatgjata është parashikuar si masë zbatuese për periudhën 2013-2014.

Kimikate të ndaluara dhe të kufizuara

Të ndaluara për t'u prodhuar, importuar, eksportuar dhe shpërndarë në Republikën e Shqipërisë janë substancat e renditura në Aneksin 2 të Ligjit Nr. 9108, dt. 17.7.2003 dhe konkretisht, bazuar në Direktiven 76/769/EEC i datës 27 korrik 1976.

Tabela 3.C :Lista e substancave prodhimi, importi, eksporti dhe shpërndarja e të cilave janë të ndaluara në Shqipëri

Nr	Emri i substancës kimike	CAS No
1	Bifenile të poliklorinuara (PCB) dhe preparate me përmbajtje të tyre në sasi më të madhe se 0,005% (me përjashtim të bifenileve të mono dhe dikloruara)	1336-36-3
2	Trifenile të poliklorinuara dhe preparate me përmbajtje të tyre në sasi më të madhe se 0,005%	61788-33-8
3	Fibra azbesti a) krocidolit b) amozit c) antrofil ç) aktonolit d) tremolit	12001-28-4 12172-73-5 77536-67-5 77536-66-4 77536-68-6
4	Monometil tetraklordifenil metan (emri tregtar Ugilec 141)	75623-60-6
5	Monometil dibromdifenil metan	

Kimikate të kufizuara

Kimikatet e kufizuara janë të përcaktuara në tabelat 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9092, të emërtuara njëjloj si ato të konventës “Për ndalimin e zhvillimit, magazinimit dhe përdorimit të armëve kimike dhe për shkatërrimin e tyre”. Personat fizikë ose juridikë që prodhojnë, zotërojnë, përdorin, transferojnë, importojnë – eksportojnë ose kryejnë veprimtari me lëndët kimike të mësipërme janë subjekt deklarimi dhe verifikimi nga autoriteti shtetëror. Rregullat për deklarim dhe marrjen e licencës miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Klasifikimi, etiketimi, paketimi

Rregullat e klasifikimit, paketimit dhe etiketimit të kimikateve të rrezikshme në Shqipëri përcaktohen në VKM Nr. 824, dt. 11.12.2003 “Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme”, vendim i cili është hartuar në përputhje me direktivën e BE 67/548/EEC e dt. 27 qershor 1967 “Për klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave të rrezikshme”.

VKM 824/03 synon, krijimin e kushteve të sigurta për administrimin e të gjitha kimikateve dhe preparateve kimike që importohen, eksportohen, prodhohen, tregtohen, përdoren dhe ruhen në vendin tonë.

Sipas pikës 3 të vendimit 824/03, klasifikimi i substancave dhe preparateve të rrezikshme bëhet sipas Sistemit Ndërkombëtar, i cili bazohet në vetitë fiziko-kimike, toksikologjike dhe në bazë të efekteve të veçanta në shëndetin e njeriut dhe efektet në ndotjen e mjedisit. Në zbatim të ligjit Nr. 9108, dt. 17.7.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike", vlerësimi i riskut të një kimikati ose të një preparati për shëndetin e njeriut bëhet me metodat tradicionale, duke përdorur përqëndrimet limite individuale të preparatit.

Pika 4 e këtij vendimi rregullon kërkesat që duhet të plotësojë prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi për ambalazhimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme si dhe jep instruksione për mënyrën e paketimit, materialin që duhet përdorur si dhe kushtet e izolimit. Kërkesat kanë lidhje me qëndrueshmërinë e ambalazhit, hermeticitetin dhe shenjat paralajmëruese të rrezikut të substancave dhe preparateve të rrezikshme.

Në pikën 5 të këtij vendimi jepen gjithashtu rregulla për etiketimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme para se ato të hidhen në treg. Po ashtu është përcaktuar përmbajtja e etiketës së ambalazhit të substancave dhe preparateve të rrezikshme të hedhura në treg si dhe jepen parashikime të veçanta në lidhje me etiketimin e disa preparateve të klasifikuara të rrezikshme për shitje publikut të gjerë. Substancat dhe preparatet kimike sipas pikës 7 të VKM 824/03 ruhen të depozituara në magazina të përcaktuara për këtë qëllim dhe në kushte të veçanta.

Në anekset e këtij vendimi paraqiten lista e frazave standarde mbi natyrën e rreziqeve të veçanta nga substancat (R-phrases), rregullat e sigurisë nëpërmjet frazave të sigurisë (S-phrases) si dhe klasifikimi i substancave dhe preparateve kimike sipas numrit rendor të elementit.

Rregullat për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin (ambalazhimin) e produkteve të mbrojtjes së bimëve (PMB) janë të përcaktuara në VKM Nr. 1555, dt. 12.11.2008 “Për miratimin e rregullave të regjistrimit dhe të kriterëve të vlerësimit të PMB-ve”. Në këtë VKM specifikohet përmbajtja e etiketës së PMB, e cila duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe e pashuajtshme; plotësimi dhe vendosja e saj mbi ambalazh; kërkesat që duhet të plotësojnë subjektet që merren me ambalazhim të PMB; detyrimet ligjore që kanë në aktivitetin e tyre, etj.

Duke patur parasysh zhvillimet europiane dhe ndërkombëtare lidhur me klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve, është e nevojshme të rishikohet legjislacioni aktual përkatës, bazuar në rregulloren (EC)1272/2008 “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve”, ose në Sistemin e Harmonizuar Globalisht për Klasifikimin dhe Etiketimin e Kimikateve (GHS-Globally Harmonized System for Classification and Labelling of Chemicals). Lidhur me zbatimin e GHS, i vetmi sektor që ka implementuar pjesërisht GHS (CLP) është Sektori i Mbrojtjes së Bimëve (MBUMK).

3.4.4. Produktet Kozmetike

Nuk ka mekanizma kontrolli. Mungon ligji bazë dhe aktet e tjera nënligjore për këto kimikate. Ministria e Shëndetësisë po përgatit bazën e re ligjore mbi produktet kozmetike.

3.4.5. Detergjentët

Rregullat për vendosjen në treg të detergjenteve dhe të lëndëve tensioaktive për detergjentët, janë përcaktuar në Ligjin Nr. 10216, dt. 21.1.2010 “Për detergjentët”, i cili transponon rregulloren Europiane 648/2004/EC si dhe amendimet e saj me Nr. 907/2006.

Ky ligj ka për qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit publik e të mjedisit në lidhje me:

- biodegradimin e lëndëve tensioaktive në detergjente;
- kufizimet ose ndalimin e përdorimit të lëndëve tensioaktive, për shkak të biodegradimit;
- etiketimin e detergjentëve, përfshirë lëndët aromatike alergjene.

Zbatimi i dispozitave të këtij ligji për detergjentët kryhet nga struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut në ministrinë përgjegjëse për çështjet e tregtisë dhe të industrisë, e parashikuar në Ligjin Nr. 9779, dt. 16.7.2008 "Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore".

Janë në proces dy aktet nënligjore :

- Draft-VKM "Për etiketimin dhe të dhënat e përbërësve për detergjentët" i cili është dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave;
- Draft-VKM "Standardet, metodat e testimit dhe kufijtë e lejuar lidhur me biodegradimin e detergjentëve, si dhe vlerësimin e rrezikut për lëndët tensioaktive në detergjentë", dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave.

Në bazë të ligjit për detergjentët, cituar më sipër, mbikëqyrja e tregut në lidhje me zbatimin e legjislacionit në këtë fushë mbulohet nga IQT (Inspektoriati Qëndror Teknik) deri në ngritjen e Strukturës Përgjegjëse për Mbikëqyrjen e Tregut.

3.4.6 Farmaceutikët

Administrimi dhe asgjësimi i barnave të konfiskuara në vend rregullohet nëpërmjet Ligjit Nr. 9323, dt. 25.11.2004 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", rishikuar nga Ligji Nr. 9523, dt. 25.4.2006, Ligji Nr. 9644, dt. 20.11.2006, Ligji Nr.10008, dt. 27.10.2008, Ligji Nr. 10350, dt. 11.11.2010

Sipas Nenit 59 të këtij ligji barnat e konfiskuara, që janë të përdorshme, me dokumentacion të rregullt, kalojnë në administrim të Ministrisë së Shëndetësisë.

Barnat e bllokuara dhe të konfiskuara, të cilat janë të papërdorshme, asgjësohen në prani të inspektorëve farmaceutikë, me procesverbal të rregullt, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit, me shpenzimet e subjektit që ka bërë shkeljen.

3.4.7. Produkte të Naftës

Procedura e lejeve në lidhje me importin dhe transportin tranzit është rregulluar me Ligjin Nr. 8450, dt. 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", ndryshuar me Ligjin Nr. 9218, dt. 8.4.2004 dhe VKM Nr. 129 dt. 28.3.1999 "Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejes e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre" si dhe VKM Nr. 130, dt. 8.4.1999 "Për inspektoriatin shtetëror të kontrollit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre". Ministria përgjegjëse për liçensimin është METE.

Cilësia e karburanteve kontrollohet nga Inspektoriati Qëndror Teknik (IQT). Në zbatim të legjislacionit përkatës, IQT merr kampione për çdo ngarkesë produkti që hyn në çdo doganë shqiptare (detare apo tokësore), për kryerjen e analizave të cilësisë, rezultatet e të cilave dokumentohen. Gjithashtu, e njëjta procedurë ndiqet për çdo kampion të gazoilit të prodhuar në vend, si dhe kryhen kontrole periodike e me sondazhe gjatë gjithë vitit në gjithë stacionet e tregimit me pakicë të karburanteve (benzinë, gasoil dizel, dhe gaz të lëngëzuar të naftës) dhe në të gjitha depozitat e tregimit me shumicë të produkteve të naftës dhe gazit.

Vlerësimi i gjëndjes teknike të automjetit për efekt të ndotjes së ajrit nga shkarkimet e gazeve dhe zhurmat e shkaktuara prej tij, janë pjesë përbërëse e procesit të kontrollit teknik të mjeteve, dhe kryhet nga entet pronare të rrugëve (Drejtorja e Përgjithshme e Rrugëve, bashkitë, komunat).

Neni 17 i ligjit Nr. 8897 i dt. 16.5.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” detyron operatorët industrialë veprimtaria e të cilëve shkakton shkarkime në ajër, të pajisen me leje mjedisore nga MMPAU, nëpërmjet Qendra Kombëtare e Liçensimit.

Sipas nenit 11 të ligjit Nr. 8897/2002, operatorët e burimeve të mëdha dhe mesatare të ndotjes detyrohen të kryejnë monitorimin e shkarkimeve në ajër dhe të publikojnë periodikisht të dhënat e tij, si dhe masat e marra për kufizimin e ndotjes. Ata duhet gjithashtu të dorëzojnë të dhënat e vetmonitorimit pranë Agjencive Rajonale të Mjedisit.

3.5 Mekanizmat jo-rregullatore për menaxhimin e kimikateve

Legjislacioni mjedisor kombëtar përcakton edhe mekanizmat e instrumentet që përdoren detyrimisht për të realizuar praktikisht kërkesat ligjore që u paraqitën më sipër, duke i vlerësuar ato si hallka të detyrueshme nëpër të cilat duhet të kalojë hartimi e miratimi i strategjive, planeve të veprimit, programeve e projekteve që trajtojnë zhvillimet e pritshme ekonomiko-shoqërore sektoriale sikurse është Vlerësimi Strategjik Mjedisor.

UNIDO dhe UNEP janë duke zbatuar së bashku në Shqipëri Programin Kombëtar për një Prodhim më të Pastër në Shqipëri. Ky program ka ofruar mbështetje për arritjet dhe hapat e mëtejshëm për përmirësimin e mekanizmave ligjore rregullatore dhe iniciativave financiare me synimin për:

- Reduktimin e degradimit të mjedisit;
- Nxitja e eficiencës së energjisë dhe përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.

Qendra Kombëtare e Prodhimit të Pastër në Shqipëri u krijua në 30 Mars 2010. Produktet kryesore të programit janë:

- Zhvillimi i kapaciteteve, nxitja e trajnimeve profesionale dhe krijimi i rrjetit të ekspertëve kombëtarë për të dhënë shërbime në ndërrmarje dhe organizata të ndryshme, veçanërisht në sektorët prioritar të industrisë.
- Implementimi i koncepteve, metodave dhe teknikave të RECP në bizneset shqiptare duke realizuar histori të suksesit në keto kompani sa i përket arritjeve dhe përfitimeve mjedisore dhe ekonomike.
- Integrimi i RECP në politikat, strategjitë dhe planet e veprimit të udhëhequra nga UNEP.

Në kuadër të këtij programi një grup prej 24 ekspertësh janë trajnuar dhe 12 kompanive të sektorit minerar, turizëm dhe industri ushqimore u është ofruar ekspertiza për zbatimin e programit të përdorimit me eficiencë të burimeve, për një prodhim më të pastër.

Konsultimet e gjera me publikun, me OJF e me të interesuarit e tjerë përbën një tjetër mekanizëm të vlefshëm që kontribuon në integrimin e mbrojtjes së mjedisit në dokumentat që parashikojnë zhvillimet në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Tërheqja e publikut, e OJF mjedisore dhe e të interesuarve të tjerë gjatë fazave të vlerësimit dhe të miratimit të një strategjie a të një dokumenti tjetër që parashikon zhvillime në fusha e sektorë të ndryshëm ekonomikë e shoqërorë, vlerësohet si mekanizëm i pazëvendësueshëm, që kontribuon në integrimin e mbrojtjes së mjedisit në dokumentat e zhvillimeve sektoriale. Kjo vjen si rezultat i zbatimit të Konventës së Arhusit, ku pjesmarrja e publikut është veçanërisht e rëndësishme për çështjet mjedisore.

Si e tillë, pjesëmarrja e publikut ka merituar trajtime të gjera e të detajuara në legjislacionin mjedisor kombëtar. Gati në çdo ligj mjedisor, informimi i publikut, organizimi i debateve publike, vlerësimi i sugjerimeve e i kërkesave të tij, tërheqja e tij në vendimmarrje, janë

trajtuar me detaje. Posaçërisht në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 994, dt. 2.7.2008 “Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin”, në një kre të veçantë detajohen rregullat, procedurat, format e realizimit praktik të tyre, mënyrat e komunikimit dhe afatet që duhet të respektojnë organet shtetërore për të realizuar tërheqjen e mendimit të publikut e të OJF.

Përfaqësimi i strukturave mjedisore në organet vendimmarrëse të llojeve e të niveleve të ndryshme është një tjetër mekanizëm dhe një mundësi më shumë për të realizuar integrimin e mjedisit në planet e programet sektoriale.

Në realitetin Shqiptar ekzistojnë shumë organizma vendimarrës, kompetencat ligjore të të cilëve përfshijnë miratimin e dokumenteve që sigurojnë zhvillimet ekonomike dhe sociale në sektorë dhe në nivele të ndryshme. Gjithashtu, legjislacioni i veçantë që rregullon organizimin dhe aktivitetet e këtyre organizmave siguron pjesmarrjen e organizatave dhe shoqatave mjedisore si anëtarë në përbërjen e këtyre organizmave kolegjalë, me qëllim që të kenë një ndikim pozitiv në integrimin e kërkesave mjedisore në dokumentat që duhen miratuar.

Duke filluar nga Këshilli i Ministrave, Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit (KKRrTSh), Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) në të cilat Ministri i Mjedisit është anëtar dhe ku MMPAU paraqet zyrtarisht me shkrim mendimin dhe kërkesat e saj për dokumentin që shqyrtohet e miratohet, dhe duke vazhduar me organet vendim-marrëse lokale në të cilat marrin pjesë përfaqësuesit e agjencive rajonale të mjedisit, praktikisht është krijuar një mundësi që deri në momenti e miratimit të dokumentave që parashikojnë zhvillimet e sektorëve të ndryshëm, të vazhdojë të realizohet harmonizimi i zhvillimeve të pritshme me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. Agjencitë Rajonale të Mjedisit në nivel Qarku bëjnë pjesë në Këshillat e Rregullimit të Territorit që miratojnë dokumenta zhvillimi brenda qarkut përkatës, si plane rajonale zhvillimi etj.

Përfaqësimi i ARM-ve në këto organe shërben si mjet për të përfaqësuar interesat mjedisore, që në procesin vendim-marrës të integrohet edhe mbrojtja e mjedisit. Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit në Republikën e Shqipërisë është organi më i lartë vendim-marrës mbi planifikimin e territorit. Ky këshill ka në përbërjen e tij edhe Ministrin e Mjedisit si autoriteti që përfaqëson objektivat e mbrojtjes së mjedisit.

MMPAU ka bashkëpunuar edhe me OJQ dhe grupime OJQ për realizimin e projekteve të kërkimit dhe zhvillimit shkencor. Në harkun kohor të tre viteve janë lidhur rreth 42 kontrata një pjesë e mirë e të cilave për kërkimin shkencor, informacion dhe rritje ndërgjegjësimi.

Në kuadrin kombëtar është e rëndësishme të përmendet edhe mbështetja rajonale e dhënë nga organizmat ndërkombëtare për institucionet kërkimore-shkencore. REC ka kontribuar përmes disa projektsh mjedisore, ndër të cilët mund të përmendim projektin “Mbështetje për forcimin dhe fuqizimin e Institutit të Trajnimit dhe Kurikulës (projekt i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës) për futjen e lëndës ekstra-kurikulare të Edukimit Mjedisor “Paketa e Gjellbër” për klasat 5-9 të arsimit bazë (REC me financim të Qeverisë së Mbreterisë së Vendeve të Ulëta).

3.6 Instrumentat ligjore lidhur me aktivitetet që kanë ndikim në menaxhimin e kimikateve.

Në tabelën 3.D përmbledhet legjislacioni me ndikim jo të drejtëpërdrejtë në fushën e menaxhimit të kimikateve me kimikatet, sikurse janë rregulloret për cilësinë e ujërave, etj.

Tabela 3.D: Instrumentat ligjore që ndikojnë në mënyrë indirekte në menaxhimin e kimikateve

Legjislacioni	Ministria dhe Autoriteti Përgjegjës, Departamenti/Kompania	Objektivat dhe Qëllimi
Ligji Nr.9115, dt. 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotura”	MMPAU	Objekti i ligjit: të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujrave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre si dhe detyrimet e shkarkusave të ujrave të ndotura
Ligji Nr. 8905, dt. 6.6.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja”	MMPAU Ministritë e Linjës	Ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit detar të R. Shqipërisë nga ndotjet dhe dëmtimet, parandalimin dhe shmangien e tyre, të shkaktuara nga veprimtaritë njerëzore në det e në zonën bregdetare, të cilat prishin cilësinë e ujit, dëmtojnë burimet e detit e të bregdetit, rrezikojnë faunën dhe florën, kërcënojnë shëndetin e njeriut, si dhe vështirësojnë zhvillimin normal të veprimtarive në këtë mjedis
Ligji Nr. 9103, dt.10.7.2003 “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare”	MMPAU	Synon mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare në gjëndjen e tyre natyrore, garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe të ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke ndaluar veprimtaritë që rrezikojnë.
VKM Nr. 177 dt. 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjedisve ujore pritës”	MMPAU Ministritë e linjës	Synon të parandalojë, të zvogëlojë dhe të shmangë ndotjen e mjedisve ujore pritëse nga substancat e rrezikshme, që shkarkohen në to përmes ujërave të ndotura, duke përcaktuar vlerat kufi për përbërësit e lejuar, sipas shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij. Kjo VKM përcakton gjithashtu një detyrim për para-trajtimin e ujrave të ndotura industriale përpara shkarkimit të tyre në sistemet për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të zeza urbane. Shtojcat I,II,III,IV të Vendimit parashikojnë: 1. Normat e lejuara të substancave të rrezikshme dhe parametrat e lejuara në ujrata e ndotura që shkarkohen nga veprimtaritë industriale. 2. Normat e lejuara për shkarkimet e lëngëta urbane të cilat i nënshtrohen trajtimit mjedisor

		paraprak nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, të ndara nga shkarkimet e tjera të lëngëta. 3. Kriteret për zonimin e mjediseve ujore pritëse të grupuara në të ndjeshme dhe më pak të ndjeshme. Gjithashtu në këtë kapitull përcaktohet trajtimi sipas ngarkesës hyrëse në sistemin kolektor. 4. Monitorimin i cili kryhet në përputhje me procedurat sipas shtojcës nr.2 të vendimit.
Ligji Nr.7643, dt. 2.12.1992 “Për Shëndetin Publik dhe Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, i ndryshuar	MSh, MMPAU, pushteti vendor	Ujrat e pijshëm prodhimin, trajtimin shpërndarjen Ky ligj përcakton organizimin dhe kompetencat e Inspektoratit Sanitar Shtetëror si dhe kundërvajtjet administrative sanitare. Ai siguron survejimin dhe sigurinë e shpërndarjes së ujit për qëllime pirjeje, për të siguruar shëndetin dhe higjienën. Ligji ndalon konsumin e ujit të pijshëm, në rast se dyshohet për ndotje të tij ose kur tejkalohen normat sanitare në fuqi. Në bazë të Nenit 13 të Ligjit, Inspektoriati i Mjedisit së bashku me Inspektoratin Sanitar Shtetëror dhe atë Bashkiak, ushtrojnë kontroll për respektimin e normave të shkarkimeve të lëngëta.
VKM Nr. 145, dt. 26.2.1998 “Rregullore higjieno-sanitare për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm, projektimin, ndërtimin dhe mbikqyrjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm”.		Kjo rregullore është përgatitur në përafrim me Direktivën e Këshillit 80/778/EEC e 15 Korrikut 1980 (Direktiva e Ujit të Pijshëm) në lidhje me cilësinë e ujit për konsum nga njerëzit si dhe bazuar në Udhëzuesin e Cilësisë së Ujit të Pijshëm të OBSH-së. Sipas kësaj rregulloreje ujrat që mund të përdoren për qëllime konsumi të ujit të pijshëm mund të jenë ujrat nëntokësore (burime natyrore të formacioneve të ndryshme gjeologjike, pus-shpime hidrogeologjike, puse individuale ose kolektive) dhe ujra sipërfaqësore (lumenj, ujmbledhësa, liqene). Ujrat sipërfaqësore, sipas karakteristikave që paraqesin në raport me standardin e ujit të pijshëm, i nënshtrohen detyrimit të trajtimeve përkatëse.
VKM Nr.797, dt. 29.9.2010 për miratimin e rregullores higjieno-sanitare “Për administrimin e cilësisë së ujrave të larjes”	MSh, Pushteti Vendor	Ky Vendim transponon direktivën 2006/7/BE e Parlamentit dhe Këshillit të Europës e 15 Shkurtit 2006 lidhur me administrimin e cilësisë së ujit për larje.
VKM Nr.1189 dt.18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e	MMPAU, Agjencia Kombëtare e Mjedisit,	Aneksi I, pika ç, përcakton : 7. Për burimet e ndotjes që shkarkojnë në ajër: a) inventari i tyre, sasia vjetore e shkarkimit të CO₂, NO_x, CH₄, NH₃, SO₂, shkalla e errësisë

programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”	Ministritë e linjës	së tymit, komponimet organike, volatile, dioksina, furani, metalet e rënda në përgjithësi; b) shpërndarja sektoriale e shkronjës “a”, për sektorët e industrisë, energjisë, transportit dhe shërbimeve.
Ligj Nr. 10137, dt.11.5.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”	QKL Ministritë e linjës	Objekti i këtij ligji janë ndryshime në ligjet e ndryshme, sipas fushave të veprimtarive dhe/ose përdorimit të të mirave.
Ligj Nr. 10081, dt.23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”		Ky ligj ka për qëllim përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative ndaj nismës së lirë në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, ose përdorimin e të mirave publike, duke garantuar, njëkohësisht, mbrojtjen e interesit publik në ushtrimin e këtyre veprimtarive dhe në përdorimin e të mirave publike.
VKM Nr. 538, dt. 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar		Përcakton rregullat bazë të licencimit nga ose nëpërmjet QKL

3.7 Komente/ analiza

Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventat e Roterdamit, Bazelit dhe Sokholmit. Ligjet përkatëse forcojnë nevojën për të vendosur një zyrë kimikatesh që do të sigurojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga këto konventa.

Kuadri ligjor për kimikatat dhe substancat e rrezikshme ekziston, megjithëse është pjesërisht në linjë me legjislacionin europian në këtë fushë (rregulloren REACH dhe rregulloren mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve të tyre-CLP).

Përsa i përket përafrimit të legjislacionit kombëtar me të drejtën europiane bazuar edhe në iniciativat ligjore të parashikuara në PKZMSA 2012 – 2015 dhe në përputhje me ligjin Nr. 9108, dt.17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, MMPAU ka nxjerrë disa akte të ndryshme ligjore që do të transpozojnë direktivat e BE; 10 prej tyre janë miratuar së fundmi ndërsa të tjerë janë në fazat e fundit dhe parashikohen të miratohen brenda 2013.

Në vijim të përgatitjeve për legjislacionin e kimikateve, MMPAU ka mbështetur projektin e BE “Forcimi i Zbatimit të Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri (SELEA)”, IPA 2010.

Sa i përket kontrollit të lëndëve të rrezikshme, kjo gjë mbulohet kryesisht nëpërmjet konventave përkatëse ndërkombëtare, por transpozimi i mëtejshëm i legjislacionit europian është i nevojshëm. Së bashku me këto mungon dhe informacioni i nevojshëm për masat e sigurisë dhe mbrojtjes nga këto lloj kimikatesh.

Tabela 3.E Çështjet prioritare dhe veprimet e mundshme: instrumentat ligjorë dhe mekanizmat jo-rregullatorë për mirëmenaxhimin kimikateve

Prioritetet sipas rëndësisë	Niveli i kapaciteteve ekzistuese	Përmbledhje e forcimit të kapaciteteve, boshllëqeve dhe nevojave	Veprimet e mundshme	Aktorët
Hartimi i legjislacionit të ri primar në fushën e kimikateve REACH, CLP	I ulët	Transpozimi i REACH dhe CLP Regulation	Asistencë teknike nga BE për hartimin e legjislacionit	Asistencë e huaj MMPAU MSh MBUMK MM MPÇSShB METE
Hartimi i akteve nënligjore të cilat janë të nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të legjislacionit primar hartuar në sektorin e kimikateve	I ulët	Hartimi i legjislacionit sekondar	Asistencë teknike nga BE për hartimin e legjislacionit	Asistencë e huaj MMPAU MSh MBUMK MM MPÇSShB METE
Përgatitja e një plani Kombëtar Veprimi për Menaxhimin e Kimikateve	I ulët		Asistencë teknike nga BE për hartimin e PKV	Asistencë e huaj MMPAU MSh MBUMK MM MPÇSShB

Prioritetet sipas rëndësisë	Niveli i kapaciteteve ekzistuese	Përmbledhje e forcimit të kapaciteteve, boshllëqeve dhe nevojave	Veprimet e mundshme	Aktorët
				METE
Ngritja e infrastrukturës, krijimi i Agjencisë/ Zyrës së Menaxhimit të Kimikateve	I ulët	Krijimi i stafit Trajnime	Trajnime	Asistencë e huaj MMPAU MSh MBUMK MM MPÇSShB METE
Rritja e kapaciteteve në nivel qëndror lidhur me menaxhimin e kimikateve, vlerësimin e kimikateve, import dhe eksport të kimikateve etj	I ulët	Trajnime	Programe trajnimi për stafin në nivel qëndror	Asistencë e huaj MMPAU, MSh MBUMK MM MPÇSShB METE
Zbatimi i rregulloreve të REACH dhe CLP	I ulët	Trajnime		Asistencë e huaj MMPAU MSh MBUMK MM MPÇSShB METE
Forcim kapacitetesh dhe asistencë teknike për trajnimin e subjekteve industriale, masat e sigurisë dhe mbrojtjes nga kimikatet.	I ulët	Trajnime	Programe trajnimi për subjektet që prodhojnë, ruajnë, përdorin, importojnë apo eksportojnë kimikate	Asistencë e huaj MMPAU MSh MBUMK MM MPÇSShB METE

KAPITULLI 4: MINISTRITË, AGJENCITË DHE INSTITUCIONET E TJERA QË MENAXHOJNË KIMIKATET

Menaxhimi i kimikateve gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor trajtohet nga disa ministri, agjenci, si dhe institucione të tjera. Ministrinë si dhe agjencitë qeveritare përgjegjëse për statet më të shumta të ciklit jetësor të kimikateve (d.m.th importi, ruajtja, transporti, shpërndarja, përdorimi, trajtimi, dhe asgjësimi) në Shqipëri janë Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, Ministria e Mbrojtjes. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Doganave, Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ka përgjegjësitë kryesore për rregullimin dhe mbrojtjen e mjedisit nga aktivitetet që përdorin substanca kimike të cilat përbëjnë një rrezik potencial për mjedisin. Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave merret me importin, ruajtjen, përdorimin dhe asgjësimin e kimikateve. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit merret kryesisht me transportin e kimikateve; Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës merret me importin, ruajtjen dhe asgjësimin e kimikateve veçanërisht atyre të papërdorura.

Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta janë përgjegjëse në mënyrë të përbashkët për kujdesin dhe sigurinë e shëndetit në punë në lidhje me rreziqet nga kimikatet. Inspektoriat Mjedisor, inspektoriat Sanitar dhe Inspektoriat i Punës janë përgjegjës për zbatimin e kontrollit në të gjitha fazat e ciklit jetësor të kimikateve. Importi dhe eksporti i kimikateve menaxhohet kryesisht nga doganat. Burimet për menaxhimin e kimikateve janë aktualisht të pamjaftueshme; janë të nevojshme përmirësime në shumicën e fazave të ciklit jetësor të kimikateve. Parandalimi i mbivendosjes së mandateve midis ministrive dhe organizmave të tjerë si dhe rreziku i dyfishimit të aktiviteteve dhe përpjekjeve duhet adresuar me anë të rishikimit të legjislacionit.

4.1 Përgjegjësitë e ministrive të ndryshme shtetërore, agjencive dhe institucioneve të tjera

Tabela 4.A tregon rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion sipas legjislacionit në fuqi të lidhur me kimikatet gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor : importi, prodhimi, ruajtja, transporti, shpërndarja/reklamimi, përdorimi dhe asgjësimi. Grupet e kimikateve të shqyrtuara janë pesticidet, produktet e naftës, kimikatet industriale dhe ato të konsumit. Mbas tabelës janë përshkruar në mënyrë më të detajuar autoritetet e ministrive dhe mandatet e tyre.

4.2 Përshkrim i autoriteteve ministrore dhe mandateve

Përgjegjësitë për menaxhimin kimikateve janë ndarë midis disa institucioneve të paraqitur në tabelën 4.A, të cilat kanë detyrimet dhe të drejtat që rrjedhin nga legjislacioni dhe instrumentat rregulluese.

Tabela 4-A: Roli i ministrive, agjencive dhe institucioneve të tjera qeveritare në lidhje me klasat e kimikateve

Ministritë Përkatëse	Gjendja e ciklit të jetës						
	Import	Prodhi m	Ruajtj e	Transporti m	Shpërndar je/ Tregtim	Përdori m	Asgjesi m
Pesticidet							
MMPAU		X	X	X	X		X
MSh	X	X	X		X	X	X
MBUMK	X		X	X			
MPÇSShB	X	X	X	X		X	X
METE					X		X
MPPT		X		X	X		
MM	X			X	X		X
MD							
MF						X	
MB		X	X	X		X	X
Produktet e Naftës							
MMPAU		X	X	X	X	X	X
MSh		X					X
MBUMK						X	X
MPÇSShB	X	X	X	X		X	X
METE	X	X	X	X	X	X	X
MPPT	X	X	X	X			
MM	X		X	X	X	X	X
MD					X		
MF	X		X			X	X
MB		X	X	X		X	X
Kimikatet Industriale							
MMPAU		X	X	X	X	X	X
MSh	X	X	X		X	X	X
MBUMK	X		X	X	X	X	X
MPÇSShB	X	X	X	X		X	X
METE	X	X	X		X	X	X
MPPT	X		X	X	X		X
MM	X		X	X	X		X
MD	X	X	X	X	X	X	X
MF	X		X				X
MB	X		X	X	X		X
Kimikatet e Konsumit							
MMPAU							X
MSh						X	X
MBUMK	X		X	X	X	X	X
MPÇSShB	X					X	
METE	X		X		X	X	
MPPT			X				X
MM	X		X	X	X		X
MD	X	X	X	X	X	X	X
MF			X			X	
MB				X			

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU). Në zbatim të neneve 5 dhe 7 të Ligjit 9108/2003 MMPAU ka përgjegjësinë për lejet e prodhimit të substancave dhe preparateve që zotërojnë vetitë e klasës 15⁵, vlerësimin, testimin, administrimin dhe kontrollin e tyre.

MMPAU nëpërmjet Zyrës së Regjistrimit të Kimikateve regjistron aplikimet për importin dhe eksportin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme të caktuara në bazë të të dhënave të ministrive të ngarkuara, nga ky ligj. Që prej 2003 kur ligji për kimikatet u aprovua, Zyra e Regjistrimit të Kimikateve nuk është krijuar akom. Në MMPAU që prej Janarit 2011 ka krijuar një sektor që merret me Ajrin, Ndryshimin e Klimës ku 2 specialist mbulojnë kimikatet ndërmjet çështjeve të tjera. Mungojnë kapacitetet në MMPAU për të mbuluar të gjitha çështjet në lidhje me mirëmenaxhimin e kimikateve.

MMPAU ka autoritetin për të kontrolluar çdo aktivitet me ndikim në mjedis dhe ka mandatin për të zbatuar sanksione ligjore nëpërmjet Inspektoratit të Mjedisit. Në përbërje të kësaj ministrie funksionojnë agjencitë rajonale të mjedisit në shkallë prefekturë. Megjithatë struktura ekziston (200 punonjës në nivel rajonal) kapacitetet teknike për menaxhimin e kimikateve janë shumë të ulëta. Mungojnë trajnimet për menaxhimin e kimikateve.

MMPAU dhe MSh kanë përgjegjësinë për kontrollin e substancave të rrezikshme. Ligji ngarkon agjencitë rajonale të mjedisit dhe dy inspektoratet shtetërore: atë të Mjedisit dhe Sanitar, për ushtrimin e kompetencave që ju jep ligji në rast të shkeljeve të detyrimeve që kanë subjektet private apo shtetërore për administrimin dhe ruajtjen e substancave të rrezikshme.

Ministria e Shëndetësisë (MSh): Në zbatim të neneve 5 dhe 7 të Ligjit 9108/2003 MSh ka përgjegjësinë për lejet e prodhimeve të substancave dhe preparateve që zotërojnë vetitë e klasës 6 deri 14¹, vlerësimin, testimin, administrimin dhe kontrollin e tyre. Ministria e Shëndetësisë në zbatim të Ligjit "Për substancat dhe preparatet kimike" dhe Ligjit "Për inspektoratin sanitar shtetëror" duhet të kontrolljë importin, prodhimin, tregëtimin, ruajtjen, përdorimin dhe dekontaminimin e substancave të rrezikshme, lëshon leje për kimikatet e reja që administrohen nga industria, bujqësia dhe nevojat e konsumit.

Kjo ministri ka një rrjet institucionesh në qendër dhe bazë që merren me mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve kontrollin higjienosanitar të ambjenteve të punës dhe gjendjen shëndetësore të punonjësve. Në Institutin e Shëndetit Publik operon Sektori i Epidemiologjisë e Shëndetit në Punë që ka këto detyra kryesore:

- Vlerëson burimet e rrezikut për shëndetin
- Vlerëson nivelet e ekspozimit në mjediset e punës
- Vlerëson kontrollin shëndetësor të punëmarrësve
- Harton metodologji të inspektimit shëndetësor
- Ndërmerr studime e analiza të gjëndjes së punonjësve në sektorë të ndryshëm të veprimtarive ekonomike
- Kryen matje të ndotjeve të mjedisit të punës: ajrit, ujit, zhurmave, infeksioneve e lëndëve toksike.

Aktualisht sot në funksion dhe mision të shëndetit në punë janë të organizuara në 24 rrethe Drejtoritë e Shëndetit Publik dhe në 12 rajonet (qendër qarku) janë të organizuara Drejtoritë

⁵ Referenca për numrat e klasave të rrezikshmërisë bëhet sipas Ligjit 9108/2003

Rajonale të Shëndetit; në të dyja këto struktura është i organizuar Shërbimi i Higjienës, ku sipas tij dhe akteve nënligjore në fuqi ndiqen problematikat e mëposhtme :

- Monitorim dhe kontroll në gjithë degët e prodhimit të subjekteve private e publike, punime minerare, gjeologjike, industri të ndryshme, etj.
- Monitorim dhe kontroll i gjëndjes shëndetësore të punëtorëve, nëpërmjet bashkëpunimit edhe me strukturat e tjera, si inspektorati shtetëror i punës;
- Monitorim i kushteve higjieno-sanitare të objekteve industriale nëpërmjet vlerësimit të riskut në mjediset e punës;

Në çdo shërbim higjienë ka të organizuar edhe laborator të toksikologjisë industriale, që në përgjithësi është tepër pak i pajisur me aparatura apo dhe mjete konsumi për vlerësimin e kushteve mjedisore të një objekti industrial.

Në bazë të draft-ligjit mbi produktet biocide, që është përgatitur nga MSh dhe pritët të miratohet së shpejti, Ministria e Shëndetësisë është autoriteti kompetent që harton politikat për shërbimin e produkteve biocide në shëndet publik, si dhe organizon dhe ndjek zbatimin praktik e shkencor të këtij shërbimi. Në funksion të zbatimit të këtij draft-ligji, Inspektorati Shëndetësor Shtetëror do ketë këto përgjegjësi:⁶

- Të inspektojë hapsirat, objektet, aparaturat, pajisjet dhe dokumentacionin e personave fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbime të produkteve biocide në shëndet publik.
- Të kërkojë dhe të marrë mostra të produkteve biocide.
- Të verifikojë nëse produktet biocide janë të regjistruara apo jo me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj.
- Të kontrollojë nëse produkte biocide jo me rrezikshmëri të ulët janë hedhur në treg në përputhje me kërkesa të parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.
- Të kontrollojë nëse produktet biocide të vendosura në treg janë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar sipas kërkesave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
- Të kontrollojë nëse subjekti është i licënsuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Të vendosë për asgjësimin e produktit biocid sipas legjislacionit në fuqi, nëse konstatohet së produkti biocid është hedhur në treg i paregjistruar dhe është jashtë periudhës së përdorimit.

Sekretariati i Regjistrimit të Produkteve Biocide do kryejë procedurën e regjistrimit të produkteve biocide.

Instituti i Shëndetit Publik është organi kompetent, institucion kërkimor shkencor dhe qendër referencë kombëtare në zbatimin e draft- ligjit të produkteve biocide, i cili ka për detyrë:

- Të monitorojë dëmtuesit e shëndetit publik, të përcaktojë statusin e tyre, metodat e kontrollit dhe të informojë Ministrin e Shëndetësisë;
- Të bëjë diagnostikimin dhe prognozë - sinjalizimin e dëmtuesve në shëndetin publik duke përcaktuar edhe masat e kontrollit të tyre;
- Të bëjë provat biologjike të efektivitetit, si dhe analizat fiziko-kimike të produkteve biocide për monitorimin e tyre;

¹Referenca për numrat e klasave të rrezikshmërisë bëhet sipas Ligjit 9108/2003

- Të kryejë trajnimin e përdoruesve profesionistë të shërbimit të produkteve biocide në shëndet publik.
- Të kryejë trajnimin e personelit në institucionet e varësisë përgjegjëse për monitorimin e shërbimit të produkteve biocide në shëndet publik.

Komisioni i regjistrimit të produkteve biocide është organ teknik këshillimor që jep rekomandime për lëshimin apo refuzimin aktit të regjistrimit dhe vendosjen në treg të produkteve biocide, ndalimin apo kufizimin e përdorimit të produkteve biocide, përcaktimin e formulimit kuadër të produkteve biocide. Ky komision funksionon aktualisht edhe në bazë të Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 365, dt. 3.8.2012 “Për lëshimin e autorizimit të lëndëve dezinfektuese, deratizuese dhe dezinfektuese” (DDD).

Brenda sistemit të Shëndetësisë, **Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave (QKKB)** është qendra e përgatitjes dhe botimit periodik të regjistrimit të barnave me çmimet përkatëse dhe emrin e importuesve të autorizuar nga kompanitë mbajtëse të liçencës së tregtimit ose nga kompanitë prodhuese. QKKB është institucion i cili depoziton regjistrin e barnave, kryen përditësimin e tij pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe është i detyruar të njoftojë menjëherë subjektet farmaceutike dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo bar të ri që regjistrohet ose çregjistrohet dhe për çdo bar të parregjistruar që importohet me autorizim të veçantë sipas Ligjit Nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE): Në zbatim të neneve 5 dhe 7 të ligjit 9108/2003 METE ka përgjegjësinë për lejet e prodhimeve të substancave dhe preparateve që zotërojnë vetitë e klasës 3 (ekstremisht të djegshme), 4 (shumë të djegshme) dhe 5 (të djegshme), vlerësimin, testimin dhe administrimin e tyre.

Kjo ministri është përgjegjëse për kontrollin e cilësisë së karburanteve. Inspektorati Qendror teknik kryhen kontrole periodike e me sondazhe gjatë gjithë vitit në gjithë stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve (benzinë, gasoil dizel, dhe gaz të lëngëzuar të naftës) dhe në të gjitha depozitat e tregtimit me shumicë të produkteve të naftës dhe gazit.

METE jep lejet për përdorimin civil të lëndëve plasëse pas miratimit më përpara të veprimtarisë nga Pushteti Vendor, MSh, MMPAU dhe institucionet e tjera vendore. Kjo ministri ushtron kontrole periodike nëpërmjet inspektorateve të sigurimit teknik që ajo ka në vartësi. Ministria ka të drejtën ligjore që të pezullojë përkohësisht ose ndalojë çdo veprimtari që shkel legjislacionin në fuqi. Përgjegjësitë kryesore për licensimin të impianteve të prodhimit, aprovimin e projekteve teknike dhe bordet punëdhënëse të menaxhimit nga kompanitë me pjesmarjen e qeverisë janë vendosur nga METE.

METE përfaqëson pronarin shtet. Të gjitha asetet shtetërore që privatizohen administrohen nga kjo Ministri dhe me miratimin e Qeverisë në rastet e dhënies me koncension kjo ministri përgatit dokumentacionin e nevojshëm për privatizim. Një pjesë e objekteve dhe aseteve i ka kaluar për administrim Pushtetit Vendor e cila për to zbaton ligjet në fuqi.

Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL), si një institucion publik qëndror në varësi të METE, funksionon në bazë të një sistemi elektronik, i cili automatizon procesin e licensimit dhe mundëson ndjekjen hap pas hapi të ecurisë së aplikimit. QKL kryen këto shërbime:

- Trajton procedurat e liçencimit, autorizimit, lejeve, ndryshimit dhe revokimit sipas ligjit Nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë;
- Mban dhe administron Regjistrin Kombëtar të Liçencave e Lejeve;

- Siguron qasje të thjeshtë e të lehtë të biznesit dhe publikut në informacionin mbi ligjet dhe rregulloret;
- Administrojnë liçencat dhe lejet në Shqipëri, si dhe mbi procesin e aplikimit, duke përfshirë kriteret, dokumentet e nevojshme, procesin e shqyrtimit, afatet e vendimmarrijes, tarifat dhe pagesat.
- Informon dhe këshillon kërkuuesit dhe publikun për procedurat e liçencimit, autorizimit e lejimit;

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSShB) është autoriteti kryesor për zbatimin e Kodit të Punës. Inspektorati shtetëror i punës në vartësi të kësaj ministrie dhe në bashkëpunim me inspektoriatet e tjera të shtetit koordinojnë punën për të siguruar zbatimin e legjislacionit të punës nga punëdhënësit dhe personat e siguruar prej tyre.

MPÇSShB ushtron kontroll në vendet e punës me qëllim sigurimin e punonjësve dhe mbrojtjen e tyre me mjetet e nevojshme për një punë pa avari dhe aksidente dhe plotësimin e nevojave të punëmarrësve me kushtet më të domosdoshme higjieno-sanitare.

MPÇSShB ka përcaktuar punët e vështira ose të rrezikshme si dhe listën e substancave të rrezikshme në VKM-në Nr. 100 datë 3.2.2008 “Për substancat e rrezikshme”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin në punë nga përdorimi i tyre. MPÇSShB lëshon lejen e punës nëpërmjet inspektoratit të punës. Një leje e vecantë kërkohet nga punëdhënësit për punonjësit që do të punojnë me substancat e shpallura si të rrezikshme nga kjo ministri. Brenda MPÇSShB-së funksionon Sektori i Substancave të Rrezikshme dhe Sëmundjeve Profesionale (3 persona) dhe Sektori i Monitorimit të Kushteve të punës (3 persona) inspektoriatit Shtetëror i Punës në Nivel Kombëtar (8 persona) kordinon inspektimet e tyre anë të inspektorëve të punës (93) në nivel vendor.

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) së bashku me MMPAU dhe MSh janë përgjegjës për hartimin e rregullave për regjistrimin e PMB. Institucionet për të kryer aktivitete të caktuara profesionale dhe teknike, veçanërisht ato që lidhen me vlerësimin e dosjeve gjate procedurës së regjistrimit, për të kryer studime toksikologjike dhe ekotoksikologjike, për të kryer vlerësime fiziko-kimike dhe analiza biologjike të produkteve për mbrojtjen e bimëve (tani e tutje të referuar si PMB) janë: Departamenti për Mbrojtjen e Bimëve (DMB) në Universitetin e Bujqësisë, Tiranë; Instituti i Shëndetit Publik (IShP); Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV); Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Importi dhe eksporti i tyre kontrollohen nga kjo ministri, përmes Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU). Ministri ka autoritetin të pezullojë ose ndalojë çdo lloj produkti për mbrojtjen e bimëve (PMB) apo pleh kimik që nuk i përgjigjet kërkesave të standardeve të miratuara.

Në fushën e produkteve për mbrojtjen e bimëve, MBUMK, nëpërmjet Drejtorisë së Shëndetit të Kafshëve dhe Mbrojtjes së Bimëve (DSHKMB), është autoriteti qendror kompetent në Republikën e Shqipërisë për:

- Çështjet e hartimit të politikave për PMB;
- Procedurat përkatëse administrative të regjistrimit dhe të monitorimit;
- Aktivitetet e inspektimit;
- Në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Inspektorati për Mbrojtjen e Bimëve (inspektorati fitosanitar) në DRBUMK-të e qarqeve është përgjegjës për aktivitetet e kontrollit, pra për mbikqyrjen e aktivitetit të mbrojtjes së bimëve në lidhje me PMB-të. Inspektori i mbrojtjes së bimëve, pranë DRBUMK-së, ka të drejtë të bllokojë një PMB, kur:

- Analizat e kryera nuk përputhen me treguesit cilësorë, të deklaruar për këtë PMB
- Ajo nuk është e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, për regjistrimin e PMB-ve.

Pranë Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) është ngritur gjatë vitit 2009 laborator i analizave cilësore të PMB-ve, si dhe i mbetjeve të tyre në produktet shtazore. Ky laborator është në fazën e përmirësimit të kapaciteteve teknike, si pajisje etj.

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT): përgjigjet për transportin e mallrave të rrezikshme. Ajo lëshon lejen për automjete që transportojnë mallrat e rrezikshme, bën kontrollin teknik dhe bashkërisht me Ministrinë e Brendshme i shoqëron këto mallra deri në destinacion brenda vendit. Transporti i lëndëve eksplozive të importit sigurohet me mjetet dhe personelin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Ministria e Mbrojtjes (MM): Në zbatim të neneve 5 dhe 7 të ligjit 9108/2003 MM ka përgjegjësinë e prodhimit, importit, eksportit, administrimit, kontrollit të substancave që zotërojnë vetitë e klasës 1 (eksplozive), 2 (oksiduese) dhe 3 (ekstremisht të djegshme). Kjo ministri me ligj nuk ka përgjegjësinë e klasës 1 vetëm për lëndët eksplozive të përdorimit civil, që i ka kaluar si përgjegjësi METE si përdoruesi kryesor i kësaj lënde. Për të gjitha llojet e tjera të eksplozivëve kjo Ministri ka përgjegjësinë e vlerësimit, testimit, administrimit dhe kontrollit të tyre. Ministria e Mbrojtjes jep lejet dhe ka përgjegjësinë kryesore për importin, eksportin, testimin e lëndëve eksplozive dhe transportin e lëndëve kimike të rrezikshme.

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKShE) është një institucion qëndror, me statusin e personit juridik, publik, në varësi të Ministrit të Mbrojtjes, i cili ka si objekt të veprimtarisë kontrollin shtetëror mbi eksportin, importin, kalimin tranzit, transferimin dhe veprimtaritë ndërmjetësuese për mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë. AKShE është institucioni përgjegjës për zbatimin e politikës shtetërore në fushën e kontrollit të eksporteve dhe importeve të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë. Krijimi dhe veprimtaria e tij gjejnë bazën ligjore në Ligjin Nr. 9707, datë 5.4.2007 “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 43, datë 16.1.2008 “Për organizimin, funksionimin dhe statusin e autoritetit të kontrollit shtetëror të eksporteve”.

Ky institucion ka këto përgjegjësi:

- Lëshon licenca dhe autorizime ndaj personave fizikë e juridike, të cilët kryejnë veprimtaritë tregtare të lidhura me eksportin, importin, transferimin e mallrave ushtarake apo me përdorim të dyfishtë, si dhe të teknologjive të tyre, në bazë të vlerësimit të kriterëve të kërkuara ligjërisht;
- Kryen të gjitha verifikimet e nevojshme, si në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga subjektet tregtare, ashtu dhe në analizën dhe ekspertizën përkatëse në lidhje me mallrat dhe veprimtaritë objekte të eksportit. Ky kontroll përfshin të gjitha fazat e procesit, duke filluar që nga faza e para - licensimit, deri në kontrollin e mëtejshëm pasi subjekti është pajisur me licensë dhe në verifikimin e përdoruesit dhe destinacionit përfundimtar të mallit;

- Sanksionon në rastet e konstatimit të shkeljeve ligjore, subjektet tregtare përgjegjëse për këto shkelje.

Ministria e Brendshme (MB) është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e planit kombëtar të emergjencave civile, dhe së bashku me institucionet e tjera zbaton politikën e Këshillit të Ministrave në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të emergjencave civile. Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile është një strukturë e përhershme dhe e specializuar, që merr pjesë në të gjitha stadet e ciklit të menaxhimit të emergjencave civile.

Shërbimi i Mbrojtjes Civile, në vendin tonë, mbështetet kryesisht në Ligjin Nr. 8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", në ligjin Nr. 8766, dt. 5.4.2001, "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin", në Planin Kombëtar të Emergjencave Civile të miratuar me VKM Nr. 835, datë 3.12.2004 si dhe në akte të tjera nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Shërbimi i emergjencave civile (mbrojtja civile) funksionon kryesisht mbi bazën e strukturave të përhershme dhe atyre të përkohshme, të cilat ngrihen dhe funksionojnë për aq kohë sa zgjat emergjenca. Përsa i përket strukturave të përhershme ato ndahen në:

- a. Struktura planifikuese, menaxhuese dhe monitoruese, ku futen kryesisht strukturat drejtuese qëndrore, në qark dhe vendore, si dhe institucionet monitoruese dhe shkencore,
- b. Strukturat vepruese aktive (operacionale) ku futen Policia e Shtetit dhe policitë e tjera, PMNZSh-ja, Urgjenca Shëndetësore, Forcat e Armatosura, Brigadat Rajonale të Mbrojtjes Civile, si dhe struktura të tjera të kërkim-shpëtimit në shërbimin e Mbrojtjes Civile dhe jashtë saj.
- c. Strukturat vepruese mbështetëse, siç janë Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, strukturat e tjera të mbështetjes logjistike, si dhe OJF-të e ndryshme.

Për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe specifikisht për mbrojtjen nga zjarri në MPB funksionon Drejtoria e Policisë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, veprimtaria e të cilit rregullohet me Ligjin Nr. 8766/2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin",

Ministria e Financave (MF): Autoritetet doganore kontrollojnë pikat shtetërore të kalimit doganor dhe futjen e substancvet apo të preparateve të deklaruara të rrezikshme me anë të miratimit nga ministria përkatëse. Në rast mëdyshje apo shkelje të ligjit Autoritetet doganore i konfiskojnë mallrat dhe lajmërojnë Inspektoriatin Mjedisor apo Inspektoriatin Sanitar Shtetror për kundravajtje. Autoritetet doganore regjistrojnë shumë substanca të rrezikshme dhe preparate që kalojnë përmes kufirit. Autoritetet doganore gjithashtu u lejojnë punonjësve të MMPAU-s si dhe inspektoriateve të tjerë të kontrollojnë regjistrat.

4.3 Komente / rekomandime

Tashmë ekzistojnë një numër i madh aktesh ligjore dhe nënligjore që mbulojnë të gjithë sektorët e ekonomisë, të cilat përcaktojnë detyrimet dhe të drejtat e institucioneve të ndryshëm dhe autoritetin e kontrollit të tyre.

Nevoja e një koordinimi në implementimin e bazës ligjore është e nevojshme në këtë periudhë të kalimit në ekonominë e tregut. Adoptimi i legjislacionit europian, përfshirja në legjislacionin e vendit të direktivave të BE duke ndjekur në vazhdimësi ndryshimet dhe të rejat në to për

përsosjen e kuadrit ligjor ekzistues, kërkon ngritjen e rolit të strukturave shtetërore, përfshirjen e institucioneve joqeveritare dhe sindikatave të puntorëve që në fillim të ndërmarrjes së iniciativave ligjor e në vecanti kur kemi të bëjmë me kimikate të rrezikshme. Aktualisht ka një boshllëk të madh ligjor dhe mungesë të rregullave e mekanizmave jo rregullatore në lidhje me kimikatet.

Vendi ka nevojë për një ligj të kimikateve (siç i kanë të gjitha vende e zhvilluara) ku të përfshihen të gjitha aktet ligjore dhe normative, të vlerësimit të tyre, të sigurimit prej tyre dhe masave mbrojtëse për ruajtjen e shëndetit të punonjësve dhe qytetarëve në përgjithësi pse jo dhe të asgjësimit të tyre.

Pra është e nevojshme të krijohet një bazë e re ligjore për administrimin e kimikateve. Kimikatet e konsumit janë të pa trajtuara nga ana ligjore dhe mungon në përgjithësi kontrolli i tyre. Kimikatet e konsumit sapo janë mbuluar nga ligji i ri “Mbi sigurinë e produkteve joushqimore” dhe “Për tregtimin dhe mbikqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” të miratuara në 2011 por kontrolli nga ato akoma mungon. Ngritja e tanishme e Inspektoriatit Qëndror pritet të zgjidhë problemet e lidhura me inspektoriatet e ndryshme dhe qëllimin e tyre në retrospektivë dhe kompetencat e tyre në lidhje me kimikatet..

Në bazë të Ligjeve të miratuara, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave duhet të ngrejë Zyrën e Regjistrimit të kimikateve, METE të krijojë shërbimin e kontrollit të kimikateve. MSh dhe MPÇSShB kanë detyra të vecanta që lidhen me normat e lejuara, masat e sigurisë dhe emrgjencës, kualifikimin e punonjësve etj.

Megjithë progresin e arritur në administrimin e kimikateve në përgjithësi duhet thesuar se pengesë kryesore në plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor por edhe administrimit më të mirë të kimikateve nga njëra anë, ka qënë mbështetja e kufizuar nga ana financiare për stabilizimin e situatës së krijuar nga prania në ndërmarrjet e privatizuara ose të nxjerrja jashtë përdorimit e mjaft kimikateve stoqe dhe të pa mbrojtura sipas rregullave dhe nga ana tjetër niveli i ulët i shkallës së ndërgjegjësimit të komunitetit dhe politikanëve në forcimin e bazës ligjore dhe masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurtë nga kimikatet në përgjithësi dhe ato të rrezikshmet në veçanti.

Tabela 4.B Prioritet dhe veprimet e mundshme: ministritë, agjencitë dhe institucionet e menaxhimit të kimikateve.

Çështjet prioritare (Renditja nga më larta te më e ulëta)	Niveli i kapacitete ve ekzistuese	Përmbledhje e kapaciteteve , pikave të forta, boshllëqeve, dhe nevojave	Veprimi i mundshëm	Aktorët e interesuar
Transpozimi i bazës ligjore të BE-së për mirëmenaxhimin e kimikate	I ulët	Legjislacioni ekzistues nuk është përditësuar me rregulloret e reja të BE-së	Transpozimi i rregulloreve të BE-së në legjislacionin kombëtar	MMPAU MSh, MBUMK, MPPT, METE
Rritja e kordinimit midis institucioneve për implementimin dhe zbatimin e legjislacionit për kimikatet	I ulët	Niveli i kordinimit është akoma i ulët në lidhje me implementimin dhe forcimit të legjislacionit për kimikatet	Duhet përcaktuar qartë përgjegjësitë e cdo institucioni nëpërmjet bashkpunimit gjatë fazës së transpozimit të rregulloreve të BE-së në legjislacionin kombëtar.	MMPAU MSh, MBUMK, MPPT, METE
Trajnime për biznesin në lidhje me ruajtjen e sigurt dhe mbrojtjen nga kimikatet në përgjithësi dhe nga të rrezikshmet në vecanti	I ulët	Nuk janë zhvilluar trajnime për biznesin në lidhje me sigurinë dhe mirëmenaxhimin e kimikateve	Ndihmesë teknike me projekte binjakëzuese	MMPAU MSh, MBUMK, MPPT, METE
Trajnime për inspektorët dhe autoritetet e tjera kontrolluese të kimikateve	I ulët	Trajnimet për autoritetet kontrolluese të kimikateve janë të pakëta dhe të jo të pa planifikuara	Ndihmesë teknike me projekte binjakëzuese	MMPAU MSh, MBUMK, MPPT, METE

KAPITULLI 5: AKTIVITETET PËRKATËSE TË INDUSTRIJË, GRUPET E INTERESIT PUBLIK, ORGANIZATAT PROFESIONALE DHE SEKTORI I KËRKIMIT

Qëllimi i këtij kapitulli është përshkrimi dhe rishikimi i aktiviteteve të organizatave jofitimprurëse (OJF), në mbështetje të përpjekjeve kombëtare për menaxhimin e kimikateve. Në këtë kapitull janë përshkruar shkurtimisht organizatat jofitimprurëse kryesore në vendin tonë, faqet e internetit, si dhe misioni i tyre në lidhje me kimikatet, mjedisin etj.; është paraqitur gjithashtu edhe legjislacioni përkatës. Informacioni në lidhje me dhomat e tregtisë që janë të vendosura në të gjitha qytetet kryesore të vendit si dhe adresari i tyre tregon gjithashtu se këto organizma ofrojnë mbështetje dhe këshillim për bizneset, akses në informacion mbi industrinë, turizmin, bujqësinë, mjedisin, importet dhe eksportet, etj. dhe mundësi për ndihmë juridike.

Janë dhënë gjithashtu strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, institucionet dhe organizatat përfaqësuese të konsumatorëve, misioni dhe qëllimi i tyre, fushat në të cilat ato operojnë si dhe lidhjen e tyre me legjislacionin dhe marrëdhëniet treg-konsumator dhe ndërgjegjësimet.

Një vend të rëndësishëm zë edhe sektori i kërkimit shkencor, reforma në arsimin e lartë, kuadri ligjor dhe institucional i sistemit të shkencës dhe institucionet përbërëse të tij: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, sistemi i akreditimit, institucionet e arsimit të lartë (universitetet), Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, qendrat kombëtare kërkimore, qendrat/agjencitë publike të zhvillimit dhe të transferimit të teknologjisë etj.

Në pjesën e fundit të kapitullit është bërë përmbledhja e ekspertizës jashtë sistemit qeveritar.

5.1 Përshkrim i organizatave dhe programeve jo-qeveritare

5.1.1 Përshkrim i organizatave dhe aktiviteteve të industrisë

Organizatat jofitimprurëse profesionale të biznesit paraqesin pikëpamjet e veta në rrugë institucionale për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Ato marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e programeve të zhvillimit, të administrimit e të mbrojtjes së mjedisit. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat për komunikimin e organeve publike mjedisore me organizatat profesionale të biznesit.

Konfindustria (Konfederata e Industrive të Shqipërisë) (<http://www.konfindustria.al/>) është institucioni që grupon dhe përfaqëson vetëm interesat e industrive të prodhimit dhe shërbimeve në vend. Anëtarë të Konfindustriës janë përfaqësuesit më të rëndësishëm të industrive shqiptare në të gjitha fushat si: industria energjetike, industria e kërkimit, shfrytëzimit dhe përpunimit të naftës, industria e nxjerrjes dhe përpunimit të mineraleve dhe metaleve, industria ushqimore, industria e prodhimit të pijeve, industria e prodhimit të letrës dhe kozmetikës, industria e përpunimit të drurit, industria e turizmit dhe shërbimeve ajrore, etj. Ka lindur si domosdoshmëri në periudhën e rrugës së integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe krijimit të kushteve

për krijimin e tregut mbarëshqiptar. Konfindustria punon vetëm me industritë e prodhimit dhe të shërbimeve vendore dhe jo tregtarët e prodhimeve të huaja.

Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë (DhTI) janë të vendosura në të gjitha qytetet kryesore të vendit. Adresat e DhTI-ve gjenden në faqen e internetit:

http://www.informacioni.com/dhomat_e_tregtise.html. DhTI-të ofrojnë mbështetje dhe këshillim për bizneset, akses në informacion mbi industrinë, turizmin, bujqësinë, mjedisin, importet dhe eksportet, etj. dhe mundësi për ndihmë juridike. DhTI-të janë bashkëpunëtore të ngushta me qeverinë qendrore dhe lokale për çështje që kanë të bëjnë me komunitetin e biznesit. Dhomat bashkëpunojnë edhe me grupe të ndryshme të komunitetit, shkolla, institucione fetare, organizata artistike dhe kulturore etj. për të organizuar konferenca, forume biznesi, panaire, misione biznesi, ngritje fondesh për bamirësi etj. DhTI-të janë të organizuara në Unionin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (<http://www.abcinfos.com/uccial/index.html>).

Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) (www.kssh.org), është krijuar dhe funksionon si bashkim vullnetar i Federatave Sindikale të profesioneve ose degëve të ekonomisë. KSSH sot është organizata sindikale më e madhe dhe më e organizuara në Shqipëri.

Struktura Përgjegjëse për Mbrojtjen e Konsumatorëve (SPMK) (<http://www.konsumatori.org>). Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE) është ministria përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit ndaj produkteve jo-ushqimore. Në mënyrë më specifike, mbrojtja e konsumatorit bie në varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme për Politikën Tregtare. Brënda kësaj drejtorie, Departamenti i Mekanizmave të Tregut dhe i Ndihmës Shtetërore është në mënyrë specifike përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorit. Institucione dhe Organizata përfaqësuese të konsumatorëve janë: Avokati i Popullit, Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Shoqata e Konsumatorëve Shqiptarë, etj. Kjo e fundit është shoqatë e pavarur dhe ka si mision dhe qëllim të saj mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të konsumatorëve shqiptar. Fushat, në të cilat Shoqata operon janë të ndryshme si: edukim dhe ndergjegjësim në shkolla, nëpërmjet takimeve, bisedave, që synojnë njohjen e ligjeve, marrëdhënieve treg-konsumator, shpërndarjen e botimeve të ndryshme, broshura, fletë palosje, si dhe jashtë tyre, shkëmbimin e informacioneve me institucionet shtetërore nëpërmjet dhënies së mendimeve për akte të ndryshme ligjore e nënligjore, paraqitjes së ankesave që prekin interesat kolektive të konsumatorëve, në lidhje me të tjerave me produktet ushqimore, ujin e pijshëm, ndotjen e mjedisit, largimin e pesticideve nga zona të ndryshme etj.

5.1.2. Organizatat jofitimprurëse (OJF) në Shqipëri

Legjislacioni mbi OJF-të

Legjislacioni mbi të cilin bazohet veprimtaria e OJF-ve përbëhet nga:

- Ligji Nr. 8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”,
- Ligji Nr. 8789, datë 7.5.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” dhe
- VKM Nr.1679, datë 24.12.2008. “Për kriteret dhe procedurat e përcaktimit të statusit të organizatave jofitimprurëse, për përfitim publik”.
- Ligji Nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” shpreh si një detyrë të pushtetit vendor dhënien e informacionit të nevojshëm, që u

mundëson qytetarëve pjesëmarrjen në vendimmarrje në lidhje me funksionet dhe kompetencat e ushtruara nga njësia e qeverisjes vendore përkatëse.

- Udhëzim (Nr. 1, datë 3.3.2009) Për detyrat e organeve mjedisore për të siguruar pjesëmarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Për sa i përket palëve të interesuara ekziston një legjislacion i zgjeruar në lidhje me pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen e tyre në çështje të lidhura me menaxhimin e kimikateve siç janë: “Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit” (miratuar me VKM Nr. 87, dt. 29.11.2007), e cila krijon një vizion dhe vendos si prioritet informimin e publikut dhe përfshirjen e shoqërisë civile në draftimin e legjislacionit mjedisor si dhe implementimin dhe monitorimin e tij. Gjithashtu, në Ligjin Nr.8934 dt.5.9.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” amenduar 2008, vendosën si elementë të domosdoshëm bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike gjatë miratimit të strategjive, programeve, planeve etj., si dhe gjatë zbatimit të politikës, kontrollit dhe masave të tjera mjedisore për mbrojtjen e mjedisit. Sipas këtij ligji, publiku dhe OJF-të njoftohen për gjendjen e mjedisit nëpërmjet publikimit të të dhënave nga organet shtetërore dhe nga personat fizikë dhe juridikë, si dhe duke kërkuar të dhëna pranë organeve shtetërore. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat për bërjen publike dhe shpërndarjen e të dhënave mjedisore nga organet e mbrojtjes së mjedisit si dhe për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjet e organeve të mjedisit. OJF-të mjedisore gëzojnë të drejtat e oponencës dhe të bashkëpunimit me organet e mbrojtjes së mjedisit. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat e detyrueshme për organet mjedisore, për të realizuar të drejtat e organizatave jofitimprurëse, sidomos: a) në hartimin e politikave, të strategjive, planeve të zhvillimit, si dhe programeve për mbrojtjen e mjedisit; b) në hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të zonave të ndryshme; c) në hartimin dhe zbatimin e programeve të monitorimit; ç) në kontrollet mjedisore; d) në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të miratimit të lejes mjedisore; dh) në hartimin e projektakteve normative mjedisore.

Përfaqësues të OJF-ve marrin pjesë si anëtarë në këshilla e komitete, që krijohen për administrimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Ministria e Mjedisit mbështet projektet e OJF-ve për mbrojtjen e mjedisit sipas rregullave të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë të Mjedisit. Gjithashtu, Ministri i Mjedisit përcakton rregullat dhe procedurat për komunikimin e organeve publike mjedisore edhe me organizatat profesionale të biznesit.

Për tërheqjen e mendimit të publikut në vendimmarrje për mjedisin VKM Nr. 994, datë 2.7.2008 specifikon si kërkesë ligjore në procesin e hartimit të politikave, strategjive rajonale e kombëtare, të përgjithshme a sektoriale dhe të planeve të veprimit në zbatim të tyre, që kanë lidhje me mjedisin. Gjithashtu po kjo VKM specifikon hapat që ndërmerren për të siguruar pjesëmarrjen e publikut gjatë përgatitjes së projektakteve normative mjedisore. Në një kre të veçantë detajohen rregullat, procedurat, format e realizimit praktik të tyre, mënyrat e komunikimit dhe afatet që duhet të respektojnë organet shtetërore për të realizuar tërheqjen e mendimit të publikut e të OJF-ve.

Gjithashtu, në Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” shprehet si një parim i domosdoshëm pjesëmarrja e palëve të interesuara në nenin “Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut” si dhe neni 14 i nxitjes se veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit ku në pikën 1.b) të saj thuhet”... mund të lidhin marrëveshje me subjektet ndotëse dhe shoqatat e tyre

për masat vullnetare që ato mund të ndërmarrin, me qëllim reduktimin e mëtejshëm të ndikimit në mjedis...”.

Regjistrimi i OJF-ve

Në Shqipëri, regjistrimi ligjor i OJF-ve është ende i vështirë, i ngatërruar dhe një proces që kërkon kohë, pavarësisht përpjekjeve për reformim të ligjit. Shqipëria ka në zbatim një proces regjistrimi me dy shkallë, në nivel qendror dhe vendor. Shkalla e parë është për regjistrimin ligjor dhe e dyta për regjistrimin për taksat. Problemet më të shumta paraqiten me shkallën e dytë të regjistrimit. Si rezultat i vështirësive në regjistrim, mjaft OJF paraqesin se ato punojnë pa përfunduar zyrtarisht të gjitha shkallët e regjistrimit, veçanërisht atë që ka të bëjë me autoritetet financiare. Avokatët kanë mundësi për t’i lehtësuar procedurat, pavarësisht se pjesa më e madhe e OJF-ve nuk i quajnë të nevojshme këto shërbime ligjore.

Të dhëna mbi OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare në Shqipëri

Informacion i përgjithshëm mbi organizatat jofitimprurese, legjislacionin ku bazohet veprimtaria e tyre, aktivitetet, etj. mund të gjendet në faqen e internetit të MPÇSShB, në adresën:

<http://www.mpcs.gov.al/dpshb/sq/bashkepunetoret/organizatat-jofitimprurese-ojf-te>

Informacion i përgjithshëm mbi organizatat ndërkombëtare në Shqipëri mund të gjendet në faqen e internetit të MPÇSShB, në adresën:

<http://www.mpcs.gov.al/dpshb/sq/bashkepunetoret/organizatat-nderkombetare-ne-shqiperi>

Lista e OJF të regjistruara pranë organeve tatimore mund të gjendet në adresën:

www.fint.gov.al/doc/Lista%20e%20OJF%20.xls

Disa nga OJF –të kryesore mjedisore në Shqipëri janë renditur më poshtë:

Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore e Lindore (REC) (<http://albania.rec.org/>) është një organizatë ndërkombëtare me mision mbështetjen për zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore e Lindore. Fushat e veprimtarisë së REC Shqipëri mbulojnë të gjitha aspektet e mbështetjes teknike, në fusha si biodiversiteti, financimi mjedisor, legjislacioni mjedisor, menaxhimi mjedisor, mjetet e edukimit, shëndeti dhe mjedisi si dhe transporti i gjelbër.

“Grupimi Ekolëvizja” (<http://www.ekolevizja.org/>): “Ekolëvizja” është grupim me shtrirje kombëtare i disa OJF-ve mjedisore. Misioni i Grupimit “Ekolëvizja” është të bashkojë dhe forcojë zërin e shoqërisë civile në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të bëhet faktor në proceset vendimmarrëse, përmes forcimit të integritetit të rrjetit të shoqatave mjedisore, rritjes së cilësisë së veprimtarive, zgjerimit të pjesëmarrjes, informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut. Programi i këtij grupimi përfshin ndër të tjera opionencë të fortë ndaj politikave anti-mjedisore, forcimin e ndërgjegjësimit të shoqërisë civile, të jetë faktor aktiv në zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm, pjesëmarrje në hartimin e politikave mjedisore dhe vendimmarrje, këshillime, konsulencë, trajnime, ndërmarrje e studimeve dhe punës kërkimore konkrete, grumbullim dhe shpërndarje e informacionit mjedisor, organizimi i aktiviteteve për zgjidhjen e problemeve mjedisore, etj. Disa nga shoqatat që bëjnë pjesë në grupimin Ekolëvizja janë Egnatia, Klubi Ekologjik Krujë, Klubi Ekologjik Elbasan, Liliu Albanicum, Instituti i Studimeve të Ambientit, Milieucontact International Tiranë, Ekomjedisi Durrës, Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror Shkodër, etj.

Milieukontakt Albania, është aktiv që në vitin 2000. Synimi i Milieukontakt është “zhvillimi i një lëvizje mjedisore të fortë e demokratike; i një lëvizjeje të dukshme në shoqëri, të aftë të ndërgjegjësojë publikun dhe të marrë pjesë aktivisht në politika dhe procese vendimmarrëse si në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar”. Strategjia e Milieukontakt mund të përmbledhet në 3 koncepte: ndërtim kapacitetesh, përfshirje qytetare dhe zgjidhje e problemeve mjedisore; ofron trainime, këshillime, dhe mbështetje për organizatat të fokusuara në zhvillimin e qëndrueshëm; stimulon dhe mbështet përfshirjen dhe fuqizimin e qytetarëve dhe zhvillon strategji për pjesëmarrjen në vendimmarrje; harton aktivitete për zgjidhjen e problemeve mjedisore. Milieukontakt ka qenë i suksesshëm në krijimin e një bashkëpunimi mes shoqatave shqiptare në nivel kombëtar duke punuar me grupe të ndryshme pune (OJF – trainerë – program këshillimi, Ekolëvizja me gazetën dhe fushatat e ndërmarra, takimet strategjike vjetore të shoqatave, edukimin mjedisor dhe procesin e planifikimit të vlerave natyrore- Paketa e Gjellbër).

Qendra EDEN (www.eden-al.org) synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm, mjedis të shëndetshëm nëpërmjet informimit dhe edukimit dhe duke ofruar shërbime për aktorët e interesuar dhe partnerët. Qendra EDEN promovon konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm me institucionet qeveritare dhe ndihmon autoritetet shtetërore në hartimin e politikave dhe të programeve mjedisore. Ajo gjithashtu mbështet iniciativat lokale për edukimin mjedisor si dhe forcimin e bashkëpunimit midis OJF-ve mjedisore, strukturave lokale, biznesit dhe aktorëve të tjerë kyç. Qendra EDEN zhvillon programe edukative, publikon materiale dhe organizon veprimtari publike, që synojnë rritjen e ndërgjegjësisë publike në lidhje me mjedisin. Organizata drejton Qendrën e Burimeve Mjedisore dhe ka një grup trajnerësh e programe për ngritjen e kapaciteteve për aktorët si publike dhe private.

5.1.3. Sektori i kërkimit shkencor

Legjislacioni mbi arsimin e lartë dhe shkencën

- [Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë \(i azhornuar\)](#)
- [Ligji Nr. 8834, datë 22.11.2001 “Për ratifikimin e Konventës për njohjen e kualifikimeve të arsimit të lartë në Europë” \(Lisbonë, 1997\)](#)
- [Ligji Nr. 9704, datë 2.4.2007 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë për realizimin e një qendre shërbimesh dhe të një rrjeti telematik për universitetet”](#)

Sistemi i shkencës dhe institucionet përbërëse të tij

Sistemi i shkencës përfshin institucionet e arsimit të lartë, të kërkimit shkencor, të zhvillimit të njohurive dhe të teknologjisë (inovacionit). Si i tillë ai nuk përfshin vetëm institucionet themelore jopublike dhe publike të arsimit të lartë dhe të kërkimit, por edhe sipërmarrjet që veprojnë në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (<http://www.akad.edu.al/>) e themeluar më 1972, është institucioni më i rëndësishëm shkencor në Republikën e Shqipërisë. Ajo përfshin shkencëtarë nga më të shquarit, akademikë, të cilët zhvillojnë veprimtari shkencore në institute dhe qendra kërkimore, si dhe organizma të tjerë shkencorë brenda dhe jashtë vendit.

Akademia ka dy seksione: Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe Seksionin e Shkencave Natyrore dhe Teknike. Në strukturën e saj përfshihen gjithashtu, Njësia e Projekteve

të Kërkim-Zhvillimit Teknologjik e Inovacioneve, Dega e Marrëdhënieve me Jashtë dhe me Publikun, Biblioteka Shkencore dhe Botimet.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) (www.mash.gov.al) harton strategjitë dhe politikat për zhvillimin e arsimit të lartë, për përmirësimin e mëtejshëm të kurrikulave dhe të cilësisë së tyre, në bazë të legjislacionit dhe standardeve në fuqi. Në përputhje me Procesin e Bolonjës, promovon programe të ndryshme kërkimore shkencore nën ombrellën e BE, si dhe mban lidhje të vazhdueshme me njësitë bazë që mbulojnë këto programe nëpër Universitete.

Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (www.akti.gov.al): Misioni i Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit është të vlerësojë, financojë, monitorojë dhe administrojë programet dhe projektet në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit në Shqipëri. Agjencia ka si qëllim financimin e projekteve në fushën e Biznesit të vogël dhe të mesëm si dhe transferimin, modernizimin dhe rinovimin e teknologjive të tyre. Vizioni i AKTI-t është të zhvillojë shkencën dhe teknologjinë në përputhje me prioritetet kombëtare, duke bashkëpunuar me të gjithë institucionet dhe sektorët e linjës. Akti kontribuon në krijimin e infrastrukturës dhe instrumenteve të përshtatshme që zbatojnë politikat e kërkimit dhe zhvillimit në Shqipëri, duke promovuar aktivitete dhe sipërmarrje që zhvillojnë shkencën, teknologjinë dhe inovacionin dhe duke luajtur një rol lider në krijimin e kulturës së kërkimit shkencor.

Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) është një institucion shtetëror dhe publik, pjesë e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në Shqipëri. APAAL është përgjegjëse për procesin e vlerësimit të jashtëm të programeve dhe institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në Shqipëri, si përpara hapjes/ licensimit të tyre ashtu dhe atyre egzistuese apo në proces. APAAL kryen gjithashtu proceset e rankimit, analiza dhe vlerësime sistematike dhe krahasuese institucionale dhe/ ose programeve në arsimin e lartë.

Sistemi i akreditimit në Shqipëri është themeluar në vitin 1999. Ai përbëhet nga dy institucione, Agjencia e Akreditimit dhe Këshilli i Akreditimit. Të dy këto institucione bashkëpunojnë për rritjen e cilësisë në arsimin e lartë.

Institucionet e arsimit të lartë (universitetet) janë institucione mësimore – kërkimore që, sipas strategjisë së arsimit të lartë (2008), kanë si mision arsimin e lartë, kërkimin shkencor, zhvillimin dhe transferimin e njohurive dhe të teknologjisë. Gjerësia dhe niveli i kërkimit shkencor në universitetet e ndryshme do të jetë i ndryshëm. Aktualisht Shqipëria ka 11 shkolla të larta publike dhe 17 shkolla të larta private. Këto të fundit kanë një “moshë” shumë të re (shkolla e parë e lartë private ka vetëm 7 vjet veprimtari). Megjithatë, disa prej tyre kanë filluar të shfaqin potencialet e tyre edhe në fushën e kërkimit.

Listat e institucioneve të arsimit të lartë publik dhe atij privat në Shqipëri gjenden përkatësisht në adresat:

<http://www.mash.gov.al/faqe.php?id1=2&id2=98>

<http://www.mash.gov.al/faqe.php?id1=1&id2=7&id3=26>

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU) si institucioni përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, ka mbështetur dhe është angazhuar në fushën e kërkimit dhe zhvillimit shkencor në fushën e mjedisit.

Kjo mbështetje parashikohet në ligjin Nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, neni 67, pika ç e të cilit thotë: “Ministria e Mjedisit mbështet projekte për punë

kërkimore-shkencore, për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për futjen e teknologjive ekologjikisht të pastra, për nxitjen e veprimtarive të organizatave jofitimprurese mjedisore”.

Në këtë kontekst MMPAU mbështet çdo vit institucionet e ndryshme shkencore me programin e Monitorimit të Mjedisit mesatarisht me një shumë prej 200'000 Eurosh. Ky program siguron njëherazi të dhëna për gjendjen dhe tendencën e komponenteve të mjedisit si dhe garanton qëndrueshmërinë e institucioneve kërkimore nëpërmjet mbështetjes financiare të tyre.

Qendrat kombëtare kërkimore janë institucione kërkimore-mësimore që kanë si mision kërkimin shkencor, formimin e thelluar universitar në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve, zhvillimin dhe transferimin e njohurive dhe të teknologjisë.

Në shkollat publike, që kanë kapacitetet më të kufizuara për kërkim, është e rëndësishme të mbështetet ngritja e **qendrave rajonale të zhvillimit**, ku kërkues të fakulteteve dhe të departamenteve të ndryshme bashkëpunojnë përmes projekteve për kryerjen e studimeve të rëndësishme për rajonin. Sipas strategjisë së arsimit të lartë ngritja e këtyre qendrave duhet të mbështetet përmes një fondi fillestar nxitës.

Qendrat/agjencitë publike të zhvillimit dhe të transferimit të teknologjisë kanë për mision kryerjen e studimeve dhe projekteve zhvillimore si dhe transferimin e njohurive dhe teknologjive në praktikën e prodhimit të produkteve dhe të ofrimit të shërbimeve.

Qendrat, agjencitë, institutet dhe sipërmarrjet e tjera **private** që veprojnë në kërkim, zhvillim dhe transferim të teknologjisë dhe njohurive. Kjo hallkë e sistemit është ende në hapat e para të zhvillimit në Shqipëri. Megjithatë, tendenca është shumë pozitive.

ECAT Tirana (www.ecat-tirana.org) punon me qeverinë rajonale dhe kombëtare, duke ndihmuar për të përmirësuar punën dhe kryerjen e shërbimeve dhe duke u lejuar atyre të bëhen më të përgjegjshme. ECAT punon me politikat, me industrinë dhe komunitetet rurale dhe urbane për të zhvilluar, integruar dhe zbatuar politika për një zhvillim të qëndrueshëm mjedisor. ECAT Tirana mbështet nisma të sigurta mjedisore në Shqipëri, për të përmbushur sfidat e pjesëmarrjes së publikut dhe kërkesat për transparencë më të madhe dhe qeverisje më të mirë.

Reforma e sistemit të kërkimit shkencor

Qeveria shqiptare në vitin 2006 ndërmoi një reformë të thellë të sistemit të kërkimit shkencor.

Kryeministri emëroi një grup ekspertësh nga komuniteti akademik, i cili mbi bazën e një vlerësimi të thelluar të sistemit të kërkimit, hartoi një platformë për reformën e sistemit të kërkimit shkencor. Rekomandimet e grupit të ekspertëve u detajuan nga Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Shkencës dhe mbi këtë bazë, qeveria mori një sërë vendimesh për riorganizimin e rrjetit të institucioneve të kërkimit shkencor.

Rezultatet kryesore të kësaj reforme mund të përmbledhen si më poshtë:

- a) Akademia e Shkencave u riorganizua sipas modelit të shumë vendeve të tjera europiane. Ajo vepron nëpërmjet një bashkësie të zgjedhur shkencëtarësh të organizuar në seksione dhe nuk administron më institute kërkimore.
- b) Institutet kërkimore të Akademisë së Shkencave u shkëputën prej saj dhe u integruan në sistemin e arsimit të lartë. Disa institucione tashmë janë nën varësinë e ministrive të linjës, dhe disa të tjera nën varësinë e universiteteve kryesore, si më poshtë:

- Tri qendra kërkimore ndërdisiplinore (Qendra Ndër-universitare e Studimeve Albanologjike; Qendra Kërkimore Universitare e Energjisë, Ujit dhe Mjedisit pranë Universitetit Politeknik të Tiranës; Qendra Kërkimore Universitare e Gjeoshkencave pranë UPT)
 - Dy fakultete të reja: Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit pranë UPT dhe Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT).
 - Dy qendra/ departamente të reja në përbërje të Fakultetit të Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës (UT): Qendra e Fizikës së Aplikuar dhe Bërthamore; Departamenti i Bioteknologjisë.
- c) Institutet kërkimore të ministrive të linjës u riorganizuan dhe mbi bazën e tyre u krijuan 12 qendra të transferimit të teknologjisë (QTT) dhe agjenci në varësi të ministrive, që kanë si mision kryesor transferimin e teknologjive e të njohurive, si dhe mbështetjen teknike për politikëbërjen në fushat përkatëse.

Përfundimi në 2008 i reformës strukturore, duke integruar institutet e kërkimit të Akademisë së Shkencave dhe të ministrive të linjës në universitete, e sjell sistemin e kërkimit të Shqipërisë në një linjë me shumicën e vendeve europiane, ku arsimit i lartë është i integruar me kërkimin shkencor, i cili është një parim bazë i sistemeve moderne të shkencës. Realizimi i procesit të riorganizimit të sistemit të kërkimit shkencor ka krijuar vetëm një kuadër modern institucional, i cili krijon premisa për një zhvillim të shpejtë të kërkimit shkencor dhe të transferimit të teknologjive e të njohurive. Institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat e reja të kërkimit dhe të transferimit të teknologjisë e të njohurive kanë filluar të hartojnë strategjitë e zhvillimit të kërkimit shkencor dhe inovacionit, në kuadër të planit afatgjatë të zhvillimit të institucionit.

Mbi kapacitetet dhe performancën e sistemit të Shkencës, teknologjisë dhe inovacionit

Kapacitetet dhe kompetenca për të menaxhuar kërkimin fundamental dhe atë të aplikuar në Shqipëri janë të kufizuara dhe, në përgjithësi, larg standardeve që do të mundësonin bashkëpunimin dhe integrimin në programet ndërkombëtare dhe europiane. Po ashtu, infrastruktura shkencore është në çdo aspekt e vjetëruar dhe e pamjaftueshme për të mbështetur kërkimin cilësor. Është i nevojshëm një program i qëndrueshëm për riinvestime për t'i sjellë pajisjet dhe mjediset shkencore në një nivel cilësor minimal për qëllime mësimore në të gjitha fushat e shkencës dhe për të zhvilluar specializime të reja dhe për të forcuar ato ekzistueset, me synim drejt bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

5.2 Përmbledhje e ekspertizës jashtë sistemit qeveritar

Tabela 5.A: Përmbledhje e ekspertizës jashtë sistemit qeveritar

Fusha e ekspertizës	Institutet kërkimore	Universitetet	Industria	Grupimet e konsumatorëve / ambjentalistëve	Unionet e punës	Org. profesionale	Të tjera
Mbledhja e të dhënave	Institutet kërkimore grumbullojnë të dhëna për kimikatet në kuadër të projekteve.	Studentët mund të mbledhin të dhëna (duke përfshirë edhe kimikatet) nga ministrinë dhe agjencitë përkatëse, po kështu edhe nga komuniteti si pjesë e kërkimit të tyre.	Mbledh dhe ruan të dhënat e të gjitha aspekteve të punës.	OJQ-të dhe komuniteti, Organizatat mbledhin të dhënat e ndryshme përmes programeve të tilla si ato të lidhur me menaxhimin e mbetjeve, mjedisin, ushqimin dhe shëndetin.	-	-	
Testimi i kimikateve	Bëhet me teknikat dhe metodat bashkëkohore	Testimet e thjeshta përmes eksperimenteve janë bërë zakonisht si pjesë e lëndëve të shkencës dhe kryhen në laboratorët e shkollës.	Testimi i kimikateve është pjesë e testeve rutinë për qëllime të identifikimit.				
Vlerësimi i riskut	Bëhet nëpërmjet vlerësimit të nivelit të ndotësve dhe shkallës së	-	-	Vlerësimi i impaktit mjedisor mund të bëhet nga			

Fusha e ekspertizës	Institutet kërkimore	Universitetet	Industria	Grupimet e konsumatorëve / ambjentalistëve	Unionet e punës	Org. profesionale	Të tjera
	ekspozimit			studiot apo institute private me ekspertë mjedisorë të licencuar ose nga ekspertë individualë të licencuar po nga MMPAU.			
Reduktimi i riskut	Nëpërmjet sensibilizimit të vendimmarrësve për nivelet e riskut të marra në analiza.	Procedurat dhe politikat “Safety”, dhe përgjegjësia që kanë universitetet si qendra edukimi siguron reduktimin e riskut në menaxhimin e kimikateve dhe aktivitetet e lidhura me to. Sfafi universitar është i informuar për këto aspekte.	Ngritja e sistemit të menaxhimit të sigurisë; Përgatitja e planit të brendshëm të emergjencës; Njoftimi i popullatës dhe trainimi i popullsisë përreth; Bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore për koordinimin e planeve të brendshme dhe të jashtme të emergjencës.	Programet e bashkëpunimit të OJF-ve me komunitetin dhe me nxënësit e shkollave si psh. ndërgjegjësimi mjedisor dhe aktivitetet vullnetare kontribuojnë në reduktimin e riskut që kërcënon shëndetin psh. në reduktimin e mbetjeve.		-	
Komunikimi i riskut	Bërja publike e rezultateve të matjeve dhe vlerësimit të riskut nëpërmjet botimeve,	Rritja e komunikimit dhe nivelit të ndërgjegjësimit në rang universitar por edhe më gjerë	Nëpërmjet publikimeve apo hartimit broshurave apo posterave sidomos për kimikatet që kanë	Krijimi i rrjeteve për komunikimin e riskut nëpërmjet hartimit të politikave të	Luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave	Rrisin ndërgjegjësimin nëpërmjet informacionit të specifikuar dhe profesional për	OJQ nëpërmjet publikimeve në uebsitet e tyre po

Fusha e ekspertizës	Institutet kërkimore	Universitetet	Industria	Grupimet e konsumatorëve / ambjentalistëve	Unionet e punës	Org. profesionale	Të tjera
	masmediave, seminareve, workshop-eve, etj.	nëpër faqet e internetit universitare, etj.	impakte akute në shëndet	komunikimit dhe përdorimi i masmedias.	për komunikim in e riskut dhe ndërgjegjësimit.	riskun e kimikateve.	ashtu edhe në gazetatat on line ose “hard copy” kanë rol të rëndësishëm në komunikimin e riskut.
Analiza e politikës		Lektorët dhe tutorët, studentët e viteve të larta shpesh janë të përfshirë në politikatat e kërkimit.	Industritë marrin pjesë në analizën e politikave përmes bordeve ekzekutive.				
Klasifikimi dhe etiketimi			Aplikuesit për regjistrim të PMB-ve janë të detyruar të paraqesin në dosjen e regjistrimit gjithë të dhënat për klasifikimin e PMB-ve si dhe etiketën, si element të komunikimit të riskut.			Lobime dhe ndërgjegjësimet duke patur parasysh zhvillimet evropiane dhe ndërkombëtare lidhur me klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve, është e	

Fusha e ekspertizës	Institutet kërkimore	Universitetet	Industria	Grupimet e konsumatorëve / ambientalistëve	Unionet e punës	Org. profesionale	Të tjera
						nevojshme të rishikohet legjislacioni aktual përkatës, bazuar në rregulloren (EC)1272/2008, “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve”, ose mbi GHS	
Trajnimi dhe edukimi	Trajnim i vazhdueshëm i stafit nëpërmjet pjesëmarrjes në trainime, konferenca e seminare kombëtare dhe ndërkombëtare.	Universitetet në tërësi sigurojnë programe trajnimi dhe edukimi në shkencat mjedisore dhe inxhinierike për topikët e lidhura me kimikatet psh efektet e lidhura me ndotjet e ajrit, ujit, ndryshimet klimaterike .	Personelit mund t'i sigurohen trajnime formale dhe jo-formale brenda vendit të punës ose marrin pjesë part-time në kurse kualifikimi formale me institucione të tjera të edukimit.				
Akreditimi	Disa laboratorë janë akredituar; të tjerë janë në proces ose e kanë si objektiv.	Politika për të filluar procesin e akreditimit nëpërmjet aplikimit në	Akreditimi mbetet si kërkesë për të prodhuar dhe kontrolluar produktet që prodhojnë për të				

Fusha e ekspertizës	Institutet kërkimore	Universitetet	Industria	Grupimet e konsumatorëve / ambjentalistëve	Unionet e punës	Org. profesionale	Të tjera
		projekte kombëtare dhe kooperime me organizma të kualifikuar.	rritur cilësinë e tyre.				
Kërkimi mbi alternativat					Si pjesë e analizës mjedisore të riskut konsulentët ose grupet sigurojnë vlerësimin që mundet gjithashtu të sigurojë zgjidhje alternative me qëllim që të minimizojë riskun dhe efektet e dëmshme në aktivitete të propozuara.	Për programet e asistencës teknike kontraktohen organizma profesionalë të tillë si ekspertët mjedisorë; Grupet që normalisht kanë detyrë kërkimin dhe sigurojnë zgjidhje alternative.	
Monitorimi	Merren me monitorimin e ndotësve mjedisorë në ujra, toka, sedimente, ajër.		Monitorimi në menaxhimin e kimikateve është i lidhur normalisht me punën p.sh. raportimi për inspektimin e				

Fusha e ekspertizës	Institutet kërkimore	Universitetet	Industria	Grupimet e konsumatorëve / ambjentalistëve	Unionet e punës	Org. profesionale	Të tjera
			përditshëm të kushteve të ruajtjes, transportimit dhe shpërndarjes së kimikateve, trajtimin dhe raportet e aksidenteve, etj.				
Mbikqyrja shëndetësore	Qendrat kërkimore ndërmarrin edhe studime të impaktit në shëndet të ndotësve mjedisorë duke kontrolluar indikatorët përkatës.		Kryerja në bazë të ligjit të monitorimeve shëndetësore për punonjësit sidomos në rastet e punës me substanca të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin. Mbajtja e regjistrave shëndetësorë dhe konsultat me specialistë.	Lista e substancave të rrezikshme, që prej natyrës së tyre përbëjnë një rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e njeriut dhe për mjedisin.			
Mbikqyrja mjedisore	Monitorime për fushat që ato mbulojnë.	Ideojnë projekte në fushat e monitorimeve, kryejnë shërbime monitoruese, hartojnë tekste me informacione monitoruese dhe raporte monitorime.	Kryen monitorime tre mujore për shkarkimet industriale në laboratorë të miratuar nga MMPAU. Hartojnë raporte monitorime të cilat i depozitojnë pranë ARM-ve.			Propozojnë metodika monitorimesh dhe vlerësime të riskut.	Shoqëria civile kryen ndërgjegjësimet për monitorimet mjedisore.
Detyrimet			Detyrimet ligjore të personave juridikë				

Fusha e ekspertizës	Institutet kërkimore	Universitetet	Industria	Grupimet e konsumatorëve / ambjentalistëve	Unionet e punës	Org. profesionale	Të tjera
			ose fizikë, në përcaktimin e vetive dhe klasifikimin e substancave dhe preparateve kimike për regjistrimin, inventarizimin, njoftimin, etj.				
Informacion për punëtorët			Punëtorët janë të informuar për kushtet e punës dhe për përdorimin e sigurt të pajisjeve, për trajtimin me kimikate që ata përdorin nëpërmjet programet e orientimit të aksesit dhe manualeve përkatëse të punës.				
Informacion për grupe specifike profesionale	Duke bashkëpunuar me biznesin bëjnë dhe promovojnë për ruajtjen e shëndetit të punonjësve nga kimikate në mjedisin e punës;	Aplikojnë si partnerë me grupe specifike dhe profesionale në menaxhimin e kimikateve.				Realizojnë përgatitjen profesionale nën mbikqyrjen e personave të kualifikuar profesionalisht.	

Fusha e ekspertizës	Institutet kërkimore	Universitetet	Industria	Grupimet e konsumatorëve / ambjentalistëve	Unionet e punës	Org. profesionale	Të tjera
Informacion për publikun	Përmes mediave private apo shtetërore japin informacion të vazhdueshëm për publikun.				Informacioni zakonisht ofrohet tek publiku nëpërmjet mediave, internetit, organizimit të ditëve kombëtare të informacionit etj.		

5.3. Vlerësimi

Deri më tani politikat qeveritare kanë qenë relativisht favorizuese për të marrë informacion nga OJF-të kombëtare; ato janë më favorizuese për të përdorur ekspertizat dhe përvojat e OJF-ve ndërkombëtare.

Janë shpesh OJF-të që kanë bërë lobime pranë organizmave të ndryshëm vendim marrës në vendin tonë sidomos në lidhje me legjislacionin mjedisor dhe kohët e fundit edhe për kimikatet, sidomos ato të rrezikshme. Roli i OJF-ve në informimin e publikut rreth rrezikut të kimikateve është i madh. Nëpërmjet publikimeve të gazetave, posterave, fushatave ndërgjegjësuese, emisioneve televizive ato jo vetëm informojnë publikun për rreziqet e mundshme por mbajnë qëndrime aktive në debate televizive, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe pranë universiteteve. Përfshirja aktive e OJF-ve në debatet publike të organizuara për prezantimin e projekteve të ndryshme dhe ndikimin e tyre në mjedis ka ndikuar mjaft pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së realizimit të këtyre projekteve nëpërmjet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të ngritura nga OJF-të, duke ndikuar njëkohësisht edhe në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të autoriteteve drejtuese për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe vlerësimin me seriozitet të aktiviteve me ndikim në mjedis.

Iniciativat vullnetare të industrisë nuk duket të kenë ndonjë rol të dukshëm në aktivitetet e menaxhimit të kimikateve në Shqipëri. Vetëmonitorimi i shkarkimeve të ndotësve është aktivitet i detyruar me ligj dhe kohët e fundit është vënë në eficiencë sidomos në rastet e industrive që emetojnë ndotje.

Megjithatë, mund të përmenden iniciativa të bashkëpunimit të sektorit publik me atë privat në fushën e trajnimit të strukturave publike dhe atyre private në lidhje me përdorimin e biocideve për kontrollin e vectorëve transmetues të sëmundjeve dhe të parazitëve në industrinë ushqimore. Si shembuj të këtyre iniciativave mund të përmendim trajnime të zhvilluara dy vitet e fundit nga ISHP dhe MSh në bashkëpunim me kompani që prodhojnë dhe/apo tregtojnë produkte biocide, si kompanitë italiane Colkim e Quark dhe kompania Pelgar International me qendër në Londër. Në këto trajnime morën pjesë epidemiologë dhe inspektorë higjieno-sanitarë të DShP-ve, bashkive, AKU-së dhe aplikuesve të lëndëve biocide në vend.

Bashkëpunimi mes organeve qeveritare dhe sektorëve jo-qeveritare për probleme mjedisore në përgjithësi ka konsistuar në konsultime me aktorët e interesuar gjatë procesit të rishikimit të legjislacionit, strategjive dhe planeve kombëtare si dhe raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Projekti “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e Qasjes Strategjike në Menaxhimin e Kimikateve në Shqipëri” ka sjellë një rritje të përfshirjes së aktorëve jo-qeveritare, si OJQ-ve, ONQ-ve dhe industrisë. Në kuadrin kombëtar është e rëndësishme të përmendet edhe mbështetja rajonale e dhënë nga organizmat ndërkombëtare për institucionet kërkimore-shkencore. Përmendim Projektin “Mbështetje për forcimin dhe fuqizimin e Institutit të Trajnimit dhe Kurikulës (Ministria e Arsimit dhe Shkencës) për futjen e lëndës ekstra kurikulare të Edukimit Mjedisor “Paketa e Gjelbër” për klasat 5-9 të arsimit bazë (REC me financim të Qeverisë së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta). Vlera e mbështetjes për këtë ndërhyrje është rreth 470’000 Euro. Megjithatë, nevojiten më shumë fonde për kërkim dhe një ndarje më e drejtë e mbështetjes financiare mes institucioneve kërkimore.

Si rezultat i kontributit që kanë dhënë institucionet kërkimore-shkencore në fushën e mjedisit, mbështetjes nga donatorë të huaj, organizmat ndërkombëtare dhe të NGO-ve në fushën e

mjedisit, të dhënat dhe produktet e tyre janë reflektuar dhe kanë shërbyer si bazë të dhënash në mjaft dokumenta politike dhe strategjike kombëtare në fushën e mjedisit, në hartimin e planeve dhe programeve të ndryshme mjedisore, në projekte monitoruese të gjendjes së mjedisit, etj.

Forcimi i rolit të OJF-ve sidomos në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit duhet të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit edhe me organizmat qeveritare në nivel qendror dhe lokal. Forcimi i kapaciteteve të tyre, menaxhimi finaciari, zhvillimi institucional, partneriteti në projekte të ndryshme me qeverisjen lokale dhe sektorin privat, komunikimi me publikun mbeten ende problematika që kërkojnë vlerësim e zhvillim.

Tabela 5.B: Veprimet prioritare dhe të mundshme: Aktivitetet e lidhura me industrinë, grupet e interesit publik, trupat profesionale dhe sektori i kërkimit

Çështjet prioritare (të renditura nga prioriteti më i lartë tek më i ulëti)	Niveli i kapaciteteve ekzistuese	Përmbledhje e pikave të forta të kapaciteteve, mangësitë dhe nevojat	Veprime të mundshme	Palët e interesuara
Ndërgjegjësim në lidhje me përdorimin e kimikateve të rrezikshme	I ulët		Fushata ndërgjegjësimi, aplikimi në projekte	OJF, Universitetet, Industria
Ndërgjegjësim në lidhje me pesticidet dhe përdorimin e tyre	I mesëm	Legjislacioni për pesticidet është relativisht i plotë; Nevojë për njohuri mbi reduktimin e riskut në nivel aplikimi	Fushata ndërgjegjësimi Aplikime në projekte	OJF, Universitetet
Ndërgjegjësim në lidhje me asgjësimin e kimikateve të rrezikshme	I ulët	Plotësime në Legjislacion	Fushata ndërgjegjësimi, aplikime në projekte	OJF, Universitetet, Industria
Ndërgjegjësim në lidhje me kimikatet e skaduara	I mesëm	Plotësime në legjislacion	Fushata ndërgjegjësimi Aplikime në projekte,	OJF, Universitetet
Ndërgjegjësim për kimikatet e konsumit; detergentët, produktet e pastrimit shtëpiak dhe profesional, biocidet etj.	I mesëm	Plotësime në legjislacion për përmbajtjen e fosforit në detergentët, pajisje me fletët e sigurisë për të gjitha lëndët e para etj.	Fushata ndërgjegjësimi me postera për mjetet mbrojtëse, spote televizive, publikime për alternativa zëvendësimi ose minimizim në përdorim.	OJF, ISHP, Universitetet, bizneset private, etj.
Përmirësimi i sistemit të klasifikimit, paketimit dhe etiketimit, si dhe trajnimin e stafit	I mesëm	Plotësime në legjislacion sipas CLP të BE.	Seminare trajnuese.	Bizneset industriale, Dhomat e Tregtisë, OJF-të.

KAPITULLI 6: KOMISIONET NDËRMINISTRORE DHE MEKANIZMAT KOORDINUES

Në kapitullin 6 përshkruhen mekanizmat që mundësojnë koordinimin dhe bashkëpunimin midis ministrive, agjencive dhe autoriteteve të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare veçanërisht në fushën e menaxhimit të kimikateve.

Për të siguruar kontributet nga organizmat joqeveritare në procesin e vendimmarrjes, mekanizmi i duhur është rregulluar nëpërmjet VKM Nr. 994, datë. 2.7.2008 “Mbi përfshirjen e publikut në vendimmarrje”. Është përgatitur një draft udhëzues “Mbi pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje për çështjet mjedisore në përputhje me parimet e Konventës së Arhusit”.

Mekanizmat ekzistues punojnë të ndarë sipas problematikës dhe specifikës së tyre. Ata nuk i mbulojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të kimikateve, të cilat kërkojnë një kooperim dhe koordinim ndërministror shumë të mirë. Është domosdoshmëri krijimi i një komiteti ndërministror për menaxhimin më të mirë të kimikateve.

6.1 Komisionet ndër-ministore dhe koordinimi

Në tabelën 6-A të seksionit 6.1 përshkruhen mekanizmat që mundësojnë koordinimin dhe bashkëpunimin midis ministrive, agjencive dhe autoriteteve të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare veçanërisht në fushën e menaxhimit të kimikateve. Në kolonën e fundit është vlerësuar efektiviteti i çdo komisioni apo komiteti. Vlerësimi “i lartë” nënkupton që këto organizma janë krijuar dhe janë në funksionim mbi bazën e rregulloreve të miratuara. Ndërsa vlerësimi “i ulët” nënkupton që këto organizma janë parashikuar të krijohen në bazë të legjislacionit, por mungon legjislacioni sekondar që rregullon funksionimin në praktikë të tyre. Pra, praktikisht këto komitete nuk janë krijuar dhe nuk funksionojnë.

6.2 Përshkrime të Komisioneve Ndër-Ministore dhe i Mekanizmave Koordinuese

6.2.1 Komisioni shtetëror i regjistrimit të PMB-ve (KShRPMB)

Komisioni shtetëror i regjistrimit të PMB-ve, i ngritur pranë Sektorit për Mbrojtjen e Bimëve në MBUMK, përbëhet nga 7 anëtarë. Përbërja e KShRPMB përcaktohet në VKM Nr.1555, datë 12.11.2008 “Për miratimin e rregullave të regjistrimit dhe të kriterëve të vlerësimit të PMB-ve”, si vijon:

Tabela 6-A. Pasqyra e komisioneve ndër-ministrorë dhe i mekanizmave koordinuese

Emërtimi i komisioneve	Përgjegjësia	Sekretariati	Anëtarët	Legjislacioni	Info. në seksionin 6.2 (po/jo)	Efektshmëria
Komisioni Shtetëror i Regjistrimit të PMB-ve	MBUMK	MBUMK	MBUMK, MMPAU, MSh, IShP, MPÇSShB, ISUV, UBT	- Pika 2/II e VKM Nr. 1555, datë 12.11.2008 “Për miratimin e rregullave të regjistrimit dhe të kriterëve të vlerësimit të PMB-ve”, - Urdhër i Ministrit të Bujqësisë Nr. 51, dt. 13.2.2009 mbi “Funksionimin e Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të PMB-ve”	Po	E lartë
Komiteti Ndër-ministror për Emergjencat Civile	MB dhe ministrinë e linjës	MB	Zëvendës/kryeministri dhe ministrat e ministrive të linjës.	Neni 6 dhe 7 i Ligjit Nr. 8756 datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” përcakton detyrat e KNEC	Po	E mesme
Komisioni Teknik Këshillimor për Emergjencat Civile	MB dhe ministrinë e linjës	MB	Ministritë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë ⁷ KKD, IEUM, IST, ShGjSh, AKBN, IShP, QSR, ISUV, QFB, AZhT, Instituti i Gjeografisë Ushtarake, Instituti i Gjeoshkencave, AMP	VKM Nr. 663, datë 18.12.2002 “Mbi përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e Komitetit Teknik Këshillimor për Emergjencat civile”	Po	E mesme
Komiteti për Administrimin e Mbetjeve	MMPAU-MPPT	MMPAU	-Ministri i MMPAU, -Zëvendësministri i MPPT, -Zëvendësministri i Financave, -Zëvendësministri i Brendshëm, -Zëvendësministri i	Neni 23 i ligjit Nr. 9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”	Po	E ulët

⁷ Për emertimet te plota te institucioneve shiko piken 6.2.3

Emërtimi i komisioneve	Përgjegjësia	Sekretariati	Anëtarët	Legjislacioni	Info. në seksionin 6.2 (po/jo)	Efektshmëria
			Drejtësisë, -Zëvendësministri i Shëndetësisë, -Zëvendësministri i Turizmit, Kultures, Rinisë dhe Sporteve, -Zëvendësministri i METE, -Zëvendësministri i Mbrojtjes, -Zëvendësministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, -Zëvendësministri i Arsimit			
Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet	MSh	MSh	MSh, MMPAU, UT, AKBN,	VKM Nr.510, datë 13.5.2009 “Për ngritjen, përbërjen, organizimin, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të komisionit të mbrojtjes nga rrezatimet”		E lartë
Autoriteti Kompetent i COMAH	MMPAU, MPÇSShB	MMPAU, MPÇSShB	MMPAU, MPÇSShB, AMP, Inspektorati i Mjedisit, Inspektorati i Punës, Autoritetet e mbrojtjes civile të qeverisjes vendore	Draft ligji për Kontrollat e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore	-	E ulët
Komisioni Qeveritar për Problemet Ujore me Vendet Fqinje	MMPAU	MMPAU dhe ministrinë e linjës.		Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 124 datë 2.3.2006 "Për krijimin e Komisionit Qeveritar për Problemet Ujore me Vendet Fqinje";	Po	E lartë
Komisioni për dhënien e lejes, për	METE	METE	METE, MSh, MB dhe MMPAU.	Sipas pikës 7.10 të VKM Nr. 824/03 depozitimi dhe ruajtja e kimikateve të rrezikshme për shëndetin dhe mjedisin i	Jo	E ulët

Emërtimi i komisioneve	Përgjegjësia	Sekretariati	Anëtarët	Legjislacioni	Info. në seksionin 6.2 (po/jo)	Efektshmëria
depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme				nënshtrohet procedurës së lejes dhe regjistrimit. Aplikimet për leje i drejtohen METE, ndërsa për regjistrim, MMPAU. Pranë METE ngrihet komisioni me përfaqësues nga ministrinë e linjës. Procedura e marrjes së lejes dhe rregullorja e funksionimit të komisionit miratohen nga titullarët e ministrive të ngarkuara.		
Komisioni i Autorizimeve për lëndët DDD	MSh	MSh	Drejtori i Shëndetit Publik në MSh, Specialistë të Sektorit Higjienë-Epidemiologji, MSh Ekspert juridik, MSh Specialistë të ISHP	Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë Nr. 5, dt. 4.1.2011 “Për lëshimin e autorizimit për importin e lëndëve DDD”	Jo	E lartë

- Një përfaqësues nga shërbimi i mbrojtjes së bimëve, në MBUMK;
- Një përfaqësues (mjek higjienist), nga MSh;
- Një përfaqësues (ekspert i mjedisit), nga MMPAU;
- Një përfaqësues (ekspert i sigurisë në punë), nga MPCSShB;
- Një kimist analist, nga Instituti i Shëndetit Publik (IShP);
- Një specialist, nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV);
- Një pedagog i mbrojtjes së bimëve, nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Lista emërore e anëtarëve të komisionit miratohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, pas propozimit të bërë nga institucionet përkatëse.

Komisioni shërben si organ këshillimor në procedurën e regjistrimit të PMB-ve. Funksionimi i këtij komisioni rregullohet me rregulloren e miratuar nëpërmjet Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë Nr. 51, dt. 13.2.2009 mbi “Funksionimin e Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të PMB-ve”. Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi në fushën e PMB-ve. Ata, paraprakisht, duhet të deklarojnë marrëdhëniet, nëse kanë, me subjektet e importimit ose të tregtimit të PMB-ve. Funksionimi i komisionit përditësohet rregullisht dhe çdo ndryshim në anëtarët e tij përditësohet me urdhër të ministrit përkatës.

6.2.2. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile

Për çdo rast të një emergjence civile kombëtare, sipas ligjit Ligjit Nr. 8756 datë 26.3.2001, pranë Këshillit të Ministrave krijohet Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile. Këshilli i Ministrave përcakton kryetarin e këtij Komiteti dhe përbërjen e tij. Komiteti Ndërmintor qëndron i mbledhur deri në shuarjen e shkaqeve që kanë çuar në emergjencë. Komiteti Ndërmintor mund të thërrasë specialistë për këshillime në emergjencë. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile kryen këto detyra:

- Bashkërendon veprimet e forcave të shërbimit të emergjencave civile.
- Bashkërendon menaxhimin e rezervave shtetërore, si dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre.
- Përcakton mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale dhe financiare në rast emergjence.
- Diskuton dhe vendos paraprakisht për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.
- Vlerëson rindërtimin dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, si dhe për të parandaluar dëmet e mundshme në të ardhmen dhe në sigurimin e kushteve bazë të jetesës.
- Në rastet e një emergjence civile kombëtare cakton drejtuesin e operacionit për menaxhimin e saj.
- Kryen detyra të tjera që burojnë nga ky ligj dhe detyra të veçanta, të caktuara nga Këshilli i Ministrave për përballimin e emergjencës civile.

6.2.3 Komisioni Teknik Këshillimor për Emergjencat Civile

Komisioni Teknik Këshillimor për Emergjencat Civile krijohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile të MB, me specialistë nga ministritë, institucionet, entet e ndryshme dhe forcat operationale. Ministritë e linjës janë përgjegjëse për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në veprimtaritë që kanë në përgjegjësi, hartojnë plane, programe, zhvillojnë projekte për mbrojtjen civile sipas llojit të veprimtarisë.

Për zhvillimin e politikave dhe të programeve të tyre në fushën e mbrojtjes civile, ministritë e linjës kanë struktura të karakterit studimor, monitorues dhe operacional. Janë për t'u përmendur Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKD), Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IEUM), Instituti i Studimit të Tokave (IST), Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Instituti i Shëndetit Publik, Qendra e Studimeve Radiologjike, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Qendra e Fizikës Bërthamore, Agjencia e Zhvillimit të Turizmit, Instituti Gjeografik Ushtarak, Instituti i Gjeoshkencës dhe Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve (AMP), si dhe struktura vartëse në nivel rajonal dhe lokal.

6.2.4. Komiteti Ndërmnistror i Menaxhimit të Mbetjeve

Komiteti Ndërmnistror i Menaxhimit të Mbetjeve nuk është krijuar akoma. Sipas kërkesave të parashtruara në legjislationin përkatës, ky komitet shqyrton, analizon dhe propozon masa të domosdoshme ligjore dhe administrative për administrimin e mbetjeve mbështetur në katër shtyllat kryesore të politikës: Planifikim, Edukim, Burime dhe Legjislacion. Komiteti siguron që brenda çdo ministrie të ketë një politikë të përbashkët dhe të unifikuar për administrimin e mbetjeve dhe të mjedisit. Komiteti garanton një konsultim ndër-ministror të rrjeteve të komunikimit brenda Qeverisë, i cili trajton administrimin e mbetjeve dhe mjedisit në një nivel të lartë politik duke siguruar që këto çështje të merren parasysh nga të gjitha ministritë.

Në rastet kur ka një kosto të menaxhimit të mbetjeve që lidhet me përputhshmërinë me standardet mjedisore, MMPAU siguron që ministria e prekur të llogarisë dhe t'i raportojë paraprakisht koston Komitetit.

Komiteti kur e sheh të arsyeshme thërret ekspertë të fushës dhe përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit për diskutim të çështjeve të veçanta që lidhen me mbetjet.

Ministri i Mjedisit është i ngarkuar për thirrjen e Komitetit dhe për organizimin e mbledhjeve të tij.

6.2.5. Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet

Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi (KMRr) është komision ndërministror në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë e që drejtohet nga Ministri i Shëndetësisë. Autoriteti ekzekutiv i Komisionit është Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimi. Është përgjegjësia e saj të përgatisë dhe përditësojë inventarin e burimeve të mbeturinave ose të burimeve të përdorshme të rrezatimit që gjenden në Shqipëri. Qendra e Fizikës Bërthamore në Fakultetin e Shkencave Natyrore është qendra e vetme që merret me mbetjet radioaktive. KMRr ka këtë përbërje:

- Një përfaqësues nga ISHP;
- Drejtorin e Drejtorisë Juridike në MSh;
- Një përfaqësues nga MMPAU;
- Një ekspert të rrezatimeve jonizuese;
- Dy përfaqësues nga Universiteti i Tiranës, ekspertë të mbrojtjes nga rrezatimet;
- Një përfaqësues nga AKBN.

Kryetari i Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet është sekretar i KMRr, ekspert i rrezatimeve jonizuese.

KMRr është autoriteti kombëtar rregullator, i cili mbikqyr dhe siguron zbatimin e Ligjit Nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, në fushën e mbrojtjes nga rrezatimet jonizuese. Komisioni mbledhet,

si rregull, një herë në 2 muaj, sipas njoftimit të kryetarit dhe mbledhjet zhvillohen me jo më pak se 2/3 e anëtarëve. Mandati i anëtarëve të komisionit është 4-vjeçar.

6.2.6. Autoriteti kompetent i COMAH (Kontrolli i Rreziqeve nga Aksidentet Madhore)

Autoritetet kompetente të parashikuara në draft ligjin "Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore Industriale", që transponon plotësisht Direktivës SEVESO II (COMAH) janë:

- Ministria përgjegjëse për punën, shëndetin dhe sigurinë në punë,
- Ministria përgjegjëse për emergjencat civile (Departamenti i planizimit dhe i përballimit të emergjencave civile),
- Ministria përgjegjëse për shëndetin,
- Ministria përgjegjëse për mjedisin.

Duke vepruar brenda sferave të kompetencave të tyre përkatëse, janë përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji dhe quhen bashkarisht "Autoriteti Kompetent".

Inspektorati Kombëtar i Mjedisit, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Inspektorati Sanitar Shtetëror, duke vepruar brenda kompetencave të tyre përkatëse, janë përgjegjës për inspektimin dhe respektimin e këtij Ligji dhe quhen bashkarisht "Autoriteti i Inspektimit".

Për zbatimin e projekt-Ligjit "Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore Industriale" është përgatitur draft Memorandumi i Mir[kuptimit (MoU) midis MPÇSShB dhe MMPAU. Të dy ministritë kanë përgjegjësitë përkatëse për mbrojtjen e njerëzve dhe mjedisit.

Meqenëse MPÇSShB ka ekspertizën primare për shëndetin e punëtorit dhe çështjet e sigurisë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit⁸ (AKM) ka ekspertizën primare për çështjet mjedisore, Ligji dhe Vendimet e përgatitur sipas ligjit do të zbatohen nga të dy palët duke vepruar së bashku dhe individualisht si Autoritet Kompetent (AK). Megjithatë, ndarja e funksioneve të nevojshme për zbatimin e këtij ligji midis MPÇSShB dhe AKM është qëllimi i Memorandumit të Marrëveshjes. Një grup i përbashkët drejtues do të krijohet për të siguruar që ky Memorandum i Marrëveshjes zbatohet, dhe rishikohet çdo tre vjet.

Për të siguruar zbatueshmërinë e draft ligjit janë përgatitur gjithashtu draft aktet e mëposhtme që rrjedhin nga ky ligj:

- Draft-Vendimi për kriteret që do të përdoren për Limitimin e Informacionit që do të përfshihet në Raportin e Sigurisë
- Draft Vendimi për Njoftimin e Aksidenteve Madhore Industriale
- Draft Vendimi mbi Raportet e Sigurisë dhe Planifikimin e Emergjencave.

Autoriteti kompetent i COMAH nuk është në funksionim, pasi draft ligji që parashikon krijimin e tij do të miratohet në fund të vitit 2012.

6.2.7. Komisioni Qeveritar për problemet ujore me vendet fqinje

Zëvendësministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave kryeson Komisionin për problemet e ujrave kufitare me vendet fqinje.

⁸ Agjencia Kombetare e Mjedisit sipas legjislacionit të ri. Aktualisht mban ende emrin Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve

Komisioni ka në përbërje 9 përfaqësues nga: Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, MF, METE, MPPT, MBUMK, MMPAU, Akademia e Shkencave, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.

6.2.8 Komiteti për implementimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (2005)

për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (2005), është krijuar një task forcë me përfaqësues nga ministritë e linjës dhe sektorët e ndryshëm në vend, e cila është e lidhur edhe me Pikën Fokale Kombëtare në ISHP. Ky komitet do të planifikojë, mbikqyrë dhe monitorojë implementimin e RNSh (2005). Përmbushja e kërkesave bazë për kapacitete të RNSh (2005) do të kontribuojë gjithashtu në plotësimin e disa prej kërkesave për futjen në BE.

6.3 Përshkrim i mekanizmave për marrjen e të dhënave nga OJQ-të

Për të siguruar kontributet nga organizmat joqeveritarë në procesin e vendimmarrjes, mekanizmi i duhur është rregulluar nëpërmjet VKM Nr. 994, datë 2.7.2008 “Mbi përfshirjen e publikut në vendimmarrje”. Një draft udhëzues “Mbi pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje për çështjet mjedisore në përputhje me parimet e Konventës së Arhusit” është përgatitur. Gjithashtu OJQ-të nëpërmjet përfshirjes në projekte të ndryshme që iniciohen nga MMPAU apo organizma ndërkombëtare, publikojnë rezultate e punës së tyre në median e shkruar, nëpërmjet broshurave, botimeve, median televizive, faqet e tyre të internetit, të disponueshme për publikun dhe palët e interesuara.

6.4. Vlerësimi

Menaxhimi i suksesshëm i kimikateve në nivel kombëtar komplikohet nga fakti që zakonisht ministritë e ndryshme marrin pjesë në kontrollin e kimikateve në faza të ndryshme të ciklit të jetës së tyre krahas faktit që ka ndërthurje në një farë shkalle të përgjegjësi për një problem të caktuar. Për këto arsye, është nevojë e domosdoshme ngritja e një institucioni koordinimi për menaxhimin e kimikateve ndërmjet të gjitha ministrive, siç do ishte Komiteti Ndër- Sektorial Kombëtar për Menaxhimin e Kimikateve.

Zyra e menaxhimit dhe regjistrimit të kimikateve në zbatim të detyrave që ka vënë Ligji Nr. 9108 dt 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”. Në Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA është parashikuar krijimi i kësaj zyre brenda vitit 2015. Kjo zyrë do të shërbejë edhe si Sekretariat i Komitetit Ndërsektorial për menaxhimin e kimikateve.

Duke patur parasysh gjendjen e institucioneve apo organizmave ekzistuese të menaxhimit të kimikateve vërehet se ato nuk funksionojnë gjithmonë siç duhet për shumë arsye :

- Përgjegjësitë dhe të drejtat e aktorëve të ndryshëm nuk janë gjithmonë të qarta dhe të përcaktuara me akte normative ligjore;
- Ministritë e linjës që administrojnë këto mekanizma nuk kanë buxhet të mjaftueshëm për ndjekjen në vazhdimësi të problemeve ;
- Drejtoritë dhe specialistët ndjekin problemet e kimikateve midis çështjeve të tjera të një sektori multidisiplinor;
- Ka mangësi në zgjidhjet teknologjike (të dhëna online, faks, lidhje telefonike).

Të gjitha sa përmendëm kanë lidhje me pamundësitë financiare për të patur një ekip më të plotë e më kompetent për ndjekjen e problemeve në mënyrë të veçantë në ministritë e linjës që tashmë kanë një reduktim të ndjeshëm të personelit administrativ.

Në të shumtën e rasteve organizmat dhe agjencitë qeveritare marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve në shkallën dhe mundësitë reale, pa mundur të operojnë në thellësi të problemit, për mungesë të personelit, të akteve nënligjore dhe, në shumë raste, të mungesës së përfshirjes në takime të rëndësishme për të kontribuar në prezantimin e përfaqësimit të mekanizmit që ato mbulojnë.

Për realizimin më të mirë të detyrave nga organet shtetërore, është bërë e mundur sipas rastit, me kërkesën ose nevojën për të zgjidhur diçka të veçantë, sjellja e mekanizmave shtesë nga jashtë strukturave të qeverisë, sikurse është kontributi i ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë për probleme që lidhen me asgjesimin e mbetjeve të kimikateve etj.

Tabela 6.B: Prioritetet dhe veprimet e mundshme: komisionet ndërministrorë dhe mekanizmat e koordinimit

Çështjet prioritare (klasifikim nga lart-poshtë)	Niveli i kapaciteteve egzistuese (i ulët, i mesëm, i lartë)	Përmbledhja e kapaciteteve. Pikat e forta, boshllëqet dhe nevojat	Veprimet e mundshme	Aktorët
Krijimi i komitetit ndër-ministrior për menaxhimin më të mirë të kimikateve.	I ulët		Përgatitja e draft rregullores për krijimin e komitetit ndër-ministrior për menaxhimin më të mirë të kimikateve	MMPAU, MSh, MBMUK, METE, MPÇSShB
Rritja e kapaciteteve të stafit në sektorin e kimikateve në MMPAU	Mesatar	Rritja e numrit të stafit Trajnim i stafit	Është parashikuar në PKZMSA krijimi i byrosë së kimikateve	MMPAU
Krijimi dhe funksionimi i Autoritetit kompetent për COMAH	I ulët	Mungesa e bazës ligjore	Miratimi i Draft ligjit brenda 2012	MMPAU, MSh, MPÇSShB
Krijimi i Komitetit Ndërministror të Menaxhimit të Mbetjeve	I ulët		Përgatitja e rregullores për krijimin e Komitetit Ndërministror të Menaxhimit të Mbetjeve	MMPAU MSh, MPPT, MF

KAPITULLI 7: MENAXHIMI, AKSESI DHE PËRDORIMI INFORMACIONIT

Qëllimi i këtij kapitulli është paraqitja e përgjithshme mbi disponueshmërinë e të dhënave dhe përdorimin e tyre në nivel lokal dhe kombëtar për uljen e riskut nga kimikatet. është paraqitur baza ligjore kombëtare lidhur me sigurimin dhe shpërndarjen e informacionit lidhur me menaxhimin e kimikateve, ku përcaktohen institucionet përgjegjëse dhe detyrimet që kanë këto institucione në këtë aspekt. Janë përshkruar procedurat e mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit mbi menaxhimin e kimikateve. Janë dhënë gjithashtu burimet e identifikuara të informacioneve ekzistuese mbi kimikatet, sistemet kombëtare të shkëmbimit të të dhënave dhe kapacitetet e teknologjisë së informacionit (IT) si dhe vendndodhje e literaturës apo linkeve ndërkombëtare.

Në këtë kapitull vihen në pah edhe mangësi të cilat lidhen me mungesën e literaturës së mjaftueshme, informacioneve bazë si dhe në shpërndarjen e tyre, të cilat kanë lidhje me sistemin e dobët të informimit në vend si dhe me mungesën e një qendre të shkëmbimit të informacionit për menaxhimin e kimikateve, për mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit nga institucionet qendrore deri tek ato lokale.

7.1 Disponueshmëria e përgjithshme e të dhënave për menaxhimin e kimikateve

Baza ligjore mbi menaxhimin e kimikateve përmban në vetvete edhe aspektin e menaxhimit të të dhënave. Në VKM Nr.100, datë 3.2.2008 “Për përcaktimin e substancave të rrezikshme” specifikohen institucionet përgjegjëse si MPÇSShB, METE, MPPT, MMPAU, MSh, MASH, MB, MM, MBUMK dhe inspektoratet në varësi të tyre si dhe detyrimet e tyre në lidhje me importin dhe eksportin e kimikateve. Sipas këtij vendimi kryhet shkëmbimi i informacionit shkencor, teknik, ekonomik si dhe informacioni toksikologjik e ekotoksikologjik në lidhje me kimikatet. Sigurimi i informacionit në dispozicion të publikut dhe palëve të tjera të interesuara bëhet përmes sekretariatit të institucioneve përgjegjëse.

Bazuar në Ligjin Nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike” janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e personave juridike ose fizikë në përcaktimin e vetive dhe klasifikimin e substancave dhe preparateve kimike për regjistrimin, inventarizimin, njoftimin, menaxhimin dhe tregtimin e tyre.

Kriteret mbi klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme përcaktohen sipas Vendimit Nr. 824, datë 11.12.2003 “Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme”. Përmirësimi i sigurisë dhe shëndetit në punë nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit apo zbutjes së faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksidenteve, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre kryhet sipas Ligjit Nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Tabela 7.A jep të dhëna të përgjithshme mbi ekzistencën e informacionit mbi kimikatet në institucionet përgjegjëse. Këto të dhëna janë të disponueshme për institucionet përgjegjëse që merren me menaxhimin e kimikateve.

Tabela 7.A: Disponueshmëria e informacionit

Të dhënat e nevojshme	Pesticidet (bujqësore, shëndeti publik, për përdorim)	Kimikate industriale	Kimikate për konsumatorin	Mbetje kimike
Vendosja e prioriteteve	MBUMK; MMPAU	METE	METE	METE
Vlerësimi i impaktit të kimikateve në kushtet lokale	MBUMK; MMPAU; MSh	MMPAU; MSh	MMPAU; MSh	METE
Vlerësimi i Riskut (shëndetësor/ mjedisor)	MMPAU; MSh; AMP	MMPAU; AMP	MMPAU; MSh;	MMPAU; MSh;
Klasifikimi/ Etiketimi	MMPAU; MBUMK; MSh	METE	METE	METE
Regjistrimi	MMPAU; MBUMK; MSh	METE	METE	METE
Liçensimi	MMPAU; MBUMK; MSh	METE; QKL	METE; QKL	METE
Lejet	MMPAU; MBUMK; MSh	MMPAU; METE;	MMPAU; METE	MMPAU; METE
Vendimet mbi uljen e riskut	MMPAU; MBUMK; MSh	METE	METE	METE
Gadishmëria për aksidentet	MMPAU; MoI; MSh	MMPAU; METE; MB	MMPAU; METE; MB	MMPAU; METE; MB
Kontrolli i helmimeve	MBUMK; MSh, Qendra e Toksikologjisë Klinike QSUT	MSh, Qendra e Toksikologjisë Klinike QSUT	MSh, Qendra e Toksikologjisë Klinike QSUT	MSh, Qendra e Toksikologjisë Klinike QSUT
Inventarizimi i emetimeve	MMPAU	METE; MMPAU; MPPTT	METE; MMPAU	METE; MSh; MMPAU
Inspektimet dhe auditimet (mjedis dhe shëndet)	MMPAU; MBUMK; MSh	MMPAU; MSh, MPÇSShB	MSh; MMPAU	MMPAU; MSh
Informacioni për publikun	MMPAU; MBUMK; MSh; Këshilli i Ministrave	MMPAU	MMPAU	MMPAU
Informacion për punëtorët	MMPAU; MBUMK; MSh; MPÇSShB; Inspektorati Shtetëror i Punës	Inspektorati Shtetëror i Punës		MMPAU

7.2 Burimi i të dhënave kombëtare, aksesit dhe formati i tyre

Tabela 7.B paraqet burimin dhe vendndodhjen e të dhënave kombëtare lidhur me menaxhimin e kimikateve që i përkasin në të shumtën e rasteve ministrive përkatëse, Institutit të Statistikës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si dhe burime potenciale të informacionit (bazuar në legjislacionin përkatës). Në disa raste informacioni është i pakët ose mungon fare, për shkak të mungësive në njerëz, kapacitete, infrastrukturë, të tilla si mungesa e nje baze të dhënash si dhe mungesa e nje qendre për shkëmbim informacioni. etj. Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri është krijuar faqja e internetit www.chemicals.al si mjet për shkëmbimin e informacionit lidhur me menaxhimin e kimikateve.

Tabela 7.B: Burimet e të dhënave kombëtare, aksesit dhe formati i tyre

Lloji i të dhënave	Vendndodhja	Burimi të dhënave	Kush ka akses	Si të kemi akses	Formati
Statistikat e prodhimit	INSTAT; METE; QKKB, MSh	M. e linjës; METE; INSTAT;	Publiku	Me kërkesë nga pala e interesuar www.qkqb.gov.al	Faqe interneti; Excel
Statistikat e eksportit/ importit	INSTAT; METE; Dogana; QKKB, MSh	INSTAT; METE; Dogana;	Publiku	http://www.dogana.gov.al/	Faqe interneti; Excel
Statistikat e përdorimit të kimikateve	METE; MBUMK; MM;	INSTAT; METE; MM; MBUMK	Publiku	Me kërkesë të palës së interesuar	
Raportet për aksidentet industriale	MMPAU; Insp. Shëndetit në Punë	METE; MPÇSShB; Inspektoriati Shëndetit në Punë	Publiku	Operatori njofton publikun, media	Aktualisht njoftimi kryhet nga MB dhe media. Sipas Projekt Vendimit “Për Formatin e njoftimeve që kërkohen nga ligji për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet industriale madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme” është përcaktuar formati i njoftimit.
Raportet për aksidentet në transport	MPPT	MPPT; INSTAT	Publiku		
Të dhëna mbi shëndetin në punë (industri)	MSh; MPÇSShB; Insp. Shëndetit në Punë	Insp. Sanitar Shtetëror; Insp. Shëndetit në Punë, ISHP	Publiku	Me kërkesë të palës së interesuar	S’ka
Të dhëna mbi shëndetin në punë (bujqësi)	MSh; MPÇSShB; MSh; MBUMK; Insp. Shëndetit në Punë	Insp. Sanitar Shtetëror; Insp. Shëndetit në Punë, ISHP	Publiku	Me kërkesë të palës së interesuar	-
Statistikat e helmimeve	MSh; Shërbimi i Toksikologjisë klinike të QSUT	MSh; Shërbimi i Toksikologjisë klinike të QSUT	Publiku	Me kërkesë nga palët e interesuara	-

Lloji i të dhënave	Vendndodhja	Burimi të dhënave	Kush ka akses	Si të kemi akses	Formati
Çlirimi Ndotësve dhe Regjistri Transfertave	MMPAU	Insp Mjedisit	Publiku	Me kërkesë nga palët e interesuara	
Të dhëna mbi mbetjet e rrezikshme	MMPAU, AMP; MBUMK; METE	Operatorët industrialë; MMPAU; MBUMK; METE	Publiku	Me kërkesë nga palët e interesuara	
Regjistri i pesticideve	MBUMK	MBUMK	Publiku	Me kërkesë nga palët e interesuara	
Regjistri kimikateve toksike	MSh	MSh	Publiku	Me kërkesë nga palët e interesuara	
Inventari i kimikateve ekzistuese	MMPAU; MSh; MBUMK; METE; QKKB	MMPAU; MSh; MBUMK; METE; QKKB	Publiku; Pjesërisht	Me kërkesë nga palët e interesuara www.qkqb.gov.al	Faqe interneti
Regjistri i importeve	Doganat	Doganat	Ekspertët e ministrive	http://www.dogana.gov.al/	Faqe interneti
Regjistri i prodhuesve	METE; MBUMK	METE	Ekspertët e ministrive	www.mete.gov.al/ www.mbumk.gov.al/	Faqe interneti
Vendimet e PIK	MMPAU	MMPAU	Ekspertët e ministrive	-	-

7.3 Proçedurat për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave kombëtare/lokale

Ligji Nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për Substancat dhe Preparatet Kimike” dhe Ligji Nr. 9362, datë 24.3.2005 “Për shërbimin e Mbrojtjes së Bimëve”, i ndryshuar me ligjin Nr. 9908, datë 24.4.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9362”, parashikojnë zhvillimin e proçedurave të grumbullimit të të dhënave dhe vlerësimit të riskut për kimikatet dhe pesticidet, në faza të ndryshme të ciklit të jetës së tyre (importit, klasifikimit, hedhjes në treg, kontrollit, regjistrimit etj).

Prodhuesit dhe importuesit janë të detyruar të regjistrojnë substancat që hedhin në treg sipas llojit, sasisë, vetive të substancës dhe të preparatit. Regjistrimi bëhet veçmas për çdo biznes. Mënyra dhe hollësitë e regjistrimit dhe të njoftimit përcaktohen nga zyra e regjistrimit të kimikateve (e cila nuk është ngritur ende). Zyra e regjistrimit të kimikateve, në bazë të të dhënave të ministrive të ngarkuara nga ky ligj, duhet të regjistrojë aplikimet për importin dhe eksportin e substancave dhe të preparateve të rrezikshme të caktuara, miratimet e dhëna, si dhe njofton MMPAU për shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave për këto substanca. **Aktualisht një zyrë e tillë nuk është ngritur.**

Personat juridikë ose fizikë të autorizuar për kryerjen e veprimtarisë tregtare janë të detyruar që për menaxhimin e substancave dhe të preparateve të klasifikuara, si helmuese të njoftojnë agjencinë rajonale të mjedisit, të regjistrojnë hyrjet e këtyre substancave dhe sasinë maksimale të ruajtur. Agjencia rajonale e mjedisit, së bashku me njësinë vendore të mbrojtjes së shëndetit, përcaktojnë 24 orë para fillimit të veprimtarisë për të cilin është bërë njoftimi kushtet e veçanta për kryerjen e kësaj veprimtarie.

Importi dhe eksporti i substancave dhe i preparateve të rrezikshme bëhen vetëm me leje të ministrit përkatës. Gjithashtu, prodhuesit dhe importuesit vetëm të substancave të rrezikshme ose që përmbahen në preparat në sasi më të madhe se 10 ton për një vit kalendarik, janë të detyruar të njoftojnë me shkrim ministrinë përkatëse 1 herë në vit për llojin e substancës së rrezikshme, që prodhojnë ose importojnë, sasinë dhe vetitë e saj.

Në VKM Nr.1555, datë 12.11.2008, “Për përcaktimin e rregullave të regjistrimit dhe të kriterëve të vlerësimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve” përcaktohen procedurat dhe kërkesat për regjistrimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve (PMB) në formën e tyre tregtare që do të importohen dhe përdoren në territorin e vendit.

Aktualisht nuk ka një regjistër zyrtar për PMB-të që janë në treg. Ekziston lista e PMB-ve të regjistruara për t’u importuar dhe përdorur në Republikën e Shqipërisë, e cila publikohet në mënyrë periodike sa herë pëson ndryshime. Lista u dërgohet zyrtarisht për zbatim të gjithë subjekteve importuese dhe tregtuese të PMB-ve, si dhe Inspektoriatit Fitosanitar që ushtron aktivitetin e tij në qarqe.

Depozitimi dhe ruajtja e kimikateve të rrezikshme i nënshtrohet procedurës së lejes dhe regjistrimit. Aplikimet për leje i drejtohen METE, ndërsa, për regjistrimin e tyre (kimikateve), Ministrisë së Mjedisit. Pranë METE ngrihet komisioni për dhënien e lejes, për depozitimin dhe ruajtjen e kimikateve të rrezikshme me përfaqësues nga METE, MSh, Ministria e Brendshme dhe MMPAU. Procedura e marrjes së lejes dhe rregullorja e funksionimit të komisionit miratohen nga titullarët e ministrive përkatëse.

Një qendër që depoziton dhe ruan kimikatet e rrezikshme duhet të ketë një drejtues teknik, që njeh rregulloren e trajtimit, të administrimit të kimikateve, si dhe masat për parandalimin e aksidenteve. Substancat dhe preparatet kimike që ruhen në depo duhet t’i nënshtrohen kontrollit të vazhdueshëm. Kontrolli përfshin kontrollin periodik të depove dhe të vendeve të tjera të ruajtjes, kontrollin e ambalazheve, si dhe analizat laboratorike.

Lista e lëndëve dhe e mbetjeve të rrezikshme, e mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, për të cilat ndalohet importimi, miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrit të Mjedisit. Importimi i çdo lloj mbetjeje me qëllim përdorimi, përpunimi e riciklimi bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave sipas rregullave, procedurave, sasive dhe afateve të miratuara prej tij, me propozimin e Ministrit të Mjedisit.

Parandalimi i aksidenteve industriale bazohet në ngritjen e sistemeve të parandalimit dhe të kontrollit të aksidenteve. Identifikimi i veprimtarive gjatë të cilave përdoren lëndë të rrezikshme, kriteret e ngritjes së sistemeve të parandalimit dhe të kontrollit të aksidenteve, masat që duhen marrë, detyrimet e personave fizikë e juridikë, organet kontrolluese dhe përgjegjësitë e tyre, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e përbashkët të Ministrit të Mjedisit, Ministrit të Punës, Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Brendshëm.

Kontrolli për gjendjen e mjedisit është detyrë e Inspektoriatit të Mjedisit, e punonjësve të caktuar nga Ministri i Mjedisit dhe e agjencive rajonale të mjedisit. Kryejnë kontrolle mbi gjendjen e mjedisit edhe Policia Pyjore, Policia e Ndërtimit, Inspektoriat Sanitar Shtetëror, Inspektoriat i

Mbrojtjes së Bimëve, Inspektoriati i Peshkimit, Inspektoriati i Hidrokarbureve, Inspektoriati Zooveteriner, inspektoriati dhe organet e kontrollit të qeverisjes vendore.

7.4 Disponueshmëria e të dhënave dhe literaturës ndërkombëtare

Dekada e fundit ka shënuar një revolucion përsa i përket lidhjes në rrjet të institucioneve publike, instituteve kërkimore dhe, praktikisht, çdo zyrë në Tiranë ka ditët e sotme akses në informacionin e disponueshëm në Internet. Situata është më problematike në rrethe, kur jo çdo zyrë ka akses në internet.

Tabela 7.C Disponueshmëria e literaturës ndërkombëtare

Literatura	Vendndodhja	Kush ka akses dhe në cilën formë?	Si të kesh akses
Infomacion mbi SAICM	http://www.saicm.org	Gjithë palët e interesuara për menaxhimin e kimikateve.	Faqe interneti
Dokumentacioni mbi Kriteret e Shëndetit Mjedisor (EHC-WHO) (Organizata Botërore e Shëndetit)	http://www.WHO.int/ipcs/publications/ehc/en/index.html	Kërkuesit, specialistë të mjedisit, specialistë të sigurisë ushqimore, specialistë të shëndetit dhe sigurisë në punë.	Faqe interneti
Udhëzues mbi Shëndetin në Punë (IPCS- Programi Ndërkombëtar për Sigurinë e Kimikateve)	http://www.WHO.int/ipcs/publications/hsg/en/index.html	Inspektorët e punës, inspektorët sanitarë; Specialistët e sigurisë dhe shëndetit në ndermarrje.	Faqe interneti
Kartat Ndërkombëtare të Sigurisë Kimike (të IPCS⁹)	http://www.inchem.org/pages/icsc.html	Inspektorët e punës, inspektorët sanitarë, specialistët e sigurisë dhe shëndetit në ndermarrje.	
Dokumentat mbi Informimin me Pëlqim Paraprak për Kimikatet	http://www.pic.int/TheConvention/Chemicals/DecisionGuidanceDocuments/tabid/2413/language/en-US/Default.aspx	Ekspertë të MMPAU	Faqe interneti
Fletët me të dhëna mbi Sigurinë e Pesticideve (MSDS) FAO/WHO	http://www.who.int/ipcs/publications/pds/en/index.html	Ekspertë të PMB-ve, universitetet,	Faqe interneti

⁹ International Programme for Chemical Safety

Literatura	Vendndodhja	Kush ka akses dhe në cilën formë?	Si të kesh akses
		anëtarët e Komisionit Shtetëror të Regjistrimit të PMB-ve, stafet e shëndetit dhe sigurisë në punë, tregtarë dhe trajtues me PMB dhe biocide.	
Dokumenta nga Mbledhja e Përbashkët e FAO/WHO mbi Mbejtjet e Pesticideve	http://www.WHO.int/ipcs/publications/jmpr/en/	Inspektorë të Ushqimit, AKU, specialistë të sigurisë ushqimore.	Faqe interneti
Dokumenta nga Mbledhja e Përbashkët e Komitetit të Ekspertëve të FAO/WHO mbi Aditivët në Ushqime	http://www.WHO.int/ipcs/publications/jecfa/en/index.html	Inspektorë të Ushqimit, AKU, specialistë të sigurisë ushqimore.	Faqe interneti
Sistemi Global i Harmonizuar i Klasifikimit dhe Etiketimit të Kimikateve (GHS)	http://www.unece.org/trans/danger/publi/ghs/ghs_welcome_e.html	Ekspertë të ministrive, aplikuesit për regjistrim, industria.	Faqe interneti
Fletët e të dhënave të Sigurisë së Materialeve (MSDS) (industri)	http://www.msds.com/index.asp http://www.permabond.com/	Ekspertët, punonjësit e industrisë.	Faqe interneti
Udhëzues të OECD për Testimin e Kimikateve	http://www.oecd.org/document/40/0,3343,en_2649_34377_37051368_1_1_1_1,00.html	Specialistët mbi çështje të lidhura me efektet e kimikateve mbi shëndetin.	Faqe interneti
Parime të Praktikave të Mira Laboratorike (OECD)	http://www.oecd.org/document/63/0,3343,en_2649_34381_2346175_1_1_1_1,00.html	Laboratorët	Faqe interneti
Parime të Praktikave të Mira të Prodhimit (WHO)	http://www.WHO.int/medicines/areas/quality_safety/quality_assurance/production/en/index.html	Prodhuesit e farmaceutikëve, QKKB	Faqe interneti

Organizatat Ndërkombëtare si UNDP, UNEP, ILO, WHO, UNITAR, FAO etj. kryejnë një punë të mirë mbi infomimin në lidhje me menaxhimin e kimikateve, punë kjo e shpërndarë jo vetëm në rrugë elektronike, por dhe nëpërmjet broshurave të përkthyer në gjuhën shqipe.

Tabela 7.D Disponueshmëria e të dhënave ndërkombëtare

Të dhëna	Vendndodhja	Kush ka akses	Si të kesh akses
ILO CIS	http://www.ilocis.org/	Specialistë të shëndetit dhe sigurisë në punë, inspektorët e punës.	Faqja e internetit
IPCS INCHEM	http://www.inchem.org/	Specialistë të shëndetit dhe sigurisë në punë, inspektorët e punës.	Faqja e internetit
IPCS INTOX	http://www.intox.org/	Toksikologë, punonjës të shëndetit publik.	Faqja e internetit
IRPTC	http://www.chem.unep.ch/irptc/irptc/databank.html	Të gjithë	Faqja e internetit
Baza e të dhënave e Shërbimeve Abstrakte të Kimikateve	http://www.cas.org/	Të gjithë	Faqja e internetit
Rrjeti Informacionit Global mbi Kimikatat	www.nihs.go.jp	Të gjithë	Faqja e internetit
Baza e të dhënave STN	http://www.cas.org/products/stnfamily/index.html	Kërkuesit	Faqja e internetit

Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për implementimin e SAICM në Shqipëri” është duke u përgatitur një bazë të dhënash për biocidet e cila do të ketë kapacitete për t’u zgjeruar dhe pasuruar më tej me klasa të tjera kimikatesh.

7.5 Sistemet kombëtare të shkëmbimit të të dhënave dhe kapacitetet e teknologjisë së informacionit (IT)

Informimi i publikut për çështje mjedisore në Shqipëri bazohet mbi Ligjin Nr. 8672, datë 26.10.2000, “Për aderimin e Shqipërisë në Konventën e Aarhusit”, sipas të cilit Konventa e Aarhusit kthehet në një akt normativ, të detyrueshëm për t’u zbatuar në Republikën e Shqipërisë.

Shqipëria ka aderuar në Protokollin për Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve nëpërmjet Ligjit Nr. 9548, datë 1.6.2006 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin për Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve”. Sipas këtij Protokolli, çdo palë krijon dhe mirëmban një regjistër kombëtar të shkarkimit dhe transferimit të ndotësve më të mundshëm. Ky është shërbim specifik përsa i përket raportimit mbi burimet, ndihmon raportimin mbi burimet e shpërndara, është ndotës specifik apo mbetje - specifik, sipas rastit, përfshin informacion mbi transferimet si dhe bazohet në raportim të detyrueshëm mbi bazë periodike.

Institucionet apo rrjetet publike që kryejnë informimin e publikut në fushën e mjedisit janë:

- Rrjeti Institucional Mjedisor, krijimi i të cilit është bazuar në Ligjin Nr. 8934, dt. 5.9 2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Përcaktimi ligjor i këtij rrjeti institucional i detyron këto struktura në mënyrë të drejtpërdrejtë të ndërmarrin hapa për shpërndarjen e informacionit mjedisor që ato posedojnë. Nga ana tjetër, identifikimi i këtij rrjeti institucional mjedisor ndihmon publikun për të identifikuar strukturat ku mund të kërkojë informacion mjedisor.

- Nëpërmjet Sektorit të Informimit të Publikut dhe Teknologjisë së Informacionit (SIPTI) MMPAU mundëson mbledhjen e informacionit nga të gjitha strukturat e saj dhe shpërndarjen e këtij informacioni për publikun e gjërë. Shpërndarja e informacionit bëhet në mënyrë pasive ose aktive:

(i) Shpërndarja pasive e informacionit mjedisor

Kërkesat me shkrim për informacion i kalohen SIPTI për të mundësuar kthimin e përgjigjeve për publiku. Për përgatitjen e përgjigjes kjo strukturë bashkëpunon me drejtoritë brenda MMPAU-së ose dhe me strukturat e varësisë. Kthimi i përgjigjeve bëhet konform Ligjit Nr. 8672, datë 26.10.2000 dhe Ligjit Nr.8503, dt. 30.6.1999. Dhe në rreth 90% të kërkesave të vizitorëve përgjigja për informacionin e kërkuar u jepet në mënyrë të menjëhershme

(ii) Shpërndarja aktive e informacionit

MMPAU ka detyrimin për të paraqitur në faqen e saj të gjithë informacioni mjedisor që duhet të jepet pa kërkesën e publikut. Ky informacion përfshin bazën e plotë ligjore të ministrisë, aktet ligjore që janë në procesin e diskutimit me publikun, dokumentet strategjike për fushën mjedisit dhe ato që janë në diskutim me publikun, raportet e gjendjes së mjedisit si dhe informacionin për shërbimet që ofron Ministria si leje, liçenca, çertifikata dhe vërtetime etj.

Gjithashtu Ministria informon edhe nëpërmjet Buletinit Elektronik Mjedisor, botim i përmuajshëm që p[ri]pilotet nga Sektori i Informimit të Publikut dhe IT. Buletini dërgohet në më shumë se 200 adresa elektronike përfshirë OJF mjedisore, pikave të informimit të të gjitha Ministrive, Dhomave të Tregtisë, si dhe zyra të projekteve që veprojnë në fushën e mjedisit.

- Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve e krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 579, dt. 23.8.2006 “Për krijimin e Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve”, harton dhe publikon Raportin Vjetor të Gjendjes së Mjedisit.

- Agjencitë Rajonale Mjedisore, hartojnë dhe paraqesin për miratim në Këshillin e Qarkut raportin dyvjeçar të gjendjes së mjedisit për qarkun që ato mbulojnë. Këto agjenci në detyrim të nenit 19 të ligjit Nr. 9890, datë 20.3.2008, “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, paraqesin këtë Raport për publikun.

- Inspektoriat i Mjedisit, sipas pikës 10 VKM Nr.24, dt.22.1.2004, “Për veprimtarinë e Inspektoriatit të Mjedisit” bën publike në një vend të dukshëm, në mjediset e institucionit, planet e veprimit që do ndërmerri gjatë vitit. Gjithashtu, sipas pikës 16 bën publike raportin e mbajtur gjatë kontrollit të subjekteve që janë pajisur me leje mjedisi, rezultatet e kontrollit dhe masat e marra kundrejt atyre subjekteve.

- Ministrinë e Qeverisë Shqiptare, fusha e të cilave takon me mjedisin (Ministrinë e Linjës) . Të gjitha Ministrinë në mbështetje të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 202, dt. 16.12.2005, kanë të publikuar në faqet e tyre dokumenta që i shërbejnë dhe publikut si informacion mjedisor. Gjithashtu pikat e kontaktit të zyra të marrëdhënieve me publikun përdoren nga SIPTI për të marrë informacionin mjedisor që ato disponojnë.

- Struktura mjaft të rëndësishme që zotërojnë informacion mjedisor janë dhe organet e qeverisjes vendore. Bashkitë e pothuajse të gjithë vendit kanë faqe interneti aktive, si Bashkia e Tiranës (www.tirana.gov.al), Bashkia e Shkodrës (www.bashkiashkoder.gov.al), Bashkia Kukës (www.bashkiakukes.com) Bashkia Korçë (www.bashkiakorçe.gov.al), Bashkia Fier (www.bashkiefier.com), Bashkia Pogradec (www.bashkiapogradec.gov.al), Bashkia Vlorë (www.bashkiavlore.org); këto faqe mund të shërbejnë si burim i rëndësishëm informacioni.

- Strukturat informuese të publikut për çështje mjedisore po mbështeten dhe nga tre Qendrat e Informacionit të Aarhus (AIC) të vendosura në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër. Këto qendra janë krijuar në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit midis MMPAU-së me Prezencën e OSBE, “Për bashkëpunimin në fushën e informacionit mjedisor dhe zbatimin e kërkesave të Konventës së Aarhus-it në Shqipëri” nënshkruar në Korrik të 2006. Qendra e Aarhusit në Tiranë ndodhet në MMPAU pranë Sektorit të Informimit të Publikut. Qendrat ndihmojnë në shpërndarjen e informacionit mjedisor në rrugë më të shpejtë drejt publikut në zonat që ato mbulojnë. Informimi

bëhet në mënyra të ndryshme, si nëpërmjet publikimeve, nëpërmjet faqes së tyre të internetit www.aic.org.al, apo nga kontaktet me mediat në zonat që ato mbulojnë.

AIC janë gjithashtu të përfshira në trajnimin e autoriteteve lokale, duke i ndërgjegjësuar dhe detyruar këto autoritete të përmbushin detyrimet e tyre ligjore kundrejt Konventës së Aarhusit. Nëpërmjet bordeve këshilluese që ato kanë, shërbejnë dhe si një strukturë lidhëse midis pushtetit qendror, lokal dhe OJF-ve mjedisore e publikut të interesuar në zonën që ato mbulojnë gjeografikisht.

Në vitin 2010 filloi zbatimi i projektit të Bankës Botërore “Për forcimin dhe implementimin e Konventës së Aarhusit”, i cili në një nga komponentet e tij synon të realizojë lidhjen në rrjet të Sektorit të Informimit të Publikut dhe IT dhe Qendrës së Aarhusit Tiranë me ARM-të, gjë që do të sigurojë informacion në kohë reale.

Siti i internetit www.dogana.gov.al i krijuar në vitin 2006, është aktiv në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Informacioni në këtë web-sit është i plotë me procedurat doganore, tarifatat, borxhin, legjislacionin, akte normative, statistika, organizimin e administratës doganore dhe informacione të tjera që përditësohen vazhdimisht nga Drejtoria e Kompjuterizimit me kërkesë të Drejtorive të tjera në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Një nga objektivat kryesore të Administratës së Doganore Shqiptare (ADSh) është të zhvillojë automatizimin e procedurave doganore dhe një sistem të integruar IT, i cili mbështet plotësisht strategjinë e administratës doganore shqiptare në përputhje me standardet ndërkombëtare. Për këtë arsye dhe në kuadrin e procesit të modernizimit të përgjithshëm të Doganave, ADSh migroi nga sistemi i përpunimit të deklaratave ASYCUDA ++, në versionin e fundit të këtij aplikacioni ASYCUDAWorld. Ky sistem i integruar i IT-së ASYCUDAWorld, i cili është bazë e plotë për E-doganat, është i zbatuar në 19 pika doganore.

Në Administratën Doganore Shqiptare analiza e riskut dhe ndërtimi i profileve të riskut për kategori të ndryshme mallrash, bazohet në informacionin e marrë nga sistemi informatik AW, databazat e inteligjencës si dhe informacion nga drejtoritë/ departamentet e tjera të administratës doganore. Në sistemin doganor veprojnë profile risku sigurie, keqklasifikimi, sasi, marke, origjine, akcize, procedure, vlerë, kompanish, etj.

Në kuadër të projektit ‘Forcimi i kapaciteteve për implementimin e SAICM në Shqipëri’ është krijuar websiti www.chemicals.al si një mjet për shkëmbimin e informacionit për menaxhimin e kimikateve

7.6 Vlerësimi

Instrumentet ligjore kërkojnë sigurimin e informacionit dhe shkëmbimin e tij në disa kontekste. Baza e plotë ligjore, aktet ligjore në proces diskutimi publik, dokumentat strategjike, projektet, raportet, dhe informacioni për shërbimet e ofruara nga ministrinë sic janë licencat, certifikatat, janë potencialisht të disponueshme në internet në websitet e ministrive përgjegjëse. Disa të dhëna sidomos ato për import-eksportet janë bërë publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, të dhënat shtetërore për shëndetin janë publikuar nga INSTAT-i. Disa të dhëna si p.sh të dhëna për përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, substancat aktive të regjistruara për mbrojtjen e bimëve dhe produktet e tyre publikohen periodikisht; sasitë e kimikateve të magazinuara mundësohen me anë të kërkesave të ministrive të interesuara. Ministria e Shëndetësisë publikon në websit listën e përditësuar të përbërësve aktivë të lejuar për produktet biocide dhe dokumentat e nevojshme për autorizimin e procedurave.

Dekada e fundit ka shënuar një revolucion në lidhje me bashkëpunimin e institucioneve publike, instituteve kërkimore dhe praktikisht çdo zyre në Tiranë ka tashmë akses në informacionin e

publikuar në internet. Situata është më problematike në rrethe ku jo cdo zyre ka mundësinë e përdorimit të internetit.

Informacioni për publikun në çështjet mjedisore në Shqipëri bazohet në Ligjin Nr. 8672 dt. 26.10.2000 “Për aderimin e Shqipërisë në Konventën e Arusit” gjë që e bën Konventën e Aahrusit një akt normativë dhe rrjedhimisht implementimin e tij të detyrueshëm.

Rrjeti Institucional Mjedisor dhe Sektori i Informacionit të Publikut dhe Teknologjisë së Informacionit (SIPTI) në MMPAU janë institucione dhe rrjete publike të cilat mbledhin informacion dhe informojnë publikun për mjedisin. Disemini i informacionit bëhet në rrugë pasive me anë të kërkesave me shkrim drejtuar SIPTI-it ose në menyra aktive me anë të publikimeve mujore të Buletinit Elektronik Mjedisor, publikimit vjetor të Raportit Shtetror për Mjedisin, përgatitja dhe dorëzimit të raportit dyvjeçar shtetror mjedisor nga Agjencitë Mjedisore Rajonale sipas rretheve, ëëbsitet e komunave etj. Strukturat për informacion publik për çështje mjedisore janë mbështetur nga tre Qendra Informacioni të Aahrusit (QIA) në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër.

Megjithatë, në disa raste informacioni është i varfër dhe me mungesa për shkak të mungesave në personel, kapacitete dhe infrastrukturë siç është mungesa e një baze të dhënash dhe një qendre shkëmbimi informacioni etj. Mungesa e një Zyre Kimikatesh, e cila sipas Ligjit 0108/2003 do të ketë detyrimin për mbledhjen e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit, është një mangësi e madhe.

Shqipëria nuk ka akoma një **qëndër informacioni për helmimet (Qendër Helmimesh).**

Ka një mungesë literature, informacioni bazë dhe diseminimi informacioni që lidhet me një sistem të dobët informacioni në vend. Kjo situatë është pasojë e buxhetit të kufizuar për literaturën përkatëse si dhe përfaqësimi i kufizuar i vendit në institucionet e jashtme të lidhura me kimikatesh.

Në kuadër të projektit ‘Forcimi i kapaciteteve për implementimin e SAICM në Shqipëri’ është krijuar websiti www.chemicals.al si një mjet për shkëmbimin e informacionit për menaxhimin e kimikateve. Në këtë websit mund të gjenden lehtësisht i gjithë legjislacioni mbi kimikatesh dhe informacione të tjera të lidhura me to. Një bazë të dhënash për biocidet do të shtohet në websit brenda 2012; kjo bazë të dhënash do të ketë kapacitetet për t’u pasuruar me klasa të tjera kimikatesh.

Tabela 7. E: Prioritetet dhe veprimet e mundshme mbi menaxhimin, aksesin dhe përdorimin e informacionit

Çështjet prioritare	Niveli kapaciteteve	Përmbledhje e anëve të forta, të dobëta dhe nevojave për kapacitete	Veprimet e mundshme	Aktorët e interesuar
Mbledhja dhe shpërndarja e informacionit	I ulët	Mungojnë kapacitetet e mjaftueshme në institucionet që duhet të mbledhin dhe shpërndajnë informacionin; Mungesë e regjistrave të kimikateve.	Ngritja e një zyre për menaxhimin e kimikateve; Krijimi i regjistrave të kimikateve; Zhvillimi i bazave të të dhënave mbi kimikate; Shtimi dhe detyrimi i kërkesave ligjore për raportim; Rritje e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse	MMPAU Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve MSh MPÇSShB Profesionistët dhe OJF shëndetësore dhe mjedisore.
Helmimet nga kimikate	I ulët	Mungon një qendër informacioni mbi helmimet (Poison Center).	Ngritja e një qendre për helmimet “Poison Center”; Forcimi kapaciteteve.	Popullsia, MSh, Qendra e Toksikologjisë Klinike QSUT, OBSH
Literatura	Mesatar	Mungesa në literaturë, informacione bazë si dhe në shpërndarjen e tyre.	Rritje e buxhetit	Specialistët e Shëndetit dhe Mjedisit,

KAPITULLI 8: INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Ky kapitull përshkruan infrastrukturën teknike dhe kapacitetet e laboratoreve kimike shqiptare, të cilat janë klasifikuar në dy grupe. Në grupin e parë futen laboratorët që varen nga ministritë (Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit). Në grupin e dytë futen laboratorët kërkimore-shkencore të universiteteve publike e jo-publike (Universiteti i Tiranës, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Shkodrës, etj.).

Në këtë kapitull, për të gjithë laboratorët e të dy grupeve përshkruhen me hollësi llojet e analizave kimike dhe fiziko-kimike që ato kryejnë, bashkë me emrat e pajisjeve analitike bashkëkohore, që përdoren për këtë qëllim. Të gjithë këto të dhëna mbi infrastrukturën teknike, bashkë me emrat, adresat, si edhe me gjendjen e akreditimit, janë paraqitur në dy tabela të veçanta, përkatësisht, për laboratorët e analizave kimike rregullatore dhe për ato të monitorimit dhe analizave.

Është trajtuar menaxhimi i cilësisë në laboratorët kimike publike dhe vihet në dukje numri i kufizuar i atyre të akredituara ose të certifikuara. Në përgjithësi, në Shqipëri nuk ekziston një program kombëtar për përmirësimin e cilësisë së analizave, që është një domosdoshmëri për përmirësimin e performancës laboratorike dhe për një përfshirje më të mirë në programe të ndryshme shkencore dhe/ose monitoruese kombëtare dhe ndërkombëtare. Ka një nevojë urgjente për futjen e metodave standarte (p.sh. ISO) në të gjithë laboratorët, për vendosjen e një sistemi të menaxhimit të cilësisë dhe për akreditimin e laboratoreve. Edhe menaxhimi teknik i laboratoreve shqiptare nuk është në nivelin e duhur. Në disa prej tyre, ka mungesa reagentësh, materialeve të referencës të certifikuara, standardeve dhe të shërbimit/servisit të rregullt të pajisjeve dhe instrumentave. Gjithashtu, mungojnë fondet për trajnimin e rregullt të stafit të laboratoreve. Laboratorët, në përgjithësi, nuk kanë procedura të shkruara për menaxhimin e lëndëve kimike/të dëmshme dhe për hedhjen e tyre. Shpesh, ato nuk sigurojnë kushte mjedisore të përshtatshme për shëndetin e personelit.

Në fund të kapitullit janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur prioritetet kryesore të përmirësimit të infrastrukturës teknike, bashkë me veprimet e nevojshme dhe aktorët e interesuar.

8.1 Përmbledhje e infrastrukturës laboratorike

Shumica e laboratorëve fiziko-kimike janë laboratorë analizues (rregullatorë) dhe pak laboratorë merren me monitorime të treguesve të ndryshëm të ndotjes në mjedis apo në ushqime. Në tabelat 8.A dhe 8.B jepen të dhëna mbi infrastrukturën laboratorike analizuese dhe monitoruese, mbi kapacitetet e tyre analitike dhe gjendjen e akreditimit.

8.2 Fusha të tjera të infrastrukturës teknike

Në Republikën e Shqipërisë operojnë shumë laboratorë kimikë e fiziko-kimike, të cilët duhet të përfshihen në menaxhimin e kimikateve. Ata kryejnë analiza të cilësisë së kimikateve, identifikimin e substancave të panjohura, analiza të mbetjeve të rrezikshme dhe të dëmshme për shëndetin dhe mjedisin, si dhe bëjnë monitorime të ndryshme të kimikateve në mjedis (në ujëra, tokë, sedimente, ajër), në ushqime, etj.

Tabela 8.A: Infrastruktura laboratorike për analiza kimike rregullatore

Emri/ përshkrimi i laboratorit	Vendndodhja/ varësia	Pajisjet/ aftësitë analitike të pranishme	Akredituar (nëse po, nga kush)	Çertifikuar GLP (po / jo)	Qëllimi
Laboratori i Kimisë Analitike Instrumentale	IShP – Tiranë, departamenti i shëndetit dhe mjedisit	GC, GC-MS, HPLC, AAS me furrë dhe flakë, pajisje hidrurë, spektrofotometër UV-Vis	JO	JO	Përcaktim i mbetjeve të pesticideve klororganike e fosfororganike, PCBve, nënprodukte klorinimi në ujë, PAH, metale të rënda në ujë, në toka, në sedimente, në ushqime, në ajër
Laboratori i Kimisë së Ujrave	IShP – Tiranë, departamenti i shëndetit dhe mjedisit	pH, spektrofotometër DR 2000, aparat për NBO, konduktometër,	JO	JO	Analizat fiziko -kimike të ujërave të pijshëm, sipërfaqësore, nëntokësore, derdhjeve industriale, ujit të ambalazhuar, ujrave banjatore.
Laboratori i Kimisë Ushqimore	IShP – Tiranë, departamenti i shëndetit dhe mjedisit	pH metër, spektrofotometër UV-Vis, HPLC me detektor fluoeshence, aparat Kjeldahl, polarimetër, refraktometër, centrifugë Gerber etj.	JO	JO	Analiza të cilësisë së ushqimeve, azoti proteinik, nitrate, nitrite, aciditet, sheqerna, lëndë e thatë
Laboratori i Jodurisë	IShP – Tiranë, departamenti i shëndetit dhe mjedisit	Spektrofotometër UV-Vis, peshore analitike, Vortex, etj	JO	JO	Analizat e jodit në urinë
Laboratori Paraklinik Toksikologjik	IShP – Tiranë, departamenti i shëndetit dhe mjedisit	Spektrofotometër UV-Vis	JO	JO	Përcaktimi i treguesve toksikologjikë tek punonjësit e metalurgjikut
Laboratori i Histaminës	ISUV – Tiranë	HPLC	JO	JO	Kontrolli i histaminës në peshk të përpunuar dhe të freskët
Laboratori i Analizave të Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve (PMB)	ISUV - Tiranë	GC-MS, LC-MS; UPLC; GC(ECD-NPD), analizator konduktometrik, titullator, spektrofotometër UV-Vis	JO	JO	Analiza cilësore të produkteve të mbrojtjes së bimëve (PMB)
Laboratori i	Fakulteti i Shkencave	GC-FID dhe GC-ECD, HPLC-UV,	JO	JO	Analiza e pesticideve, PCB-ve,

Emri/ përshkrimi i laboratorit	Vendndodhja/ varësia	Pajisjet/ aftësitë analitike të pranishme	Akredituar (nëse po, nga kush)	Çertifikuar GLP (po / jo)	Qëllimi
Analizës Organike Instrumentale	Natyrore, UT	spektrofotometër UV-Vis			hidrokarbureve alifatike e aromatike, BTEX, klorbenzeneve, vajrave esenciale, etj.
Laboratori i Kimisë Analitike	Fakulteti i Shkencave Natyrore	SAA, spektrofotometra UV-Vis, furrë me mikrovalë, DTA, titrimetra e pH-metra automatikë, electrochemical workstation	JO	JO	Metalet e rënda, nutrientët dhe metaltioninat
Laboratori i Qendrës së Fizikës së Aplikuar dhe Bërthamore	Fakulteti i Shkencave Natyrore, UT	SAA me furrë dhe flakë	JO	JO	Metale të rënda
Laboratori i Kimisë	Laboratori Qendror i Ushtrisë	GC-MS, HPTLC, AAS me flakë dhe furrë dhe pajisje hidrurë, spektrofotometër UV-Vis, analizator squfuri, APD2000, multiRAE , LUDLUM për rrezatimet β dhe γ	PO nga DPA Ka sistem cilësie sipas ISO 17025		Analiza të LHL-ve, lëndëve eksplozive, metaleve të rënda, gazeve toksike CO, VOX, H ₂ S, karburanteve
Laboratori Kimik pranë TEC-Ballsh	Ballsh	Spektrofotometër, universal, fotometër	JO	JO	Analizat e ujit
Laboratori Kimik	Firma Kurum Metalurgjiku, Elbasan	Gaskromatograf, spektrofotometër etj	JO	JO	Analiza të metaleve ferrozë
Laboratori Fiziko-Kimik	Instituti i Teknologjisë. Nxjerrëse e Përpunuese të Mineraleve, Tiranë	AAS, Spekol 21, spektrofotometër universal, fotometër.	JO	JO	Analiza të mineraleve
Laboratori Kimik Doganor	Drejtoria e Përgjithshme e	Gaz kromatograf, HPLC, AAS dhe aparat numër oktani IROX 2000,	Po përgatiten	JO	Analiza të të gjithë mallrave (ushqime, tekstile, industriale, hidrokarbure, plehra

Emri/ përshkrimi i laboratorit	Vendndodhja/ varësia	Pajisjet/ aftësitë analitike të pranishme	Akredituar (nëse po, nga kush)	Çertifikuar GLP (po / jo)	Qëllimi
	Doganave, Tiranë	aparaturë për përcaktimin e squfurit në gase multi EA.	për aplikim		kimike, pesticide, etj) që futen nga importi në RSH
Laboratori Kimik i Repartit të Inspektim-Shpëtim të Minierave	Tiranë	Pajisje për monitorimin e substancave të rrezikshme në ajër	JO	JO	Analiza të ndotjes së ajrit, ujit
Laboratori kimik	Instituti i Hidrometeorologjisë Tiranë	AAS, gaz- kromatograf, etj.	JO	JO	Analiza të ndotjes së ajrit, ujit
Laboratori i Kontrollit të Naftës dhe Gazit	Inspektorati Qendror Teknik, Tiranë	Spektrofotometër IR, aparat për përcaktimin e pikës së flakërimit, viskozimetra, etj.	PO, DPA	JO	Analiza të treguesve të naftës: S, H ₂ S në gazin e lëngshëm, pikë flakërimi, korrozion, komponime të oksigjenuar, etj.
Laboratori i Kimisë dhe Pesticideve	UBT, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve	HPLC –DAD (Diode Array Detector) dhe fluoreshcencë, GC (FID, ECD, NPD), aparat Kjeldahl, aparat NBO, NKO.	JO	JO	Analiza fizike të formulimeve të pesticideve, pH, konduktivitetin, emulgueshmërinë suspensibilitetin. Analiza të mbetjeve të pesticideve që janë në proces regjistrimi dhe që përdoren tani në bujqësi në mostra toke, bime dhe uji. Analiza fizike - kimike të ujërave për vaditje: pH, konduktivitet, N- total, NBO, NKO etj. Analiza fizike - kimike të tokave bujqësore pH, konduktivitet, lëndë organike, humus, hiri, azoti total (Kjeldal)
Laboratori i mjedisit	UBT, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Departamenti i Agromjedisit dhe	Absorbër atomik dhe spektrofotometër	JO	JO	Analiza të ujërave: pH, konduktiviteti, nutrientët, NBO (nevoja biokimike për oksigjen) dhe NKO (nevoja kimike për oksigjen), metalet e rënda. Analizat e tokave për pH, konduktivitet,

Emri/ përshkrimi i laboratorit	Vendndodhja/ varësia	Pajisjet/ aftësitë analitike të pranishme	Akredituar (nëse po, nga kush)	Çertifikuar GLP (po / jo)	Qëllimi
	Ekologjisë				lënda organike, hiri, metalet e rënda.
Sektori i laboratorit analitik	QTTB (Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore) Fushë - Krujë	pH-metër, spektrofotometër, konduktometër, absorber atomik, aparat distilimi për azotin	Është në proces akreditimi, nga një bashkëpunim italiano-shqiptar	Në pritje të marrjes së vlerësimit	Analizohen mostra të tokave, ujërave për ujë, bimëve dhe plehrave kimike.
Laboratori fiziko-mekanik dhe kimik i analizave të tekstilit dhe lëkurës	Fakulteti i Tekstilit, UPT, Tiranë		PO	PO	Fibra Tekstile dhe lëkure
Laboratori i firmes “Kibe”	KIBE Sh.p.k. autostrada TR-Dr Km 13		PO nga DPA		Lëndë të para inorganike, materiale ndërtimi
Laboratori i firmës “EHW”	Tiranë	Mikroskop, termostate për bakteriologji, etj.	Në proces akreditimi nga DPA		Mikrobiologjia e produkteve të mishit
Laborator kërkimor shkencor	Universiteti “A. Xhuvani”, Elbasan		PO nga DPA		Beton dhe çelik
REDI-SH sh.p.k	Kombinat, Tiranë		PO nga DPA		Analiza mikrobiologjike ushqimore
Laboratori Toksikologjik	QSUT Klinika e sëmundjeve profesionale	Centrifuge, termostate, furrë, spekol, spektrofotometër	JO	JO	Kryen analiza për sëmundjet profesionale nga helmimet në punë

Tabela 8.B: Infrastruktura laboratorike për monitorim dhe analiza

Emri/ përshkrimi i laboratorit	Vend ndodhja	Pajisjet/ aftësitë analitike të pranishme	Akredituar (nëse po, nga kush)	Qëllimi kryesor dhe substancat kimike të analizuar	Numri i mostrave/vit (thuj cilën substancë)
Laboratori i cilësisë së ajrit	IShP – Tiranë, Departamenti Shëndeti dhe Mjedisi	Peshore analitike, analizator (stacion) automatik, pajisje për marrje mostrash	JO	Kontroll i cilësisë së ajrit, analiza të ajrit për PM ₁₀ , SO ₂ , NO _x , NO, NO ₂ , CO, BTX, PM ₂ , blozë, Pb, grimca totale	960 mostra / vit për grimca totale, blozë, PM ₁₀ , NO _x në 5 qytete, dhe stacioni i monitorimit të vazhduar.
Laboratori i biotoksinave	ISUV – Tiranë	HPLC	PO, ACREDIA (Agjencia Italiane e Akreditimit)	Plani kombëtar i mbetjeve (PKM), biotoksinat ASP, PSP, DSP në Molusqe dhe produkte peshku	144 mostra/vit nga 3 stacione monitorimi për 3 lloj toksinash
Laboratori i mbetjeve të medikamenteve veterinarë	ISUV – Tiranë	ELISA, HPLC, GC, LC-MS, LC-MS/MS, GC-MS/MS	JO	PKM, mbetjet e medikamenteve veterinarë (antibiotikë, hormone etj.) në produktet shtazore	2500 mostra /vit produkte shtazore për antibiotikë dhe hormone
Laboratori i analizave të metaleve të rënda	ISUV – Tiranë	AAS me furrë	Ka filluar procedurat për akreditim, nga DPA	PKM, kontrolli i molusqeve, metalet e rënda, si: Pb, Cd, Cr, Hg etj. në ujin e detit si dhe në produktet shtazore	24 mostra /vit
Laboratori i mbetjeve të pesticideve në produktet joshtazore	ISUV – Tiranë	GC, GC-MS/MS	Ka filluar procedurat për akreditim nga DPA	PKM, kontrolli i molusqeve, mbetjet e pesticideve klororganike dhe PCB-ve në produktet shtazore	12 mostra /vit
Laboratori i kimisë	Laboratori Qendror i Ushtrisë	GC-MS, HPTLC, AAS me flakë dhe furrë, pajisje hidrurë, spm UV-Vis, analizator squfuri APD2000, multiRAE, LUDLUM për rrezatimet	PO nga DPA është në proces rifreskimi të akreditimit	Monitorim mjedisi për tre parametra	720 mostra / vit

Emri/ përshkrimi i laboratorit	Vend ndodhja	Pajisjet/ aftësitë analitike të pranishme	Akredituar (nëse po, nga kush)	Qëllimi kryesor dhe substancat kimike të analizuara	Numri i mostrave/ vit (thuj cilën substancë)
		β dhe γ			
Laboratori fiziko-kimik	Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve	Spektrofotometër UV-Vis, AAS me furrë dhe flakë, GC me dedektor ECD dhe FID, oksimetër, multimetër	PO, nga DPA për 8 parametra	Monitorim i ujërave sipërfaqësore pH, NKO, NBO, nutrientët, oksigjeni i tretur, lëndët në pezulli, konduktiviteti, TDS	140 mostra / vit

8.2.1 Laboratorët në varësi të ministrive

Laboratorët në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh): përfshijnë laboratorët e IShP, të cilët janë laboratorë reference për sistemin e shëndetit publik, laboratorët e Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave (QKKB), laboratorët e Drejtorive të Shëndetit Parësor (DShP) të rretheve dhe laboratorët e qendrave spitalore.

Laboratorët e qendrave spitalore merren me analizat klinike-biokimike, toksikologjike dhe bakteologjike në lëngjet biologjike.

Laboratorët e Institutit të Shëndetit Publik (IShP) analizojnë një gamë më të gjerë të treguesve fiziko kimikë (rreth 20 parametra) të cilësisë së ujërave të pijshëm, të ujërave të shkarkimeve industriale, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Gjithashtu në laboratorët e IShP analizohen: mbetjet e pesticideve në ujëra dhe toka/sedimente, si dhe në ushqime e lëngje biologjike; metalet e rënda në ujë, në toka/sedimente, në gjak, në serum, në ushqime, në ajër, etj.; hidrokarburet policiklike aromatike në ujëra, toka e sedimente; substancat e ekstraktueshme në hekzan ose HEM (vaj dhe graso) në ujë dhe toka; produktet polare në vajra; elementët toksikë në gjak; jodi në urinë; PM₁₀, PM₂; SO₂, bloza, NO_x, NO, NO₂, CO, grimca totale; BTX në ajër, etj. Laboratorët e IShP janë kryesisht laboratorë rregullatorë, por ka dhe laboratorë monitorues siç është Laboratori i Cilësisë së Ajrit dhe Laboratori i Mikrobiologjisë së Ujërave.

Laboratorët kryesorë fiziko-kimikë të IShP janë: Laboratori i Kimisë Analitike Instrumentale, Laboratori i Kimisë së Ujërave, Laboratori i Kimisë së Ushqimeve, Laboratori i Cilësisë së Ajrit, Laboratori Paraklinik Toksikologjik, Laboratori i Jodit.

Këta laboratorë janë të pajisur me mjetet matëse dhe përpunuese kryesore të punës për një laborator, si psh: spektrofotometra UV-VIS, gaz kromatografë me dedektor ECD, dhe TCD, GC-MS, HPLC, spektrometër të absorbimit atomik me furrë dhe flakë, konduktometër, spektrofotometër për lexim direkt për analizat e ujërave, aparat për përcaktimin e NBO-5, klorimetër, oksimetër, pH-metër etj., stacione të monitorimit automatik të ajrit, etj.

Laboratorët e Qendrës Kombëtare të Kontrollit të Barnave (QKKB) merren me kontrollin cilësor dhe analizat fiziko-kimike të barnave që hyjnë në Republikën e Shqipërisë. Ata janë të pajisur me spektrofotometra UV-Vis dhe IR, pH-metra, HPLC, Dissolutest, konduktometër, aparat Kofier, aparat fortësie, polarimetër, toksinometër.

Laboratorët e Drejtorive të Shëndetit Publik (DShP) të rretheve janë të pajisur pjesërisht me spektrofotometra UV-Vis për kontrollin e cilësisë së ujërave, por jo të gjitha rrethet dhe qarqet janë të plotësuar me aparaturat e nevojshme për kontrollin e parametrave të dëmshëm për shëndetin. Këtë vit ministria e shëndetësisë ka marrë masa për pajisjen e laboratorëve kryesorë të 12 qarqeve me mjete dhe aparatura të nevojshme për analizat fiziko-kimike të ujërave të pijshëm. Laboratorët e DShP-ve mbulojnë analizat kimike të ujërave të pijshëm për treguesit kryesorë fiziko-kimikë, si: pH, fortësia, klori i lirë, nitratet, nitritet, amonjaku, fosfatet, kripshmëria, si dhe treguesit bakteriologjikë. Gjithashtu këta laboratorë merren edhe me analizat e ndotjes së ajrit.

Laboratorët në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK) përfaqësohen nga laboratorët e Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV), të cilët merren në kuadrin e planit kombëtar të mbetjeve, me monitorimin e mbetjeve të pesticideve klororganike dhe PCB-ve në produktet shtazore, analiza të metaleve të rënda (Pb, Cd, Cr, Hg) në ujë deti dhe në produktet shtazore, analiza të mbetjeve të medikamenteve veterinarë (antibiotikë dhe hormone) në produktet shtazore, analiza të toksinave detare (PSP,

DSP, ASP) në peshq dhe molusqe etj, analiza cilësore të produkteve të mbrojtjes së bimëve (PMB), etj.

Laboratorët kryesorë fiziko-kimikë të ISUV janë: laborator i biotoksinave, laborator i mbetjeve të medikamenteve veterinarë, laborator i metaleve të rënda, laborator i mbetjeve të pesticideve në produktet shtazore, laborator i analizave të PMB-ve, laborator i histaminës, etj. Këto laboratorë janë të pajisur me aparatura moderne të përpunimit dhe matjes/analizimit të treguesve të mësipërm, si psh: spektrofotometra, HPLC–UV dhe fluoreshencë, HPLC-MS, HPLC-MS/MS, GC-MS, GC-MS/MS, absorber atomik me furrë dhe flakë, furra disgregimi me mikrovalë, etj. Laboratorët e ISUV janë akredituar për disa tregues nga ACREDIA (Agjencia Italiane e Akreditimit) dhe janë në proces akreditimi për disa tregues të tjerë në produktet shtazore me DPA.

Laboratorët e ISUV janë laboratorë reference kombëtare për sa i përket sigurisë ushqimore (metaleve të rënda, mbetjeve të barnave veterinarë, pesticideve, toksinave, etj.), shëndetit të kafshëve, kontrollit cilësor të barnave veterinarë dhe të produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe kontrollit të ushqimeve.

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) në Fushë-Krujë ka në strukturën e vet sektorin e laboratorit analitik, ku analizohen tokat, ujërat për ujitje, bimët dhe plehrat kimike. Ky laborator është i pajisur me spektrofotometër, konduktometër, absorber atomik, aparat distilimi për azotin, etj.

Laboratorët në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU)

Laboratorët kimikë të mjedisit përfaqësohen nga laboratorët fiziko kimike të Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve (AMP) dhe Laboratori i Monitorimit të Liqenit të Ohrit në Pogradec. Këta laboratorë merren me analizat fiziko kimike të ujërave sipërfaqësore dhe me përcaktimin e mbetjeve të metaleve të rënda në ujëra, në toka dhe në ajër. Laboratorët kimike të Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve bëjnë monitorimin e ujërave sipërfaqësore për treguesit kryesorë fiziko-kimikë (pH, NKO, NBO, nutrientët, oksigjeni i tretur, lëndët pezull, konduktiviteti, TDS, etj.) në 8 qytete kryesore të vendit, kurse laborator i Pogradecit bën monitorimin e ujit në liqenin e Ohrit. Edhe këta laboratorë janë të pajisur me aparatura bashkëkohore, si: spektrofotometra UV-VIS, absorber atomik me furrë dhe me flakë, gaz kromatograf me dedektor ECD dhe FID, oksimetër, multimetër, etj. Laboratori i AMP tashmë është i akredituar për disa tregues të cilësisë së ujërave. Përmirësime mund të bëhen vetëm për shtimin e stafit, kryerjen e trajnimeve, shtimin e fondeve për laboratorin dhe përditësimin e metodave ISO me variantet më të fundit.

Laboratorët në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes (MM)

Laboratori Qendror i Ushtrisë (LQU) që varet nga Ministria e Mbrojtjes, ka një bazë të mirë teknike instrumentale, si: GC-MS, HPTLC, absorber atomik AAS me flakë e furrë dhe pajisje hidrurë, spektrofotometer UV-Vis, aparat APD2000 (për dedektimin e LHL), konduktometer, pH metër, Multi RAE (për dedektimin e gazeve toksike CO, VOX, H₂S dhe nivelet e O₂), LUDLUM për përcaktimin e niveleve të rrezeve β dhe γ, etj.

LQU merret me analizimin e lëndëve helmuese luftarake, kontrollin e cilësisë së ushqimeve për ushtrinë, analizat e karburanteve, analizat e lëndëve eksplozive dhe monitorim mjedisor. Laboratorët kimike të LQU janë të akredituar nga DPA.

Laboratorët në varësi të Ministrisë së Brendshme (MB)

Këtu hyjnë laboratorët e mjekësisë ligjore dhe të drogave. Laboratorët e mjekësisë ligjore merren me analiza toksikologjike të provave materiale në organet e brendshme të kufomave

(të freskëta, të egzumuara, të kalbëzuara) dhe në lëndë biologjike (gjak, urinë), me analiza biologjike (gjak, urinë), prova materiale (fije floku, etj). Këto laboratorë kanë procedurë standarde të punës, por edhe këta kanë problematikën e zakonshme të furnizimit me materiale të çertifikuara dhe probleme të trajnimit të stafit analitik.

Laboratorët në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE)

Nën varësinë e kësaj ministrie janë disa laboratorë fiziko-kimikë: Laboratori i analizave kimike të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh), i cili merret me përcaktimin e metaleve me ndihmën e teknikës së SAA në minerale të ndryshme, dhera, rëra, etj. Gjithashtu ky laborator merret edhe me monitorime të cilësisë së ujërave nëntokësore e sipërfaqësore, nëpërmjet përcaktimit të treguesve kryesorë fiziko-kimikë, me analiza mjedisore në dhera, rëra, etj. Laboratorët e këtij instituti nuk janë të akredituar, por konsiderohen si referencë për linjën.

Në varësi të METE-s janë edhe:

- Laboratori kimik i Furrës Kurum (i privatizuar)
- Laboratori kimik i Deka Co. (i privatizuar)
- Laboratori kimik i Uzinës së Kablllove në Shkodër, (i privatizuar)
- Laboratori fiziko-kimik i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), ish-Instituti të Studimeve dhe Projektmeve të Teknologjisë së Mineraleve, Tiranë
- Laboratori kimik i Repartit të Inspektim-Shpëtim Minierave, Tiranë
- Laboratori i kontrollit analitik të produkteve të naftës në Uzinën e Përpunimit të Thellë të Naftës Ballsh (i privatizuar)
- Laboratori kimik pranë TEC-Ballsh

Laboratorët në varësi të Ministrisë së Financave (MF)

Këtu futet Laboratori i Doganave, i cili është i pajisur me mjete bashkëkohore të analizave si GC, HPLC, AAS dhe aparat numër oktani (për analiza hidrokarburesh), ku analizohen të gjithë mallrat (ushqime, tekstile, industriale, hidrokarbure, plehra kimike, pesticide etj) që futen nga importi në dogana për klasifikim për efekt fiskal. Laboratori doganor nuk është i akredituar, por ka filluar procedurat e akreditimit për disa tregues.

Laboratorët në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (MPPT):

Nga kjo ministri varet Departamenti i Laboratorëve i Institutit të Ndërtimit. Laboratori kimik i këtij departamenti është i pajisur me mjete bazë të përpunimit dhe të matjeve për metodat kimike klasike, si: pH-metra, peshore analitike, furrë mufel, termostat, etj., dhe kryen analizat kimike të produkteve të ndërtimit, si: përcaktimi i sulfatëve, i klorureve, i humbjeve në kalcinim, i mbetjes së patretshme, i oksideve të kalciumit dhe magneziumit, i hekurit, i aluminit, etj.

8.2.2 Laboratorët kërkimorë-shkencorë të universiteteve (publike dhe jopublike)

Në sistemin tonë arsimor universitetet janë të pajisura me laboratorë fiziko-kimikë të pajisur me mjete pune dhe pajisje matëse dhe përpunuese, të cilat analizojnë parametra të ndryshëm fiziko-kimike. Këto laboratorë janë në shërbim të zhvillimit të procesit mësimor dhe punës kërkimore shkencore të stafit akademik. Në shumë nga institucionet shqiptare të arsimit të lartë funksionimi i këtyre laboratorëve është tashmë një traditë dhjetra vjeçare, ndërsa në disa të tjera, përfshirë dhe shkollat e larta jopublike, ato s'kanë shumë vite që janë ngritur.

Laboratorët kërkimorë-shkencorë të shkollave të larta publike:

Laboratorët e Universitetit të Tiranës: Laboratorët fiziko-kimikë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FShN), përveç aktivitetit didaktik, merren edhe me tema studimore dhe projekte për matjen dhe përcaktimin e mbetjeve të pesticideve, të PCB, të PAH, të HK, të BTEX, të klorbenzeneve, vajrave esenciale, metaleve të rënda, metaltioninave, nutrientëve, etj. Kryesisht me këto analiza merren Laboratori i analizës organike instrumentale, laboratorit i kimisë analitike dhe mjedisore dhe laboratorit i Qendrës së Fizikës së Aplikuar dhe Bërthamës. Ato disponojnë aparatura si: GC-FID, GC-MS, GC-ECD, SAA, spektrofotometra UV-VIS, furra me mikrovalë, DTA, titrimetra e pH-metra automatike, HPLC-UV, etj. Numri i analizave të kryera në këtë institucion në matrica të ndryshme është relativisht i vogël, për faktin se nuk ka një buxhet të planifikuar për kryerjen e tyre dhe fondet sigurohen vetëm nëpërmjet projekteve dhe analizave për të tretët.

Laboratorët e Universitetit Politeknik (UPT): Laboratori i Departamentit të Kimisë në UPT është i pajisur me sisteme për përcaktimin e NKO dhe NBO, gaz analizator, spektrofotometër dhe turbidimetër portativ për analiza ujërash, pajisje për përcaktimin e PM₁₀, etj. Laboratori i Departamentit të Tekstilit kryen kryesisht analiza të fibrave tekstile.

Laboratorët e Universitetit Bujqësor të Tiranës: Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) ka disa laboratorë që merren me analiza mbetjesh, por edhe me analiza formulimesh, siç janë: laboratorit i kimisë dhe pesticideve në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve, që merret me analizat e formulimeve të pesticideve, pH, konduktivitetin, emulgueshmërinë. Në këtë laborator kryhen gjithashtu analiza të mbetjeve të pesticideve që janë në proces regjistrimi dhe që përdoren tani në bujqësi në mostra toke, bime dhe uji. Këto analiza kryhen në kuadrin e diplomave të studentëve, tezave Master dhe punimeve të doktoraturave dhe jo për qëllime monitorimi. Kryhen gjithashtu analiza fiziko-kimike të ujërave që përdoren për vaditje, si edhe analiza fizike-kimike të tokave bujqësore, si: pH, konduktiviteti, lënda organike, hiri, azoti total (Kjeldal).

Laboratori i Mjedisit pranë Departamentit të Agromjedisit dhe Ekologjisë merret me analiza të ujërave, si: pH, konduktiviteti, nutrientët, NBO /NKO dhe metalet e rënda. Në këtë laborator kryhen gjithashtu analiza fiziko-kimike të tokave bujqësore, si: pH, konduktiviteti, lënda organike, hiri dhe metalet e rënda.

Laboratorët e Universitetit të Shkodrës: Universiteti i Shkodrës ka laboratorin e absorberit atomik, laboratorin e analizave kimike të ujërave dhe laboratorin e toksikologjisë, të cilat disponojnë përkatësisht SAA, spektrofotometër UV-VIS dhe GC-FID/ECD. Në këto laboratorë kryhen analiza të ujërave për metalet e rënda, fosforin dhe nutrientët, ndotësit klororganikë dhe poliklorbifenilet (PCB).

Laboratorët e Universitetit “Fan Noli”, Korçë: Pajisjet kryesore janë: spektrofotometër UV-Vis, HPLC, GC, Kjeldal, pajisje për ekstraktimin e mostrave. Laboratori kryen këto analiza: alkool metilik dhe etilik në pijet alkoolike, proteinat, azoti në tokë, etj. Është në proces akreditimi për konservantët në pijet jo-alkoolike.

Laboratori Kërkimor Shkencor i Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan kryen analiza të betoneve dhe çelikut dhe është i akredituar.

Laboratorët kërkimorë shkencorë të shkollave të larta jopublike:

Universiteti jo publik “Kristal” ka një bazë të mirë laboratorike me pajisje bashkëkohore si HPLC, GC-FID, spektrofotometër FTIR, dhe UV-Vis Dissolution Test *Equipment* dhe i shfrytëzon këto vetëm për qëllime didaktike dhe diploma studimore.

Universiteti jo publik “Albanian University” ka gjithashtu pajisje bashkëkohore, si HPLC, GS-FID dhe Spektrofotometër UV-Vis për qëllime didaktike.

8.3 Vlerësimi i menaxhimit të infrastrukturës

8.3.1. Menaxhimi i cilësisë

Laboratorët kimikë publikë që operojnë në fusha të ndryshme, në përgjithësi kanë një sistem menaxhimi të cilësisë akoma larg kërkesave bashkëkohore dhe që ka nevojë për përmirësim të vazhdueshëm. Në përgjithësi laboratorët nuk kanë të ngritur një zyrë të sigurimit të cilësisë, me përjashtim të atyre laboratorëve që janë të akredituar dhe që janë në proces akreditimi. Kjo bën që në këto laboratorë të mungojë edhe audit i brendshëm për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së produktit të këtyre laboratorëve. Si rrjedhojë, vetëm një numër i kufizuar i tyre është akredituar ose certifikuar. Laboratorët përdorin si metodat standarde për kryerjen e analizave, psh metoda ISO apo metoda të AOAC, apo të Farmakopeve të ndryshme (për laboratorët mjekësorë) ashtu dhe metoda të vjetra klasike për përcaktimin e treguesve të veçantë. Kjo kushtëzohet dhe aparaturat dhe mjetet e vjetra të punës, që disponojnë laboratorët e ndryshëm. Por tendenca është drejt futjes dhe përshtatjes së metodave ISO. Në përgjithësi në Republikën e Shqipërisë nuk ka një program kombëtar për përmirësimin e cilësisë dhe të sasisë së analizave që kryejnë laboratorët e ndryshëm fiziko kimike, që është i domosdoshëm për një performancë më të mirë laboratorike, cilësi më të mirë të dhënash, produkte më të sigurta dhe përfshirje më të madhe në programe të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare shkencore ose monitorimi.

Laboratorët e kontrollit të molusqeve bivalve në ISUV janë akredituar për biotoksinat detare ASP, PSP, DSP, për fitoplanktonin dhe për mikrobiologjinë e molusqeve (përcaktimin ose numërimin e E. Coli si dhe zbulimin e Salmonella spp.) nga ACREDIA (Agjencia Italiane e Akreditimit)

Laboratori Qendror i Ushtrisë është gjithashtu i akredituar dhe në proces rifreskimi të akreditimit, si rrjedhojë disponon një sistem të sigurimit dhe menaxhimit të cilësisë.

Laboratori i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve është i akredituar për tetë parametra të ujit dhe ka në funksionim një sistem cilësie gjithashtu.

Standardet e punës dhe gjithë metodikat standarde laboratorët e kontrollit të kimikateve i sigurojnë pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS)** (<http://www.dps.gov.al/>), që është organizmi kombëtar i standardizimit në Republikën e Shqipërisë, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE). Ajo përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizatat europiane e ndërkombëtare të standardizimit dhe interesat e të gjithë ekonomisë së vendit në hartimin dhe adoptimin e standardeve evropiane e ndërkombëtare si standarde shqiptare (SSH). Ajo bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera të infrastrukturës së cilësisë në vend, duke u vënë atyre në dispozicion standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fuqi, me objektivin që infrastruktura e cilësisë në Shqipëri të kryejë funksionet e saj sipas këtyre standardeve. DPS-ja është i vetmi institucion publik në Shqipëri i certifikuar sipas standardit ndërkombëtar ISO 9001:2008.

Të gjithë laboratorët e akredituar, me përjashtim të rasteve kur është specifikuar agjenci tjetër akreditimi, kanë bërë akreditim brenda vendit nga **Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA)** (<http://www.dpa.gov.al/>), e cila është i vetmi organizëm kombëtar i akreditimit, i njohur nga qeveria për të vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare kompetencën teknike të organizmave të vlerësimit të konformitetit, që kryejnë aktivitete të tillë si: testim, kalibrim, certifikim dhe inspektim, qofshin në sektorët publikë apo privat, të fushës

vullnetare apo të detyrueshme. Lista e organizmave të akredituar nga DPA (laboratorë, organizma certifikues, organizma inspektues) jepet në adresën

<http://www.dpa.gov.al/sq/organizma-te-akredituara>

Drejtoria e Përgjithshme e Meteorologjisë është në hapat e para të zhvillimit të trajnimeve në meteorologjinë në Kimiktet.

Në kushtet e sotme, duhet punuar për futjen e metodave standarde, si p.sh. ISO, etj. në të gjithë laboratorët, vendosjen e sistemit të kontrollit të cilësisë në çdo laborator dhe duhet synuar akreditimi.

8.3.2 Menaxhimi teknik

Në përgjithësi menaxhimi teknik i laboratorëve nuk është në nivelin e duhur. Në disa laboratorë mungon ose vonon servisi i rregullt i aparaturave, në disa të tjerë pajisja me substanca CRM dhe standarde. Shpesh furnizimi me reagentë dhe kite për laboratorët vohet për shkak të procedurave të tenderimit, në disa laboratorë mungojnë reagentë për shkak të *fondeve të limituara*, kurse në disa të tjerë ka materiale jashtë përdorimit për shkak të mos-llogaritjes së mirë të nevojave vjetore ose të mos rakordimeve të tjera teknike.

Në përgjithësi laboratorët nuk kanë procedura të shkruara për menaxhimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshme si dhe për eliminimin e tyre në vendet e caktuara nga ligji.

Shpesh laboratorët nuk kanë kushtet e duhura mjedisore për sigurimin e shëndetit të stafit punonjës.

Numri i madh i firmave të aparaturave laboratorike që kanë hyrë në RSh e komplikon sigurimin e servisit periodik të instrumenteve dhe krijon nevojën e sigurimit të serviseve të aparaturave me ndihmën e ndonjë kompanie ndërkombëtare që ofron këtë shërbim kompleks. Kështu do të sigurohej në kohë servisi i pajisjeve. Për këtë duhet të rishikohet fondi i përvitshëm nga buxheti për serviset e mjeteve dhe aparaturave që disponojnë laboratorët në bazë të nevojave aktuale dhe pajisjeve që ka çdo institucion.

Nevojiten trajnime të personelit të ri, si brenda dhe jashtë vendit, dhe rifreskimet apo specializimet në fusha të ngushta të stafit ekzistues laboratorik. Çdo vit duhet të ketë një fond të disponueshëm për trajnimet e stafit.

Nevojitet një inventarizim i pajisjeve ekzistuese laboratorike në gjithë vendin (secila ministri më vete), sepse ka institucione ose laboratorë që disponojnë aparatura të reja që nuk i kanë vënë në punë. Mund të bëhet një rishpërndarje më e mirë, për një shfrytëzim maksimal të kapaciteteve ekzistuese, ose një trajnim i stafit për përdorimin e tyre.

Tab.8.C Prioritetet dhe veprimet e mundshme : Infrastruktura teknike

Çështjet prioritare nga më e larta tek më e ulëta	Niveli i kapacitetit	Përmbledhje e anëve të forta, mangësive dhe nevojave për kapacitete	Veprimet e mundshme	Aktorët e përfshirë
Kapacitetet analitike	Mesatar	Disa institute dhe laboratorë të futur në rrugën e akreditimit janë pajisur me aparaturë bashkëkohore, si: laboratorët e ISUV, laboratorët e Agjencisë së Mjedisit, laboratorët qëndror i ushtrisë, laboratorët e mjekësisë ligjore, disa laboratorë privatë, etj. ,por ka dhe laboratorë me pajisje dhe instrumenta të vjetër që duhen rinovuar.	- Financimi nga buxheti i shtetit dhe donacionet; - Aplikimet e përbashkëta në projekte; - Rishpërndarja dhe menaxhimi më i mirë i fondeve që vijnë nga analizat për të tretët.	Ministritë e linjës, stafet e laboratorëve
Niveli profesional i stafit analitik	Mesatar	Nëpër institutet dhe laboratorët përveç personelit të përgatitur e me eksperiencë, ka dhe personel të patrajnuar që duhet përditësuar me metodat e reja standarde (ISO, etj) ndërkombëtare dhe me përdorimin e aparaturave dhe instrumentave matës bashkëkohore.	- Krijimi i një buxheti për trajnim dhe rifreskim dijes; - Ngritje e sistemit të cilësisë nëpër laboratorët analizues; - Trajtime jashtë dhe brenda vendit; - Pjesëmarrje në prova interlaboratorike ndërkombëtare.	Administrata e laboratorëve, stafi i laboratorëve
Kapacitetet teknike	Mesatar	- Servisi dhe mirëmbajtja e aparaturave nuk është në nivelin e duhur, shpesh nuk bëhet në kohën dhe mënyrën e duhur. Vetëm laboratorët e akredituar që marrin servis nga jashtë sigurojnë mirëmbajtje të vazhduar të instrumentave. - Operatorët vendas të serviseve dhe mirëmbajtjes së aparaturave janë relativisht të rinj, ata duhet të përmirësojnë nivelin shkencor dhe teknik të stafit të tyre. - Pajisja me reagentë cilësorë, standarde ndërkombëtare dhe me materiale referencë të çertifikuar (CRM) është në nivel të ulët për shkak të kostos së lartë të tyre.	- Futja e sistemit të menaxhimit të cilësisë nëpër laboratorët; - Sigurimi i servisit periodik të rregullt nëpërmjet trajnimit të stafit të servisit dhe/ose kontraktimit me aktorë ndërkombëtarë; - Sigurim i një buxheti për CRM.	Administrata e laboratorëve, stafi i laboratorëve, kompanitë që ofrojnë servis
Menaxhimi i mbetjeve laboratorike	I ulët	Në përgjithësi laboratorët nuk menaxhojnë mbetjet e rrezikshme laboratorike dhe kimikate jashtë përdorimi. Shpesh tretësit hidhen në kanalizimet e ujërave të bardha dhe kimikate në vendgrumbullimet e mbetjeve urbane.	- Duhet ngritur sistemi i menaxhimit të mbetjeve dhe kimikateve të skaduara; - Riciklimi i tretësve në laboratorë.	

KAPITULLI 9: PARANDALIMI, GATISHMËRIA DHE PËRGJIGJA NDAJ EMERGJENCAVE KIMIKE.

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC) i miratuar nga Këshilli i Ministrave Nr.835, i datës 3.12.2004 është dokumenti më i rëndësishëm i Shtetit Shqiptar për sa i përket emergjencave civile. Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Emergjencave Civile përfshin struktura permanente dhe provizore në nivel qendror, rajonal dhe lokal.

Qendra Kombëtare Operacionale për Emergjenca Civile është në qendër të sistemit të menaxhimit të emergjencave civile në Shqipëri, duke luajtur një rol kryesor në të katër fazat e sistemit të menaxhimit të emergjencave.

Në anekset e PKEC janë përcaktuar faktorët që do të merren parasysh në parandalimin, përgatitjen, dhe mbrojtjen në rast emergjencash industriale. Aktualisht nuk ka plane të veçanta të jashtëm të emergjencës për aktivitete industriale, të përgatitur nga autoritetet përgjegjëse në nivel rajonal ose lokal.

MMPAU me asistencë të KE CARDS 2006 INPAEL, ka hartuar projektligjin “ Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore”, që transpozon plotësisht Direktivën SEVESO II “Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substancat e rrezikshme”. Ky draft- ligj parashikohet të hyjë në fuqi brenda 2012. Hartimi i këtij projektligji është një hap shumë i rëndësishëm në fushën e parandalimit të rreziqeve industriale dhe synon parandalimin e aksidenteve madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme dhe kufizimin e pasojave të tyre mbi njerëzit dhe mjedisin duke siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje.

9.1. Planifikimi i emergjencave kimike

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile i miratuar nga Këshilli i Ministrave Nr. 835, i datës 3.12.2004 është dokumenti më i rëndësishëm i Shtetit Shqiptar për sa i përket emergjencave civile. Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Emergjencave Civile përfshin struktura permanente dhe provizore në nivel qendror, rajonal dhe lokal. Si pjesë e këtyre strukturave, çdo ministri, institucion ose drejtori e përfshirë luan aktualisht rol specifik. Plani Kombëtar është përgatitur bazuar në një metodologji dhe procedurë e cila përfshin studimin e vlerësimit të risqeve, konsultime të gjera, ndarjen e informacionit, kontribut të gjerë të të gjithë institucioneve dhe organizatave të lidhura me emergjencat. Plani Kombëtar i Emergjencës Civile:

- Reflekton politikat dhe prioritetet kryesore të Shqipërisë lidhur me Shërbimin Kombëtar të Emergjencave Civile dhe eksperiencat ndërkombëtare në fushën e emergjencave civile;
- Reflekton kuadrin ligjor shqiptar, standardet dhe procedurat e pranura gjerësisht;
- Sistematizon dhe qartëson rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë institucioneve qeveritare përkatëse dhe organizatave të shoqërisë civile për menaxhimin e emergjencave civile.
- Siguron një përdorim të planifikuar dhe të koordinuar të të gjithë kapaciteteve kombëtare dhe ndërkombëtare në vend.
- Nuk zëvendëson plane të hartuara të ministrive të tjera të linjës dhe plane të institucioneve të tjera, dhe në anën tjetër shërben si një guidë për to.

Planet e Emergjencës Civile krijohen në nivel rajonal dhe në bashkitë më të mëdha, por këto plane janë për të gjitha llojet e emergjencave. Nuk ka plane të veçanta të jashtme të emergjencës për aktivitete industriale, të përgatitur nga autoritetet përgjegjëse në nivel rajonal ose lokal. Disa nga aktivitetet si p.sh. depozitat e naftës, kanë krijuar planet e tyre të brendshme të emergjencës, por këto plane nuk janë në përputhje me kërkesat e Direktivës SEVESO II dhe Aneksit VII të Konventës së Aksidenteve Industriale në Kontekst Ndërkufitar.

Sipas Aneksit A A.6 (A.6-1, 6-2, 6-3) të PKEC janë përcaktuar faktorët që do të merren parasysh në **parandalimin, përgatitjen, dhe mbrojtjen** në rast emergjencash industriale si me poshtë:

- Një identifikim kombëtar dhe lokal i zonave të riskut dhe tipeve të emergjencave industriale është një mënyrë efektive për të kufizuar rrezikun e popullsisë;
- Brenda këtyre zonave, hartimi i planeve të emergjencës në nivel kombëtar dhe lokal, duke përfshirë një sistem publik paralajmërimi të shpejtë dhe plane evakuimi mund të jetë i paçmueshëm nëse një ngjarje e këtij lloji ndodh;
- Ky informacion duhet të përfshihet në plane të tjera të emergjencës për ngjarje sizmike, rrëshkitje toke dhe përmytje, sepse mund të ketë gjithashtu efekte sekondare të një natyre industriale, të cilat nuk duhet të vijnë si surprizë në moment gjatë përgjigjes;
- Përgjigja direkte ndaj fatkeqësive industriale është një punë mjaft e specializuar, e cila duhet të ndërmerret vetëm nga njësi të kualifikuara dhe me ekperiencë;
- Përveç evakuimit të planifikuar të menjëhershëm të popullatës, efektet gjerësisht të ndryshueshme mund të jenë të paparashikueshme. Modelimi i efekteve dytësore të mundshme në ujëmbledhës dhe në atmosferë duhet të jetë një bazë e planifikimit për ngjarje me ndikim maksimal;
- Shumë agjenci mund të përfshihen në garantimin e sigurisë së popullatës dhe mjedisit në zonat e drejtimeve dominante të erës ose të ujit nga vendi i fatkeqësisë. Koordinim i fortë i përgjigjes është thelbësor në këtë aspekt;
- Nevojat shëndetësore mund të jenë shumë specifike dhe planifikimi i skenarit duhet të përfshijë burime dhe të dhëna specifike të kujdesit shëndetësor si për parandalim ashtu edhe për kurim;
- Për skenare ekstreme, ndihma eksperte ndërkombëtare është potencialisht e disponueshme nëpërmjet Programit Mjedisor të Kombeve të Bashkuara (UNEP) nëpërmjet UNDAC. Përfaqësitë Rezidente të OKB lehtësojnë vënien në zbatim me kërkesë të qeverisë së vendit që ndikohet.

Gjithashtu në Kreun V «Subjektet që përfshihen në planizimin dhe përballimin e emergjencave civile», neni 29 2 (c) i Ligjit Nr. 8756, të datës 26.3.2001 “Për Emergjencat Civile”, entitetet ekonomike dhe institucionet, të cilët në ndjekje të aktiviteteve të tyre përdorin, prodhojnë, transportojnë ose depozitojnë substanca të rrezikshme: "...organizojnë, kur është e nevojshme, evakuime të punonjësve, ndërtojnë vetë organizimin e tyre për përgjigje ndaj situatave emergjente brenda zonës së tyre të aktivitetit".

Në përgjithësi ndërmarrjet/ subjektet që përdorin produkte hidrokarbure janë të pajisura me një plan në rast emergjence kimike. Pjesa më e madhe e aktiviteteve që kanë një impakt në mjedis kalojnë nëpërmjet një procedure të marrjes së një leje mjedisore sipas legjislacionit mjedisor përkatës. Pjesë e aplikimit për këtë leje është kërkesa për të dorëzuar planet në raste emergjencash dhe leja parashikon masat që duhet të ndërmerren në lidhje me rastet e përgjigjes ngaj këtyre emergjencave. Janë të nevojshme disa përmirësime në këtë aspekt dhe për këtë arsye MMPAU ka përgatitur një Draft-vendim “Për raportet e sigurisë dhe

planifikimin e emergjencave” Brenda ligjit “Për kontrollin e rrezikut nga aksidentet e mëdha industriale që përfshijnë substanca të rrezikshme.”

Ministria e Brendshme ka hartuar draftligjin "Për mbrojtjen civile nga fatkeqësitë". Draftligji do të përmirësojë të gjithë kuadrin ligjor dhe atë për mbrojtjen civile nga fatkeqësitë dhe emergjencat dhe do të shoqërohet me krijimin e Strategjisë Kombëtare të Reduktimit të Rreziqeve, e cila do të rishikojë parimet, bazat e reja ligjore, do të zhvillojë politikat sektoriale për mbrojtjen nga emergjencat dhe fatkeqësitë, forcimin dhe modernizimin e shërbimit të sistemit të mbrojtjes dhe administrimin e krizave, si dhe pajtueshmërinë me shërbime analoge të BE-së.

Gjithashtu do të rishikohet Plani Kombëtar i Emergjencave Civile me synim:

- Koordinim më të mirë midis strukturave ekzistuese në nivel lokal e kombëtar
- Aktivizimin e mjeteve të reja që mundësojnë rritjen e efikasitetit në menaxhimin e informacionit dhe komunikimit
- Zhvillimin e praktikave të përbashkëta midis institucioneve për menaxhimin e rrezikut

MMPAU me asistencë të KE ka hartuar Projektligjin “ Për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore”, që transponon plotësisht Direktivën 96/82/EC SEVESO II për kontrollin e rreziqeve nga aksidentet madhore që përfshijnë substancat e rrezikshme, duke përbërë bazën për hartimin e akteve të tjera nënligjore që do të sigurojnë zbatueshmërinë e këtij ligji. Ky ligj është parashikuar të miratohet brenda vitit 2012.

Hartimi i këtij projektligji është një hap shumë i rëndësishëm në fushën e parandalimit të ndotjes dhe rreziqeve industriale dhe synon: parandalimin e aksidenteve madhore që shkaktohen nga substanca të rrezikshme dhe kufizimin e pasojave të tyre mbi njerëzit dhe mjedisin sigurimin e një niveli të lartë mbrojtjeje.

Disa nga detyrimet baze të operatorëve industriale sipas sasisë së substancave që ruajnë lidhen me:

- Njoftimin që duhet t’u bëjnë autoriteteve që i përkasin kësaj Direktive
- Hartimin e Politikës për Parandalimin e Aksidentit Madhor
- Raportimin e aksidenteve
- Bashkëpunimin me Autoritetet
- Hartimin e Raportit të Sigurisë
- Ngritjen e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë
- Hartimin e Planeve të Brendshme të Emergjencës
- Sigurimi i informacionit për publikun

Detyrimet e autoriteteve kompetentë lidhen me:

- Vlerësimin e Raporteve të Sigurisë
- Rishikimin e dokumentacionit në raste të modifikimeve
- Organizimin e inspektimeve/ sanksioneve ligjore
- Ndalimin e aktivitetit nëse:
 - Paraqiten mangësi serioze
 - Dokumentacion i parregullt ose i papërshtatshëm
- Përgatitjen dhe testimin e planeve të jashtme të emergjencës nga Autoriteti i Përcaktuar Lokal ose Kombëtar
- Identifikimin e efektit të mundshëm Domino

- Zbatimin e politikave të planifikimit urban
- Autoriteti i komunikon Operatorit detaje të planit në mënyrë që të sigurohet përputhshmëria e planeve të brendshme dhe të jashtme të emergjencës.
- Mban një regjistër që përmban informacionin që përfshihet në Nenin 7, raportet e sigurisë Neni 9, paralajmërimet Neni 17 (2), dhe komunikimet në Nenin 18

Gjithashtu, projektligji parashikon masat për aksidentet në kontekst ndërkuftar, në përputhje kjo edhe me Konventën e UNECE "Mbi Efektet Ndërkuftare të Aksidenteve Industriale", çfarë lidhet me njoftimin e palëve.

Konkretisht neni 11 i Kreut 4 të Projektligjit "Për Kontrollin e Rreziqeve nga Aksidentet Madhore Industriale që shkaktohen nga substanca të rrezikshme", parashikon që operatori i ndërmarrjes së nivelit më të lartë duhet të përgatisë një plan të brendshëm emergjence.

Neni 12 i këtij projektligji parashikon hartimin e Planit të jashtëm të emergjencës për ndërmarrjet e nivelit më të lartë, nga njësia e qeverisjes vendore e zonës ku ndodhet ndërmarrja. Disa nga kërkesat kryesore të këtij neni janë:

- Operatori i jep njësisë së qeverisjes vendore të zonës ku ndodhet ndërmarrja informacionin e nevojshëm që mundëson njësinë e qeverisjes vendore të përgatisë planin e jashtëm të emergjencës.
- Njësia e qeverisjes vendore, për përgatitjen e planit të jashtëm të emergjencës, konsultohet me operatorin, Autoritetin Kompetent, shërbimet e emergjencës dhe autoritetin shëndetësor të zonës ku ndodhet ndërmarrja, me anëtarë të publikut që i konsideron të përshtatshëm, me njësitë fqinje të qeverisjes vendore që kanë gjasa të ndikohen nga aksidentet madhore në ndërmarrje.
- Njësia e qeverisjes vendore pas marrjes së informacionit dhe pas konsultimeve përgatit projekt planin e jashtëm të emergjencës dhe e vë në dispozicion të publikut.
- Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të Ministrave, miraton rregullore për planet e jashtme të emergjencës.

Në shtojcën B: 'Baza ligjore, funksionet dhe detyrat e institucioneve të Planit Kombëtar të Emergjencave Civile' përcaktohen rolet, përgjegjësitë dhe bazat ligjore të ministrave kryesore dhe agjencive që merren me çështjet e emergjencës civile.

Sistemi Kombëtar i Emergjencës Civile përbëhet nga struktura permanente dhe provizore në nivel qendror, rajonal dhe lokal.

- Këshilli i Ministrave drejton dhe qeveris sistemin e menaxhimit të Emergjencave Civile në Shqipëri. Ministria e Brendshme zbaton politikat e Këshillit të Ministrave në fusha të Planifikimit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile.
- Komiteti Ndërmarrës për Emergjencat Civile koordinon veprimet e përshtatshme të të gjithë institucioneve që merren me këtë çështje në të gjitha fazat e përgjigjes ndaj situatave të emergjencës civile.
- Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile është një strukturë e përhershme dhe e specializuar, që merr pjesë në të gjitha fazat/stadet e ciklit të menaxhimit të emergjencave civile. Gjithashtu DPEC është direkt përgjegjëse për koordinimin në çastet e para të përgjigjes ndaj një situatë aktuale të emergjencës civile. Në strukturën e përhershme, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile ka Drejtorinë e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile, si dhe Drejtorinë Operacionale të Drejtim Komandimit të Emergjencave Civile (Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile.)




Fig. 5.A Përgjegjësitë në nivel kombëtar për emergjencat civile

- Bazuar në Planin Kombëtar të EC, si dhe në VKM Nr. 663, datë 18.12.2002 «Për përbërjen funksionimin dhe përgjegjësitë e komisionit tekniko-këshillimor të specialistëve për emergjenca», si strukturë e përkohshme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të EC ngrihet dhe funksionon një komision teknik këshillimor i specialistëve, me përbërje nga specialistë të ministrave, institucioneve, ente të ndryshme dhe forcat operacionale.

- Çdo Ministri e linjës është përgjegjëse për planifikimin dhe menaxhimin e emergjencave civile sipas fushës së tyre të veprimtarisë. Aktivitetet e tyre përfshijnë të gjitha fazat/ stadet e ciklit të menaxhimit të emergjencave civile dhe kur është e përshtatshme luajnë një rol drejtues ose mbështetës.




Fig. 9.B Sistemi Kombëtar i Emergjencës Civile

Forcat Kryesore Vepruese ose strukturat aktive në Shqipëri bazuar Planit Kombëtar të EC, si dhe Vendimit Nr.531, datë 1.8. 2003 “Për detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit përfshijnë:

Forcat e Armatosura, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe i Shpëtimit (PMNZSh), Shërbimi i Ambulancës, Policia e Shtetit dhe njësi të tjera të Policisë, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, Njësi të specializuara në miniera, struktura mbështetëse monitoruese dhe vepruese. Këto struktura kanë role specifike dhe përgjegjësi për të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave civile dhe është thelbësore që ata të bashkëpunojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin që të sigurohet përgjigjia më e efektive e mundshme

Kryetari i Operacionit është drejtues i përpjekjes për përgjigje, dhe koordinon menaxhimin e operacionit të emergjencës civile në zonën e prekur.

Qendra Kombëtare Operacionale për Emergjencë Civile është në qendër të sistemit të menaxhimit të emergjencave civile në Shqipëri. Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile funksionon me shërbim 24 orësh. Detyra kryesore është mbajtja nën kontroll e situatave të emergjencave civile në gjithë territorin e vendit, grumbullimin e informacionit, koordinimin e forcave operacionale për përballimin e emergjencave civile.

Përgjegjësitë në nivel qarku, bashkie dhe komune për Emergjencat Civile

- Një komision lokal, i kryesuar nga Prefekti (ose bashkiaku i komunës) krijohet në çdo rreth (ose bashki ose komune), detyra e të cilit është të koordinojë aktivitetet e autoriteteve të rrethit (ose bashki ose komune) dhe organizatave vullnetare.

Institucionet dhe strukturat përfshijnë:

- Ministritë e Linjës,
- Qarqet, bashkitë dhe komunat,
- Kryqi i Kuq Shqiptar dhe OJQ të tjera,
- Akademia e Shkencës dhe institute kërkimore të tjera,
- Familje, mësues, komunitet,
- UNDP dhe agjenci të tjera të Kombeve të Bashkuara NATO/CEP/EADRCC,
- Vendet partnere,
- Iniciativat rajonale dhe europiane si CMEP, DPPI, Marrëveshja e Detit të Zi, Marrëveshja e Rrezikut EUROPA, NEQ.

Duke marrë parasysh faktin që fatkeqësitë natyrore të çdo lloji janë jashtëzakonisht me pasoja mbi mjedisin, dhe në fakt disa prej tyre shkaktohen nga përdorimi i substancave të rrezikshme, Ministria e Mjedisit luan një rol të rëndësishëm në të gjitha fazat e fatkeqësisë.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave:

- Luan një rol parësor duke vlerësuar paraprakisht një situatë të dyshueshme për të shkaktuar një emergjencë mjedisore të përmasave të mëdha, me efekte negative në mjedis përgjithësisht, në jetën e qytetarëve dhe gjallesave, pronat private dhe publike dhe trashëgimisë kulturore;
- Së bashku me monitorimin operacional aktiv, strukturat informative dhe mbështetëse, paraqesin një kërkesë për struktura internacionale të specializuara që të marrin pjesë në mision, në vijim të marrëveshjeve bilaterale dhe konventave të nënshkruara;
- Siguron teknikë të nevojshme për skuadrat e ndërhyrjes, duke lehtësuar marrjen dhe shoqërimin e tyre në vendet e veprimit;
- MMPAU kordinon aktivitetin e tij së bashku me ministritë e tjera sipas rastit dhe nevojave.

Inspektimet (përfshirë subjektet e industrisë kimike) parashikohen të kryhen nga inspektorate të ndryshme.

Ministria e Shëndetësisë:

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me zyrën e Shqipërisë të OBSH-së (Organizata Botërore e Shëndetësisë), ka përgatitur “ Platformën e përgjithshme të Ministrisë së Shëndetësisë për menaxhimin e riskut dhe fatkeqësive” dhe “Udhëzimet për përgatitjen e planit të përgjigjes së spitaleve ndaj fatkeqësive”. Këto janë dokumente udhëzues që ndihmojnë procesin e përgatitjes së planeve spitalore të menaxhimit emergjenca të fatkeqësive, duke përfshirë aksidente nga kimikatet apo fatalitetet, strukturat që janë përfshirë sipas niveleve të ndryshme të emergjencave civile si dhe role dhe përgjegjësitë për secilin prej këtyre strukturave në çdo rast të dhënë. Këto dokumente përdoren si bazë për ndërtimin e politikave dhe programeve të Ministrisë së Shëndetësisë në këtë fushë.

Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit (RNSh) (2005)

Në kuadër të RNSh (2005) (<http://www.who.int/ihr/en/>), shtetet duhet të sigurojnë që sistemet e tyre të shëndetit publik të jenë në gjendje të zbulojnë dhe të përgjigjen ndaj ngjarjeve të shkaktuara nga lëndët kimike.

Në shtator 2010 nëpërmjet VKM Nr. 772, datë 29.9.2010 “Për Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit”, Këshilli i Ministrave emëroi Institutin e Shëndetit Publik (IShP) përgjegjës për koordinimin me sektorët përkatës qeveritare për të siguruar zbatimin e IHR (2005). Përveç se është pikë kombëtare kontakti për RNSh, IShP është gjithashtu përgjegjës për sigurimin e zbatimit të RNSh (2005). Ka plane të IShP-së për të ndërtuar një grup të RNSh për të koordinuar dhe kontrolluar zbatimin e RNSh (2005) në Shqipëri. Në vitin 2011 u krye një takim me të gjithë pjesëmarrësit përkatës nga IShP dhe institucione të tjera të përmendura edhe në Urdhërin e Këshillit të Ministrave, të përfshirë në zbatimin e RNSh (2005), për të diskutuar planin e veprimit për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Janë pesë persona kontakti për RNSh të cilët janë në gadishmëri 24/7/365. Këta pesë persona përdorin Instrumentin e Vendimit në Shtojcën 2 të RNSh për të vlerësuar nëse ngjarjet e Shëndetit Publik janë Urgjenca potenciale të Shëndetit Publik që përbëjnë Shqetësim Ndërkombëtar dhe duhet të njoftojnë OBSH. IShP ka përgatitur një draft të protokollit ose procedurës standarte të veprimit për personat e kontaktit të RNSh në vlerësimin e rreziqeve për Shëndetin Publik dhe për komunikimin dhe njoftimin brenda vendit dhe me OBSH. Ky protokoll ka filluar të përdoret në praktikë megjithëse përsëri ekzistojnë disa mangësi.

Në këtë moment nuk ka mekanizëm për të regjistruar ngjarjet e Shëndetit Publik përfshi edhe ato kimike që vlerësohen duke përdorur Instrumentin e Vendimit. Pesë personat e kontaktit

duhet të kenë akses në faqen e internetit për informacione përrreth ngjarjeve (Event Information Site, EIS) dhe duhet të jenë në gjendje të bëjnë postime në EIS në qoftë se është nevoja. Një person i emëruar në zyrën e OBSH në Shqipëri ka gjithashtu akses në fjalëkalimin e mbrojtur të EIS.

Survejanca kimike dhe përgjigja

Ekziston një Shërbim i Toksikologjisë Klinike pranë Qendrës Spitalore Universitare në Tiranë (QSUT) me tre ekspertë të toksikologjisë klinike. Ka një trajnim dy-vjeçar në toksikologji klinike dhe 17 mjekë janë trajnuar deri tani. Buxheti për shërbimin e toksikologjisë vjen nga QSUT. Çdo vit rreth 6'000-7'000 pacientë hyjnë në shërbimin e urgjencës që lidhet me këtë departament dhe rreth 10% pranohen. Shumica e rasteve kanë të bëjnë me overdoza droge dhe helmime nga kimikate. Ekzistojnë 13 shtretër plus 2 shtretër për reanimacionin.

Ka rreth 200 helmime në muaj shkaktuar nga pesticidet. Testimi laboratorik për rastet ligjore kryhet nga Laboratori i Mjekësisë Ligjore. Ka 5 analistë kimikë në Laboratorin e Kimisë Analitike Instrumentale pranë ISHP-së të cilët bëjnë analiza të përbërësve organikë dhe inorganikë, si pesticidet dhe metale të rëndë, ndërsa Laboratori i Toksikologjisë Paraklinike pranë ISHP ka kapacitete të kufizuara. Një manual mbi trajtimin klinik në rastet e helmimit ka përfunduar në formën e një drafti dhe ka nevojë për diskutim dhe më pas publikimin dhe trajnimin sipas tij.

Nuk ka proces komunikimi formal midis Shërbimit të Toksikologjisë Klinike dhe ISHP. Ekziston nevoja për një proces formal të komunikimit dhe ndërtimit të një Qendre Kombëtare të Helmeve që t'u japë një shërbim 24 orë/7 ditë në javë mjekëve në të gjithë vendin dhe do të lehtësonte dokumentimin e rasteve të helmimit në vend. Kjo qendër mund të kontribuonte për vlerësimin dhe vlerësimin periodik të aksidenteve kimike dhe sëmundjeve të shkaktuara prej tyre, nëpërmjet bashkëpunimit me ISHP.

Nga vlerësimet e kryera në bazë të RNSH (IHR) 2005, rezulton se survejanca për ndodhitë e shkaktuara nga lëndët kimike është tejet e dobët dhe ka mangësi koordinative pavarësisht dokumentacionit dhe legjislacionit ekzistues. Koordinimi nga pika fokale për këtë subjekt në grupin e IHR pranë ISHP do të sillte risi në këtë drejtim. Po kështu ka një nevojë urgjente trajnimit në vlerësimin e riskut dhe menaxhimin e tij si edhe në drejtim të koncepteve të epidemiologjisë së terrenit dhe survejancës për të gjithë specialistët që punojnë në fushën e menaxhimit të kimikateve.

Ndërkohë, në fillim të vitit 2012 ka nisur një trajnim online mbi njohjen e RNSH 2005 me ekspertë të menaxhimit të lëndëve kimike.

Inspektorati i Mjedisit:

Ushtron kontroll të vazhdueshëm mbi mjedisin dhe aktivitetet ndotëse që të garantojë mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe kushteve për leje dhe deklarata mjedisore. Inspektimi përfshin:

- Krijon një dosje mjedisore për aktivitetet e shënuara për leje mjedisore. Ministri i Mjedisit përcakton rregullat e detajuara në lidhje me formain, përmbajtjen dhe administrimin e dosjes mjedisore;
- Ndihmon personat fizikë dhe juridikë të përmbushin vetëmonitorimin, verifikimin dhe implementimin e sistemeve të integruar të menaxhimit dhe kontrollon implementimin e tyre ;
- Urdhëron implementimin e masave të detyrueshme që duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për minimizimin ndotjes dhe të dëmeve në mjedis;
- Kontrollon regjistrin e ndotjeve, rregulloret e brendshme, teknike dhe teknologjike si dhe

dokumente të tjera që lidhen me aktivitetin dhe rreziqet e ndotjes;

– Vendos sanksione sipas këtij ligji si dhe akteve të tjera ligjore që mbrojnë pjesë të vecanta të mjedisit.

Inspektorati Teknik Qendror (ITQ) është një institucion publik kombëtar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës dhe përbëhet nga:

- Drejtoria e Inspektimit të Naftës dhe Gazit;
- Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve Elektrike;
- Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën presion;
- Drejtoria Qëndrore e Kontrolleve Laboratorike.

Inspektoriati i Minierave dhe Njësia e Shpëtimit, monitoron nëpërmjet inspektimeve periodike zbatueshmërinë e ligjeve të veçanta për të garantuar një regjim normal pune të parandalimit të risqeve në aktivitetet minerare dhe ndërhyjnë në kohë në rast emergjence, për të ndërmarrë operacione shpëtimi në aktivitete minerare dhe në kontekstin e emergjencave civile.

Inspektorati Shtetëror i Punës si trupi përgjegjës i fushës së sigurisë dhe shëndetit në punë ka këto detyrime:

- Kontrollon implementimin e detyrimeve mbi parandalimin e risqeve në punë.
- Kërkon ekzekutimin/ zbatimin e masave dhe marrjen e kampioneve për analiza të materialeve dhe substancave të rrezikshme, të përdorura gjatë procesit të punës. Në çdo rast, i punësuarit ose përfaqësuesi i tij duhet të jetë i ndërgjegjshëm për qëllimin e marrjes së kampioneve.
- Urdhëron ndalimin e aktivitetit, riparimin e defekteve të vërejtura gjatë veprimit të pajisjes ose përdorimit të metodave të punës, kur përcaktohet ekzistenca e një rreziku serioz dhe të menjëhershëm investigon ngjarjen dhe konfirmon natyrën e aksidenteve.
- Koordinon, sëbashku me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe, nëse është e nevojshme, me institucione të tjera të përfshira në proces, duke raportuar sistemin dhe mbajtjen e proces-verbalit të aksidenteve në punë.
- Koordinon, sëbashku me Ministrinë e Shëndetësisë, performancën mbi sistemin raportues të sëmundjeve profesionale dhe sëmundjeve lidhur me punën.

Në rast të një incidenti industrial, burimet e mëposhtë mund të sigurojnë informacion për Qendrën Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile: Qytetarët, entet private ose shtetërore në rrezik, inspektoratet përkatës, Prefektë, Autoritete Lokale, Struktura Monitoruese, Stacione të Policisë së Shtetit, Policia e Zjarrit dhe Shërbimeve të Shpëtimit, forcave vullnetare të emergjencës civile, njësi të forcave të armatosura, dhe të tjerë. Ky informacion duhet t'i transmetohet menjëherë: Ministrisë së Brendshme, Drejtorit të Përgjithshëm të Emergjencave Civile, Drejtorit të Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencës Civile, Drejtorit të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe Drejtorit të Drejtimit Operacional të Drejtimit Komandimit të Emergjencave Civile.

Përveç kësaj, Qendra Kombëtare Operacionale për Emergjencat Civile në Drejtorinë Operacionale të Drejtimit Komandimit të Emergjencave Civile duhet të informojë: Stacionin me të afërt të Zjarrfikësave dhe Shërbimeve të Shpëtimit, Ministrinë e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, Ministrinë e Mbrojtjes (MM), Ministrinë e Shëndetësisë (MSh), Shërbimin e Ambulancës dhe helikopterët e evakuimit mjekësor, Ministrinë e Mjedisit, Prefektin e qarkut përkatës dhe kryetarin e komunës së prekur/ bashkiakun, Kryqin e Kuq Shqiptar, dhe të tjerë. Qendra Kombëtare e Operacionale për Emergjencat Civile mbledh informacionin si është shpjeguar më lart dhe të njëjtat institucione duhet ta mbajnë këtë qendër të përditësuar mbi ngjarjen.

Lidhur me inventarin e instalimeve dhe mjeteve të transportit që përbëjnë risk për incident kimik:

- Inspektoriati Mjedisit ka draftuar listën e parë të aktiviteteve industriale të bazuara në Aneksin i të direktivës së IPPC (Integrated Pollution Prevention and Control) dhe protokollit PRTR (Pollutant Release and Transfer Register).
- Aktivitetet që depozitojnë dhe tregtojnë produkteve të naftës janë identifikuar nga Inspektorati Teknik Qendror.
- MPÇSShB ka identifikuar gjithashtu 73 aktivitete që mbajnë substanca kimike të rrezikshme në të gjithë vendin në përputhje me Aneksin i të VKM Nr. 200 që ka listuar 220 substanca të rrezikshme.
- Është e nevojshme rritja e kapaciteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, duke kryer aktivitete trajnuese, në mënyrë që të përmirësohet njohuria e ekspertëve në identifikimin e aktiviteteve të rrezikshme nën Konventën dhe Direktivën SEVESO II, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin e industrisë ndaj riskut të fuqishëm.
- Ministria e Punëve Publike dhe Transportit licenson subjekte që transportojnë mallrat e rrezikshme, të klasifikuar dhe shënuar si të rrezikshme nga Marrëveshja Europiane për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), transporti i të cilave në rrugë është i ndaluar, ose i lejuar vetëm në kushtet e caktuara nga kjo marrëveshje. Në rastin e transportit rrugor të mallrave të rrezikshme janë përcaktuar kriteret e liçencimit, ku kërkesa për kompetencë profesionale plotësohet përveç zotërimit të Çertifikatës së Kompetencës Profesionale sipas veprimtarive përkatëse ose zotërimit të diplomës universitare në inxhinieri mekanike ose ekonomik, edhe me zotërimin e Çertifikatës së Trajnimit si Këshilltar i Sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme.

Neni 31 “Transporti i mallrave të rrezikshme brenda vendit” i Udhëzimit Nr.15, datë 24.7.2007 të MPPT “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” rregullon veprimtarinë e transportit të mallrave të rrezikshme brenda vendit, veprimtari e cila ushtrohet kundrejt çertifikatës së mallrave të rrezikshme.

Kjo çertifikatë lëshohet për çdo subjekt fizik ose juridik që kërkon të kryejë transport mallrash të rrezikshme brenda vendit dhe që zotëron:

- Çertifikatën e aprovuar për mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme të caktuara (sipas ADR-Marrëveshja europiane për transport rrugor ndërkombëtar të materialeve të rrezikshme), të lëshuar nga DPSHTR (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor).
- Çertifikatën e Kontrollit të Pajisjes së Transportueshme për mallra të rrezikshme të lëshuar nga Instituti i Enëve Nën presion.

Lista e subjekteve të licensuar për transportin e mallrave të rrezikshme është e identifikuar nga MPPT.

Duke patur parasysh zhvillimet europiane dhe ndërkombëtare lidhur me klasifikimin dhe etiketimin e kimikateve, është e nevojshme të rishikohet legjislacioni aktual përkatës, bazuar në Rregulloren (EC)1272/2008, “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve”, ose në Sistemin e Harmonizuar Globalisht për Klasifikimin dhe Etiketimin e Kimikateve.

Aktualisht rregullat e klasifikimit, të paketimit dhe etiketimit në Shqipëri përcaktohen në VKM Nr. 824, datë 11.12.2003 “Për klasifikimin, ambalazhimin, etiketimin dhe ruajtjen e substancave dhe të preparateve të rrezikshme”, vendim i cili është hartuar në përputhje me Direktivën e BE, 67/548/EEC e datës 27 Qershor 1967 “Për klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e substancave të rrezikshme”. Kjo VKM vendos kushte të sigurta për

administrimin e të gjitha kimikateve dhe preparateve të prodhuara, importuara, tregtuara, përdorura dhe ruajtur në Shqipëri.

Sipas pikës 3 të Vendimit 824/03, klasifikimi i substancave dhe preparateve të rrezikshme bëhet sipas Sistemit Ndërkombëtar. Pika 4 e këtij Vendimi rregullon kërkesat që duhet të plotësojë prodhuesi, importuesi dhe shpërndarësi për ambalazhimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme si dhe jep instruksione për mënyrën e paketimit. Gjithashtu në pikën 5 të këtij vendimi jepen rregulla për etiketimin e substancave dhe preparateve të rrezikshme para se ato të hidhen në treg. Substancat dhe preparatet kimike sipas pikës 7 të VKM 824/03 ruhen të depozituara në magazina të përcaktuara për këtë qëllim dhe në kushte të veçanta. Në anekset e këtij vendimi paraqiten lista e frazave standarte mbi natyrën e rreziqeve të veçanta nga substancat (R-phrases), rregullat e sigurisë nëpërmjet frazave e sigurisë (S-phrases) si dhe klasifikimi i substancave dhe preparateve kimike sipas numrit rendor të elementit.

Rregullat për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve (PMB) janë të përcaktuara në VKM Nr. 1555, datë 12.11.2008 “Për miratimin e rregullave të regjistrimit dhe të kriterëve të vlerësimit të PMB-ve”,

Sa i përket emergjencave nga kimikatet, aktualisht nuk ka asnjë qendër informacioni në vend lidhur me helmimet nga kimikatet, por ka një qendër koordinuese të emergjencave mjeksore, nën administrimin e Ministrisë së Shëndetësisë, kapacitetet e së cilës në terma praktikë janë të kufizuara, veçanërisht për transportin e viktimave në rastin e aksidentëve që përfshijnë kimikatet e rrezikshme.

Gjithashtu nuk ka një dokument udhëzues, ku në mënyrë të përmblodhur të ketë një informacion lidhur me incidentet nga kimikatet e rrezikshme, menaxhimin e incidenteve, toksikologjinë në përgjithësi, metodat e dekontaminimit, përdorimit të antidotëve apo pajisjeve ndihmëse gjatë ndodhjes së një emergjence kimike.

Lidhur me trajnimet në përgjigje të emergjencave në përgjithësi, si fikje zjarri, ngjitje në lartësi, kërkim-shpëtimi, transport të dëmtuarish, Drejtoria e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit (PMNZSh) në strukturën e saj ka drejtorinë, 1 (një) sektor: atë të Vlerësimit të Standardeve dhe Koordinimit Operacional si dhe Qendrën Kombëtare të Trajnimit. Detyra kryesore e Drejtorisë së PMNZSH është planifikimi, koordinimi, kontrolli si dhe ngritja e nivelit të personelit të strukturave të PMNZSh në të gjitha nivelet.

Forcimi i kapaciteteve institucionale trajtohet nga draft-ligji i ri “Për mbrojtjen civile nga fatkeqësitë”, që pritet të miratohet brenda 2012.

- Ndryshimet strukture në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, në projektligjin e ri, synojnë kthimin e saj nga drejtori në Agjenci, duke ndryshuar si në strukturë, përgjegjësi dhe në funksion direkt si dhe krijimin e Inspektoratit të Mbrojtjes Civile si një strukturë të specializuar me zgjerim vertikal, si pjesë e strukturës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.
- Është parashikuar që edukimi dhe trajnimi në fushën e Mbrojtjes Civile organizohet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile përmes Qendrës Kombëtare të Trajnimit.

Nuk ka trajnime të veçanta sa i përket emergjencave kimike në veçanti dhe aq më pak trajnime për veterinerët lidhur me ekspozimin e kafshëve ndaj substancave toksike.

9.2 Përgjigja ndaj incidenteve kimike

Në tabelën 9.A janë dhënë disa shembuj të incidenteve me implikim të kimikateve të ndodhur vitet e fundit në Shqipëri dhe pasojat përkatëse.

Tabela 9.A: Shembuj të incidenteve kimike në vend

Data e incidentit	Vendndodhja	Tipi i incidentit	Kimikatat e përfshira ³	V: Numri i vdekjeve D: Numri i të dëmtuarve E: Numri i të evakuuarve	Ndotja apo dëmtimi i mjedisit
2005	Shëngjin Lezhë	Aksident industrial, eksplozion i depozitës së karburanteve	hidrokarbure	V: 0 D: 0 E: 0	Ndotje e përkohshme e ajrit; Ndotje e lagunës së Kune Vainit ; Ndotje e detit
Qershor 2005	Vau i Dejës, Shkodër	Shpërthim i transformatorit të hidrocentralit	Vaj mineral i transformatorit	V: 0 D: 0 E: 0	Ndotje e ajrit Ndotje e mureve të godinës
2008	Gërdec; Tirane	Shpërthim i uzinës së demontimit të armëve	Barut nga armët	V: 26 D: 300 E: 4000	Ndotje e përkohshme e ajrit Ndotje e tokës
2011	Tiranë	Aksident industrial, shpërthim i një pike karburanti	hidrokarbure	V: 0 D: 0 E: 3	Ndotje e ajrit, e përkohshme
2011	Tiranë	Aksident industrial, shpërthim i një depo vaji mineral	Vaj mineral për automjetet	V: 0 D: 0 E: 0	Ndotje e ajrit, e përkohshme

- Nisur nga incidentet e mësipërme ajo çfarë mësuam lidhet me detyrimin e operatorëve për përgatitjen e planeve të brendshme të emergjencës dhe paraqitjen e tyre pranë MMPAU, së bashku me dokumentacionin shoqërues për t'u pajisur me leje mjedisore. Sektori që licenson subjektet ka nevojë të rrisë kapacitetet për përcaktimin e kushteve në lejet mjedisore lidhur me masat për parandalimin e aksidenteve industriale. Gjithashtu, një mangësi që u vu re lidhej me mungesën e ekspertizës për vlerësimin e dëmit në mjedis dhe marrjen e përgjegjësisë së dëmit nga ana e operatorit për të bërë rehabilitimin e mjedisit, duke synuar reduktimin e ndotjes në mjedis.

- Një regjistër i aksidenteve kimike sipas rekomandimeve të OBSH-së mendohet të vendoset pranë departamentit të shëndetit dhe mjedisit në ISHP. Ka plane për të ndërtuar indikatorë kombëtarë të mjedisit dhe shëndetit për lëndët kimike.

- Gjatë procesit të Planeve Kombëtare të Veprimit të Shëndetit dhe Mjedisit (PKVShM) dhe Planit European të Veprimit të Shëndetit dhe Mjedisit për Fëmijët, ku Shqipëria është pjesëmarrëse, bashkëpunimi vazhdon me OBSH dhe vendet e rajonit.

9.3 Vlerësimi dhe ndjekja e një incidenti kimik

Plani Kombëtar i Emergjencës Civile parashikon faktorë që duhen konsideruar për t'iu përgjigjur rastit kur ndodh një incident industrial.

Faktorët që duhen marrë parasysh në përgjigje janë :

- Evakuimi i menjëhershëm i popullsisë së prekur ose potencialisht të prekur është thelbësor. Paralajmërimi publik dhe sistemet e informacionit duhet të mirëmbahen gjatë gjithë ngjarjes.
- Shpëtim shumë i specializuar mund të duhet për shpëtimin e personave të ngecur.
- Evakuimi i shpejtë në mjedise shëndetësore, ku kërkesa shëndetësore të veçanta, përfshirë këtu djegiet dhe komplikacione, duhet të planifikohen në mënyrë të veçantë.
- Një vlerësim i menjëhershëm teknologjik kërkohet për të përcaktuar efektet ekzistuese dhe ato potenciale, duke përfshirë ndotjen mjedisore gjerësisht të përhapur.
- Shkaku fillestar i ngjarjes duhet të stabilizohet dhe të sigurohet ose të bëhet më i sigurtë se para ngjarjes. Një skenar i përsëritur duhet të shmanget.
- Efektet dytësore duhet të minimizohen, duke u bazuar në koordinimin më të fortë të agjencive të lidhura me këtë ngjarje.
- Sektori i shëndetit dhe shërbimet e zjarrit dhe shpëtimit në veçanti mund të kërkojnë mbështetje shtesë të menjëhershme. Burimet e fuqishme të mbështjës duhet të jenë një element shumë i rëndësishëm në planifikimin e emergjencës në nivel lokal dhe kombëtar.

Faktorë që merren parasysh gjatë shpëtimit

- Popullsia e evakuar duhet të jetë në dijeni të risqeve deri në kohën kur situata të jetë e sigurtë për t'u kthyer. Kjo përfshin risqe specifike si psh. ato të parashtruara nga burimet e ndotura të ujit.
- Ka pasur raste që një popullsi e ka pasur të pamundur të kthehet e sigurt në shtëpitë e tyre, dhe alternativa provizore të përshtatshme duhet të krijohen për këto raste.
- Është thelbësore që të vlerësohen ndikime mjedisore të një shkallë më të gjerë ose më afatgjatë, efektet në botën e 'egër', gjallesat, të korrat dhe në ujrat nëntokësore. Këshilla në kohë të përshtatshme duhet tu jepet popullsisë së prekur nëpërmjet mjeteve të edukimit publik.
- Mund të ketë mundësi për lehtësim për vendin e prekur ose vende të ngjashme gjatë operimeve të rikuperimit. Ndërtimi i mureve të lira mbrojtëse ose i digave, mbyllja e dyshemeve të betonit dhe ujmbledhësave, dhe kontrollimi dhe riparimi i tipareve ekzistente të dëmtuara të sigurisë dhe pajisja me tregues për paralajmërim të hershëm mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në parandalimin e përsëritjes së një ngjarjeje.

Nuk ka një regjistër kombëtar ku të regjistrohen incidentet e ndryshme që mund të ndodhin për shkak të substancave kimike dhe gjithashtu nuk ka një institucion që kryen investigimin e shkaqeve dhe përgjegjësi të ndodhjes së një incidenti. Nuk ka forma standarde të grumbullimit të informacionit rreth incidentit dhe të ndjekjes së pasojave në shëndet apo mjedis të tij. Plane për ndërtimin e një inventari të tillë janë shënuar në planin kombëtar të zbatimit të Rregullores Ndërkombëtare të Shëndetit

Lidhur me përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar në mjedis, në ligjin «Për mbrojtjen e mjedisit» Nr. 10431, datë 9.6.2011 është parashikuar përgjegjësia mjedisore dhe konkretisht:

- Neni 47 Përgjegjësia për dëmin në mjedis;

- Neni 48 Shpenzimet për masat parandaluese dhe korigjuese;
- Neni 49 Kompensimi i dëmit në mjedis;
- Neni 50 Detyrimi për të siguruar fondet e disponueshme për kompensimin e dëmit;
- Neni 51 Mbulimi suplementar i shpenzimeve për masat korigjuese.

9.4 Komente/Analiza

- Meqënëse legjislacioni Europian, përkatësisht Direktivat 76/769/EEC dhe 67/548/EEC, të cilat ishin transpozuar në legjislacionin ekzistues kombëtar, janë shfuqizuar si dhe janë identifikuar boshllëqe të tjera në legjislacionin kombëtar lidhur me kimikatet, ka dalë nevoja për hartimin e një legjislacioni të ri kombëtar në fushën e kimikateve dhe përkatësisht për transpozimin në legjislacionin kombëtar të rregullores (EC)1272/2008, “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve” dhe rregullores REACH (EC) 1907/2006.
- Një nga problemet e identifikuar është edhe mungesa e një baze të dhënash të aktiviteteve industriale që përbëjnë risk për aksidente me natyrë kimike. Në këtë kontekst është i domosdoshëm inventari i instalimeve industriale që përmbajnë substanca të rrezikshme.
- Sektori që licenson subjektet në MMPAU ka nevojë të rrisë kapacitetet për përcaktimin e kushteve në lejet mjedisore lidhur me masat për parandalimin e aksidenteve industriale
- Procedura e vlerësimit të rrezikut për substanca të tilla të rrezikshme duhet të përkufizohet nga Ministri i Shëndetësisë, ndërsa vlerësimi i rrezikut ndaj ambjentit vendoset nga MMPAU. Sot për sot Ministria e Shëndetësisë dhe MMPAU nuk ka një mekanizëm në vend për vlerësimin e riskut dhe impaktit në shëndet të substancave kimike.
- Nuk ka asnjë qendër informacioni në vend lidhur me helmimet nga kimikatet, dhe kapacitetet aktuale në terma praktik janë të kufizuara, veçanërisht për transportin e viktimave në rastin e aksidenteve që përfshijnë kimikatet e rrezikshme.
- Mungon një regjistër kombëtar për regjistrimin e aksidenteve që mund të shkaktohen nga kimikatet dhe nuk ka një institucion të specializuar teknik që kryen monitorimin a shkaqeve dhe përgjegjësit për aksidentin. Mungojnë forma standarte për mbledhjen e informacionit rreth aksidenteve si dhe ndjekjen e pasojave në shëndet dhe mjedis.
- Survejanca për aksidentet nga kimikatet është shumë e dobët pasi mungon koordinimi pavarësisht egzistencës së dokumentacionit dhe legjislacionit përkatës. Ka një nevojë urgjente për trajnime për vlerësimin e riskut dhe menaxhim në lidhje me epidemiologjinë e aplikuar dhe survejancën për të gjithë specialistët që punojnë në fushën e menaxhimit të kimikateve.
- Nuk ka një dokument udhëzues lidhur me incidentet nga kimikatet e rrezikshme, menaxhimin e incidenteve, toksikologjinë në përgjithësi, metodat e dekontaminimit, përdorimit të antidotëve apo pajisjeve ndihmëse gjatë ndodhjes së një emergjence kimike.
- Rritja e kapaciteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal i autoriteve kompetente për identifikimin dhe vlerësimin e raporteve të sigurisë së aktiviteteve industriale që përbëjnë risk për aksident industrial për shkak të substancave të rrezikshme, përbën një kërkesë të domosdoshme.
- Lidhur me trajnimet në përgjigje të emergjencave kimike, Qendra Kombëtare e Trajnimit duhet të organizojë trajnime në nivel lokal për parandalimin, gadishmërinë dhe përgjigjen ndaj emergjencave kimike për autoritetet kompetente dhe operatorët industrialë.
- Gjithashtu për t’iu përgjigjur me sukses problemeve që shkaktohen nga një aksident kimik është i nevojshëm forcimi i kapaciteteve të forcave të ndërhyrjes nga Ministria e Brendshme (Struktura të gatshme PMNZSh), ministritë e linjës, në drejtim të përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të përshtatshme për aksidentet industriale.

– Rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë mbi rrezikun e aksidenteve industriale dhe të drejtën e informimit të tyre.

Tabela 9.B më poshtë tregon çështjet prioritare dhe masat e mundshme lidhur me emergjencat kimike, gadishmërinë, përgjigjen dhe ndjekjen e tyre, sipas rendit zbritës. Kjo është bërë bazuar në analizën e kryer më lart duke vlerësuar pikat e forta, të dobëta dhe nevojat për të adresuar çështjet e ndryshimeve klimatike.

Tabela 9.B: Prioritetet dhe veprimet e mundshme: gadishmëria, përgjigjia dhe ndjekja e emergjencave kimike.

Çështjet prioritare (klasifikim nga lart-poshtë)	Niveli i kapaciteteve egzistuese	Permbledhja e kapaciteteve Pikat e forta, boshlleqet dhe nevojat	Veprimet e mundshme	Aktorët
Draftimi i legjislacionit të ri kombëtar që transponon rregulloret REACH and CLP	I ulët	Nuk ka përgjegjësi të qarta të përcaktuara midis institucioneve në legjislacionin egzistues	Hartimi i legjislacionit të ri	MMPAU; MSh; METE
Kryerja e inventarit të aktiviteteve industriale që përmbajnë substanca të rrezikshme	Mesatar	Mungesa në bazën e të dhënave të aktiviteteve industriale që përmbajnë substanca të rrezikshme dhe që përbëjnë risk për incidente të shkaktuara nga kimikatet.	Trajnimi i stafit për të realizuar inventarin dhe krijimin e databasës	MMPAU; MPÇSShB; METE
Rritja e kapaciteteve të licensuesve dhe inspektorëve të mjedisit dhe të punës si dhe operatorëve industrialë.	I ulët	Kapacitete të ulëta në nivel kombëtar të autoriteteve përgjegjëse që lidhen me parandalimin e aksidenteve industriale.	Aktivitete trajnuese për licensuesit, inspektorët e mjedisit dhe të punës si dhe operatorët industrial.	MMPAU; MPÇSShB,
Krijimi i mekanizmit për vlerësimin e riskut dhe ndikimit në shëndet dhe mjedis të substancave kimike	I ulët	Nuk ka një mekanizëm në vend për të vlerësuar riskun dhe ndikimin në shëndet dhe	-Hartimi i një rregulloreje për vlerësimin e riskut dhe ndikimit në shëndet dhe mjedis të substancave kimike. Udhëzues lidhur me	MMPAU; MSh

		mjedis të substancave kimike.	incidentet nga kimikatet e rrezikshme, menaxhimin e incidenteve, toksikologjinë në përgjithësi, metodat e dekontaminimit, përdorimit të antidotëve apo pajisjeve ndihmëse gjatë ndodhjes së një emergjence kimike.	
Forcimi i kapaciteteve të forcave të ndërhyrjes nga Ministria e Brendshme (Struktura të gatshme PMNZSh), ministritë e linjës, në drejtim të përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të përshtatshme për aksidentet industriale.	Mesatar		Aktivitet trajnuese	MB; MSh

KAPITULLI 10: NDËRGJEGJËSIMI/ TË KUPTUARIT E PUNONJËSVE DHE PUBLIKUT; TRAJNIMI DHE EDUKIMI I GRUPEVE TË SYNUARA DHE SPECIALISTËVE

Qëllimi i kapitullit 10 është të përshkruajë mekanizmat e institucioneve publike dhe jo-publike dhe aktivitetet që mund të sigurojnë informacionin punonjësve dhe publikut në lidhje me rrezikun potencial të lidhur me kimikatet si dhe kapacitet për trajnim dhe edukim për grupet e prekura nga kimikatet.

Ky kapitull përshkruan instrumentat ligjorë, programet, politikat dhe aktivitetet e lidhura me ndërgjegjësimin e puntorëve, grupeve target dhe profesionistëve. Ai gjithashtu siguron informacion mbi edukimin dhe trajnimet për sektorë të caktuar të shoqërisë të lidhura me implementimin e mirëmenaxhimit të kimikateve dhe mbetjeve.

Aktivitetet përkatëse të qeverisë dhe institucioneve jo-publike për ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit e çështjeve të sigurisë kimike janë të përfshira gjithashtu.

Ndonëse në Shqipëri tani nuk prodhohen kimikate të rrezikshme, kjo nuk do të thotë se nuk ka probleme me to. Produktet e shumta kimike përdoren në jetën e përditshme, në shkollë, në shtëpi dhe në mjedise të tjera. Këto kimikate mund të kenë pasoja negative tek njerëzit dhe në mjedis kur ato përdoren në mënyrë të papërshtatshme (psh. Ilacet, detergjentët, kozmetikët, bojrat, plastikët, fibrat sintetike, bateritë, pesticidet dhe kimikate të tjera bujqësore). Çdo qytetar i vendit duhet të jetë i mirë-informuar për rreziqet e kimikateve, në mënyrë që të jetë në gjendje të bëjë vlerësim të përafërt të riskut nga kimikatet dhe të dallojë atë çka është më e përshtatshme, dhe e sigurt për mjedisin dhe shëndetin.

Angazhimi i publikut është i nevojshëm në planifikim, marrjen e vendimeve dhe zbatimin e politikave për shëndetin mjedisor.

Që të japë kontributin e duhur, çdo qytetar shqiptar duhet të jetë i mirëinformuar, sepse perceptimet publike janë të kufizuara dhe nga eksperiencia, dyshimet e bazuara në informimin e papërshtatshëm ose çorientues, mund të luajnë një rol të madh në formën e perceptimit publik dhe qëndrimit ndaj riskut. Mund të themi që në vendin tonë, ndërgjegjësimi i punonjësve dhe publikut është i mangët në njohjen e risqeve potenciale nga ekspozimi dhe keq menaxhimi i kimikateve.

Institucionet përgjegjëse në vendin tonë si Ministria e Shëndetësisë, Institucionet e Shëndetit Publik, etj. duhet të ndihmojnë në informimin e publikut mbi rrezikshmërinë e kimikateve, nëpërmjet analizave informuese e vërejtjeve të ndryshme. Është e nevojshme të rritet cilësia e informacionit të disponueshëm si për publikun, ashtu dhe për vendim-marrësit. Kjo kërkon investime të mëdha në kërkim, analiza dhe vlerësim.

Qeveria Shqiptare dhe publiku tashmë kanë arritur të kuptojnë se një informacion më i mirë dhe ndërgjegjësim më i mirë i niveleve zyrtare dhe komunitetit në tërësi, do të rezultojnë në vendime me përfitim për mjedisin dhe shëndetin e brezave që do të vijnë. Në qoftë se publiku përfshihet në të gjithë procesin e vendimmarrjes, shqetësimet e tyre dalin që në fillim të procesit të planifikimit kur ndryshimet janë më lehtë për t'u bërë, sesa më vonë kur edhe ndryshime të vogla kushtojnë shumë kohë dhe para.

10.1 Ndërgjegjësimi dhe të kuptuarit e çështjeve për sigurinë ndaj kimikateve, institucionet e përfshira.

Institucionet publike

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU): Një arritje e rëndësishme në fushën e informacionit dhe pjesëmarrjes së publikut ishte nënshkrimi më 25 qershor 1998 dhe ratifikimi më 27 qershor 2001, i Konventës e Åarhusit, të UNECE “Mbi të Drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’ju drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore”.

Nën udhëheqjen e Ministrisë së Mjedisit dhe në bashkëpunim me ministri të tjera dhe OJF u hartua në vitin 2004 “Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e Konventës së Åarhusit në Shqipëri”, i cili është dokumenti bazë që parashtron politikën shtetërore për rritjen e rolit aktiv të shoqërisë civile, të publikut, të OJF-ve, të organizatave të biznesit e të individit në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Ndërkohë me nismën e Bankës Botërore po bëhet një rifreskim i kësaj strategjie.

Njëkohësisht MMPAU, bën të mundur komunikimin te publiku të të dhënave të monitorimit për ajrin, nëpërmjet publikimit të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit, intervistave, informimi midis ministrive të linjës, OJQ-ve, qeverisë lokale si dhe mediave. Raportet e Gjendjes në Mjedis i paraqiten publikut në website-in e kësaj ministrie www.moe.gov.al dhe AMP www.aefalbanian.org.

Qendra e Åarhus-it në Tiranë e ngritur pranë MMPAU nën sektorin e Informimit të Publikut dhe Teknologjisë së Informacionit, mundëson sigurimin e informacioneve të përgjithshme dhe specifike mbi mjedisin në bazë të kërkesave të publikut. Qendra e Åarhus-it është përdorur nga ana e MMPAU si shtesë e funksioneve të përmendura më lart, si një institucion për të promovuar Konventën e Åarhus-it. Ajo është përfshirë në mbështetjen e ministrive të tjera të linjës, OJF-ve, biznesit dhe aktorëve të interesuar dhe koordinon me to aktivitetet e zbatimit të detyrimeve të konventës. Statusi i Qendrës Åarhus dhe kushtet e tij të referencës janë diskutuar së fundmi, pas ngritjes së një Bordi të ri Këshillues për Zbatimin e Konventës së Åarhus-it. Bordi përbëhet nga 14 anëtarë: 7 anëtarë nga autoritetet publike (përfaqësues të MMPAU (3), METE (1), MPPT (1), MSh (1), MIE (1) dhe 7 anëtarë nga shoqëria civile, që janë aktivë në çështjet e mjedisit duke përfshirë këtu një përfaqësues nga biznesi, nga Dhoma e Tregëtisë. Qendra Åarhus, vepron si Sekretariat i Bordit Këshillues për Zbatimin e Konventës së Åarhusit në Shqipëri.

Kjo qendër është lehtësuese e debateve publike që ndërmerren për draft ligjet dhe strategjitë që hartohen me iniciativën e MMPAU. Vetëm gjatë 2010 janë organizuar mbi 13 debate publike me publikun e interesuar për legjislacionin mjedisor, ku funksioni i kësaj qendre ka qënë lehtësimi i pjesëmarrjes së grupeve të interesit si dhe mbledhjes së komenteve në lidhje me dokumentet e politikave dhe draft ligjet, duke promovuar dialogun mes OJF-ve, aktorëve të tjerë të interesit dhe MMPAU-së.

Inspektorati Shtetëror i Punës (<http://www.sli.gov.al/>) është në varësi të Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSShB). Ministria e Punës me Inspektoratin e saj ka edhe ndjek gjithë detyrat që rrjedhin nga Kodi i punës i RSH, ku përfshihen edhe detyrat në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Në faqen e internetit të Inspektoratit Shtetëror të Punës gjenden udhëzime për zbatimin e legjislacionit të shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe fletë faktesh të Agjencisë Europiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë lidhur me substancat e rrezikshme në vendin e punës. Këto fletë faktesh janë përkthyer në shqip dhe mund të gjenden në adresën:

http://www.sli.gov.al/images/stories/focal_point/factsheet%2039-albanian.pdf

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUK): Në misionin dhe programin e MBUMK ka marrë nje theks të veçantë siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Bujqësore (DPPB) mban regjistrin e produkteve për mbrojtjen e bimëve (pesticideve) dhe plehërave kimike, i teston dhe kontrollon ato mbi bazën e legjislacionit dhe rregullave të nxjerra për një administrim më të mirë të tyre.

Ministria e Shëndetësisë (MSh) është hartuese e politikave të shëndetit mjedisor nëpërmjet strukturave të Drejtorisë së Kujdesit Shëndetësor Parësor në MSh, dhe konkretisht Inspektoratit Sanitar të tij dhe Sektorit të Higjienë-Epidemiologjisë, Departamentit të Shëndetit Mjedisor në Institutin e Shëndetit Publik, Drejtorive Rajonale të Shëndetësisë dhe shërbimeve të Inspektoratit Sanitar Shtetëror. Ministria e Shëndetësisë nuk kryen trajnime. Institucione të tjera janë përgjegjëse për to si p.sh Institui i Shëndetit Publik. MSh ka përgatitur draftin e një projektligji mbi produktet biocide.

Për të realizuar dhe zbatuar politikën e shëndetit mjedisor MSH bashkëpunon me shumë institucione të tjera në vend, si MMPAU, që është një nga partnerët kryesorë, MBUMK, MPPT, METE, etj. Këtu vlen për t'u përmendur edhe bashkëpunimi i ngushtë që ka ekzistuar prej kohësh dhe që vazhdon të jetë i tillë me organizma ndërkombëtare si OBSH, UNICEF, UNDP, etj.

Instituti i Shëndetit Publik (IShP) është qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër qendër informacioni. **IShP** është i organizuar dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik". IShP është përgjegjës për informimin, këshillimin dhe mbështetjen e MSh në hartimin e politikave dhe të strategjive në fushën e shëndetit publik, sigurimin e ekspertizave, realizimin e studimeve të pavarura, dhe pjesëmarrjen në formimin e burimeve njerëzore në shëndet publik. IShP kryen disa funksione, një prej të cilëve është informimi i popullatës rreth çështjeve të shëndetit publik. Për shembull Ministria e Shëndetësisë në bashkpunim me IShP ka organizuar me epidemiologjistë dhe inspektorë sanitarë të departamenteve të Shëndetit dhe bashkitë tre trajnime në dy vitet e fundit me tematikë të lidhur me biocidet dhe përdorimin e tyre në shëndetin public.

Departamenti i Promocionit, si pjesë e IShP, synon përmirësimin e shëndetit të popullatës dhe të individëve nëpërmjet promovimit të shëndetit, përmes proceseve sociale e politike, në nivel kombëtar dhe vendor, për krijimin e kushteve sociale, mjedisore dhe ekonomike, që rezultojnë në shëndet, si dhe të veprimeve që forcojnë aftësitë dhe mundësitë e komuniteteve e të individëve. Departamenti i Promocionit prej disa vitesh harton kalendarin e promocionit të shëndetit, i cili shërben për informim-sensibilizim- ndërgjegjësim të publikut të gjerë, mediave, strukturave të ndryshme rreth problemeve që ndikojnë në shëndetin e tyre. Në këtë kalendar janë vendosur edhe ditët botërore të ujit dhe mjedisit për organizimin e sensibilizimit të popullatës së gjerë për mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e ujit të pastër për të mbrojtur shëndetin e tyre. Specialistë të departamentit kanë publikuar artikuj në median e shkruar mbi rreziqet e përdorimit të qeseve plastike, kanë kryer aktivitete të përbashkëta me Bashkinë e qytetit të Pogradecit me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave të mesme të qytetit, me temë "Plazh i pastër, Shëndet për ju". Për ditën botërore të mjedisit për vitin 2011 u organizuan disa ditë aksione pastrimi në parkun e liqenit artificial të Tiranës me nxënës të shkollave të kryeqytetit me temë "Të ruajmë natyrën për një jetë të shëndetshme" i pasqyruar në web-in e IShP (www.ishp.gov.al).

Inspektorati Sanitar Shtetëror (ISSh) funksionon në varësi të MSh. ISSh ka ndjekur për shumë vite dhe vazhdon të ndjekë çështje thelbësore të shëndetit të punëmarrësve në gjithë veprimtaritë prodhuese të vendit, me fokus higjienën e industrisë, kushtet e punës, kushtet

higjieno–sanitare të degëve të ndryshme të veprimtarive të subjekteve publikë apo privatë dhe gjendjen shëndetësore të punëmarrësve.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) synon edukim cilësor për këdo e kudo në arsimin parauniversitar, arritje të standardeve bashkëkohore evropiane në arsimin universitar. Impulse konkrete në kërkimin shkencor dhe potencialin njerëzor, me qëllim impaktin e drejtpërdrejtë në zhvillimin.

Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe veterinarisë (ISUV) është instituti i referencës kombëtare dhe është organizuar në bazë të VKM. Nr. 515, datë 19.7. 2006. Ky institut është në varësi të MBUMK dhe është i cilësuar si laborator kombëtar reference. Ky institut kryen analiza në përputhje me nenin 18 të rregullores 2076/2005 të KE-së si dhe nenit 12 të rregullores 882/2004 të KE. Në bashkëpunim me OJF-të ekspertët e institutit kontribuojnë në fushatat e ndërgjegjësimit dhe edukimit në lidhje me përdorimin e pesticideve dhe kimikateve në ushqim.

Operatori i Sistemit të Transmetimit: Deri para pak vitesh, në Shqipëri nuk është punuar aq sa duhet për njohjen e PCB-ve dhe ndikimin e tyre në mjedis e në njerëz. Niveli i ndërgjegjësimit të punonjësve në objektet e sistemit energjistik mbi rrezikun e PCB-ve ka qenë shumë i ulët, për shkak të mungesës së informacionit, mungesës së legjislacionit përkatës dhe akteve normative që rrjedhin prej tij e për pasojë mungesës së procedurave për administrimin mjedisor të vajit të pajisjeve elektrike që mund të jetë i ndotur me PCB.

Për të përmirësuar situatën ekzistuese mjedisore, për të forcuar kapacitetet administruese mjedisore dhe rritur nivelin e ndërgjegjësimit të punonjësve të sistemit, pak vjet më parë në të gjithë objektet e sistemit u krijuan me mbështetjen e konsulencave ndërkombëtare mjedisore strukturat për menaxhimin e mjedisit. Stafi qëndror mjedisor inspekton rregullisht sipas Planit Vjetor të Inspektimit, verifikon situatën mjedisore dhe lejon detyrat konkrete të përmirsojnë situatën. Përgatit në mënyrë konstante materiale ndërgjegjësimi për mbrojtjen mjedisore, siguron informacion për legjislacionin mjedisor Shqiptar, organizon kurse të ndryshme trajnuese për punonjësit.

Qendra Kombëtare e Trajnimit të Mbrojtjes Civile është projektuar për të rritur numrin dhe kualifikimin e punonjësve të shërbimit të emergjencave civile në nivele të ndryshme, duke synuar përgatitjen e rezervave efektive dhe vullnetarëve. Krijimi i 3 njësive përgjegjëse dhe 3 Qendrave logjistike për mbrojtjen civile nga emergjencat dhe fatkeqësitë, është masa kryesore që do të mundësojë mbylljen deri në një shtrirje të caktuar të rrethit të menaxhimit të emergjencave, duke pasur parasysh që strukturat e tanishme dhe reagimi shpesh është i vonuar dhe jo profesional.

Media: Shkëmbimi i informacionit në çështjet e lidhura me kimikatet është tepër i rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimit si dhe për krijimin e njohurive të reja. Media luan një rol shumë të rëndësishëm për rritjen e ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e shoqërisë. Një media e lirë shpesh është e vetmja mënyrë për mobilizimin e popullsisë për implementimin e ndryshimeve. Janë organizuar 2 trajnime në Tiranë për gazetarët me tematikë gazetaria investigative. Trajnimet u organizuan në bashkpunim me projektin për zhvillim të One UN “Rritja e aftësive profesionale të gazetarët Shqiptarë në një botë të globalizuar” ajo u drejtohet gazetarëve nga klub UN press dhe të tjerë me interesa specifike në mjedis dhe u organizua nga kompania Inter Press Service. Takimet ndërsektoriale dhe ndërdisiplinore, takimet e përfaqësuesve të brezave të ndryshëm, qasja dhe përdorimi i rrjeteve të ndryshëm, e drejta për informacion, për gjendjen e mjedisit në çdo komunitet si dhe në të gjithë vendin, bazuar në shtyllën tre të Konventës së Åarhusit, janë mjete që përdoren për këtë qëllim. Këto takime organizohen nga organizata të ndryshme, (sektori privat), të interesuarit për këto çështje.

Media është një mjet i përshtatshëm për shpërndarjen e informacionit gjerësisht. Mjete të tjerë shumë të rëndësishëm për shkëmbimin e informacionit janë faqe interneti si: <http://chemicals.al>, <http://www.un.org.al/>, <http://pesticide-al.com>, <http://albania.rec.org>, www.mjedisot.info etj, buletinët e ndryshëm, si dhe media e shkruar, gazeta dyjavore “Ekolëvizja” dhe faqja e internetit (www.ekolevizja.org) si dhe Buletini i Ministrisë së Mjedisit, materiale ndërgjegjësuese, fletëpalosje, postera etj.

Pavarësisht informacionit të shpërndarë, dhe njëkohësisht rritjes së interesit për mjedisin, qytetarët shqiptarë nuk janë ende të mirëinformuar për marrëdhëniet mes mjedisit dhe shëndetit publik, si dhe përfitimet e një mjedisi të pastër për ekonominë dhe shoqërinë si një e tërë. Akoma ka një mungesë së menaxhimit të mbetjeve. Qytetarët shqiptarë akoma nuk i riciklojnë produktet e tyre. Shpesh herë, dyqanet vazhdojnë të shesin produkte pa etiketimin e duhur. Klientët nuk janë të interesuar për produktet e padëmshme për mjedisin, si dhe i kushtojnë shumë pak vëmendje përmbajtjes së produkteve që ata konsumojnë. Niveli i qytetarëve të aktivizuar në çështjet mjedisore mbetet akoma i ulët. Ende ekziston nevoja për të përmirësuar ndërgjegjësimin mjedisor në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Përveç kësaj, duhen marrë masa për të lehtësuar dhe për të nxitur të drejtën e publikut për të kërkuar informacion mjedisor. Interesi i publikut dhe shqetësimi për çështjet mjedisore është rritur gjatë viteve të fundit.

Ngritja e Qendrës së Informacionit Mjedisor të Åarhus-it ka rritur nga viti në vit interesin publik përse i përket informacionit mjedisor. Përpara krijimit të kësaj qendre, qytetarë Shqiptarë të interesuar në çështjet e ndryshme mjedisore shpesh nuk dinin ku t'i drejtonin kërkesat e tyre. Nga ana tjetër, kërkesat e Ministrisë së Mjedisit nuk përfundonin gjithmonë me një përgjigje. Krijimi i kësaj qendre ka si synim kryesor informacionin publik rreth çështjeve mjedisore, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe lirshmëri legislative për çështjet mjedisore.

PNUD: Përmes programit për Qeverisje Demokratike, PNUD-i në Shqipëri ka mbështetur reformën në administratën publike dhe trajnimin e shërbimit civil, menaxhimin ekonomik dhe transparencën, forcimin e menaxhimit të ndihmës së huaj dhe rritjen e besueshmërisë. PNUD-i në Shqipëri ka ndihmuar në ngritjen e institutit të parë dhe të vetëm për trajnimin e administratës publike në vend. PNUD-i ka ndihmuar Qeverinë për mbrojtjen e mjedisit përmes adresimit të çështjeve globale të mjedisit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve. Gjithashtu, PNUD-i ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për çlirimin e Shqipërisë nga efekti i minave dhe municioneve të paplasura. Në këtë kuadër, gjeti mbështetje adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Veprimit ndaj Minave për Shqipërinë, zhvillimi i kapaciteteve kombëtare për koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve të veprimit ndaj minave, pastrimi i minave, edukimi për rrezikun e minave dhe asistencë ndaj viktimave. PNUD-i synon të adresojë mungesën e informacionit mbi Shqipërinë në planin ndërkombëtar duke përmirësuar cilësinë dhe sasinë e informacionit mbi vendin në mënyrë që të rrisë reagimet pozitive dhe të krijojë një program më pozitiv që reflekton realitetin shqiptar. Gjithashtu, PNUD-i po ndihmon forcimin e kapaciteteve të media-s në vend për nxitjen e raportimit të përgjegjshëm mbi zhvillimin njerëzor.

UNICEF, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, Ministrinë e Mjedisit dhe me tre shoqata mjedisore në Shqipëri, Qendrën e grupimit “Ekolëvizja”, shoqatën EDEN dhe Institutin e Konservimit të Natyrës ka nisur që në 2008 dhe vazhdon zbatimin e një projekti në rang kombëtar për edukimin mjedisor dhe ndryshimin e sjelljes së fëmijëve në shkollat e ciklit të ulët. Projekti është quajtur Cleen. Një nga nënprojektet e veçantë të këtij projekti të madh është përqëndruar në informimin, ndërgjegjësimin dhe veprimin e fëmijëve në lidhje me plastikën, projekt i zbatuar nga Grupimi Ekolëvizja.

10.2 Edukimi dhe trajnimi për menaxhimin e shëndetshëm të kimikateve dhe mbetjeve

Institucione të ndryshme publike dhe jopublike kanë zhvilluar herë pas here aktivitete formimi e trajnimi mbi mirëmenaxhimin e kimikateve dhe mbetjeve. Disa nga këto aktivitete po i përshkruajmë më poshtë:

Specialistë të MMPAU kanë marrë pjesë në trajnime me tematikë menaxhimin e kimikateve, si “Workshop mbi NOQ dhe Planet Kombëtare të Veprimit në kuadër të Konventës së Stokholmit”, kryer në Qershor 2011 në Brno, Çeki, trajnim 5-ditor mbi “Menaxhimi i integruar i mbetjeve”, organizuar nga Horizont 2020 në Kajro, Egjipt në Mars 2011.

Agjencia e Kimikateve e Suedisë (KEMI) ka organizuar për disa vite rresht program trajnimit mbi “Strategji të Menaxhimit të Kimikateve”. 8 persona nga institucione të ndryshme të vendit, përfshirë MMPAU patën mundësi të merrnin pjesë në trajnimet e kryera në periudhën 2009 - 2011.

Instituti i Shëndetit Publik, në bashkëpunim me OBSH ka kryer herë pas here trajnime të stafit të Drejtorive të Shëndetit Publik në rrethe dhe Inspektorëve Sanitarë mbi çështje të shëndetit në punë, përfshirë edhe kimikatet e rrezikshme.

MSh dhe ISHP në bashkëpunim me kompanitë Arli International, PelGar dhe Quark, kanë organizuar me epidemiologët dhe inspektorët sanitarë të DShP-ve dhe bashkive dy trajnime mbi lëndët biocide, trajnimit me temë “Kontrolli i dëmtuesve: Lëndët biocide dhe metodat e aplikimit të sigurt në shëndet publik”, në Janar 2011 dhe trajnimit me temë “Metodologjitë e zbatuara për inspektimin higjieno-sanitar të strukturave publike për vlerësimin e nivelit të infestimit nga vektorët biologjikë (insekte dhe brejtës)” në Qershor 2011. Gjatë muajit Tetor 2011 është organizuar nga ISHP seminar trajnues me mjekë stomatologë për biocidet në fushën e stomatologjisë, ku u trajtuan gjerësisht jo vetëm fushat e përdorimit të biocideve në parandalimin e infeksioneve, por edhe në rregullat e përdorimit, ato të mbrojtës së shëndetit dhe mjedisit nga këto lëndë. Këto trajnime u akredituan nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim (QKEV).

Përmes zbatimit të projektit “Identifikimi dhe prioritizimi i pikave të nxehta mjedisore në Shqipëri”, gjithashtu është realizuar trajnimi i aktorëve lokalë për të siguruar zbatimin e masave të integruara dhe zbatimin e politikave të reja të menaxhimit për pastrimin e zonave, si dhe është përgatitur dhe shpërndarë një broshurë për menaxhimin e zonave të nxehta mjedisore.

Aktivitete të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare, si konferenca e kongrese janë përdorur si mundësi për shpërndarjen e njohurive dhe trajnime. Kështu, gjatë Kongresit III Ndërkombëtar të Shëndetit Rural për Mesdheun dhe vendet e Ballkanit, që u zhvillua në Tiranë në vitin 2010, një sesion i posaçëm iu kushtua një trajnimi mbi vlerësimin e riskut shëndetësor.

ISHP, në bashkëpunim me Shërbimin Shëndetësor të Bashkisë së Limburgut të Jugut, Hollandë, dhe me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Mjedisit të Hollandës (RIVM) ka zhvilluar në vitin 2011 një trajnim mbi “Mjekësinë mjedisore dhe vlerësimin e riskut”. Në trajnim morën pjesë specialistë të ISHP dhe të DShP-ve të rretheve.

Shoqata Europiane e Toksikologëve (EUROTOX) organizoi në 2009 një trajnim një-javor mbi Toksikologjinë Bazë. Në aktivitet morën pjesë specialistë dhe studentë nga Europa dhe nga Shqipëria.

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) ka hartuar të parën kurrikul të plotë për edukimin mjedisor në Shqipëri, të quajtur “Paketa e Gjellbër”. Ajo është shpërndarë me ndihmën e

Drejtorive Arsimore Rajonale, në të gjitha shkollat 9-vjeçare të vendit. REC vazhdon të kontribuojë jo vetëm në njohjen dhe futjen e lëndës së edukimit mjedisor në shkollë, por dhe në ngritjen profesionale të mësuesve që do të trajtojnë këtë lëndë në shkollë. REC ka organizuar disa trajnime për mësuesit e edukimit mjedisor mbi zhvillimin e aktiviteteve mjedisore në shërbim të komunitetit dhe të përmirësimit të cilësisë së mjedisit. Pjesë e aktiviteteve të REC janë dhe seminarët e organizuara me universitete të ndryshme të vendit, me tematika të edukimit mjedisor dhe ligjeve mjedisore. REC në kuadër të një programi për grant-dhënie ka mbështetur OJF të ndryshme në aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit si Instituti i Kërkimeve Bioteknologjike për organizimin e një workshop-i në lidhje me përmirësimin e legjislacionit për grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve vajore si dhe kimikateve përbërëse. Njëkohësisht janë përgatitur dhe shpërndarë postera, fletëpalosje dhe materiale ndërgjegjëse.

Qendra EDEN zhvillon programe edukative, publikon materiale dhe organizon veprimtari publike, që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit publik në lidhje me mjedisin. Organizata drejton Qendrën e Burimeve Mjedisore dhe ka një grup trajnerësh e programesh për ngritjen e kapaciteteve për aktorët si publike dhe private. Në kuadër të ndërtimit të kapaciteteve të lidhura me informacione për kimikatet e rrezikshme, Qendra EDEN ka organizuar dy aktivitete trajnime. Qëllimi i të parit është “Mënyra e kompozimeve, përdorimi i tyre dhe përfitimet e tyre”. Pjesë e këtij aktiviteti ishte punësimi nga ana e bashkisë së Divjakës dhe të fermerëve të zonës. Aktiviteti i dytë i organizuar kishte si target grup gjeneratën e re, me synimin rritjen e dijeve të rinjëve në lidhje me kimikatet që gjenden në ushqime, efektet e tyre negative, mënyrat se si mund të kontrollohet ushqimi i tyre. Ky aktivitet u zhvillua nën projektin “Sa të sigurt janë produktet tona ushqimore”.

10.3 Vlerësimi

Ende ekziston një perceptim i dobët për çështjet në lidhje me sigurinë ndaj kimikateve dhe se si ekspozimi ndaj kimikateve dhe mbetjeve toksike mund të shkaktojë dëmtime të pakthyeshme në shëndet dhe degradim të mjedisit, çka ndikon më tej në mirëqenie dhe zhvillim ekonomik. Egzistojnë disa aktivitete të shpërndarjes së informacionit por aplikimet praktike për këtë meten të ulta. Mundësitë për alternativat e produkteve mbetet i kufizuar. Mungojnë trajnimet e rregullta dhe programet për çështjet e lidhura me kimikatet. Grupe të caktuara të popullsisë mund të jenë në rrezik të veçantë ndaj ekspozimit të kimikateve toksike, si rrjedhim, një edukim më i mirë, mund t'i ndihmojë ata në reduktimin e ekspozimeve të tilla.

Ndërgjegjësimi për rrezikun ndaj kimikateve në të gjitha grupmoshat si dhe në të gjitha nivelet është ende i ulët. Ka ende nevojë për ndërhyrje në nivelin universitar për zhvillimin e një kurrikule për sigurinë ndaj kimikateve. Krahas Paketës së Gjelbër, duhet të futet si lëndë e veçantë në shkollat e larta të sistemit Bachelor Higjiena e Punës dhe Siguria në Punë, kjo veçanërisht në shkollat mjekësore dhe ato profesionale të tjera. Kjo do të kontribuojë në ngritjen e nivelit të dijeve të rinjëve lidhur me mbrojtjen në punë nga faktorë dëmtues të shëndetit, përfshirë edhe dëmtuesit kimikë.

Ndërgjegjësimi si dhe trajnimi i grupeve të ndryshme të profesionistëve, si fermerëve, transportuesve, industrialistëve, stafit teknik, si edhe i konsumatorit, për sigurinë në përdorimin e kimikateve, është një hap i rëndësishëm për uljen e këtij risku. Akoma mungojnë trajnime për fermerët, puntorët e industrive, punonjësit e doganave, profesionistët e përgjigjes ndaj emergjencave kimike. MSh është duke përgatitur draft-vendime të reja të bazuara në Ligjin për shëndetin dhe sigurinë në punë. Qëllimi i këtyre draft-vendimeve është të sigurojë një bashkëpunim midis të tjerëve për të mbushur këtë boshllëk.

Është i nevojshëm organizimi i kurseve të informimit/ trajnimit me specialistë të shëndetit publik në rrethe lidhur me vlerësimin e riskut, menaxhimin e riskut dhe përcaktimin e algoritmeve për subjekte apo objekte industriale, duke patur parasysh mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve.

Mungon bashkëpunimi mes institucioneve dhe organizatave të ndryshme për rritjen e ndërgjegjësimit për kimikatet.

Duhet rritur dhe strukturuar roli i mediave dhe duhet të hapet komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale, ato mund të përdoren për qëllime informimi dhe sensibilizimi.

Tabela 10.B: Prioritetet dhe veprimet e mundshme: Ndërgjegjësimi/ të kuptuarit e punëtorëve dhe publikut dhe trajnimi e edukimi i grupeve të synuara dhe profesionistëve

Çështjet e rëndësishme (renditur sipas prioritetit)	Niveli i kapaciteteve ekzistuese	Përmbledhje e kapaciteteve, pikave të forta, mangësive dhe nevojave	Veprimet e mundshme	Aktorët e interesuar
Pesticidet	Mesatar	Mungesë informacioni të mjaftueshëm mbi rrezikun e përdorimit të tyre në shëndet dhe mjedis, mbi përdorimin e duhur të etiketës si mjet shumë i rëndësishëm i komunikimit të riskut.	Trajnime për farmacistët bujqësorë, fermerët dhe emisione televizive; Spote televizive, fletë palosje, artikuj në median e shkruar, postera; Hapja e faqeve sociale në internet, Facebook, Twitter.	MBUMK, Universiteti Bujqësor, MPÇSShB, MSh, ISHP (Dep. Promocionit), Kompanitë importuese, OJF-të mjedisore, punonjësit e spërkatjes apo trajtimeve, etj.
Nafta dhe produktet e saj	I ulët	Mungesë informacioni	Programet televizive, reklamat, shkrime në median e shkruar, posterat, faqet në rrjetet sociale, Facebook dhe Twitter.	MPPT, MSh, QRM, Bashkitë, ARM (Agjencitë rajonale mjedisore)
Detergjentët	I ulët	Nuk ka informacion	Trajnim sidomos me shoqatat e grave, emision televiziv dhe reklama, spote televizive, fletë palosje, artikuj në median e shkruar, Postera, Faqet sociale në internet, Facebook e Twitter	METE, MSh, Kompanitë prodhuese, popullsia (veçanërisht gratë)
Barnat e skaduara	I ulët	Farmacistët nuk kanë informacion për rrezikun që shkakton asgjësimi jo korrekt i mbetjeve farmaceutike.	Trajnim për farmacistët dhe emision televiziv mbi mënyrën e asgjësimit të barnave të skaduara dhe rrezikshmërinë që paraqet në rastin e një asgjësimi jo konform rregullave Spote televizivë, fletë palosje, artikuj në median e shkruar, Postera, Faqet sociale në internet, Facebook e Twitter.	MSh, QKKB, Farmacitë, Shoqatat mjedisore dhe shëndetësore
Bojrat në tekstile	-	-	Programe televizive në	METE, MSh,

			lidhje me kujdesin ndaj tekstileve me ngjyrë, spote publicitare, fletëpalosje, artikuj në median e shkruar, postera, faqet në rrjetet sociale si Facebook dhe Twitter.	Dhomat e Tregëtisë, Shoqata të ndryshme mjedisore, konsumatorët; OJF Mjedisore
Mbetjet kimike në laboratorë ¹	I ulët		Përgatitja e një udhëzuesi se si të menaxhohen mbetjet në laborator; Trajnim për stafin e laboratorëve; Spote televizive, fletë palosje, artikuj në median e shkruar, postera.	Të gjitha institucionet që kanë laboratorë, institucionet kërkimore,
Bateritë	I ulët		Informacioni dhe rritja e sensibilizimit për rreziqet e baterive për shëndetin dhe mjedisin kur nuk asgjësohen në mënyrë të përshtatshme, reklamat, fletpalosje, artikuj në median e shkruar, postera, faqe në rrjetet sociale Facebook dhe Twitter.	Shoqata të ndryshme mjedisore.

¹ Ndërgjegjësimi dhe trajnimi duhet të paraprihen apo të zhvillohen paralelisht me krijimin i infrastrukturës së përshtatshme.

KAPITULLI 11: BASHKËPUNIMI DHE PËRFSHIRJA NË ORGANIZATAT, ORGANIZMAT DHE MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Kapitulli i 11 jep në mënyrë të përmblëdhur përfshirjen e vendit në aktivitetet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, duke bërë të mundur për të gjitha grupet e interesuara kontaktet në institucionet shtetërore që koordinojnë punën me organizatat përkatëse ndërkombëtare. Pikat kryesore të kontaktit në kuadër të këtyre marrëveshjeve janë në MMPAU, METE, MSh, MPÇSShB, MPPT. Gjithashtu në këtë kapitull tregohen projektet që janë zbatuar apo që janë duke u zbatuar në vend në kuadër të këtyre marrëveshjeve, nën asistencën teknike dhe financiare të organizmave ndërkombëtare.

Koordinimi në nivel kombëtar lidhur me zbatimin e kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e kimikateve, mbetet i ulët.

11.1 Bashkëpunimi dhe përfshirja me organizatat ndërkombëtare, organet e ndryshme dhe marrëveshjet.

Tabela 11.A përmblëdh kontaktet në organizatat ndërkombëtare, veprimet e duhura ose programet e ndërmarra si dhe ministri dhe agjenci të tjera të përfshira.

Table 11.A: Anëtarësimi në organizatat, programet dhe organizmat ndërkombëtare

Organizma ndërkombëtare	Pika Fokale kombëtare	Ministri dhe agjenci të tjera të përfshira	Aktivitetet kombëtare
UNEP	Z. Sejdi Qerimaj, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe i Plotëfuqishëm. Përfaqësues i përhershëm Shqipërisë në Gjenevë <i>Adresa:</i> Rue du Môle 32 1201 Geneva Tel: +41 22 731 11 43 Fax: +41 22 738 81 56 Email: mission.geneve@mfa.gov.al	MMPAU	Programi Kombëtar për një Prodhim më të Pastër në Shqipëri
UNEP/UNIDO Qendrat Kombëtare të Prodhimit të pastër	Znj. Marieta Mima, ECAT Tirana (Qendra mjedisore për administrim dhe teknologji) <i>Adresa;</i> Rr. A. Frashëri, Pall.16/ Shk.6/ Ap.53, Tirana, Albania Phone / Fax: +355 4 2223930 Mob/ 00355-682085689 e-mail: ecat@ecat-tirana.org www.ecat-tirana.org	MMPAU; METE	Programi Kombëtar për një Prodhim më të Pastër në Shqipëri
IPCS Programi Ndërkombëtar i Sigurisë Kimike	Zyra vendore OBSH, Tiranë, Shqipëri <i>Adresa;</i> Rruga Themistokli Gërmenji, Pallati 10 office@who-albania.org http://www.euro.who.int	MSh	Forcimi i kapaciteteve në vendet e Ballkanit për të përmirësuar angazhimin në aktivitete Codex Alimentarius,

			Durrës, Shqipëri, 6-8 shtator 2011
WHO	Z.Ehad Mersini MersiniE@euro.who.int Zyra vendore OBSH, Tiranë, Shqipëri Adresa; Rruga Themistokli Gërmenji; Pallati 10, Tiranë office@who-albania.org http://www.euro.who.int	MSh	Nuk ka të dhëna
FAO	Z. Zef Gjeta Zef.Gjeta@fao.org Tel: +355-4-228355 Fax: +355(0) 4-228355 E-mail: NC-FAO-ALB@fao.org		
UNIDO	Këshilli i Ministrave; Një program i KB në Shqipëri; Departmenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj Këshilli i Ministrave Adresa: Blv. Dëshmorët e Kombit, Tirana, Albania Tel: +355 4 2 277 357 Fax: +355 4 2 226 354 E-mail: koordinimi@km.gov.al Website: www.dsdc.gov.al	MMPAU; METE	-Programi Kombëtar për një Prodhim më të Pastër në Shqipëri -Plani kombëtar për menaxhimin e substancave ozonholluese.
ILO	Z. Alfred Topi Zyrat e KB, Godina Gurten Adresa; Rr. Kavajës, Tirana Cel: +355 692 434916 E-mail: topi@ilo.org	MPÇSShB	ILO nuk ka zhvilluar në Shqipëri asnjë aktivitet që lidhet me kimikatet
UNDP	Znj. Fioralba Shkodra Drejtues grupi/ UN analist koordinimi/ fioralba.shkodra@one.un.org Znj. Elvita Kabashi, Analiste e programit për sektorin e mjedisit. Elvita.kabashi@undp.org Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri Adresa: Rr. "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, kati i 6, Tiranë, Shqipëri Tel.: +355 (4) 2400 721, 2400 722, 2400 723, 2400 724 Fax: +355 (4) 2400 725, 2400 726	MMPAU dhe ministrinë e linjës	Projekti 'Identifikimi dhe Prioritizimi i Pikave të Nxeha Mjedisore në Shqipëri' financiar nga Qeveria e Mbretërisë së Hollandës. Ky studim përmbledh përgatitjen e vlerësimit të ndikimit në mjedis sëbashku me planet rehabilituese dhe kostot respektive për nëntë pika të nxeha mjedisore.
Banka Botërore	Znj. Ana Gjokutaj Zyra e Bankës Botërore Adresa; Rr. "Dëshmorët e 4	MB; Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IEWE);	

	Shkurtit" Tiranë, Shqipëri Tel. (355 4) 2280 650/1 Fax. (355 4) 2240 590 Email: agjokutaj@worldbank.org	MPPTT; MF	
Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD)	Adresa: Rr. Abdi Toptani Ndërtesa Torre Drin, kati i 4 Tiranë, Shqipëri Tel: +355 4 2232 898 Fax: +355 4 2230 580	MMPAU; METE; MF	Banka po punon aktualisht në vendosjen e prioritetëve për përmirësimin mjedisor të pikave kritike të Fushës së Naftës së Patos Marinzës si një pjesë e një Grupi Pune ndërministror
OECD	Nuk ka përfaqësi Proj LEED (Projektet për ekonominë dhe punësimin vendas)		Vlerësimi i zhvillimit të kapaciteteve në nivel lokal në vendet kandidate dhe potencial kandidate në BE
UN Regional Economic Commissions	Znj. Laureta Dibra , Pikë Fokale Kombëtare, P/Spektori në MMPAU UNECE/CLRTAP UNECE/ Konventa për mbrojtjen dhe përdorimin e rrjedhave ujore ndër kufitare dhe liqeneve ndërkombëtare MMPAU Rruga e Durrësit, Nr.27, Tiranë Laureta.Dibra@moe.gov.al Z. Fatos Bundo , Konventa e Aarhusit MMPAU Rruga e Durrësit, Nr.27, Tiranë Fatos.Bundo@moe.gov.al	MMPAU dhe ministritë e linjës	U hartua PKV për ratifikimin dhe zbatimin e 3 Protokolleve: Metalet e Rënda, Gothenborg, POP-s
Agjencia Europiane për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë	Znj. Frosina Gjino Inspektorati Shtetëror i Punës Adresa: Rr. Dervish Hima Tel: +355 4 251348 Email: fgjino@hotmail.com	MPÇSShB	Agjencia Europiane për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë nuk ka zhvilluar në Shqipëri asnjë aktivitet që lidhet me kimikatet
UNICEF	Ms. Mariana Bukli Adresa: Rr. Skënderbej, Volkswagen Bld., 3rd floor, Tirana, Albania mbukli@unicef.org	MASh, MMPAU, Grupimi “Ekolëvizja”, Qendra “Eden”, Instituti i Konservimit të Natyrës	UNICEF, ka nisur që në 2008 dhe vazhdon zbatimin projektit CLEEN në rang kombëtar për edukimin mjedisor dhe

			ndryshimin e sjelljes së fëmijëve.
--	--	--	------------------------------------

Tabela 11.B jep një përmbledhje të pjesëmarrësve në marrëveshjet ndërkombëtare apo procedurat e lidhura me ciklin jetësor të menaxhimit të kimikateve, agjencitë kryesore të lidhura me marrëshjen përkatëse, pikat e kontaktit dhe aktivitetet kombëtare përkatëse të implementimit. Ministritë kryesore të përfshira në aktivitetet e organizuara në kuadër të këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare janë MMPAU, METE, MSh, MPÇSShB, MPPT, ku për çdo marrëveshje ndërkombëtare janë përcaktuar edhe Pikat Fokale nga institucionet përkatëse.

Table 11.B: Pjesëmarrja në marrëveshjet ndërkombëtare/ procedurat në lidhje me menaxhimin e kimikateve

Marrvëshjet ndërkombëtare	Agjencia përgjegjëse kryesore, pika e kontaktit	Implementimi i aktiviteteve të rëndësishme kombëtare
SAICM (Qasja Strategjike Ndërkombëtare ndaj Menaxhimit të Kimikateve)	Znj. Lindita Tafaj (Hajri) Pikë Fokale Kombëtare (PFK) www.saicm.org Instituti i Shëndetit Publik Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, Nr.80, Tiranë, Shqipëri: ltafaj@chemicals.al linda_tafaj@yahoo.com www.chemicals.al	Projekti SAICM QSPTF “Forcimi i kapaciteteve për implementimin e SACIM-it në Shqipëri
Konventa e Stokholmit	Znj. Roven Agalliu, PFK, MMPAU; Adresa: Rr. Durrësit, Nr. 27, Tiranë, Shqipëri Rovena.Agalliu@moe.gov.al	Plani kombëtar i implementimit për reduktimin dhe eliminimin e NOQ-ve përgatitur në 2006
Konventa e Roterdamit	Znj. Roven Agalliu, PFK, MMPAU Adresa: Rr. Durrësit, Nr. 27, Tiranë, Shqipëri Rovena.Agalliu@moe.gov.al	
Konventa e Bazelit	Z. Redi Baduni Drejtor i Drejtorisë së Mbrojtjes Së Mjedisit, MMPAU Adresa: Rr. Durrësit, Nr. 27, Tiranë, Shqipëria Redi.Baduni@moe.gov.al	
Protokolli i Montrealit	Znj. Laureta Dibra PFK, Drejtoreshë e Sektorit, MMPAU Adresa: Rr. Durrësit, No.27, Tiranë, Shqipëri Laureta.Dibra@moe.gov.al	
Konventa e ILO-s Nr.170 Për Sigurinë e Përdorimit të Kimikateve në Punë (1990)	MPÇSShB	Konventa e ILO-s Nr.170 nuk është ratifikuar
Konventa e ILO Nr.174 Për Parandalimin e Aksidenteve të Mëdha Industriale (1993)	MPÇSShB	Ratifikuar në 203

Konventa e Armëve Kimike	Z. Fadil Vucaj Ministria e Mbrojtjes Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë fadilvucaj@mod.gov.al	
Rekomandimet e Kombeve të Bashkuara për Transportin e produkteve të rrezikshme	MPPT, Drejtoria e Transportit	Marrveshja Europiane për transportin të rrugëve ndërkombëtare të mallrave të rrezikshme(ADR) i 30 Shtatorit 1957, i ratifikuar me Ligjin Nr. 9272, dt. 16.9.2004; protokolli që amendon nenin 1 (A) and 14 (1), (3) B i ADR i 28 Tetorit, 1993, i ratifikuar nga parlamenti Ligj Nr. 9378 i 28.4.2005 ka hyrë në fuqi në 9.3.2006 .
Agenda 21 – Komisioni për Zhvillim të Qëndrueshëm	Znj. Valbona Kuko, Drejtore i DEBASKON (Departamenti i Strategjisë dhe i kordinimit të donatorëve) Adresa:Këshilli i ministrave, Blv. Dëshmorët e Kombit, Tirana, Albania koordinimi@km.gov.al www.dsdc.gov.al	MMPAU dhe ministritë e linjës
Udhëzimet e Londrës të UNEP (procedurat vullnetare)	MMPAU	Nuk ka informacion
Marrëveshjet Rajonale/Nënrajonale për Konventën “ Për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga Ndotja” (Konventa e Barcelonës). Protokolli ‘ Për parandalimin dhe eliminimin e ndotjeve të detit Mesdhe nga hedhjet e mbetjeve nga anijet dhe avionët si dhe nga djegia e tyre në det” Protokolli “ për bashkëpunimin në luftën kundër ndotjeve në detin Mesdhe të shkaktuara nga derdhjet e naftës dhe substancave të tjera në raste aksidentesh” (protokolli i emergjencës mesdhetare) Protokolli “ Për mbrojtjen e detit Mesdhe nga burimet tokësore dhe aktivitetet”Protokolli “Për zonat e mbrojtjes së veçantë” Protokolli i Mbrojtjes së detit Mesdhe kundër Ndotjeve të Shkaktuara nga Zbulimi dhe Shfrytëzimi i shtratit detar dhe	Z. Redi Baduni Drejtore i Drejtorisë së Mbrojtjes së Mjedisit MMPAU Adresa: Rr. Durrësit, Nr. 27, Tiranë, Shqipëri Redi.Baduni@moe.gov.al	

nëntokës” Protokolli “ Për parandalimin e ndotjes së detit Mesdhe nga transporti ndërkufitar i mbetjeve të rrezikshme dhe depozitimeve të tyre ”. Janë në vazhdim procedurat për të bërë Shqipërinë pjesë të protokollit të shtatë të kësaj konvente të quajtur ”Menaxhimi i Integruar i Zonave bregdetare”.		
CP/RAC	Znj. Laureta Dibra Pikë Fokale Kombëtare MMPAU Adresa: Rr. Durrësi, Nr.27; Laureta.Dibra@moe.gov.al	
REMPEC	Z. Shkëlqim Xhaxhiu Pikë fokale, Drejtori i Politikave të Transportit Detar, Parandalimi dhe Konventat ndërkombëtare të Gadishmësisë, përgjigjes dhe bashkpunimit të ndotjeve nga nafta OPRC, MPPT Adresa: Rr. Durrësit, Nr. 27, Tiranë, Shqipëri Tel: +355 (4) 23 80 744 Fax: +355 (4) 22 25 106	
Marrëveshjet bilaterale	MMPAU, MPJ, ministritë e linjës	

11.2 Pjesëmarrje në projekte të caktuara të Asistencës Teknike dhe të Zhvillimit

Tabela 11.C jep një përmbledhje të projekteve që janë duke u zbatuar në vend që lidhen drejtpërdrejtë ose indirekt me menaxhimin e kimikateve të zbatuara nga organizma të ndryshëm ndërkombëtarë.

Rehabilitimi i zonave të nxehta mjedisore vazhdon të jetë një prioritet që kërkon zgjidhje të shpejtë me qëllim mbrojtjen e mjedisit, shëndetit, jetës dhe ekonomisë së komuniteteve përgjithësisht rreth tyre, si dhe për të shmangur implikimet në mjedisin ndërkufitar.

Të mbështetur nga programet e UNDP për mjedisin, Qeveria Hollandeze, projektet CARDS 2000 dhe 2005, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ka ndërmarrë një sërë masash dhe ka një progres në rritje përsa i takon disa prej hot spoteve më problematike.

Nën asistencën e projektit SELEA (IPA 2010) është parashikuar që brenda vitit 2013 të përgatitet drafti i ri i ligjit për kimikatet që do të transpozojë Rregulloren 1907/2006 të Këshillit të Europës, në 18 Dhjetor 2006 mbi Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin e Kimikateve.

Ndër këto aktivitete mund të përmendim:

- Projekti “Forcimi i kapaciteteve të Ballkanit Perëndimor për rehabilitimin e pikave të nxehta mjedisore – projekti i Bajzës”;
- Projekti “Identifikimi dhe prioritizimi i hot spoteve në Shqipëri”;
- Rehabilitimi i pikës së nxehtë të Porto Romanos në Durrës;
- Reduktimi i ndotjes në pikën e nxehtë të rafinerisë së naftës në Ballsh;
- Eliminimi i Arsenikut në Fier Faza II;
- Rehabilitimi i hot-spot-it në Rubik;
- Rehabilitimi i Hot-spot-it të PVC-së në Vlorë.

Sa i përket inventarit të aktiviteteve dhe pajisjeve që përdorin lëndë ozonholluese (LHO), ky inventar është kryer me sukses nga Projekti i Ozonit dhe plotëson edhe një nga detyrimet që vendi ynë ka ndaj kërkesave të Protokollit të Montrealit. Brenda vitit 2009, vendi ynë ka realizuar plotësisht detyrimet ndaj Protokollit të Montrealit.

Është planifikuar të bëhet përditësimi i Planit Kombëtar për Reduktimin dhe Eliminimin e Ndotësve Organike të Qëndrueshëm (NOQ).

Tabela 11.C: Pjesëmarrje në projekte të caktuara të asistencës teknike

Emri i projektit	Agjencitë donatore bilaterale/ndërkombëtare të përfshira	Pika kombëtare e kontaktit	Aktivitetet relevante
Projekti "Për largimin e PCB"	Financuar nga GEF-UNDP, 2005-2006	Z. Pellumb Abeshi Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Mjedisore MoEFWA Adresa: Rr. Durrësit, Nr. 20, Tirana, Albania Pellumb.Abeshi@moefwa.gov.al	U përgatit Plani Kombëtar i Veprimit për reduktimin dhe eliminimin e Ndotësve Organike të Qëndrueshëm (NOQ).
Programin kombëtar të heqjes nga përdorimi të substancave ozonholluese	UNIDO dhe UNEP	Z. Gazmend Gjyli Njësia e Projektit të Ozonit MMPAU ggjyli@yahoo.com	Planifikimi për vitin 2009 ishte reduktimi i sasisë së CFC nga 4,08 ton në 2,2 ton. Masat për heqjen nga prodhimi dhe përdorimi i të gjitha substancat ozonholluese (CFC) të kontrolluara nga protokollit në përputhje me kuotat vjetore të importuara të konsumit, u realizuan plotësisht duke i reduktuar këto sasi nga 4,08 ton në 0 ton. Është hartuar PKV për heqjen nga përdorimi të HCFC i miratuar nga UNIDO. Duke qënë së detyrimi për heqjen nga përdorimi dhe prodhimi të CFC u realizua, atëherë për periudhën 2010-2013 do të futet për monitorim një indikator tjetër dhe pikërisht mbajtja në kuotën 120 ton të hidroklorflorkarboneve (HCFC), të pandryshuar deri në vitin 2013 (detyrim sipas Protokollit të Montrealit). Synohet që sasia prej 120 ton të reduktohet me 10% nga viti 2013 në vitin 2015 duke e zvogëluar sasinë në 108 ton. Objektivi afatgjatë është zvogëlimi në 29 ton deri në vitin 2040.
Projekti "Identifikimi dhe Prioritizimi i Hot-spoteve në Shqipëri" Janar 2008 — Gusht 2011	UNDP	Znj. Klodiana Marika METE, MMPAU	Është kryer inventari i 35 pikave të nxehta të identifikuara -Janë përgatitur raportet e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe 9 plane për rehabilitimin e pikave të nxehta prioritare; http://hotspotsproject.org/index.php?hs=news_details&id=2

Emri i projektit	Agjencitë donatore bilaterale/ ndërkombëtare të përfshira	Pika kombëtare e kontaktit	Aktivitetet relevante
		Menaxhere e projektit klodiana.marika@undp.org Tel: +35542242738 Mob: +355692092872	
Projekti: “Forcimi i kapaciteteve në vendet perëndimore të ballkanit për të ulur problemet mjedisore me anë të rehabilitimit të pikave të nxehta me prioritet të lartë. Hotspoti i Bajzës”. Tetor 2007 – Qershor 2011	UNDP; Qeveria Hollandeze	METE, MMPAU Znj. Klodiana Marika Menaxhere e projektit klodiana.marika@undp.org Tel: +35542242738 Mob: +355692092872	-Ne kuader te ketij projekti eshte realizuar rehabilitimi mjedisor dhe shendetesor duke bere te mundur trajtimin, ripaketimin dhe largimin e kimikateve nga Stacioni Hekurudhor i Bajzes. -Ka perfunduar Plani Lokal i Veprimit ne Mjedis per komunen e Bajzes dhe pritet miratimi përfundimtar i tij. -U identifikuan dhe u rehabilituan pikat e nxehta mjedisore NFIM Balëz në Elbasan, Minierat Repts dhe Rrëshen. -Gjithashtu në kuadër të këtij projekti u zhvilluan aktivitete që synuan rritjen e kapaciteteve me fokus menaxhimin e kimikateve, cilësisë së ujrave, cilësisë së ajrit, minierave dhe riskut. http://www.undp.org/me/rep/Reg%20Env%20HS%20ProDoc.pdf
Programi Kombëtar për Prodhim më të Pastër (PKPP) në Shqipëri si pjesë e Programit të One UN Programme në Shqipëri 2010-2013	Në Shqipëri PKPP zbatohet nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (UNIDO) sëbashku me Programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP) si pjesë e programit të tyre të përbashkët	Znj. Marieta Mima ECAT Tirana, MMPAU, METE. Adresa: Rr. A. Frasheri, Pall.16, Shk.6, Ap.53, Tirana, Albania Phone/Fax: +35542223930 Mob: 00355682085689 ecat@ecat-tirana.org	Programi Kombëtar për një Prodhim më të Pastër në Shqipëri mbështet arritjet e mekanizmave ligjore dhe rregullatore me synim: -reduktimin e degradimit të mjedisit -nxitja e efijencës së energjisë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve promote. Zhvillimi i kapaciteteve, promovimi dhe trajnimet profesionale, dhe vendosja e një rrjeti shqiptar personash që do të zhvillojnë shërbimet e vlerësimit të RECP në ndërmarrjet Shqiptare dhe organizata të tjera, në veçanti sektorët prioritar industrial. Demonstrime industriale që paraqesin një koleksion punësh të sukseshme për zbatimin e koncepteve, metodave dhe teknikave të RECP të bizneseve shqiptare me mjedise, përdorim burimesh dhe fitime

Emri i projektit	Agjencitë donatore bilaterale/ ndërkombëtare të përfshira	Pika kombëtare e kontaktit	Aktivitetet relevante
	global për Përdorimin e Efektshëm të Burimeve dhe Prodhim më të Pastër (PEBPP)	www.ecat-tirana.org	ekonomike të faktuara. Mekanizmave mbështetës politikë për futjen e koncepteve të RECP dhe instrumentave politikë në politikat dhe strategjitë kryesore shqiptare duke përfshirë edhe marrveshjet institucionale.
Në kuadër të “Konventës mbi Ndotjen Ndërkufitare e Ajrit në Distançë të Largët (CLRTAP)”, në bazë të Projektit Ballkanik është hartuar Plani Kombëtar i Veprimi (PKV) «Për ratifikimin dhe implementimin e Protokollit të Metaleve të Rënda, Protokollit për Ndotësit Organik të Qëndrueshëm dhe Protokollin e Gothenburgut të Konventës së Ndotjes Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët ».	Qeveria Hollandeze Sekretariati CLRTAP	Znj. Laureta Dibra Përgjegjëse e Sektorit të Ajrit, Ndryshimeve Klimatike dhe Kimikateve MMPAU Adresa: Rr. Durrësit, Nr. 20, Tiranë, Shqipëri Tel: 0692040456 Laureta.Dibra@moe.gov.al	U aprovua Plani Kombëtar i Veprimi. Është hartuar Inventari Kombëtar i Shkarkimit të Emisioneve 1990-2008. http://www.ceip.at/review-process/review-2011/review-results-2011/

11.3 Vlerësimi

Në MMPAU ka një drejtori që menaxhon projektet në fushën e mjedisit, e cila koordinon punën me drejtoritë teknike në ministri për të identifikuar nevojat dhe prioritetet për identifikimin e projekteve të ndryshme që lidhen me menaxhimin e cilësisë së ajrit, ujrave, mbetjeve, kimikateve, ndryshimeve klimatike, ndotjes industriale, në përputhje kjo edhe me kërkesat e marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara.

Aktualisht nuk ka një koordinim në nivel kombëtar lidhur me zbatimin e kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e kimikateve, të integruara në një program kombëtar. Mungojnë procedurat që sigurojnë koordinimin midis agjencive përgjegjëse për zhvillimin e aktiviteteve të asistencës dhe atyre përgjegjëse për mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit. Në këtë kontekst, agjencitë ndërkombëtare duhet të përmirësojnë mekanizmat e koordinimit midis institucioneve, duhet të sigurojnë një komunikimin më të mirë, praktik dhe gjithashtu të sigurojnë adaptimin me kushtet lokale.

Vështirësitë në zbatimin e kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare lidhen me mungesën e kapaciteteve në numër dhe kapaciteteve teknike në institucionet përgjegjëse. Nuk ka një agjenci të menaxhimit të kimikateve që të kryejë detyrat që dalin në zbatim të kërkesave bazë të konventave dhe rregulloreve përkatëse të BE në fushën e kimikateve. Mungojnë projektet e asistencës teknike për zhvillimin e kapaciteteve teknike në nivel kombëtar dhe lokal.

Gjithashtu zbatueshmëria e legjislacionit sa i përket identifikimit të operatorëve industrialë që prodhojnë, ruajnë, përdorin, importojnë apo eksportojnë kimikate është e ulët. Forcimi i kapaciteteve për inspektorët sanitarë, të mjedisit, të sigurisë në punë dhe punonjësve të doganave mbetet një prioritet. Hartimi dhe zbatimi i procedurave lidhur me importin dhe eksportin e kimikateve dhe asgjësimin e mbetjeve të tyre sipas kërkesave të Konventës së Roterdamit, Stokholmit, Bazelit duhet të konsiderohet si një tjetër prioritet.

Në dhjetor të vitit 2005, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë (KM) krijoi zyrtarisht Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DEBASKON) si pjesë përbërëse e strukturës së tij organizative. Njësia e Koordinimit të DEBASKO-s siguron një “one stop shop” për donatorët në lidhje me çështjet strategjike të ndihmës së huaj. Si e tillë, ajo është përgjegjëse për organizimin e aktiviteteve të mëdha koordinuese si tryezat e rumbullakëta të Qeverisë me donatorët dhe Grupin e Ndihmës së SPI-së, që është një bord këshillues në nivel përcaktimi të politikave. Departamenti, në bashkëpunim me Sekretariatit Teknik të Donatorëve, ka krijuar tashmë një sistem kompjuterik të dhënash bazë, që përmban të dhënat për të gjithë donatorët aktivë që kanë punuar që prej vitit 1994; përfshirë informacionin mbi shlyerjen e ndihmës së huaj. Bashkë me Ministrinë e Financave, DEBASKON-i bashkë-udhëheq negociatat me donatorët mbi kushtet e bazuara në politika për huatë/kreditë dhe merr pjesë në negociatat e drejtuara nga Ministria e Integrimit Evropian mbi programimin e NIP-së (Ndihmës së Planifikimit të Integruar). Në bashkëpunim me donatorët dhe ministrinë e linjës, Departamenti krijoi 10 Grupe Pune Sektoriale, qëllimi i të cilave është të sigurojnë bashkërendimin në mënyrë efikase të ndihmës së huaj dhe të mbështesin objektivat strategjike sektoriale.

Table 11.D: Prioritetet dhe masat e mundshme: lidhjet ndërkombëtare

Çështjet prioritare (klasifikim nga lart-poshtë)	Niveli i kapaciteteve egzistuese lartë)	Përmbledhja e kapaciteteve, pikat e forta, boshllëqet dhe nevojat	Veprimet e mundshme	Aktorët
---	--	--	----------------------------	----------------

Të përmirësohet koordinimi në nivel kombëtar lidhur me zbatimin e kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara në fushën e kimikateve	I ulët	Mungesa e procedurave dhe institucioneve që të sigurojnë koordinimin	Krijimi i byrosë së kimikateve; Krijimi i mekanizmit koordinues ndërministror.	MMPAU, MBUMK, MSh, MPPT
Krijimi i procedurave të importit dhe eksportit të kimikateve	I ulët	Mungesa e procedurave lidhur me importin dhe eksportin e kimikateve	Hartimi i një akti ligjor mbi procedurat e import eksportit	MMPAU, MBUMK, MSh, MPPT
Zhvillimi i politikave për sigurinë kimike	I ulët	Mungesa e projekteve të asistencës teknike për zhvillimin e kapaciteteve mbi sigurinë kimike	Përgatitja e një draft- projekti në kuadër të IPA	MMPAU

KAPITULLI 12: BURIMET EKZISTUESE DHE NEVOJAT PËR MENAXHIMIN E KIMIKATEVE

Në këtë kapitull janë paraqitur në mënyrë të përmblendhur të dhënat mbi burimet njerëzore ekzistuese në vend: përgjegjësitë specifike të specialistëve të angazhuar me menaxhimin e kimikateve, numri i stafit dhe tipi i ekspertizës përkatëse në institucionet shtetërore. Janë paraqitur edhe kapacitetet e disa OJQ-ve lidhur me menaxhimin e kimikateve. Pavarësisht se informacioni mbi kapacitetet ekzistuese është pothuaj i plotë, përsëri disa të dhëna ende mungojnë, sidomos lidhur me OJQ-të.

Është përgatitur edhe një përmblendhje e nevojave për kapacitete për institucionet shtetërore. Janë paraqitur gjithashtu burimet e vëna në dispozicion të Shqipërisë për programe e projekte relevante përmes aktiviteteve të asistencës së zhvillimit dhe bashkëpunimit teknik. Në vijim të analizës së kryer janë identifikuar probleme e mangësi ekzistuese dhe janë propozuar rrugë për zgjidhjen e tyre.

Në këtë kapitull janë reflektuar edhe komentet dhe vërejtjet e specialistëve të përfshirë në mënyra, institucione e nivele të ndryshme me menaxhimin e kimikateve në vend.

12.1 Burimet ekzistuese në ministritë/ institucionet për menaxhimin e kimikateve

Tabela 12. A: Burimet ekzistuese për ministritë/ institucionet

Ministria/agjencia	Përgjegjësitë specifike të personave (lidhur me menaxhimin e kimikateve)	Numri i stafit profesional	Tipi i ekspertizës ekzistuese
Sektori i Mjedisit			
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU)	Hartimi i politikave dhe legjislacionit lidhur me kimikatet dhe mbetjet	1 shef sektori për ajrin, ndryshimet klimatike dhe kimikatet, 1 specialist për kimikatet, 1 specialist për mbetjet	1 kimist; 1 biokimist, trajnuar për menaxhimin e kimikateve; 1 specialist
Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve	Mbështetje teknike për MMPAU lidhur me njohjen e situatës mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe gjatë hartimit e plotësimit të kuadrit ligjor në fushën e kimikateve dhe mbetjeve; Mbledhje dhe përpunimi i të dhënave për evidentimin dhe identifikimin e kimikateve në vendin tonë; Përpunimi i të dhënave të monitorimit të mjedisit për kimikatet; Monitorimi i indikatorëve të mjedisit	2 specialistë për mbetjet dhe kimikatet; 1 specialist për ujin; 4 analistë: (2 për metalet e rëndë dhe mbetjet, 1 për ujin, 1 për ajrin)	4 kimistë, MSc; 3 kimistë; të trajnuar
Inspektorati i Mjedisit	Inspektimi i aktiviteteve industriale	Rreth 200 inspektorë në të gjithë vendin	Asnjë i specializuar për kimikatet
Sistemi i Shëndetësisë			
Ministria e Shëndetësisë (MSh), Drejtoria e Shëndetit	Autoriteti kompetent që harton politikat për shërbimin e kontrollit të dëmtuesve në shëndet publik dhe produkteve	2 nëpunës: 1 përgjegjës sektori;	1 mjek, diplomuar në shëndet publik , MPH, student PhD,

Ministria/agjencia	Përgjegjësitë specifike të personave (lidhur me menaxhimin e kimikateve)	Numri i stafit profesional	Tipi i ekspertizës ekzistuese
Publik	biocide, si dhe organizon dhe ndjek zbatimin praktik e shkencor të këtij shërbimi; Lëshimi i autorizimeve të importit të lëndëve DDD, përfshirë menaxhimin e dezinfektantëve të ujit të pijshëm	1 specialiste	pjesërisht i trajnuar në fushën e biocidëve; 1 inxhinier hidroteknike
Instituti i Shëndetit Publik (IShP)	Departamenti i Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DKSI) Përgjegjësi të përbashkëta për të tre specialistët: - Anëtarë të komisionit të MSh për vlerësimin teknik të substancave biocide gjatë procedurës së dhënies së autorizimit të importit; - Hartimi dhe rinovimi i listës së biocidëve të lejuara të përdoren në vend (bazuar në direktivën 98/8 të KE; - Vlerësimi i efektshmërisë dhe rezistencës ndaj biocidëve. DKSI-Programi i Kontrollit të Vektorëve: Përgjegjësitë e mësipërme, për insekticidet dhe rodenticidet DKSI- Njësia e Kontrollit të Infeksioneve Spitalore dhe Laboratori i Kontrollit të Infeksioneve Spitalore Përgjegjësitë e mësipërme për dezinfektantët, si dhe: - Kontrolli i lëndëve dezinfektante që përdoren në ambjentet spitalore për kontrollin e infeksioneve nozokomiale, veçanërisht në sallat operatore; - Kontrolli dhe vlerësimi i menaxhimit të mbetjeve spitalore; - Vlerësimi i menaxhimit të mbetjeve spitalore.	3 specialistë	1 entomologe PhD, e trajnuar; 1 rodentolog MSc dhe student PhD, i trajnuar për menaxhimin e kimikateve; 1 mjeke mikrobiologe MSc dhe studente PhD, e trajnuar
	IShP - Departamenti Shëndeti & Mjedisi (DShM), Seksioni i Sanitetit dhe Ujit: Kontroll i parametrave fiziko- kimike tek ujrë sipas kërkesave të standardit, vlerësim higjeno- sanitar; Vlerësim i produkteve për dezinfektimin e ujit të pijshëm.	1 specialiste, shefe e seksionit; 1 specialiste	1 mjeke, në proces doktorate; 1 inxhinier agromjedisi
	DShM- Seksioni i sigurisë ushqimore dhe ushqyerjes: - Vlerësimi i të dhënave mbi sëmundshmërinë dhe mbi shperthimet epidemike me origjinë ushqimore; - Kërkim në aplikimin e metodave të reja analitike në bashkëpunim me analistët; - Hartim dhe zbatim i projekteve apo studimeve në lidhje me ushqimet e sigurta dhe ushqyerjen;	1 specialistë për sigurinë ushqimore; 2 specialist për ushqyerjen	1 mjek, Dr. Prof. Assoc.; 1 mjek, MSc, në proces doktorate; 1 zooteknik; Të trajnuar

Ministria/agjencia	Përgjegjësitë specifike të personave (lidhur me menaxhimin e kimikateve)	Numri i stafit profesional	Tipi i ekspertizës ekzistuese
	- Kryerje e trajnimeve për specialistë të shëndetit publik të rretheve por dhe studentëve;		
	DShM – Laboratori i Analizave Fiziko-kimike të Ujrave	2 analistë	1 kimiste, kërkuese; 1 kimiste, MSc, në proces doktrate
	DShM – Laboratori i Analizave Fiziko-kimike të Ushqimeve Kontrolli i parametrave fiziko- kimike të ushqimeve dhe jodit në kripë dhe urinë.	2 analistë	1 kimiste, MSc.; 1 kimiste, në proces doktrature, e trajnuar
	DShM - Laboratori i Kimisë Analitike Instrumentale: Analiza të metaleve të rënda dhe ndotësve organike (PAH dhe pesticide) në ujra, toka , sedimente, ushqime	1 shefe e Seksionit të Laboratorëve dhe analiste; 3 analistë	1 kimiste, Prof. Asoc. Dr.; 1 kimiste, Dr.; 2 kimistë, MSc.; Të trajnuara
	DShM - Laboratori i Toksikologjisë Paraklinike: Provat respiratore tek punonjësit e metalurgjisë	2 specialistë	1 kimiste; 1 kimiste, kërkuese
	DShM - Higjena e Punës: Kontrolli i shëndetit në punë	2 specialistë	1 mjek, kërkues; 1 mjek epidemiolog
	DShM - Seksioni i ajrit: Kontrolli i cilësisë së ajrit dhe monitorimi i ndotjes në disa qytete, Analizat fiziko kimike të ajrit, PM ₁₀ , PM _{2,5} , NOx, CO, H ₂ S, bloza, Vlerësimi i impaktit në shëndet	1 specialist; 2 analistë	1 mjek, PhD; 2 kimistë, kërkues
Drejtoritë e Shëndetit Publik (DShP- të) të rretheve	Shërbimi DDD (dezinfektim, dezinfektim, deratizim)	2 DShP nga 4 punonjës; 13 DShP nga 2 punonjës; 12 DShP nga 1 punonjës; 5 DShP nga 3 punonjës; 4 DShP nuk ka info	Ka shumë nevojë për trajnime
	Inspektorë sanitarë (përfshirë 36 DShP-të e rretheve, Autoritetin Shëndetësor Rajonal-AShR dhe ISHP): Higjienë ushqimore, higjienë shkollore e parashkollore, higjienë komunale dhe higjienë e punës.	167 inspektorë të lartë; 239 inspektorë të mesëm	Mjekë, veterinerë, trajnuar në shëndet publik ose higjienë
	Laboratorët e DShP-ve të rretheve		
Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”	Shërbimi i Toksikologjisë: Menaxhimi i ekspozimeve të qëllimshme dhe të paqëllimshme ndaj kimikateve; Trajnime në nivel universitar dhe pas-universitar, edukim në vazhdim dhe tema studimore të nivelit të tretë (doktoratura); Informacion përmes linjës dhe bashkëveprimi direkt me qendrat e tjera për raste akute dhe mbidozime; Studime statistikore epidemiologjike për	3 toksikologë; 1 psikolog; 1 punonjës social	12 toksikologë të trajnuar. Këtu përfshihen edhe trainimet për problemet e alkoolit dhe drogave; 9 toksikologë janë në training 1 vjeçar, pas-universitar/ afatgjatë; Çdo vit trajnohen 4-

Ministria/agjencia	Përgjegjësitë specifike të personave (lidhur me menaxhimin e kimikateve)	Numri i stafit profesional	Tipi i ekspertizës ekzistuese
	incidencën dhe prevalencën e helmimeve nga kimikatet të përfshira rastet akute dhe mbidozimet; Përcaktim i faktorëve të riskut për helmimet e qëllimshme dhe të paqëllimshme; Informacion i publikut me anë të medias për shkaqet, trajtimin dhe parandalimin e helmimeve		5 toksikologë
	Klinika e sëmundjeve profesionale Laboratori toksikologjik: Analiza kimike në funksion të sëmundjeve profesionale	1 kimist toksikolog; 3 asistente; 1 mjek me titull As. prof	
Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave (QKKB)	Sektori i analizave: Kontrolli i cilësisë së barnave	11 analistë	3 MSc; 1 mjeke; 3 farmacistë; 4 kimistë
	Sektori i Inspektimit: Inspektim i subjekteve farmaceutike edhe për barnat e skaduara	18 inspektorë	1 MSc.
	Autoriteti i Kontrollit të Vaksinave: Kontrolli i cilësisë së vaksinave	2 kimiste	1 kimiste, Dr.; 1 kimiste
Sistemi i Ekonomisë			
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE)	Drejtoria e Politikave Minerare dhe Industriale: Mbledhje e të dhënave mbi kimikatet e sistemit të ekonomisë, gjetje e zgjidhjeve dhe burimeve për menaxhimin e tyre	1 specialist, me kohë të pjesshme	1 kimist, njohuri mbi menaxhimin e kimikateve
	Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore, Drejtoria e Tregut të Brendshëm: Përgatitje e legjislacionit mbi disa kimikate (detergjentët)	1 specialiste	1 kimiste
Ndërmarrja e Furnizimit të Industri Minierave (NFIM)	Inventar i kimikateve të mbledhur në NFIM, ndjekja e procedurave të asgjësimit	1 specialist, me kohë të pjesshme	1 kimist
	Ngarkim, shkarkim, riambalazhim	2 punëtorë	Ambalazhim, etiketim dhe ruajtje e kimikateve
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)	Reparti i Rigjenerimit të vajit të transformatorëve, ku trajtohet/ rigjenerohet vaji i pajisjeve elektrike për të gjithë Shqipërinë	1 inxhinier kimiste; 1 teknologe e mesme; 2 specialiste të mesme të përgjithshme	
Sistemi i Mbrojtjes¹			
Ministria e Mbrojtjes (MM) – Autoriteti i	Ndjekje e zbatimit të detyrimeve të Konventës së Armëve Kimike;	2 specialistë	1 kimist (nënkolonel) Trajnuar mbi

¹ Të dhënat nuk janë të plota

Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE)	Aspekte ligjore		konventat kimike 1 juriste
Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura	Kontrolli i cilësisë së ushqimeve për FA; Analiza të karburanteve; Kontrolli i cilësisë së lëndëve eksplozive me përdorim ushtarak ose civil; Monitorimi i mjedisit nga aktivitetet ushtarake dhe industria ushtarake.	15 kimistë	
Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), Universiteti i Tiranës (UT), Fakulteti i Shkencave Natyrore (FShN)	Të angazhuar me kohë të plotë në përdorimin e kimikateve në laboratorët mësimorë dhe shkencorë; Analiza kimike klasike dhe instrumentale; Analiza mjedisore;	20 teknikë laborator	Të diplomuar në Kimi e Kimi Industriale kryesisht të patrajnuar, por me eksperiencë pune me kimikatet
	Të angazhuar me kohë të pjesshme në përdorimin e kimikateve në laboratorët shkencorë; Analiza kimike instrumentale; Analiza mjedisore; Analiza për të tretët	40 kërkues	Pedagogë, kërkues shkencorë, të doktoruar në Kimi, të trajnuar shumica jashtë shtetit, me eksperiencë pune në analiza kimike instrumentale, mjedisore.
MASH, Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT), Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	Departamenti i Agromjedisit dhe Ekologjisë; Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve: Analiza të ndryshme fiziko – kimike për vlerësime mjedisore; Rritja e ndërgjegjësimit në përdorimin e pesticideve dhe menaxhimin e integruar të pesticideve, me qëllim reduktimin e përdorimit të kimikateve.		2 kimistë, 1 kimist (Prof.Asoc.Dr) 12 agronomë të kualifikuar (Prof.Asoc.Dr, Prof.Dr.)
MASH, UBT, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	Departamenti i Biologji-Kimisë: Edukimi me disiplinat e kimisë, biologjisë, zoologjisë etj.	12 staf akademik	1 Prof.Dr; 3 Prof.Asoc.Dr; 4 Dr; 4 Lektorë
	Qendra e Kërkimeve të Ushqimit Veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi në fushën e teknologjisë agroushqimore, bioteknologjise dhe ushqimit	3 specialistë	1 docent; 1 Dr; 1 lektor
Sistemi i Bujqësisë dhe Ushqimit			
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	Drejtoria e Mbrojtjes së Bimëve: Hartimi i politikave për PMB Kryerje e procedurave të regjistrimit për PMB	1 specialist	Agronom i lartë, i trajnuar

(MBUMK)			
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV)	Laboratori i Histaminës: Analiza të histaminës në peshk të përpunuar dhe të freskët	1 analist	Biolog, MSc; i trajnuar
	Laboratori i Biotoksinave: Analizë e biotoksinave ASP, PSP, DSP në molusk të freskët me dhe pa guackë/produkte peshku	2 analistë	1 kimiste, MSc; 1 Biologe, MSc; të trajnuar
	Laboratori i mbetjeve të medikamenteve veterinarë: Analizat e mbetjeve të medikamenteve veterinarë (antibiotikë, hormone etj.) në produktet me origjinë shtazore dhe ushqimet e kafshëve sipas Planit Kombëtar të Mbetjeve	5 analistë	3 Kimistë; 1 kimist, MSc; 1 biolog; të patrajnuar
	Laboratori i analizave të metaleve të rënda: Analiza të metaleve të rënda, si Pb, Cd, Cr, Hg etj. në ujin e detit si dhe në produktet me origjinë shtazore dhe ushqimet e kafshëve sipas Planit Kombëtar të Mbetjeve	2 analistë	1 Kimist, MSc; 1 kimist të trajnuar pjesërisht, në hapat e validimit dhe akreditimit të disa provave
	Laboratori i mbetjeve të pesticideve në produktet shtazore: Analizat e mbetjeve të pesticideve organoklorure dhe PCB në produktet me origjinë shtazore dhe ushqimet e kafshëve sipas Planit Kombëtar të Mbetjeve	2 analistë	1 kimist, MSc; 1 kimist; Të patrajnuar
	Laboratori i analizave të Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve (PMB) Analiza cilësore e (PMB) si pesticide, insekticide etj.	2 specialistë MSc; 1 specialist	1 kimist, MSc; 1 biolog, MSc; 1 biolog; Të trajnuar pjesërisht (për programet e aparaturave)
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)	Inspektim i PMB-ve dhe inputeve të tjera bujqësore	43 inspektorë	Agronomë të lartë
Ministria e Punës, Çështjeve Sociale e Shanceve të Barabarta (MPÇSShB) - Inspektorati Shtetëror i Punës	Siguron zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, higjienën dhe mirëqënien, etj.		
	Spektori i Substancave të Rrezikshme dhe Sëmundjeve Profesionale	1 përgjegjës sektori 2 inspektorë	
	Spektori i Parandalimit të Aksidenteve	1 përgjegjës sektori 2 inspektorë	
	Drejtoria Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës (12 drejtori)	18 përgjegjës sektori 92 specialistë inspektimi	
Ministria e Brendshme (MB), Drejtoria e Përgjithshme e	Zbatimi i planit kombëtar të emergjencave civile. Pikë kontakti në nivel kombëtar, për të gjitha problemet që kanë lidhje me emergjencat civile.	Nuk ka specialistë që kanë lidhje me menaxhimin e kimikateve dhe as	

Emergjencave Civile		të specializuar për kimikatet	
Ministria e Punëve Publike e Transportit (MPPT)	Hartimi i politikave për transportin e mallrave të rrezikshme, për mjetet dhe ambalazhimin, paketimin, etj, si dhe organet e kontrollit për veprimtarinë e transportit rrugor të mallrave të rrezikshme	Nuk ka specialistë që kanë lidhje me menaxhimin e kimikateve dhe as të specializuar për kimikatet	
Ministria e Financës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi, në funksion të rritjes së performancës së veprimtarisë së shërbimit doganor në mbrojtje të sigurisë kombëtare, duke përfshirë ndër të tjera dhe parandalimin e trafikut të kimikateve të rrezikshme.	Drejtori i Drejtorisë së Antitrafikut; 2 Specialiste	1 jurist; 2 kimiste
Bashkitë	Trajtime DDD (dezinfektim, dezinfektim, deratizim)	2 bashki nga 7 punonjës 2 bashki nga 4 punonjës 3 bashki nga 2 punonjës 7 bashki nga 1 punonjës 18 bashki nuk kanë asnjë punonjës Për 4 bashki nuk ka informacion	Punonjës për trajtime, ka shumë nevojë për trajnime
Bashkia Berat ¹	Inspektimi i bizneseve që përdorin kimikate e shkarkojnë kimikate; Kontrolli e grumbullimi i informacionit mbi monitorimin e shkarkimeve industriale; Njoftim i komunitetit, strukturave vendore e në qeveri për probleme të hasura.	1 specialiste	1 kimiste, e trajnuar për menaxhimin e kimikateve

12.2 Burimet e nevojshëm nga institucionet qeveritare për të plotësuar përgjegjësitë lidhur me menaxhimin e kimikateve

Në tabelën 12.B janë përmbledhur nevojat që kanë institucionet, agjencitë e ndryshme, si dhe universitetet për trajnime lidhur me menaxhimin e kimikateve.

Tabela 12.B: Burimet që nevojiten nga institucionet qeveritare për të plotësuar përgjegjësitë lidhur me menaxhimin e kimikateve

Ministria/agjencia	Përgjegjësitë (lidhur me menaxhimin e kimikateve) për të cilat nevojiten burime	Numri dhe tipi i stafit profesional që nevojitet	Kërkesat për trainime
Ministria e Mjedisit, Pyjeve	Hartimi i politikave dhe legjislacionit për kimikatet	2 kimistë	Trajnime lidhur me direktivat e BE për fushën e kimikateve,

¹ si shembull nga pushteti lokal

Ministria/agjencia	Përgjegjësitë (lidhur me menaxhimin e kimikateve) për të cilat nevojiten burime	Numri dhe tipi i stafit profesional që nevojitet	Kërkesat për trainime
dhe Administrimit të Ujrave			procedurat e import-eksportit të kimikateve të rrezikshme
Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve	Mbledhje dhe përpunim i të dhënave për evidentimin dhe identifikimin e kimikateve në vendin tonë;	1 kimist	Trajnim për përgatitjen e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave; Trajnim për metodologjitë e përpunimit të të dhënave për kimikate
Inspektoriati i mjedisit	Inspektimi i aktiviteteve industriale që prodhojnë apo gjenerojnë kimikate	Duhet të riorganizohen brenda numrit ekzistues	Trajnime për kontrollin dhe inspektimin e aktiviteteve industriale që gjenerojnë, prodhojnë apo ruajnë kimikate; Trajnim për kontrollin e importit dhe eksportit të kimikateve
Instituti i Shëndetit Publik	DSHM: Vlerësim i kimikateve të dëmshëm në produkte, psh. lodrat e fëmijëve, produkte kozmetike, materialet plastike, etj. Monitorimi i çrregulluesve endokrinë; Ekspertizë për vlerësimin e riskut shëndetësor nga kimikate; Njësime metodologjike dhe organizim i trainimeve të programuara; Survejancë e helmimeve nga kimikate; Promovim i sigurisë së kimikateve	2 specialistë	Trainime, përgatitje e manualeve për vlerësimin e riskut
	DKSI: Trajnimi i personelit të DShP-ve, bashkive dhe aplikuesve privatë për mënyrat e aplikimit të lëndëve biocide në shëndetin publik; Kryerja e provave të rezistencës ndaj biocideve dhe dezinfektantëve; Vlerësimi në laborator dhe në terren efektshmërisë pas trajtimit me lëndë biocide dhe dezinfektante	1 entomolog, 1 rodentolog, 1 mjek mikrobiolog, 1 kimist, 1 mjek toksikolog, 1 epidemiolog	Hartim i udhëzuesve; Përgatitje e kurrikulave për kontrollin e dëmtuesve si dhe për lëndët biocide për inspektorët, specialistët e trajtimeve, etj.; Trajnim të stafit; Organizim i trajnimeve me inspektorët dhe specialistët e tjerë
	Departamenti i Promocionit: Promovim i sigurisë kimike; Përmirësim apo plotësim i programeve mësimore mbi aspekte të kimikateve dhe toksikologjisë		Trajnime, përgatitje e materialeve promovuese e didaktike
Drejtoritë e	Shërbimi DDD	Plotësimi i	Ka shumë nevojë për trajnime

Ministria/agjencia	Përgjegjësitë (lidhur me menaxhimin e kimikateve) për të cilat nevojiten burime	Numri dhe tipi i stafit profesional që nevojitet	Kërkesat për trainime
Shëndetit Publik (DShP) të rretheve		strukturës së shërbimit DDD me stafin përkatës	të personelit
Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”- Departamenti i Toksikologjisë	Ndërtimi i një qendre informimi për helmimet	3 specialistë	Trajnime
Ministria e Bujqësisë. Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	Politikat lidhur me PMB-të (legjislacioni)	1 agronom i lartë	Trajnim
	Regjistrimi i PMB	1 kimist ose agronom i lartë	Trajnim
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë	Laboratori i Mbetjeve të Medikamenteve Veterinare	2 specialistë me master, 2 specialistë me arsim të lartë 2 teknikë laborantë (kimistë)	Trajnim për mënyrën e trajtimit të mostrave për analizën e mbetjeve të medikamenteve veterinare; Trajnim i avancuar për përdorim aparaturash HPLC UV/VIS dhe Fluoreshencë, LC/MS, LC/MS/MS, GC-FID/ECD/NPD, GC/MS, GC/MS/MS; Trajnim për shtrimin e metodave screening dhe vlerësimin e tyre për grupet e substancave të ndaluara; Trajnim për përpunimin statistikor të të dhënave Trajnim për shtrimin e metodave
	Laboratori i Metaleve të Rënda	1 specialist me arsim të lartë 1 teknik laborant (kimist)	Trajnim për mënyrën e trajtimit të mostrave për analizën e metaleve të rënda; Trajnim i avancuar për përdorimin e AAS me furrë, Trajnim për validimin e metodave; Trajnim për përpunimin statistikor të të dhënave.
	Laboratori i Mbetjeve të Pesticideve në Produktet Shtazore	1 specialist me arsim të lartë; 1 teknik laborant (kimist)	Trajnim për mënyrën e trajtimit të mostrave për analizën e mbetjeve të pesticideve; Trajnim i avancuar për përdorim aparaturash GC-FID/ECD/NPD, GC/MS, GC/MS/MS; Trajnim për shtrimin e

Ministria/agjencia	Përgjegjësitë (lidhur me menaxhimin e kimikateve) për të cilat nevojiten burime	Numri dhe tipi i stafit profesional që nevojitet	Kërkesat për trainime
			metodave screening dhe konfirmatore, validimin e tyre për të gjithë; Trajnim për përpunimin statistikor të të dhënave; Trajnim për shtrimin e metodave konfirmatore për grupet A (substancat e ndaluara dhe ato me veprim anabolic dhe B (medikamentet veterinarë dhe ndotësit) në kuadër të Planit Kombëtar të Mbetjeve
	Laboratori i Analizave të Produkteve të Mbrojtjes së Bimëve (PMB)		Trajnim për përdorim aparaturash HPLC UV/VIS&Fluo, LC/MS, GC-FID/ECD/NPD, GC/MS; Trajnim për shtrimin e metodave për analizimin e PMB dhe validimin e tyre; Trajnim për përpunimin statistikor të të dhënave
	Laboratori i Analizave të Mbetjeve të Pesticideve në Fruta e Perime (propozim për një laborator të ri)	2 specialistë të lartë me master ose PhD; 2 teknike të mesëm (kimistë)	Trajnim për mënyrën e trajtimit të mostrave për analizën e mbetjeve të pesticideve; Trajnim për përdorim aparaturash HPLC UV/VIS&Fluoreshencë, LC/MS, GC-FID/ECD/NPD, GC/MS; Trajnim për shtrimin e metodave për analizimin e mbetjeve të PMB dhe validimin e tyre; Trajnim për përpunimin statistikor të të dhënave
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	Monitorimi i mbetjeve të pesticideve	13 kimistë ose agronomë të lartë	Trajnim
MASH, UT Fakulteti i Shkencave Natyrore	Teknikë ose inxhinierë laborator të kërkimor, pa angazhime në procesin mësimor	8 kimiste me profil universitar	Eksperiencë në përdorimin e metodave kromatografike dhe spektrofotometrike
MASH, UBT, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit	Menaxhimi i kimikateve, teknika në përdorimin e autorizuar të produkteve për mbrojtjen e bimëve	1 kimist	Trajnime për praktikat mjedisore dhe rehabilitime të zonave të ndotura; Trajnime për aplikimin e Praktikave të Mira Bujqësore, aplikimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve sa me

Ministria/agjencia	Përgjegjësitë (lidhur me menaxhimin e kimikateve) për të cilat nevojiten burime	Numri dhe tipi i stafit profesional që nevojitet	Kërkesat për trainime
			paqësore për mjedisin
Bashkitë	Trajtime DDD (dezinfektim, dezinfektim, deratizim)	Të gjitha bashkitë duhet të kenë strukturën për shërbimin DDD	Personeli duhet të trajnohet respektivisht
Bashkia Berat ¹	Krijimi i bazës së të dhënave për kimikatet e përdorura në industri; Krijimi i regjistrit të shkarkimeve industriale në mjedis; Informimi i bizneseve mbi rrezikshmërinë e kimikateve (klasifikimi, etiketimi, paketimi, kushtet e magazinimit, kujdesi ndaj punonjësve, ndikimi në ekosistemin e zonës ku ndodhet industria etj.); Hartimi i studimeve eko-social-shëndetësore në zonën ku ndodhet e instaluar industria	3 punonjës	Menaxhimi i kimikateve nga pushteti vendor në mbështetje të legjislacionit (jo vetëm detyrimet por edhe mënyrat e mjetet e duhura për të arritur mirëmenaxhimin e kimikateve); Metoda të aksesueshme nga publiku mbi përdorimin e kimikateve në qytet, rrezikshmërinë dhe kujdesin që nevojitet; Forcimi i bashkëpunimit pushtet vendor-biznes-qeveri për të administruar përdorimin e kimikateve dhe zonat e ndotura; Informimi i të rinjve mbi kimikatet (kjo jo vetëm si pjesë e kurrikulave, por edhe nëpërmjet fushatave sensibilizuese mbi kimikatet e përdorimet dhe risqet e tyre)
Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave	Sektori i analizave: Kontrolli i cilësisë së barnave		Trajnim
	Sektori i Inspektimit: Inspektim i barnave, përfshirë për barnat e skaduara		Trajnim për menaxhimin e barnave që skadojnë

12.3 Burimet ekzistuese për menaxhimin e kimikateve në organizatat jo-qeveritare

Tabela 12.C: Burimet ekzistuese për menaxhimin e kimikateve në organizatat jo-qeveritare

Organizata	Përgjegjësitë specifike të personave (lidhur me menaxhimin e kimikateve)	Numri i stafit profesional	Tipi i ekspertizës ekzistuese
Grupimi Ekolëvizja	Informim, ndërgjegjësim, trajnim	4 specialistë	Ndërgjegjësim dhe informim i publikut
Milieukontakt Shqipëri	Studime, planifikim, monitorim, networking	3 specialistë	Pesticidet e vjetër, NOQ, menaxhim i mbetjeve
Instituti i Kërkimeve	Vlerësime në mjedis; Monitorime në tokë, ajër dhe ujë;	7 specialistë	Kimistë e biokimistë, të trajnuar në fushën e

¹ Si shembull nga pushteti lokal

Bioteknologjike	Projekte zbatimi teknologjik		trajtimit të hidrokarbureve, mbetjeve të rrezikshme e kimikateve, monitorimeve, etj.
Lëvizja e Gruas për Zhvillim Integral	Informim, ndërgjegjësim, trajnim	3 specialistë	Ndërgjegjësim dhe informim i publikut
Koalicioni Shqiptar për Sigurinë e Lodrave	Informim, ndërgjegjësim, trajnim		
Ekomjedisi Durrës	Informim ndërgjegjësim, Trainim, ekspertiza mjedisore, etj	7	Trajnime, ndërgjegjësim dhe informim i publikut
Qendra Rajonale e Mjedisit, REC Shqipëri	Mbështetje për institucionet, për fuqizimin e kuadrit ligjor mjedisor; Informim, ndërgjegjësim, trajnim	3 specialistë	Mbështetje për institucionet, për fuqizimin e kuadrit ligjor mjedisor; Informim, ndërgjegjësim, trajnim

12.4 Burimet nga aktivitetet e asistencës për zhvillim

Në tabelën 12.D janë renditur projektet më të rëndësishëm të mbështetur nga burime të asistencës për zhvillim lidhur me kimikatet apo mjedisin, duke i renditur nga ata më të fundit tek ata më të hershëm.

Tabela 12.D: Burimet nga aktivitetet e asistencës për zhvillim

Institucionet financuese dhe institucionet mbështetës	Titulli i projektit, data e fillimit dhe mbarimit	Tipi i ekspertizës së ofruar	Burimet financiare të projektit (nga donatorët dhe burimet lokale)
IPA 2010	Forcim kapaciteteve për hartimin e ligjeve dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar mjedisor, Shtator 2011 - Qershor 2014	Përmirësimi i menaxhimit mjedisor nga agjencitë e mjedisit në nivel kombëtar dhe rajonal; Përafrim i plotë i legjislacionit primar për sektorin e ajrit dhe kimikateve; Përgatitje e legjislacionit sekondar për sektorin e mbetjeve, ujrave dhe ndotjes industriale	4'400'000 Euro Shuma bashkëfinancues e nga Qeveria Shqiptare: 400'000 Euro
UNDP	Program i kërkesave për mjedisin të BE; Mbështetje për t'u përgjigjur ndaj kërkesave mjedisore lidhur me anëtarësimin e ardhshëm në BE, Janar 2011- Dhjetor 2013	Mbështetje Qeverisë Shqiptare për të plotësuar disa kërkesa të legjislacionit mjedisor të KE; Hedhja e themeleve për një mekanizëm për mundësimin e qëndrueshmërisë financiare të aktiviteteve mjedisore; Përmirësimi i pjesëmarrjes së publikut në vendim-marrje; Përmirësimi i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve në zonat rurale; Mbështetje e integritetit të problemeve të mjedisit në politikat e tjera	6'120'200 USD

Institucionet financuese dhe institucionet mbështetës	Titulli i projektit, data e fillimit dhe mbarimit	Tipi i ekspertizës së ofruar	Burimet financiare të projektit (nga donatorët dhe burimet lokale)
		sektoriale	
UNEP dhe UNIDO	Programi kombëtar për prodhim më të pastër (PKPP) në Shqipëri si pjesë Programit të One UN në Shqipëri, 2010-2013	Trajnim i ekspertëve/ auditorëve mbi përdorimin me efikasitet të burimeve për prodhim më të pastër (PEBPP); - Demonstrime PEBPP; Ndërgjegjësim dhe promovim i PEBPP; - Komponenti politik përkatës	787'423 USD
Komisioni i Europës, me numër reference EUROPA-AID 2010- 251 517	Produktet dhe Siguria Kimike ne Ballkan Bashkepunimi i Shoqerise Civile ne acquis komunitare, vlerat per konsumatorët dhe pergjegjesia e bashkepunimit Shkurt 2011- Shkurt 2013	Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile, autoriteteve, sindikatave, perfaqesuesve te biznesit si dhe të aktorëve të tjerë në te 3 vendet e Ballkanit dhe BE-së me qëllim përmirësimin e mbrojtjes se konsumatoreve dhe te sigurise se produkteve, duke siguruar ne kete forme njohuri rreth acquis të BE-se; Ngritja e kapaciteteve dhe forcimi i kapaciteteve ekzistuese te organizatave lokale prej shoqërisë civile ne promovimin e nje pjesemarrje demokratike, ne kontributin e zhvillimit te politikave dhe sensibilizimit te publikut te gjerë mbi masat për konsumatorët dhe mbrojtjen e mjedisit, në veçanti në lidhje me produktet dhe lëndet kimikate; Promovimi i njohurive te ndersjellta midis Ballkanit dhe organizatave të shoqërisë civile të BE-se mbi çështjen e politikave dhe legjislacionit të BE-se persa i takon konsumatoreve dhe mbrojtjes së mjedisit, në veçanti sigurisë së produkteve, kimikateve, lodrave, kozmetikës, klasifikimit ekologjik, plumbit, merkurit; Ndërtimi i rrjeteve të qëndrueshme nga organizatat e shoqërisë civile në vendet e Ballkanit, dhe të bashkëpunohet me rrjete më të gjera europiane, për t'u angazhuar në dialog konstruktiv me prodhuesit, shitësit dhe politik-bërësit me qëllim marrjen e masave për mbrojtjen e konsumatorëve, veçanërisht lidhur me substancat e rrezikshme	
IPA 2008,	Konsolidimi i	Realizimi i matjeve për ajrin dhe ujrat;	2'000'000 EUR

Institucionet financuese dhe institucionet mbështetës	Titulli i projektit, data e fillimit dhe mbarimit	Tipi i ekspertizës së ofruar	Burimet financiare të projektit (nga donatorët dhe burimet lokale)
MMPAU	sistemit të monitorimit të mjedisit në Shqipëri, Korrik 2010 - Dhjetor 2012	Trajnime shtesë kryesisht për stafin e ri lidhur me monitorimin e ajrit dhe ujrave dhe pajisjeve; Rinovimi i bazës së të dhënave kombëtare dhe prodhimi i raporteve respektive; Realizimi i Regjistrat Kombëtar të Shkarkimeve dhe Transferimeve të Ndotjes (PRTR)	Nga të cilat Qeveria Shqiptare 200'000 Euro
UNIDO dhe UNEP	Programin kombëtar të heqjes nga përdorimi të substancave ozonholluese, Shkurt 2011-Korrik 2012		109'400 USD
Qeveria Hollandeze Sekretariati CLRTAP Qeveria Italiane	Plani kombëtar i veprimit (PKV) për ratifikimin dhe implementimin e Protokollit të Metaleve të Rënda, Protokollit për Ndotësit Organik të Qëndrueshëm dhe Protokollin e Gothenburgut të Konventës së Ndotjes Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët, 2011	Drafti final i rishikuar nga ekspertët e qeverisë hollandeze është aprovuar në prill 2011	40'000 USD
CARDS 2006	Forcimi i kapaciteteve për hartimin dhe detyrimin e legjislacionit mjedisor kombëtar, Maj 2008-Maj 2011	Mbështetje për zbatimin e Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor (hartimi i legjislacionit primar në fushën e ajrit dhe kimikateve dhe legjislacionit sekondar në fushën e mbetjeve, ujrave dhe detyrimet përkatëse për zbatim); Rritje e kapaciteteve për forcimin e adoptimin dhe legjislacionit sipas kërkesave të <i>Acquis</i>	2'500'000 USD
Qeveria e Hollandës	Identifikimi dhe vendosja e prioritetëve në	U përgatit një listë me vatra të ndotura dhe një listë e vatrave të ndotjes më prioritare për pastrim	1'299'686 USD

Institucionet financuese dhe institucionet mbështetës	Titulli i projektit, data e fillimit dhe mbarimit	Tipi i ekspertizës së ofruar	Burimet financiare të projektit (nga donatorët dhe burimet lokale)
	“pikat e nxehta mjedisore” në Shqipëri, Janar 2008- Gusht 2011		
Banka Botërore, Qeveria e Hollandës	Komponenti C i projektit “Menaxhimi i integruar të zonës bregdetare dhe pastrimit: Pastrimi i zonës së nxehtë Porto Romano”, 2005- Qershor 2011	Prezantimi i një sistemi monitorimi afatgjatë; Kryerja e punëve të riparimit të domosdoshëm dhe pastrimit; Prezantimi i një modeli për kryerjen e pastrimit në zonat e nxehta të rrezikshme, që, nëse është e suksesshme, mund të përsëritet në zona të tjera të nxehta gjatë bregdetit	3’113’333 USD
Fondi Global i Mjedisit (GEF), UNDP, Qeveria e Hollandës dhe Qeveria Shqiptare	Forcimi i kapaciteteve në vendet e Ballkanit Perëndimor për t’iu adresuar pikave të nxehta mjedisore përmes një qasjeje të integruar, komponenti për Shqipërinë, Tetor 2007- Qershor 2011	Vlerësim mjedisor paraprak; Vlerësim risku dhe plan veprimi për zonën e ndotur të Bajzës; Pastrimi i zonës së ndotur të Bajzës	2’118’840 USD nga të cilat bashkëfinancim i Qeverisë Shqiptare 600’000 Euro
UNEP	Projekti i Ozonit, Forcimi Institucional, 2003-2011	Koordinimi i të gjithë veprimeve të përcaktuar në Programin Kombëtar; Zhvillimi i një sistemi iniciativash dhe barrierash për përdorimin e LHO; Fushata ndërgjegjësimi; Raportimet pranë sekretariatit të ozonit	369’600 USD Nga të cilat bashkëfinancim nga Qeveria Shqiptare 21’200 USD
Qeveria e Hollandës, Qeveria Shqiptare dhe OSBE	2010	Pastrimi i magazinave të NFIM, Balëz-Elbasan	476’000 USD
Qeveria Austriake në bashkëpunim me UNDP	Ndërtimi i kapaciteteve për të pranuar financimet e karbonit në Shqipëri, 2007-2010	Krijimi i kuadrit ligjor dhe institucional në Shqipëri për të pranuar financimet e karbonit, si dhe ndërtimi i kapaciteteve për të identifikuar dhe zbatuar projekte për mekanizmin e zhvillimit të pastër dhe mekanizmin e tregut të karbonit	317’951 USD dhe Kontributi i Qeverisë Shqiptare për të gjithë kohën e zbatimit të projektit ishte 10’000 USD
Ministria e Arsimit dhe Shkencës, REC me financim te	Program për Edukimin Mjedisor,	Rritje e kapaciteteve të stafit të shkollave dhe universiteteve për të përmirësuar dhe përgatitur programet	470’000 Euro

Institucionet financuese dhe institucionet mbështetës	Titulli i projektit, data e fillimit dhe mbarimit	Tipi i ekspertizës së ofruar	Burimet financiare të projektit (nga donatorët dhe burimet lokale)
Qeverise se Hollandës	2004-2010	mjedisore gjithëpërfshirëse; Krijimi i mjeteve specifike edukative për promovimin e vlerave të zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërdisiplinore; Rritje e ndërgjegjësimit publik nëpërmjet zhvillimit të mjeteve dhe fushatave për rritjen e njohurive dhe e vetëdijes për çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm	
Banka Botërore, Qeveria e Hollandës	2006	Ripaketimi i kimikateve të Magazinat e Bishtit të Pallës	1'000'000 USD
GEF, UNDP	Përgatitja e Planit Kombëtar të Veprimit për reduktimin dhe eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm, 2005-2006		Kontributi i GEF-it 347'000 USD, kontributi i Qeverisë Shqiptare 31'400 USD

12.5 Vlerësimi

Siç shihet nga tabela 12.A, ekzistojnë bazat e kapaciteteve për menaxhimin e kimikateve dhe, në një pjesë të mirë, sidomos në institucionet qendrore, stafi ekzistues është i trajnuar. Duhet thënë se specialistët në nivel të ministrive janë përgjithësisht të përgatitur, por përballen me një ngarkesë shumë të madhe pune për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm, duke marrë parasysh detyrimet e shumta ligjore që lidhen me menaxhimin e kimikateve. Problematika e hasur në nivel qendror mund të përshkruhet si më poshtë:

- Përgjegjësitë dhe të drejtat e aktorëve të ndryshëm nuk janë gjithmonë të qarta dhe të përcaktuara me akte normative ligjore, p.sh. në ligjin bazë të kimikateve kërkohet të ngrihet zyra e regjistrimit të kimikateve, por që prej 2003 nuk ka një akt nënligjor që ta ketë krijuar atë; thuhet që për substancat kimike me ndikim në mjedis është përgjegjëse MMPAU, ndërkohë që nuk ka një listë kimikatesh që ka vetëm ndikim në mjedis. Ka substanca që kanë njëkohësisht ndikim në mjedis dhe shëndet për të cilat nuk është e qartë si do funksionojë përgjegjësia e secilit institucion, etj.
- Ministritë e linjës që administrojnë mekanizmat ligjorë nuk kanë buxhet të mjaftueshëm për ndjekjen në vazhdimësi të problemeve;
- Drejtoritë dhe specialistët shpesh ndjekin problemet e kimikateve midis çështjeve të tjera të sektorëve multidisiplinorë;
- Reduktim i personelit administrativ;
- Ka mangësi në infrastrukturë (të dhëna online, faks, lidhje telefonike).

Fenomen pozitiv në këtë nivel ka qenë qëndrueshmëria relative e stafit gjatë viteve e fundit, gjë që ka bërë të mundur përmirësime dhe plotësime të legjislacionit lidhur me kimikatet dhe përgjigje në kohë ndaj kërkesave të ushtruara ndaj institucioneve qendrore, si psh. detyrimet për raportim dhe veprim në kuadër të përpjekjeve për integrimin europian të vendit.

Megjithatë, pavarësisht se stafi ekzistues është i përkushtuar dhe i përgatitur, është nevojë imediate rritja e numrit të stafit në nivel qendror, kualifikimi i stafit të ri dhe krijimi i një agjencie apo zyre për menaxhimin e kimikateve.

Pavarësisht përpjekjeve për formimin e personelit të përfshirë në hallkat e ndryshme të menaxhimit të kimikateve dhe burimeve të shumta të përdorura për këtë qëllim vitet e fundit, siç duket edhe nga tabela 12.D, ende mbetet shumë punë për të bërë në këtë drejtim. Kjo nevojë shfaqet si pasojë e disa shkaqeve dhe presioneve, si:

- Kërkesa lidhur me bazën e ligjore të hartuar rishtas;
- Kërkesa të reja lidhur me përpjekjet e Shqipërisë për t'u integruar në Europë;
- Kërkesa të reja ligjore si rezultat i ratifikimit të disa konventave dhe protokolleve mbi kimikatet;
- Krijimi i institucioneve dhe shërbimeve të reja, si Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
- Ndryshime të vazhdueshme të stafeve profesionale, sidomos në nivel lokal.

Siç shikohet nga tabela 12.B, nevojiten trainime të stafeve lidhur me realizimin e detyrave lidhur me aspektet respektive të menaxhimit të kimikateve që mbulojnë, si:

- Procedurat e vlerësimit të riskut shëndetësor dhe mjedisor;
- Forcimi i kapaciteteve analitike, përmirësimi i performancës dhe shtimi i treguesve që analizohen;
- Nevojitet krijimi i një qendre informacioni për helmimet dhe formimi i stafit përkatës;
- Menaxhimi i kimikateve nga pushteti vendor në mbështetje të legjislacionit (jo vetëm detyrimet por edhe mënyrat e mjetet e duhura për të arritur mirëmenaxhimin e kimikateve);
- Vlerësimi i raporteve të sigurisë të aktiviteteve industriale që përbëjnë rrezik për aksidente industriale për shkak të substancave të rrezikshme (rritje e kapaciteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal);
- Parandalimi, gatishmëria dhe përgjigja ndaj emergjencave kimike (për autoritetet kompetente dhe për operatorët industrialë, trainime në nivel lokal); përpjekjet për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (2005) mund të koordinoheshin me ato të institucioneve të tjerë për këtë qëllim;
- Forcimi i bashkëpunimit qeveri - pushtet vendor - biznes për të administruar përdorimin e kimikateve dhe zonat e ndotura;
- Përcaktimi i kushteve në lejet mjedisore (Qendra Kombëtare e Licensimit)

Problem që haset në nivelin e rretheve është ekzistenca e disa lloj inspektorateve: të shëndetësisë, mjedisit, të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit dhe të punës, kompetencat e të cilëve lidhur me kimikatet jo gjithmonë janë të qarta.

Në këtë kuadër është e nevojshme gjetja e një zgjidhjeje për qartësimin dhe/apo koordinimin e kompetencave respektive, gjë që do ndihmohet nga krijimi kohët e fundit e Inspektoratit Qendror. Në të njëjtën kohë është i nevojshëm plotësimi i bazës ligjore për të institucionalizuar bashkëpunimin mes inspektorateve.

Problem është gjithashtu mungesa e trajnimeve të mjaftueshme në nivel të specialistëve dhe inspektoreve të rretheve, edhe për shkak të mungesës së programeve të organizuara të trainimit, sidomos lidhur me problemet e kimikateve. Nevojitet të ngrihen programe të mirëfillta trajnimesh, të cilat të jenë të qëndrueshëm dhe metodologjikisht të konsoliduar. Nevojiten si programe të plotë për formimin e kuadrit të ri, ashtu edhe programe të shkurtër rifreskues. Në sistemin e shëndetësisë, funksionimi i programeve të trajnimit do mund të mbështetëj edhe nga Qendra Kombëtare e Edukimit të Vazhduar, e cila zbaton sistemin e krediteve për stafin shëndetësor.

Mangësi e nevoja të tjera lidhur me rritjen e kompetencës së organeve të menaxhimit të kimikateve janë:

- Nevoja për plotësimin e legjislacionit sekondar dhe hartimin e udhëzuesve përkatës;
- Nevoja për krijimin e bazave të të dhënave p.sh. për kimikatet e përdorur në industri, për kimikatet e rrezikshëm, si biocidet, PMB, për planet e emergjencave, etj.;
- Mungesa e regjistrimit të shkarkimeve industriale në mjedis;
- Kontrolli i bizneseve lidhur me klasifikimin, etiketimin e paketimin e kimikateve, kushtet e magazinimit, kujdesin ndaj shëndetit të punonjësve, parandalimin e ndikimit në ekosistemin e zonës ku ndodhet industria etj.;
- Hartimi i studimeve eko-social-shëndetësore në zonat e banuara pranë instalimeve industriale, etj.

Vitet e fundit ka patur nisma për inkurajimin e partneritetin mes sektorit publik dhe atij privat; si shembuj të këtij partneriteti mund të përmenden aktivitete të përbashkëta trajnuese të ndërmarra nga Instituti i Shëndetit Publik dhe kompanitë që tregtojnë produkte biocide. Këto aktivitete kanë qenë efektive si në formimin e specialistëve të rretheve, ashtu edhe në krijimin e një kulture të re të partneritetit të sistemit publik me industrinë.

Tabela 12.E: Prioritetet dhe veprimet e mundshme: burimet disponibël dhe të nevojshëm për menaxhimin e kimikateve

Çështjet prioritarë (renditur nga prioriteti më i lartë te ai më i ulët)	Niveli i kapaciteteve të ekzistues (i ulët, i mesëm, i lartë)	Përmbledhje e anëve të forta, mangësive dhe nevojave të kapaciteteve	Veprimet e mundshme	Aktorët e mundshëm
Krijimi i një agjencie apo zyre për menaxhimin e kimikateve	I ulët	Nivel përgjithësisht i mirë i përgatitjes së kuadrove ekzistues, sidomos në nivelin qendror; Mungesë e kuadrove të mjaftueshëm në nivel qendror për të mbuluar gjithë problematikën e lidhur me kimikatet	Krijimi i një agjencie apo zyre të menaxhimit të kimikateve; Shtim i kuadrove të nevojshëm	MMPAU, MSh, MBUMK
Ndërtimi/ forcimi i kapaciteteve	I mesëm	Mungojnë programe të mirëfilltë, të unifikuar, rishikuar dhe miratuar të trajnimeve; Mungesë e trajnimeve periodike; Mungesë e materialeve didaktike dhe udhëzuesve	Përgatitja e kurrikulave të unifikuara për formimin dhe rifreskimin periodik të dijeve, sidomos për specialistët e rretheve; Hartim i udhëzuesve; Zhvillim i kurseve trajnuese	MSh, MMPAU, MBUMK, MPÇSShB, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, institutet përkatës, inspektorët dhe specialistët e tjerë në rrethe
Ngritja e një qendre informimi për helmimet	I ulët	Ka një numër të konsiderueshëm toksikologësh të formuar; Nuk ekziston një qendër informacioni për rastet e helmimeve	Ngritje e një qendre informacioni për helmimet, 24/7, trajnimi i stafit përkatës	QSUT, Shërbimi i Toksikologjisë, MSh
Përmirësim dhe koordinim i punës së inspektorateve lidhur me menaxhimin e kimikateve	I mesëm	Numër i madh inspektorësh të shëndetësisë, mjedisit, sigurisë ushqimore; Koordinim i ulët mes inspektorateve të ndryshëm	Përmirësim i bazës ligjore; Përmirësim i koordinimit nëpërmjet Inspektoratit Qendror	Inspektorati Qendror, MSh, MMPAU, MBUMK, MPÇSShB, inspektoratet përkatëse

KAPITULLI 13: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Qëllimi i këtij kapitulli është të japë konkluzione të përgjithshme mbi situatën e menaxhimit të kimikateve në vend dhe një përmbledhje të prioriteteve dhe rekomandimeve më të rëndësishëm.

Ky Profil Kombëtar i Rishikuar i Menaxhimit të Kimikateve përbën një dokument të rëndësishëm për Qeverinë Shqipëtare, pasi përfaqëson një vlerësim të aspekteve ligjore, institucionale, infrastrukturore, teknike, etj. mbi menaxhimin e kimikateve në Shqipëri, të hartuar me pjesëmarrjen e aktorëve më të rëndësishëm të përfshirë në menaxhimin e kimikateve në vend.

Parimet që kanë udhëhequr procesin e zhvillimit të këtyre rekomandimeve kanë qenë përqasja e kujdesshme dhe përqasja pjesëmarrëse, sipas së cilës të gjitha palët e përfshira në menaxhimin e kimikateve në vend kishin mundësinë të kontribuonin në procesin e rishikimit të profilit.

Shqyrtimi i hollësishëm i situatës së menaxhimit të kimikateve në vend ka përbërë bazën për identifikimin e prioriteteve. Ky proces është bazuar mbi kritere si urgjenca që paraqet çështja, realizueshmëria e saj etj. Duke u bazuar në analizën e hollësishme të aspekteve ligjore, institucionale, infrastrukturore, teknike të kimikateve në Shqipëri janë propozuar këto konkluzione dhe rekomandime për veprime të mëtejshme:

- Kuadri ligjor për kimikatet dhe substancat e rrezikshme ekziston, megjithëse është pjesërisht në linjë me legjislacionin europian në këtë fushë (Rregulloren REACH dhe Rregulloren mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve të tyre (CLP). Kontrolli i lëndëve të rrezikshme mbulohet kryesisht nëpërmjet konventave përkatëse ndërkombëtare, por transpozimi i mëtejshëm i legjislacionit europian është i nevojshëm. Meqenëse legjislacioni europian, përkatësisht direktivat 76/769/EEC dhe 67/548/EEC, të cilat ishin transpozuar në legjislacionin ekzistues kombëtar, janë shfuqizuar si dhe janë identifikuar boshllëqe të tjera në legjislacionin kombëtar lidhur me kimikatet, ka dalë nevoja për hartimin e një legjislacioni të ri kombëtar në fushën e kimikateve dhe përkatësisht për transpozimin në legjislacionin kombëtar të rregullores (EC)1272/2008, “Mbi klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve” dhe rregullores REACH (EC) 1907/2006. Me propozim dhe me kontributin e projektit SAICM-QSP “Forcimi i kapaciteteve për implementimin e SAICM në Shqipëri”, Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur së fundmi një draft-ligj për biocidet dhe synon të përafrojë plotësisht direktivën e BE 98/8 me legjislacionin dytësor përkatës. Asistenca teknike do të jetë shumë e kërkuar gjatë këtij procesi. MMPAU është aktualisht duke punuar për legjislacionin dytësor për kimikatet e rrezikshme dhe do të ketë një ndihmesë të konsiderueshme gjatë 2013 nga projekti SELEA (shiko kapitullin 3).

- Ndërsa procedura për menaxhimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, përfshirë bazën ligjore, regjistrimin dhe kontrollin është e kompletuar, ende mbetet punë për të bërë për plotësimin dhe zbatimin e legjislacionit për kimikate të tjerë, si kimikatet industriale, biocidet, kimikatet e konsumit.

- Duke ndjekur plotësimin dhe përditësimin e bazave ligjore do të përgatiten dokumente udhëzues posaçërisht për to.

- Duhet të përgatitet një ligj për kimikatet në të cilin do të përfshihen të gjitha aktet normative dhe ligjore, masat parandaluese për mbrojtjen e shëndetit, hapat që duhen ndërmarrë për menaxhimin e kimikateve etj.
- Adoptimi i legjislacionit European duke ndjekur dhe pasqyruar në vazhdimësi ndryshimet dhe të rejat në to për përsosjen e kuadrit ligjor ekzistues, kërkon ngritjen e rolit të strukturave shtetërore, përfshirjen e organizatave joqeveritare dhe sindikatave të punëtorëve që në fillim të ndërmarrjes së iniciativave ligjore e në veçanti, kur kemi të bëjmë me kimikate të rrezikshme.
- Menaxhimi i kimikateve në nivel kombëtar ndërlikohet nga fakti që ministri të ndryshme marrin pjesë në kontrollin e grupeve të ndryshme të kimikateve në faza të ndryshme të ciklit të jetës së tyre. Gjithashtu ka ndërthurje në një farë shkalle të përgjegjësisë për probleme të caktuara. Është nevojë e domosdoshme ngritja e një institucioni koordinues për menaxhimin e kimikateve, siç do ishte zyra e menaxhimit dhe regjistrimit të kimikateve në zbatim të detyrave të parashtruara nga ligji Nr 9108 dt 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”. Në Planin Kombëtar të Zbatimit të MSA është parashikuar krijimi i kësaj zyre brenda vitit 2015. Kjo zyrë do të shërbejë edhe si sekretariat i një (nën) komiteti ndërsektorial për menaxhimin e kimikateve, i cili është gjithashtu shumë i nevojshëm.
- Institucionet qendrore hasin në punën e tyre mangësi e probleme lidhur me angazhimet përkatëse mbi menaxhimin e kimikateve, si mungesa e theksuar e stafit të mjaftueshëm, buxheti i pamjaftueshëm për ndjekjen në vazhdimësi të problemeve si dhe mangësi në infrastrukturë. Mungesa e stafit përbën një problem shumë serioz, që mund të çojë ndjeshëm aftësinë e vendit për t’iu përgjigjur kërkesave të anëtarësimit në BE. Është shumë kritike që të rritet numri i stafit që angazhohet me menaxhimin e kimikateve edhe që të përgatitet kontingjenti i nevojshëm për ngritjen e Zyrës së Kimikateve gjatë zbatimit të projekteve dhe veprimtarive të tjera intensive që zhvillohen aktualisht dhe që do intensifikohen në një të ardhme të afërt. Përveç një rritjeje sasiore të stafit, është po aq e rëndësishme që të rekrutohet staf cilësor, i aftë për të përballuar kërkesat e shumta të kësaj fushe që kërkon nivel shumë të lartë ekspertize.
- Mungojnë kapacitetet e mjaftueshëm gjithashtu në institucionet që duhet të mbledhin dhe shpërndajnë informacionin. Për të përmirësuar situatën aktuale mbi menaxhimin e informacionit, është e nevojshme rritja e buxhetit, organizimi i trainimeve dhe rritje e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për informim sepse në shumë raste, aksesit në internet mungon dhe mjetet e tjera nuk janë të disponueshme. Në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri është krijuar faqja e internetit www.chemicals.al si mjet për shkëmbimin e informacionit lidhur me menaxhimin e kimikateve.
- Në Republikën e Shqipërisë nuk ka akoma një regjistër të kimikateve që të plotësojë kërkesat e legjislacionit European. Nevojitet krijimi i bazave të të dhënave p.sh. për kimikatet e përdorur në industri, për kimikatet e rrezikshëm, si biocidet, PMB, për planet e emergjencave, etj. Në kuadër të Projektit SAICM-QSP është krijuar një bazë të dhënash mbi biocidet, e cila ka kapacitet të pasurohet me klasa dhe çështje të tjera të kimikateve.
- Mungojnë mekanizma dhe metodologji të miratuara për përcaktimin e vetive të kimikateve, për klasifikimin e tyre sipas rrezikshmërisë si dhe për vlerësimin e riskut të kimikateve për shëndetin dhe mjedisin. Proçeduara e vlerësimit të riskut për substancat e rrezikshme duhet të përkufizohet nga Ministri i Shëndetësisë, ndërsa ajo për vlerësimin e riskut ndaj ambjentit vendoset nga MMPAU. Bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, Këshilli i Ministrave vendos kushtet për prezantimin e

këtyre substancave në Shqipëri. Sot për sot Ministria e Shëndetësisë nuk ka një mekanizëm në vend për vlerësimin e riskut dhe impaktit në shëndet të substancave kimike.

– Nuk ka asnjë qendër informacioni në vend lidhur me helmimet nga kimikatet, dhe kapacitetet aktuale në terma praktikë janë të kufizuara, veçanërisht për transportin e viktimave në rastin e aksidenteve që përfshijnë kimikatet e rrezikshme. Për disa klasa kimikatesh mungon informacioni i nevojshëm dhe udhëzuesit për masat e sigurisë dhe mbrojtjes nga këto lloj kimikatesh.

– Megjithë progresin relativ të arritur në administrimin e kimikateve në përgjithësi duhet theksuar se ndër pengesat kryesore në plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor por edhe administrimit më të mirë të kimikateve nga njëra anë, ka qenë mbështetja e kufizuar nga ana financiare edhe për stabilizimin e situatës së krijuar nga prania në ndërmarrjet e privatizuara ose të nxjerrja jashtë përdorimit e mjaft kimikateve stoqe dhe të pa mbrojtura sipas rregullave, dhe nga ana tjetër niveli i ulët i shkallës së ndërgjegjësimit të komunitetit dhe politikanëve në forcimin e bazës ligjore dhe masave për ruajtjen dhe mbrojtjen e sigurtë nga kimikatet në përgjithësi dhe ato të rrezikshmet në veçanti.

– Deri më tani politikat qeveritare kanë qenë relativisht favorizuese për të marrë informacion nga OJF-të kombëtare; ato janë më favorizuese për të përdorur ekspertizat dhe përvojat e OJF-ve ndërkombëtare. OJF-të shpesh luajnë rol aktiv duke bërë lobime pranë organizmave të ndryshëm vendim marrës në lidhje me legjislacionin mjedisor dhe kohët e fundit edhe për kimikatet, sidomos ata të rrezikshëm. Roli i OJF-ve në informimin e publikut rreth rreziqeve të kimikateve është i konsiderueshëm, por duhet të forcohet akoma më shumë. Forcimi i rolit të OJF-ve sidomos në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit duhet të arrihet nëpërmjet bashkëpunimit edhe me organizmat qeveritare në nivel qendror dhe lokal. Forcimi i kapaciteteve të tyre, menaxhimi financiar, zhvillimi institucional, partneriteti në projekte të ndryshme me qeverisjen lokale dhe sektorin privat, komunikimi me publikun mbeten ende problematika që kërkojnë vlerësim e zhvillim.

– Iniciativat vullnetare të industrisë nuk duket të kenë ende ndonjë rol të dukshëm në aktivitetet e menaxhimit të kimikateve në Shqipëri. Megjithatë, si shembull pozitiv në këtë drejtim mund të përmendet vetëmonitorimi i shkarkimeve të ndotësve, aktivitet i detyruar me ligj, që kohët e fundit është vënë në eficiencë sidomos në rastet e industrive që emetojnë ndotje. Gjithashtu, ka nisur të krijohet një përvojë e mirë e bashkëpunimit të sektorit publik me atë privat në fushën e trajnimit të strukturave publike dhe atyre private; si shembuj mund të përmenden trajnime mbi kontrollin e dëmtuesve në shëndet publik dhe përdorimin e biocideve organizuar me kontributin e kompanive tregtuese të produkteve biocide, organizuar nga ISHP dhe MSh. Projekti “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e Qasjes Strategjike në Menaxhimin e Kimikateve në Shqipëri” ka kontribuar në rritjen e përfshirjes së aktorëve jo-qeveritare, si OJQ-ve, ONQ-ve dhe industrisë. Duhet gjetur mekanizmat dhe rrugët për të rritur angazhimin e industrisë dhe biznesit në mirëmenaxhimin e kimikateve.

– Mekanizmat ekzistues punojnë të ndarë sipas problematikës dhe specifikës së tyre. Ata nuk i mbulojnë të gjitha aspektet e rëndësishme të kimikateve, të cilat kërkojnë një kooperim dhe koordinim ndërsektorial shumë të mirë. Mungon gjithashtu koordinimi në nivel kombëtar i zbatimit të kërkesave të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e kimikateve. Është domosdoshmëri krijimi i një komiteti ndër-sektorial për menaxhimin më të mirë të kimikateve. Termat e referencës për funksionimin e këtij komiteti janë përgatitur në kuadër të projektit “Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e SAICM në Shqipëri” dhe janë të disponueshme në faqen e internetit www.chemicals.al.

– Nuk ka një dokument udhëzues lidhur me incidentet nga kimikatet e rrezikshme, menaxhimin e incidenteve, toksikologjinë në përgjithësi, metodat e dekontaminimit, përdorimit të antidotëve apo pajisjeve ndihmëse gjatë ndodhjes së një emergjence kimike. Forcimi i kapaciteteve në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal i autoriteve kompetente për identifikimin dhe vlerësimin e raporteve të sigurisë së aktiviteteve industriale që përbëjnë risk për aksident industrial për shkak të substancave të rrezikshme, përbën një kërkesë të domosdoshme. Kapacitetet ekzistuese në praktikë janë mjaft të kufizuara, vacanërisht për sa i përket transportit të viktimave të aksidenteve që përfshijnë kimikate të rrezikshme. Qendra Kombëtare e Trajnimit duhet të organizojë trajnime në nivel lokal për parandalimin, gadishmërinë dhe përgjigjen ndaj emergjencave kimike për autoritetet kompetente dhe operatorët industrialë. Një nga problemet e identifikuar është edhe mungesa e një database të aktiviteteve industriale që përbëjnë risk për aksidente me natyrë kimike..

– Mungon një regjistër kombëtar për regjistrimin e aksidenteve që mund të shkaktohen nga kimikatet dhe nuk ka një institucion të specializuar teknik që kryen monitorimin a shkaqeve dhe përgjegjësit për aksidentin. Mungojnë forma standarte për mbledhjen e informacionit rreth aksidenteve si dhe ndjekjen e pasojave në shëndet dhe mjedis. Mungon një sistem për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave për sasinë dhe të tipave të mbetjeve të reja industriale të prodhuara nga aktivitetet e subjekteve industriale të licensuara pas 1992.

– Si pasojë e kontributit të dhënë nga institutet e kërkimeve në fushën e mjedisit i mbështetur nga donatorët e huaj dhe burimet e tjera në vend të dhënat janë mbledhur dhe kanë shërbyer si bazë faktesh dhe argumentash në dokumente të ndryshëm politik dhe strategjik kombëtar në fushën e mjedisit në hartimin e planeve dhe programeve të ndryshme mjedisore në monitorimet e projekteve për gjendjen e mjedisit etj. Gjithsesi janë të nevojshme më shumë fonde si dhe një shpërndarje më e barabartë e mbështetjes financiare midis institucioneve të ndryshme..

– Në kuadër të nevojës për forcimin e kapaciteteve mbi menaxhimin e kimikateve në vend nevojitet të ngrihen programe të mirëfillta trajnimesh për inspektorët dhe stafet profesionale, të cilat të jenë të qëndrueshëm dhe metodologjikisht të konsoliduar si në trajtën e programeve të plotë për formimin e kuadrit të ri, ashtu edhe programe të shkurtër rifreskues. Në sistemin e shëndetësisë funksionimi i programeve të trajnimit do ishte mirë të mbështetej edhe nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim, e cila zbaton sistemin e krediteve për stafin shëndetësor. Programe trajnimi duhet të organizohen gjithashtu për biznesin mbi ruajtjen e sigurt, sigurinë dhe shëndetin në punë, GHS, etj. Survejanca për aksidentet nga kimikatet është shumë e dobët pasi mungon koordinimi pavarësisht egzistencës së dokumentacionit dhe legjislacionit përkatës. Ka një nevojë urgjente për trajnime për vlerësimin e riskut dhe menaxhim në lidhje me epidemiologjinë e aplikuar dhe survejancën për të gjithë specialistët që punojnë në fushën e menaxhimit të kimikateve. Ka ende nevojë për ndërhyrje në nivelin universitar për zhvillimin e një kurrikule për sigurinë ndaj kimikateve. Krahas Paketës së Gjellbër, duhet të futet si lëndë e veçantë në shkollat e larta të sistemit Bachelor siguria dhe shëndeti në punë, veçanërisht në shkollat mjekësore dhe ato të tjera profesionale.

– **Infrastruktura laboratorike** është në mjaft raste e vjetëruar dhe jo bashkëkohore. Metodologjia e përdorur jo gjithmonë bazohet në metoda standarde dhe ka mangësi të shumta, si probleme në sigurimin e serviseve të aparaturave, në sigurimin e reagentëve e standardeve të kalibrimit, etj. Nuk është vendosur ende në të gjithë laboratorët sistem i brendshëm cilësie, dhe vetëm një numër i kufizuar laboratorësh janë akredituar. Mungojnë procedurat për menaxhimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshëm si dhe për eliminimin e mbetjeve të tyre. Nuk ka një sistem të sigurt për administrimin e mbetjeve të rrezikshme (atyre të prodhuara nga industrinë dhe ato shtëpiake). Mbetet problem mungesa e ndarjes se

mbetjeve që në burim. Grumbulluesit individualë dhe kompanitë hasin vështirësi në gjetjen e mbetjeve të pastra dhe të ndara. Në vend mungon një landfill industrial qendror për trajtimin e mbetjeve të përcaktuara dhe klasifikuara sipas udhëzimeve të Konventës së Bazelit. Nuk ka ndonjë impiant për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme kimike. Në kuadër të përmbushjes së objektivave për një administrim më të mirë të mbetjeve, MMPAU ka hartuar Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve 2010 – 2025, në bashkëpunim me projektin “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor”. Ka ende raste, kur ruajtja e kimikateve të rrezikshme bëhet në mjedise të papërshtatshme dhe duke përbërë rrezik për jetën e njerëzve. Nevojitet një shqyrtim i hollësishëm i kushteve të ruajtjes së kimikateve për përdorim në shëndet publik, që duhet të shoqërohet me rekomandimet dhe masat e nevojshme. Është i nevojshëm përmirësimi i kushteve të përdorimit të kimikateve për shëndetin publik, nevojiten më shumë fonde për blerjen e lëndëve biocide, si edhe të materialeve manipuluese, veshjeve mbrojtëse të punonjësve etj. Shumë i nevojshëm është edhe trajnimi i stafeve që kryejnë trajtimet me biocide.

– Nevojitet një projekt i përbashkët midis MSh, ISHP dhe Bashkive, i cili të jetë efikas për një program të kontrollit të integruar të dëmtuesve (pesteve) në shëndet publik. Po kështu, duhet promovuar edhe menaxhimi i integruar i dëmtuesve të kulturave bujqësore. Gjithashtu është e nevojshme të promovohen alternativa natyrore dhe më pak të dëmshme për kimikatat shtëpiake.

– **Ndërgjegjësimi** për rrezikun ndaj kimikateve në të gjitha grupmoshat si dhe në të gjitha nivelet është ende i ulët. Ndërgjegjësimi si dhe trajnimi i grupeve të ndryshme të profesionistëve, si fermerëve, transportuesve, industrialistëve, stafit teknik, si edhe i konsumatorit, për sigurinë në përdorimin e kimikateve, është një hap i rëndësishëm për uljen e këtij risku. Mungon bashkëpunimi mes institucioneve dhe organizatave të ndryshme për rritjen e sensibilizimit dhe ndërgjegjësimin. Duhet rritur dhe strukturuar roli i mediave dhe duhet të rritet komunikimi nëpërmjet rrjeteve sociale.

– MMPAU ka bërë një punë të mirë për identifikimin, priorizimin dhe studimin e vatrave të ndotura mjedisore. Vatra më problematike e Porto-Romanos dhe vatra të tjera të ndotura janë pastruar me ndihmën e UNDP dhe me kontributin e Qeverisë së Hollandës. Në vazhdim të përpjekjeve të MMPAU për identifikimin dhe pastrimin edhe të vatrave të tjera problematike, është bërë edhe një studim paraprak i 35 pikave të nxehta mjedisore në Shqipëri dhe është përcaktuar një listë e shkurtër prej 14 vatrash ndotjeje prioritare për ndërhyrje rehabilituese.

– Përgjegjësia për ndotjen është një çështje e rëndësishme në pastrimin e zonave të ndotura dhe privatizimit të tyre. Nuk ka një legjislacion specifik për përgjegjësinë për ndotjen industriale të mëparshme dhe nuk është e qartë se kush duhet të paguajë.

– Nevojitet hartimi dhe zbatimi i një plani kombëtar veprimi për menaxhimin e kimikateve, çka do mundësojë plotësimin e mangësive të shumta të identifikuara gjatë rishikimit të Profilit Kombëtar.

Shtojca 1: Raportet dhe dokumentat kombëtare për aspekte të ndryshme të menaxhimit të kimikateve

1. Këshilli i Bashkimit European: Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet Komunitetit European dhe shteteve anëtare nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë nga ana tjetër, Bruksel, 22 Maj 2006.
http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06_en.pdf
2. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave: Profili Kombëtar i Menaxhimit të Kimikateve dhe Implementimi i SAICM Shqipëri, Prill 2006
http://www.chemicals.al/doc/profili_shqip.pdf
3. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave : Raporti Shtetëror për Mjedisin 1999-2002, Janar 2005.
<http://aefalbania.org/Env%20Report%201999-2002.pdf>
4. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave: Raporti Shtetëror për Mjedisin 2009, Tiranë 2010.
<http://www.moe.gov.al/upload/publikimet/raporte%20te%20gjendjes%20mjedisit/Raporti%202009.pdf>
5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave: Plani Kombëtar i Implementimit për Uljen dhe Shkatërrimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm, Tiranë, 2006
<http://www.pops.int/documents/implementation/nips/submissions/Albania.pdf>
6. Komisioni Ekonomik për Europën i OKB, Komiteti për Politikat Mjedisore: Rishikimi i Performancës Mjedisore - Shqipëri, New York dhe Gjenevë, 2002
http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/epr/epr_studies/albania.pdf
7. Komisioni Ekonomik për Europën i OKB, Komiteti për Politikat Mjedisore: Rishikimi i Dytë i Performancës Mjedisore - Shqipëri Rekomandime, Dokument Informimi, Prill 2012
http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/cep/CEP-18/CEP-18_EPRAlbania_IP.9.e.pdf
8. Këshilli i Ministrave, Republika e Shqipërisë: Plani Kombëtar për Implementimin e Marrëveshjes së Asociim Stabilizimit 2007 – 2012, Tiranë, 2007.
<http://www.kshm.gov.al/msaanglisht.pdf>
9. Instituti i Shëndetit Publik dhe Instituti Kombëtar i Statistikave: Studimi Demografik dhe Shëndetësor. Shqipëri, (2008-2009)
<http://www.measuredhs.com/>
http://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNADS749.pdf
10. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave: Plani i veprimit për zbatimin e detyrimeve të Protokollit të NOQ, Protokollit të Metaleve të Rënda dhe Protokollit të Gotenburgut të CLRTAP, Tiranë, 2010.
11. Instituti i Statistikave: <http://www.instat.gov.al/>
12. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave: <http://www.dogana.gov.al/>

Shtojca 2: Grupi i punës ndërsektorial i SAICM

STAFI I PROJEKTIT SAICM-QSP :

Znj. Lindita Tafaj (Hajri)	ltafaj@chemicals.al , linda_tafaj@yahoo.com
Menaxhere dhe koordinatore e Projektit	Tel. +35542363066 Adresa: Instituti i Shëndetit Publik, Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr. 80, Tiranë, Shqipëri
Z. Leandro Xhama	lxhama@chemicals.al , xhama_leandro@yahoo.com
Jurist i Projektit	Tel: +355693669900 Adresa: Instituti i Shëndetit Publik, Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr. 80, Tiranë, Shqipëri
Znj. Eniana Xhanari	exhanari@chemicals.al , enianaxhanari@yahoo.com
Asistent- menaxhere e projektit	Tel: +355692197943 Adresa: Instituti i Shëndetit Publik, Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr. 80, Tiranë, Shqipëri

Institucioni	Personat e kontaktit dhe adresat
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU)	Znj. Laureta Dibra: Laureta.Dibra@moe.gov.al Znj. Roven Agalliu: Rovena.Agalliu@moe.gov.al Adresa: Rr. e Durrësit, Nr 27, Tiranë Tel: +355 4 2224537 Fax: +355 4 2270627 http://www.moe.gov.al
Ministria e Shëndetësisë (MSh)	Z. Albert Gajo: Albert.Gajo@moh.gov.al Z. Gazmend Bejtja: Gazmend.Bejtja@moh.gov.al Znj. Zhaneta Miska: Zhaneta.Miska@moh.gov.al Z. Arjan Bregu: Arjan.Bregu@moh.gov.al Adresa: Blv. “Bajram Curri”, Nr.1, Tiranë Tel:+355 2364663 Fax: +355 2362937 http://www.moh.gov.al
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK)	Z. Ismet Bici: bici.ismet@yahoo.com Z. Kristaq Nicaj: kristaqnica@yahoo.com Adresa : Sheshi “Skënderbej”, Nr. 2 1001 Tiranë E-mail: info@mbumk.gov.al Telephone: +355 222 6551 Fax: +355 222 6551 http://www.mbumk.gov.al
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (METE)	Z. Zef Lleshi: zef.lleshi@mete.gov.al Znj. Erinda Prifti: erinda.prifti@mete.gov.al Adresa: Blv. ”Dëshmorët e Kombit”, 1001 Tel: +355 4 222245 http://www.mete.gov.al/
Ministria e Mbrojtjes (MM)	Z. Ilir Zeneli: ilir.zeneli@aaf.mil.al Z. Ferdinand Ziu: ziu.ferdinand@yahoo.com Tel: +355 694160396 http://www.mod.gov.al/

Ministria e Punëve Publike, Transporteve dhe Telekomunikacionit (MPPT)	Znj. Xhiliola Jaçe: Xhiliola.Jace@mppt.gov.al Znj. Ljutvilda Gugushka: Ljutvilda.Gugushka@mppt.gov.al Adresa: Sheshi “Skënderbej” Nr. 5, Tiranë Tel: (+355) 42 380 833; (+355) 4 223 23 89 http://www.mppt.gov.al
Ministria e Punëve të Brendshme (MB)	Znj. Manjola Ademi: manjola.ademi@moi.gov.al Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nr.3, Tirana- Albania
Ministria e Drejtësisë (MD), Sektori i Integritimit	Znj. Orjola Shurdha: orjola.shurdha@justice.gov.al Znj. Florida Baci: florida.baci@hotmail.com Adresa: Bulevardi “Zogu I”, Tiranë
Institute i Shëndetit Publik (IShP)	Dr. Enver Roshi: roshienvi@yahoo.com Znj. Lindita Molla: lindimolla2002@yahoo.com Znj. Donika Bocari: donikabocari@yahoo.com Znj. Enkelejda Dikolli: keladikolli@yahoo.com Z. Elton Rogozi: eltonrogozi@yahoo.com Znj. Jeta Lakrori: jetalakrori@yahoo.com Znj. Fatbardha Sina: bardha.lila@yahoo.com Znj. Zahide Sulejmani: zsulejmani1@hotmail.com Z. Agim Shehi: agimshehi@hotmail.com Z. Artan Simaku: artan.simaku@gmail.com Adresa: Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr. 80, Tiranë
Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV)	Znj. Elmira Mehmeti elmira_mehmeti@hotmail.com Adresa: Rr. “Aleksandër Moisiu”, Nr. 82, Tiranë
Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FShN)	Znj. Elda Marku: eldamarku@hotmail.com Znj. Kozeta Vaso: kozeta_v@yahoo.it Adresa: Blv. “Zogu I”, Tiranë Tel: 00355-4-227669
Grupimi Ekolëvizja	Z. Xhemal Mato: xh.mato@icc-al.org Adresa: Rr. “Abdyl Frashëri”, Tiranë Tel: +355 672049160/ +355 684053164 http://www.ekolevizja.org/
Ekompjedi Durrës	Znj. Magdalena Cara: magdacara@gmail.com Znj. Neriona Vorpsi: neriona.vorpsi@hotmail.com Adresa : Qendra “Ekolëvizja”, Komuna e Parisit, Universiteti i New Yorkut, Tiranë Telefon / Fax: +355 (4) 481 5271 E-Mail: ekolevizja@yahoo.com http://www.ekolevizja.wordpress.com http://www.tirane.gjelber-gcs.al
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	Znj. Alma Tola: a_tola@dogana.gov.al Znj. Ana Gorenca: a_gorenca@dogana.gov.al Znj. Miranda Sharkaj: m_sharkaj@dogana.gov.al Adresa : Drejtoria e Përgjithëshme e Doganave, Rr. e Durrësit, Laprakë, Tiranë
Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT)	Znj. Zamira Dana: radazamira@yahoo.com Adresa: Universiteti Bujqësor i Tiranës, Kamëz, Tiranë Tel/Fax: +355 4 227804 http://www.ubt.edu.al
Inspektoriati Shtetëror i Punës	Znj. Migena Elezi: migenaelezi@yahoo.com Adresa: Rr. “Kavajës”, Nr. 1001, kati 4 Tel/Fax: 04 2368466 http://sli.gov.al
Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të	Znj. Eriola Karagjozi: eriola_karagjozi@yahoo.com

Eksporteve (AKShE)	Z. Fadil Vucaj: fadilvucaj@yahoo.com Adresa: Blloku i Ambasadave, Sheshi "Skënderbej", Tiranë Tel: +355 42 416 096 Fax: +355 42 235 975 Email: info_akshe@mod.gov.al
Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave (QKKB)	Znj. Merita Kuçuku: emkoni@hotmail.com Adresa: Fakulteti i Mjekësisë, Rr. e Dibrës, Tiranë, Tel / Fax: 42 372892 www.qkkb.gov.al
Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL)	Znj. Katerina Muka: katerina.muka@qkl.gov.al Znj. Enhela Shehu: enhela.shehu@qkl.gov.al Adresa: Rr. "Papa Gjon Pali i II" Nr. 3, kati III, Tiranë, Tel: + 355 4 22 29 416; + 355 4 22 74 499 Fax: + 355 4 22 39 957 www.qkl.gov.al
Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)	Znj. Zhuljeta Hoxha: xh.hoxha@ost.al Tel: +355 682027888
Bashkia e Beratit	Znj. Mirela Buhuri: mbuhuri@yahoo.it Adresa: Berat Tel: 355 32 234453 http://www.bashkia-berat.net/
Qendra "EDEN"	Znj. Albana Bregaj: albana.bregaj@eden-al.org Znj. Jonida Mamaj: jonida.mamaj@eden-al.org Adresa: Rr. "Luigj Gurakuqi", Nr.33, H.2, Ap.13 Kodi postar Nr. 1017 Tiranë - Shqipëri E-mail: eden@eden-al.org Tel / Fax: +355 4 223 9619 http://www.eden-al.org
Q-Plan	Znj. Anni Koci: a_koci@hotmail.com Adresa: QPLAN-INE Rr. Hamid Shijaku, P.6/3, Tiranë http://www.qplan-ine.com/
REC Albania	Z. Mihallaq Qirjo: miha@albania.rec.org Znj. Julia Selmani: jselmani@rec.org Adresa: Rr. "Ismail Qemali", Nr.27, Tiranë Kutia Postare Nr. 127, Tiranë Tel/Fax: 04 223 29 28 E-mail: rec.albania@rec.org
UNDP	Znj. Elvita Kabashi: elvita.kabashi@undp.org Adresa: Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Sheshi "Skënderbej", Ndërtesa Gurten Kati 2, Tiranë, Shqipëria Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234 Fax: +355 (4) 2250 286, 2250 289
WHO	Z. Ehadu Mersini, OBSh- Zyra Kombëtare Rr. Themistokli Gërmenji, Pallati i Ri
Agro Input	Z. Engjëll Jazxhi: engjell_jazxhi@yahoo.com

Shtojca 3: Aktorët kombëtarë për fushat e punës të listuara në tabelën A në Planin Global të Veprimit të SAICM.

Fusha e punës	Aktorët kryesorë	Agjenci/ aktorë të tjerë
1. Vlerësimi i menaxhimit të kimikateve kombëtare për të identifikuar boshllëqet dhe vendosur prioritetet për veprim	Projekti SAICM	Ministritë dhe agjensitë e përfshira në menaxhimin e kimikateve; OJQ-të, universitetet, industria, agjensitë ndërqeveritare ndërkombëtare
2. Mbrojtja e shëndetit të njeriut	MSh	IShP, Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe (DShP), Inspektoriati Shtetror Sanitar, pushteti vendor, OJQ-të, OSh-ja, media, shoqatat e konsumatorit
3. Siguria kimike dhe fëmijët	MSh	MASH, IShP-Departamenti i Promocionit, UNICEF OJQ-të, media, IEZh (Instituti për Edukim dhe Zhvillim), shoqatat e konsumatorit
4. Shëndeti dhe siguria në punë	MSh MPÇSShB	Inspektoriatet (Sanitar dhe i Punës), MPÇSShB (për aksidentet), MSh, sindikatat, ONP (Organizata Ndërkombëtare e Punës-ILO), sektori privat, industria
5. Implementimi i Sistemit të Harmonizuar Global të Klasifikimit dhe Etiketimit të Kimikateve (GHS)	MMPAU (Agjencia e Kimikateve ¹)	MSh, MBUMK, Doganat, organizatat industriale, dhoma e tregëtisë, MSh, MBUMK,
6 Menaxhimi dhe ulja e riskut të pesticideve me toksicitet të lartë	MMPAU	ISUV, QKL, Inspektorët, OSh, importuesit, Dogana, Komisioni Shtetëror për Regjistrimin e PMB, shoqatat e fermerëve etj.
7. Programet e pesticideve	MMPAU	ISUV, UBT, IShP, DShP-të e rretheve, OJQ-të.
8. Ulje e riskut të pesticideve për mjedisin dhe për shëndetin e njeriut	MMPAU	MSh, MMPAU, ISUV, UBT, DShP-të e rretheve, OJQ-të, MSh, MMPAU
9. Prodhim i pastër	MMPAU	METE, UNIDO, ECAT, AMP, industria
10. Rehabilitimi i zonave të ndotura	MMPAU	METE, Donatorë, AMP
11. Plumbi në benzinë	MMPAU	Inspektorati Qendror Teknik
12. Praktikë e mira bujqësore	MBUMK	UBT, shoqatat e fermerëve
13. Substanca persistente bio-akumulative dhe toksike; substanca shumë persistente dhe bio-akumulative; kimikate që janë kancerogjene ose mutagjene ose me efekte negative për sistemin riprodhues, endokrin, imunitar apo nervor	MMPAU	MSh, universitetet, OJQ, IShP
14. Mërkuri dhe kimikate të tjera që paraqesin shqetësim global; kimikate të përdorur apo të prodhuar në sasi të mëdha;	MMPAU	MSh, METE, IShP

¹ Ose institucionet përkatëse që mund të krijohen për menaxhimin e kimikateve bazuar në Ligjin 9108, dt 17.7.2003 “Për preparatet dhe substancat kimike”

Fusha e punës	Aktorët kryesorë	Agjenci/ aktorë të tjerë
kimikatat që i nënshtrohen një gamë të gjerë përdorimesh të shpërhapur, si dhe kimikate problematike në nivel kombëtar		
15. Vlerësimi, menaxhim dhe komunikim i riskut	MSh MMPAU	AMP, IShP, RNSh(Rregulloret Ndërkombëtare të Shëndetit), Media, OJQ
16. Menaxhimi i mbetjeve (dhe minimizimi i tyre)	MMPAU	MPPT, AMP, QRM, sektori privat
17. Formulimi i masave për parandalimin dhe përgjigjen që të ulen impakti mjedisor dhe shëndetsor për urgjencat e kimikateve.	MSh MMPAU	IShP – RNSh, AMP, Kryqi i Kuq, QOKEC (Qendra Operacionale Kombëtare e Emergjencave Civile)
18. Kërkim, monitorim dhe të dhëna	MMPAU	ISUV, AMP, IShP, MSh, Institucione të tjera, universitete, dogana
19. Prodhimi i të dhënave dhe disponueshmëria e të dhënave për riskun	Zyra e kimikateve Error! Bookmark not defined.	Industria, AMP, ARM, MSh
20. Promovimi i pjesëmarrjes së industrisë dhe përgjegjësitë	Dhoma e tregtisë	METE, AIDA (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve), METE
21. Menaxhimi dhe shpërndarja e informacionit	Zyra e kimikateve Error! Bookmark not defined.	DPD, INSTAT, ministritë e linjës
22. Cikli jetësor	Zyra e kimikateve Error! Bookmark not defined.	MSh, MMPAU, METE, MBUMK, Dogana, MPPT, Dhoma e Tregtisë, Shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit.
23. Vendosja e regjistrave kombëtarë të lëshimit dhe të transferimit të ndotjeve	MMPAU	AMP, Inspektoriati mjedisor, ARM, Industria,
24. Edukimi dhe trajnimi (Ndërgjegjësimi publik)	IShP- Departamenti i Promovimit	MMPAU, OJQ, media, Fakulteti i Mjekësisë- Departamenti i Shëndetit Publik
25. Pjesëmarrja e palëve të interesuara	Komitete Ndër-sektorial	Ministritë e linjës, OJQ, universitetet, etj.
26. Zbatimi i programeve kombëtare të integruar për mirë-menaxhimin e kimikateve në nivel kombëtar në formë fleksibël	Zyra e kimikateve	Ministritë e linjës, PNUD, OBSH, OSBE
27. Marrëveshjet Ndërkombëtare	MMPAU	MPJ, Ministritë e linjës
28. Konsideratat sociale dhe ekonomike	Ministria e Financave	Ministritë e linjës, sektori privat (industria)
29. Aspekte ligjore, politike dhe institucionale	MMPAU	Zyra e kimikateve, projektet e përafrimit të legjislacionit të BE
30. Përgjegjësitë dhe kompensimi	Inspektoriati mjedisor	AMP, MF, MMPAU, MSh, MBUMK, MPÇSSHb
31. Inventari dhe monitorimi i arritjeve (Zhvillimi i indikatorëve të objektivave për efektet e kimikateve në shëndetin e njeriut dhe mjedisor)	MSh	MMPAU, IShP, AMP
32. Zonat e mbrojtura	MMPAU	AMP, ARM, pushteti vendor
33. Parandalimi i trafikimeve kontrabandë	Doganat	Inspektoratet e Doganave

Fusha e punës	Aktorët kryesorë	Agjenci/ aktorë të tjerë
të mallrave të rrezikshme dhe toksike		
34. Tregtia dhe mjedisi	METE	MMPAU, MBUMK, MSh, Inspektoratet, doganat
35. Pjesmarrja e, organizatave jo-qeveritare të shoqërisë civile me interes publik	MMPAU, Zyra e kimikateve	Komiteti Ndër-sektorial i menaxhimit të kimikateve, OJQ-të, shoqatat e konsumatorit
36. Ndërtimi i kapaciteteve për të mbështetur veprimet kombëtare	MMPAU	MSh, AMP, ISHP, universitetet, OJQ, grupet e konsumatorit, institute të tjera

Shtojca 4: Shpjegues i shkurttimeve

ACREDIA	Agjencia Italiane për Akreditim
ADR	Marrëveshja Europiane për Transport Rrugor Ndërkombëtar të Materialeve të Rrezikshme
ADSh	Administrata Doganore Shqiptare
AIC	Qendra e Informacionit të Aarhus
AIDA	Agjencia për Zhvillim Industrial
AK	Autoritet Kompetent
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKShE	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve
AKTI	Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AMP	Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve
AOAC	Shoqata Amerikane e Kimistëve Analistë Zyrtarë (Association of Official Analytical Chemists)
APAAL	Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë
ARM	Agjencitë Rajonale të Mjedisit
BE	Bashkimi European
CEZ	Kompani për shpërndarjen e energjisë elektrike
CFC	Klorfluorkarbonet
CLP	Direktiva e PE dhe KE 1272/2008 për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe preparateve
CLRTAP	Konventa mbi Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët
CMEP	Planifikimi i emergjencave civile-ushtarake (Civil-Military Emergency Planning)
COMAH	Kontrolli i Rreziqeve nga Aksidentet Madhore (Control of Major Accident Hazards)
CP/RAC	Qendra Rajonale e Aktiviteteve për Prodhim më të Pastër (Regional Activity Center for Cleaner Production)
CRM	Materiale Reference të Certifikuar
DAP	Diamonium Fosfat
DDD	Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim

DEBASKO	Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj
DhTI	Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë
DMB	Departamenti për Mbrojtjen e Bimëve
DPA	Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPPI	Iniciativa për Parandalimin dhe Gatishmërinë për Fatkeqësitë (Disaster Preparedness and Prevention Initiative)
DPS	Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
DPSHTR	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
DRBUMK	Drejtoria Rajonale Bujqësise Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
DRShP	Drejtore të Rajonale të Shëndetit Parësor
DShKMB	Drejtoria e Shëndetit të Kafshëve dhe Mbrojtjes së Bimëve
DShP	Drejtore të Shëndetit Publik
EBRD	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
ECAT	Qendra Mjedisore për Administrim dhe Teknologji (Environmental Center for Administration and Technology)
EUROTOX	Shoqata Europiane e Toksikologëve
FAO	Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë
FShN	Fakulteti i Shkencave të Natyrës
GEF	Fondi Mjedisor Global
GHS	Sistemi Global i Harmonizuar për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e kimikateve
HCFC	Hidroklorfluorkarbone
HEC	Hydrocentral
IEUM	Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
IKM	Inspektoriati Kombëtar i Mjedisit
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës (International Labour Organization)
INPAEL	Projekti i Implementimit të Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOMC	Programi Ndër-organizativ për Mirë-menaxhimin e Kimikateve
IPA	Instrumentit për Asistencë Para-aksesimit në BE

IPCS	Programi Ndërkombëtar për Sigurinë e Kimikateve
IPPC	Kontrolli dhe Parandalimi i Integruar i Ndotjes (Integrated Pollution Prevention and Control)
IQT	Inspektoriati Qendror Teknik
IShP	Instituti i Shëndetit Publik
ISKSh	Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor
ISSh	Inspektoriati Sanitar Shtetëror
IST	Instituti i Studimit të Tokave
ISUV	Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Këshilli i Europës
KEMI	Agjencia Suedeze e Kimikateve
KESH	Korporata Elektro-energjitike Shqiptare
KKD	Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha
KKRrTSh	Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit Shqipëtar
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujit
KM	Këshilli i Ministrave
KMRr	Komisioni për Mbrojtjen nga Rrezatimi
KNB	Komisioni për Nomenklaturën e Barnave
KShRPMB	Kmisioni Shtetëror i Regjistrimit të PMB-ve
KSSh	Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë
LHO	Lëndët ozonholluese
LQU	Laboratori Qendror i Ushtrisë
MASh	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MB	Ministria e Brendshme
MBUMK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
MD	Ministria e Drejtësisë
METE	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës
MF	Ministria e Financave
MIE	Ministria e Integritit European
MKRTS	Ministria e Kulturës, Rinisë, Turizmit dhe Sporteve
MM	Ministria e Mbrojtjes
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave

MPÇSShB	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanceve të Barabarta
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPPT	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSDS	Fletët e të Dhënave të Sigurisë
MSh	Ministria e Shëndetësisë
NBO	Nevoja Biologjike për Oksigjen
NFIM	Ndërmarrja e Furnizimit të Industrisë së Minierave
NKM	Nomenklatura e Kombinuar e Mallrave
NKO	Nevoja Kimike për Oksigjen
NOQ	Ndotësit Organikë të Qëndrueshëm
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OECD	Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik
OJF	Organizatë Jo Fitimprurëse
OJQ	Organizatë Jo Qeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuar
ONQ	Organizatë Ndër-Qeveritare
OPRC	Konventa Ndërkombëtare mbi Ndotjen nga Nafta
OSBE	Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PCB	Bifenile të polikloruara
PEBPP	Përdorimi i Efektshëm i Burimeve dhe Prodhimit më të Pastër
PFK	Pikë Fokale Kombëtare
PKEC	Plani Kombëtar i Emergjencave Civile
PKM	Plani Kombëtar i Mbetjeve
PKPP	Programi Kombëtar për Prodhim më të Pastër
PKV	Plani Kombëtar i Veprimit
PKVShM	Plani Kombëtar i Veprimit të Shëndetit dhe Mjedisit
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PMB	Produkt për Mbrojtjen e Bimëve
PMSHz	Policia e Mbrojtjes dhe Shpëtimit nga Zjarret
PNUD	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

PRTR	Regjistri për Çlirimin dhe Transferimin e Ndotësve (Pollutant Release and Transfer Register)
PVC	Kloruri i polivinilit
QKEV	Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
QKKB	Qendra Kombëtare e Kontrollit të Barnave
QKL	Qendra Kombëtare e Licensimit
QRM	Qendra Rajonale e Mjedisit
QSP	Programi i Startimit të Shpejtë i SAICM (Quick Start Programme)
QSUT	Qendra Spitalore Universitare- Tiranë
QTT	Qendra të Transferimit të Teknologjisë
QTTB	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë
REACH	Rregullore e BE për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimet e Kimikateve
REC	Regional Environmental Center
RECP	Përdorimi Efikas i Burimeve dhe Prodhim më i Pastër (Resource Efficient and Cleaner Production)
REMPEC	Qendra Rajonale e Emergjencave të Ndotjeve Detare
RIShM	Reparti i Inspektimit dhe Shpëtim Miniera
RNSh 2005	Rregulloret Ndërkombëtare të Shëndetit 2005
RSh	Republika e Shqipërisë
SAICM	Qasja Ndërkombëtare Strategjike për Menaxhimin e Kimikateve (Strategic Approach to International Chemicals Management)
SELEA	Projekti për Forcimin dhe Zbatimin e Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri
ShGjSh	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
SIPTI	Sektori për Informacionin Publik dhe Teknologjinë e Informacionit
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SSh	Standard Shqiptar
UBT	Universiteti Bujqësor i Tiranës
UNDAC	Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Vlerësimin dhe Koordinimin e Fatkeqësive (United Nations Disaster Assessment and Coordination)
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuar për Zhvillim (United Nations Development Programme)
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Europën

UNEP	Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara (United Nations Environment Programme)
UNICEF	Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara (United Nations Children's Fund)
UNIDO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (United Nations Industry Development Organization)
UPAF	Uzina e Prodhimeve Azotike, Fier
UPT	Universiteti Politeknik i Tiranës
UT	Universiteti i Tiranës
WHO	Organizata Botërore e Shëndetit (World Health Organization)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësim i Ndikimit në Mjedis